

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN



VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKITË  
TIRANË, DURRËS, KRUIË, LEZHË DHE SHKODËR  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË TYRE


PROGRAMI "MBËSHTETJA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE NË SHQIPËRI"



Empowered lives.  
Resilient nations.

VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
**ROME DHE EGJIPTIANE**  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE  
TË JETESËS SË TYRE

BASHKIA TIRANË .....	3
BASHKIA DURRËS .....	26
BASHKIA KRUJË .....	49
BASHKIA LEZHË .....	73
BASHKIA SHKODËR .....	94



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

PROGRAMI “MBËSHTETJA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE NË SHQIPËRI”

VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
**ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKINË TIRANË**  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË TYRE

---

RAPORTI FINAL  
Janar 2017



BASHKIA TIRANË



## PËRMBAJTJA

FALËNDERIME	5
LISTA E SHKURTIMEVE	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
HYRJE	9
KAPITULLI 1: RISHIKIMI I KONTEKSTIT LIGJOR KUNDREJT TË DREJTËS PËR STREHIM TË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE	11
1.1 Situata e përgjithshme e nevojave për strehim të Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë e Tiranës	
1.2 Treguesit e përmirësimit të kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Tiranës	
KAPITULLI 2: METHODOLOGJIA E KËRKIMIT	14
2.1 Qëllimi, synimi dhe objektivat	
2.2 Karakteristikat e kampionit	
2.3 Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave	
2.4 Parimet e analizës	
A. Proçesi i përmirësimit të kushteve ekzistuese të jetesës në strukturat rezidenciale	
B. Përdorimi i fondit të lirë ekzistues të strukturave rezidenciale (nëpërmjet blerjes ose proçesit të punësimit)	
C. Ndërtimi i strukturave të reja dhe infrastrukturës për qëllim të strehimit social	
KAPITULLI 3: ANALIZA PËRSHKRUESE DHE E DETAJUAR E KUSHTEVE TË STREHIMIT DHE JETESËS SË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE (GJETJET E STUDIMIT)	20
3.1 Situata e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	
3.2 Situata ekonomike dhe sociale e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	
3.3 Territori dhe infrastruktura e vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane	
3.4 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 3	
KAPITULLI 4: ALTERNATIVA TË POLITIKAVE PUBLIKE	32
4.1 Ndërhyrje dhe plane të qeverisë vendore	
4.2 Sugjerime të politikave publike për të zgjidhur çështjen e strehimit në Bashki	
4.3 Vlerësimi i kostove të ndërhyrjes	
4.4 Plan veprimi për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	
4.5 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 4	
KONKLuzionet finale	42
BIBLIOGRAFIA	43
SHTOJCË: HARTA E VENDBANIMEVE	44

### Raport

*“Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Tiranë, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të tyre”*

Ky dokument është përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Urban në konsultim të ngushtë me përfaqësues të Bashkive dhe shoqërisë civile, si dhe ekspertëve të organizatave lokale dhe të fushës së strehimit social.

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit është ofruar nga Qendra Kombëtare Shqiptare për Studime Sociale (NCSS) dhe WeissGerber & Partners (W&P) në kuadër të Projektit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (UNSSIA), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), apo të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Tiranë, Janar 2017

**Foto e kopertinës:** Pikturë nga Rudina Proda

## Lista e tabelave dhe figurave

Tabela 1: Karakteristikat e kampionit	15
Tabela 2: Numri i familjeve të Pastreha në Bashkinë Tiranë të ndara sipas etnicitetit kulturor, 2016	21
Tabela 3: Situata e familjeve të pastreha Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Tiranë	21
Tabela 4: Vendbanimet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Tiranë, 2016	22
Tabela 5: Numri i intervistave ballë për ballë në Bashkinë Tiranë	24
Tabela 5.1: Intervistat në secilin vendbanim Rom dhe Egjiptian të Bashkisë Tiranë, 2016	24
Tabela 6: Familjet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane sipas situatës së tyre të strehimit	24
Table 7: Akses ndaj ujit, kanalizimeve dhe rrjeteve të furnizimit me energji të komunitetit R/E në Bashkinë Tiranë	25
Table 8: Treguesi i Përbërë i situatës socio-ekonomike dhe e strehimit e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	27
Tabela 9: Kërkesa për strehim e komunitetit Rom në Bashkinë Tiranë	29
Tabela 10: Kërkesa për strehim e komuniteti Egjiptian në Bashkinë Tiranë	30
Tabela 11: Numri i familjeve Rome dhe Egjiptiane të cilat kanë përfituar dhe programet përkatëse të strehimit social, 2011-2016	32
Tabela 12: Arsytet që pengojnë familjet Rome dhe Egjiptiane të përmbushin të drejtën e tyre për "Strehim"	33
Table 13: Buxheti i Bashkisë Tiranë i alokuar për strehimin social, 2010-2016	33
Tabela 14: Vlerësimi i programeve të Strehimit Social kundrejt kushteve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	35
<hr/>	
Figura 1: Numri i familjeve të pastreha përballë popullsisë totale, 2016	20
Figura 2: Numri i Familjeve Rome dhe Egjiptiane në nevojë strehimi, 2016	22
Figura 3: Komunitetet Rome dhe Egjiptiane, Situata e Strehimit në Bashkinë Tiranë, 2016	22
Figura 4: Familjet Rome dhe Egjiptiane të cilat jetojnë në banesa nën standartet e banimit, sipas vendbanimeve, 2016	23
Figura 5: Situata aktuale e strehimit e komuniteteve R/E	26
Figura 6: Llojet e banesave, komuniteti Rom	26
Figura 7: Llojet e banesave, komuniteti Egjiptian	26
Figura 8: Familjet Rome dhe Egjiptiane të cilat jetojnë në banesa nën çdo standart sipas të ardhurave të tyre, 2016	28
Figura 9: Nevojat e strehimit për komunitetin Rom	30
Figura 10: Nevojat e strehimit për komunitetin Egjiptian	31



## FALËNDERIME

Qendra Kombëtare Shqiptare e Studimeve Sociale (NCSS), dhe Weiss Gerber & Partners, produkt i punës së të cilëve është ky studim, falënderojnë grupin e ekspertëve të drejtuar nga Prof.Asoc.Dr. Arlinda Ymeraj dhe Znj. Ardiana Fortuzi.

Falënderime të veçanta për punonjësit e Bashkive Tiranë, Durrës, Lezhë, Krujë dhe Shkodër që, në cilësinë e institucioneve zbatues të programeve të strehimit, mbledhën dhe përpunuan informacionin në përputhje të plotë me kërkesat e këtij vlerësimi. I shprehim mirënjohje stafit të Ministrisë së Zhvillimit Urban, në veçanti Znj. Aida Seseri, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Urbane dhe Strehimit, për mbështetjen e profesionale në kryerjen e studimit si dhe stafin e UNDP për administrimin e kujdesshëm të procesit.

## LISTA E SHKURTIMEVE

Banesa me kosto të ulët	<b>BKU</b>
Bashkimi European	<b>BE</b>
Subvencionet për banesa	<b>SB</b>
Ministria e Zhvillimit Urban	<b>MZHU</b>
Enti Kombëtar i Strehimit	<b>EKS</b>
Dokumenti I Politikës së Përfshirjes Sociale	<b>DPPS</b>
Banesat sociale me qera	<b>BSQ</b>
Programi i Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri	<b>UNSSIA</b>

## PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i studimit të nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rom dhe Egjiptian në bashkinë Tiranë me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre, bazohet në një analizë të kujdesshme të nevojave për strehim dhe të të ardhurave, sugjeron disa politika të shoqëruara me kostot respektive, të përmbledhura në një plan veprimi. Si i tillë, ai udhëheq punën e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe bashkëpunimit të saj me institucionet e nivelit shtetëror, qeveritë vendore dhe organizatat komunitare për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Tiranës.

Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës konstatoi se:

- ▶ Familjet e pastreha në Tiranë përbëjnë 1,1 përqind të popullsisë, ndërsa Romët dhe Egjiptianët bashkarisht përbëjnë 13 përqind të të gjitha familjeve të pastreha, gjithsej 267 familje të pastreha nga të dy komunitetet.
- ▶ Edhe pse të gjithë Romët dhe Egjiptianët zotërojnë një hapësirë banimi, ajo është jashtë çdo standarti jetese.
- ▶ Komunitetet Rome dhe Egjiptiane janë të përqëndruara në 4 vendbanime, sipas Hartës të paraqitur në shtojcë.
- ▶ Të gjitha familjet Rome dhe Egjiptiane, përveç se të pastreha, janë edhe pa të ardhura, ndërsa pothuajse  $\frac{3}{4}$  e tyre, përpos mungesës së të ardhurave vuajnë nga përjashtimi i shumëfishhtë për shkak të situatës sociale të familjes.
- ▶ Edhe pse vendbanimet e tyre janë të pajisura me infrastrukturë dhe janë afër me qytetin e Tiranës si dhe shërbimet bazë të mirëqënies sociale, mungesa e higjienës bazë dhe kushteve të jetesës, i vendos ata në rrezik të lartë përjashtimi.
- ▶ Kushtet e strehimit të komunitetit Rom në bashkinë e Tiranës janë veçanërisht të këqija: asnjë prej tyre nuk jeton në banesa të standardizuara. Vetëm 4 përqind e familjeve janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve. Vetëm 61 përqind janë të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë edhe pse të gjitha banesat janë të pajisura me rrjet të furnizimit me ujë.
- ▶ Është e nevojshme të ndërtohen 267 banesa, përkatësisht për 200 familje Rome dhe 67 familje Egjiptiane, të cilat mund të realizohen në një hapësirë ndërtimi prej 15.808,4 m<sup>2</sup>, ndërsa bashkia nuk ka ofruar terren ndërtimi.
- ▶ Fatkeqësisht, komunitetet Rome dhe Egjiptiane nuk mund ta zgjidhin vetë situatën e tyre të strehimit për shkak të mungesës së të ardhurave. 90 përqind e atyre në nevojë kritike për strehim (jetojnë në banesa jashtë çdo standarti) nuk kanë asnjë të ardhur.
- ▶ Strehimi social mbetet politika më efektive për të zgjidhur nevojat e strehimit midis komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.
- ▶ Midis alternativave të ndryshme të politikave të sugjeruara në raport, Opsioni 1 (Programi: Qeveria vendore ndërton njësi strehimi) duket i realizueshëm. Kosto e tij në lekë është

558,194,640 (267 banesa) ndërsa Opsioni 2, Rikonstruksioni i banesave ekzistuese (13 banesa), kushton 12,025,000 lekë.

- Kosto e rehabilitimit të infrastrukturës është 50,539,454 lekë.

Raporti përbëhet nga katër kapituj përveç Hyrjes dhe Konkluzioneve Finale. Kapitulli i parë rishikon kontekstin ligjor në lidhje me të drejtën e strehimit të Romëve dhe Egjiptianëve. Kapitulli i dytë përshkruan metodologjinë e analizës. Kapitulli i tretë adreson gjetjet, ndërsa kapitulli i fundit shtjellon analizën e mëtejshme në lidhje me vlerësimin e kostove të alternativave të ndryshme të politikave, duke nxjerrë në pah argumentat për variantin më të përshtatshëm. Raporti mbyllet me konkluzionet finale. Një hartë dixhitale jep informacion të përditësuar rreth vendndodhjeve të Romëve dhe Egjiptianëve.



## HYRJA

Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë dhe po zbaton një reformë sociale të gjerë dhe komplekse, me qëllim fuqizimin e mekanizmave institucionalë për të siguruar se askush nuk do të përjashtohet nga gëzimi i të drejtave të tyre. Sipas Termave të Referencës, politika e përfshirjes sociale është çelësi i promovimit të qëllimeve më të gjera të politikave të rritjes dhe zhvillimit si dhe adresimit të shkaqeve të mungesave të shumëfishta dhe varfërisë. Adoptimi i Dokumentit Politik të Përfshirjes Sociale 2015-2020 i hap rrugën:

- Identifikimit dhe adresimit të sfidave me të cilat përballet monitorimi dhe vlerësimi i përfshirjes sociale duke nxjerrë në pah indikatorët e BE-së dhe kombëtar, prej të cilëve kërkohet të mbështesin reduktimin e varfërisë dhe zhvillimin e masave efektive që përmirësojnë mirëqënien;
- Promovimit të koherencës së politikës, vendosjes së prioriteteve dhe caktimit të përgjegjësive për kryerjen e monitorimit dhe matjes së përfshirjes sociale;
- Vlerësimin në mënyrë transparente të efektit të politikave që ndiqen dhe përpjekjeve të Qeverisë për të fuqizuar politikën që ndikojnë mbi përfshirjen sociale.

Në këtë kontekst, Programi i Mbështetjes së Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri (UNSSIA) kërkon të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve Shqiptare në nivel qendror dhe vendor për të avancuar me axhendën kombëtare të përfshirjes sociale me një pikëpamje të tillë e cila do të sigurojë konsistencë dhe koherencë nga politikën qeveritare dhe programuesit në arritjen e efektit maksimal të mundshëm për përfshirjen sociale të personave në risk; dhe rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe qytetarëve si mbajtësit e të drejtave në procesin kombëtar të përfshirjes sociale.

Brenda kontekstit të UNSSIA, vëmendje e veçantë i kushtohet veprimeve që mund të eliminojnë barrierat me të cilat Romët dhe Egjiptianët përballen për të aksesuar shërbimet, për të përmirësuar kushtet e jetesës nëpërmjet integritit dhe promovimit të dialogut interkulturor. Plani Kombëtar i Veprimit për Integritin e Romëve dhe Egjiptianëve përfaqëson një angazhim të ri i cili mbulon periudhën 2016-2020, dhe synon respektivisht këto dy komunitete. Në të reflektohet rritja e masave që po implementohen dhe gjithashtu planet për aktivitete të reja për promovimin e integritit të Romëve dhe Egjiptianëve, me një fond të angazhuar nga buxheti i Shtetit dhe hapësirat e financimit të identifikuar për periudhën 2016-2020 si dhe gjetja e mjeteve financiare nëpërmjet koordinimit me programe të tjera ndërkombëtare.

Romët dhe Egjiptianët përballen me barrierë direkte dhe indirekte në marrjen e shërbimeve publike, si rrjedhojë e pamundësisë për përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes, mungesës së informacionit ose të të kuptuarit të procedurave administrative, ashtu si dhe stigmatizimi dhe sjellja diskriminuese nga ana e shumicës së popullsisë. Përjashtimi afatgjatë ka ndikuar në kushtet e jetesës së Romëve dhe Egjiptianëve, trajtimi diskriminues nga shumica e popullsisë dhe marrëdhënia me institucionet qeveritare.

Midis të gjithë grupeve të pambrojtura, ekzistojnë të dhëna domethënëse të cilat tregojnë se Romët dhe Egjiptianët jetojnë në lagje të varfëra ku ka shumë pak ose aspak mundësi për të marrë shërbime publike. Studimet tregojnë se niveli i varfërisë midis komunitetit Rom është dy

herë më i lartë se shumica e popullsisë, ndërsa shkalla e papunësisë është tre herë më e lartë se mesatarja<sup>3</sup>. Tridhjetë e nëntë përqind e banesave ku jetojnë Romët dhe 21 përqind e atyre të banuara nga Egjiptianët nuk kanë akses ndaj ujit të pijshëm<sup>4</sup>. I njëjti burim informacioni tregon se 36 përqind e Romëve jetojnë në shtëpi të rrënuara ose lagje të varfëra (geto).

Si pjesë e strategjisë së përgjithshme për përfshirjen e grupeve më të cënueshme dhe në një linjë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU) po nis implementimin e Strategjisë për Strehimin Social (SSS) për periudhën 2015 -2025. Qëllimi i SSS është “ti ofrojë familjeve me të ardhura të ulta dhe mesatare të cilat nuk e përballojnë dot një shtëpi në tregun e lirë, dhe veçanërisht, familjeve me indikatorë vulnerabiliteti që rezultojnë në përjashtimin nga strehimi, zgjidhje për strehimin të cilat janë të disponueshme, të prekshme, të përballueshme dhe cilësore.”

Është bërë e njohur nga të gjitha palët e interesuara se ekzistojnë hendeqe kritike përsa i përket informacionit në lidhje me popullsinë Rome/Egjiptiane. Mungesa e regjistrimit në gjendjen civile, kryesisht e popullsisë Rome, ka pasur një ndikim vendimtar në “padukshmërinë” e “problemeve kritike” të popullsisë Rome. Megjithatë, shkaqet rrënjësore gjenden më thellë, në strukturën ligjore dhe institucionale të sistemit të shërbimeve publike të Shqipërisë. Veç kësaj, Reforma Territoriale dhe Administrative e implementuar së fundmi, ka ndryshuar ndarjen territoriale të bashkive.

Për të mundësuar integrimin dhe përfshirjen e popullsisë Rome/Egjiptiane, veçanërisht për të zgjidhur problemin e strehimit, është e nevojshme të kryhet një analizë e thellë e vendbanimeve jashtë standartit të strehimit të Romëve dhe Egjiptianëve në nivel bashkie dhe të vlerësohet nevoja për investime në mënyrë që të përmirësohen kushtet e strehimit dhe të jetesës së këtyre dy komuniteteve.

Raporti “ Studim mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkinë e Tiranës me qëllim vlerësimin e nevojës për investime për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së këtyre dy komuniteteve” sjell një analizë të thellë të vendbanimeve të Romëve dhe Egjiptianëve kundrejt standarteve të strehimit ashtu si dhe programeve të strehimit social. Raporti ofron të dhëna që lejojnë identifikimin e nevojave për investime në bashki, të ndara nga programet aktuale të strehimit social dhe do të udhëheqë punën e MZHU dhe bashkëpunimin e saj me institucionet e nivelit shtetëror, qeveritë vendore, dhe organizatat e komunitetit në përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Tiranë.

1.

## RISHIKIMI I KONTEKSTIT LIGJOR KUNDREJT TË DREJTËS PËR STREHIM TË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE

Strehimi është një e drejtë njerëzore themelore e ruajtur në marrëveshje dhe traktate ndërkombëtare. Kur individët kanë strehim të sigurt dhe të përballueshëm i cili është i përshtatshëm me rrethanat e tyre jetësore, nevojat e tjera mund të plotësohen, siç janë punësimi, edukimi dhe mundësitë e jetës. Disa grupe qytetarësh në Shqipëri janë në risk mohimi të kësaj të drejte njerëzore themelore për shkak të çështjeve të përballueshmërisë së strehimit. Midis tyre, Romët dhe Egjiptianët janë veçanërisht të riskuar për shkak të përjashtimit të shumëfishtë.

Komunitetet Rome konsiderohen si grupi minoritar më vulnerabël në Shqipëri, i cili përballlet më vlefshëm gjerësisht të përhapur, marginalizimit socio-ekonomik dhe diskriminimit e shpeshtë, veçanërisht në lidhje me marrjen e shërbimit të edukimit, mbrojtjen sociale, shëndetësinë, punësimin dhe strehimin e përshtatshëm. Romët nuk njihen publikisht si minoritet i veçantë dhe ata kanë statusin e minoritetit etno-gjuhësor. Pavarsisht nga kjo, Kushtetuta e Shqipërisë adreson të gjitha parimet themelore të të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Shqipëria është gjithashtu pjesë e traktateve kryesore ndërkombëtare për sa i përket të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve.

Shqipëria ka nënshkruar Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut (2.10.1996), Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (4.10.1991), Konventën Ndërkombëtare mbi Eliminimin e Çdo Forme Diskriminimi Racial (11.5.1994) dhe Kartën Sociale Europiane (e rishikuar) (14.11.02). Si e tillë, shtetet anëtare janë të detyruara të sigurojnë qasje ndaj strehimit të barabartë për çdo qytetar.

### 1.1 Situata e përgjithshme e nevojave për strehim të Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë e Tiranës

Duke qenë të detyruar të bëjnë një jetë rruge për vite me rradhë pa qasje ndaj shërbimeve të strehimit, shkollimit, kujdesit shëndetësor dhe punësimin, familjet Rome janë kyçur brenda rrethit vicioz të informalitetit, duke bërë të pamundur përfitimin nga shërbimet sociale standarte duke përfshirë dhe programet e strehimit social. Krahasuar me Romët, komuniteti Egjiptian duket më i integruar në mjedisin social.

Midis Romëve, varfëria dhe mungesa e strehimit të përshtatshëm janë më dominante. Për shembull, në një anketë rajonale të 2011 mbi situatën e strehimit të Romëve në Shqipëri, 8 përqind e Romëve që morrën pjesë në studim konfirmuan se përjetojnë humbje të shumëfishta të strehimit, në krahasim me më pak se 1 përqind të jo-Romëve, ndërsa 30 përqind e Romëve të anketuar nuk kishin përmirësim të ujit, kanalizimeve dhe furnizimit me energji elektrike në krahasim me 7 përqind e jo-Romëve. Rreth 45 përqind e Romëve pjesëmarrës në anketë jetonin në banesa të cilave iu mungonte të paktën një nga komoditetet e mëposhtme: kuzhinë e brendshme, tualet i brendshëm, dush ose vaskë e brendshme, dhe energji elektrike. Gjithashtu u raportua se mesatarisht, më shumë se dy persona jetonin në të njëjtën dhomë, çka është shumë më tepër se mesatarja e OECD-së prej 0.8 personash për dhomë<sup>3</sup>.

<sup>3</sup> Decade of Roma Inclusion Secretariat Foundation, Civil Society Monitoring Report on the Implementation of the National Roma Integration Strategy and Decade Action Plan in 2012 in Albania, përgatitur nga një grup autorësh (Bajrami, Ivia; Cabiri, Ylli; Hasantari, Adriatik; Kazanxhiu, Latif; Koci, Renart; Mustafaj, Enver; Myrteli, Laver; Nuredin, Albana; Pegini, Hafize; Rama, Lindita; Rushiti, Selvie; Xega, Gerta; Ziu, Dritan), publikuar në Maj 2013, [http://www.issuelab.org/click/download2/civil\\_society\\_monitoring\\_report\\_on\\_the\\_implementation\\_of\\_the\\_national\\_roma\\_integration\\_strategy\\_and\\_decade\\_action\\_plan\\_in\\_2012\\_in\\_albania](http://www.issuelab.org/click/download2/civil_society_monitoring_report_on_the_implementation_of_the_national_roma_integration_strategy_and_decade_action_plan_in_2012_in_albania), fq. 20.

<sup>4</sup> Të dhëna nga UNDP/WB/EC 2011 Socio-economic Survey quoted in the UNDP's Needs Assessment Study on Roma and Egyptian Communities in Albania, Shkurt 2012, <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/roma-needs-assessment-report/>, fq. 24.-25.

<sup>3</sup> [www.oecdbetterlifeindex.org/topics/housing/](http://www.oecdbetterlifeindex.org/topics/housing/)



Sipas "Studimit të Vlerësimit të Nevojave të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri", shumica e familjeve Rome jetojnë në shtëpi të vjetra (38.4 përqind) ose kasolle (20.8 përqind) dhe përbëhen nga një (66.3 përqind) ose më shumë familje bërthamë (27.5 përqind)<sup>4</sup>. Ata e konsiderojnë veten pronarë të vendbanimit të tyre (80.6 përqind), me vetëm rreth 10.8 përqind të cilët raportojnë se jetojnë me qera<sup>5</sup>. Shumë vendbanime Rome të kohëve të fundit janë kampe ku Romët jetojnë në tenda të improvizuara ose kasolle prane brigjeve të lumit. Madhësia e kampeve ndryshon sipas zonës.

Ndërkohë në bashkinë e Tiranës, familjet e pastreha në Tiranë përbejnë 1.1<sup>6</sup> përqind të popullsisë, ndërsa Romët dhe Egjiptianët së bashku përbëjnë 19 përqind të të gjitha familjeve të pastreha. Familjet e pastreha të Komunitetit Rom janë tre herë më shumë se ato të komunitetit Egjiptian. Të gjitha familjet Rome jetojnë në banesa nën standartet e banimit në kushte të dëshpëruara. Atyre i mungojnë kushtet bazë të higjienës dhe të jetesës, gjë e cila i vendos në risk të lartë përjashtimi.

Kushtet e strehimit të komunitetit Rom në bashkinë e Tiranës janë veçanërisht të këqija: asnjë prej tyre nuk jeton në banesa të standardizuara. Vetëm 4 përqind e familjeve janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve. Vetëm 61 përqind janë të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë edhe pse të gjitha banesat janë të pajisura me rrjet furnizimi të ujit.

Në Shqipëri, komuniteti Egjiptian është përgjithësisht më i integruar se ai Rom. Megjithatë, ata gjithashtu, përballen me një numër të ngjashëm kufizimesh ashtu si Romët. Anëtarët e komunitetit Egjiptian jetojnë kryesisht në shtëpi të vjetra (45.8 përqind) ose banesa në gjendje të mirë riparimi, por jo të reja. Ata gjithashtu raportojnë se janë pronarë të shtëpive (83.5 përqind), dhe vetëm një përqindje e vogël (7.1 përqind) thonë se e kanë marrë me qera strehimin e tyre. Vetëm 10.9 përqind e anëtarëve të komunitetit Egjiptian raportojnë se jetojnë në kasolle, një përqindje shumë më e ulët se midis Romëve<sup>7</sup>.

Megjithatë, në Bashkinë Tiranë situata e komunitetit Egjiptian duket më e keqe se përshkrimi i mësipërm. Ndonëse vetëm 67 familje Egjiptiane janë të pastreha, banesat e tyre janë jashtë çdo standarti bazë.

## 1.2 Treguesit e përmirësimit të kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Tiranës

Bashkia Tiranë e ka adresuar çështjen e strehimit që në vitin 2004. Strehimi me Projektin e Qëllimit Social<sup>8</sup> financohet nëpërmjet një marrëveshje huaje midis Qeverisë së Shqipërisë dhe Bankës së Zhvillimit të Këshillit të Europës miratuar në Nëntor 2007. Projekti adresonte mungesën e strehimit e cila ndikonte mbi familjet me të ardhura të ulta dhe të mesme në Shqipëri. Projekti pritej të krijonte zgjidhje për strehimin nëpërmjet ndërtimit të afërsisht 1,100 apartamenteve në bashki të ndryshme urbane të Shqipërisë. Qeveria e Shqipërisë propozoi të financoje Projektin me një hua Shtetërore prej € 15 milion nga BKE, e cila do të përfaqësonte deri në 70% të kostove të pranueshme të strehimit. Kostot e mbetura pritej të bashkë financoheshin nga Qeveria dhe bashkitë pjesëmarrëse, duke përfshirë Tiranën, si përfitues kryesor.

Si rezultat, u ndërtuan 400 apartamente për 1,400 banorë. Bashkia është pronare e banesave të reja sociale si dhe ofruesi i asistencës për strehim. Për më tepër, Bashkia Tiranë ka adoptuar gjerësisht programet e strehimit social si më poshtë (shih edhe të dhënat në tabelën 14):

- ▶ Banesat sociale me qera (BSQ)
- ▶ Subvencionet për banesa (SB)
- ▶ Banesat me kosto të ulët (BKU)

Që në 2013, 1.059 familje të pastreha kanë përfituar nga legjislacioni. 385 familje kanë përfituar nga BSQ në gusht 2015 dhe korrik 2016. Nga Maj 2016, çdo muaj, Këshilli Bashkiak ka aprovuar strehim për familjet e pastreha nëpërmjet SB, kryesisht për kategoritë sociale të përjashtuara, sipas specifikave të ligjit mbi Strehimin Social.

Bashkia e Tiranës planifikon gjithashtu të ndërtojë banesa sociale për 52 familje Rome të cilat jetojnë në Shkozë dhe 93 të tjera të cilat janë vendosur në Bregu i Lumit/Allias. Deri tani, 108 familje Rome dhe Egjiptiane kanë përfituar nga programet e Strehimit Social.

4 A Needs Assessment Study on Roma and Egyptian Communities in Albania, CESS mbështetur nga UNDP, 2012, fq.24

5 Njëlloj

6 Kapitulli 3 i këtij raporti siguron analizë të thelluar të informacionit.

7 Njëlloj

8 Dokumenti u përgatit nga Dr. Sasha Tsenkova për CEB në Mars 2006 me kërkesën e bashkisë Tiranë, mbështetur nga UNICEF Shqipëri.

## 2. METODOLOGJIA E KËRKIMIT

### 2.1 Qëllimi, synimi dhe objektivat e Studimit

Studimi “Mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkinë e Tiranës me qëllim vlerësimin e nevojës për investime për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së këtyre dy komuniteteve” synon të vlerësojë “nevojën për investime për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe të jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Tiranë” për të drejtuar punën e MZHU dhe partnerëve të saj në përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Tiranë”.

Duke qëndruar në një linjë me qëllimin e përgjithshëm, Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës ka arritur objektivat si më poshtë:

- ▶ Ofrimin e të dhënave të sakta mbi kushtet e strehimit dhe të jetesës (p.sh. kushtet e banimit, aksesit ndaj ujit, elektricitetit, dhe kanalizimeve) të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë e Tiranës.
- ▶ Vlerësimin e investimeve që duhet të bëhen në bashkinë e Tiranës me qëllim përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.
- ▶ Zhvillimin e Planit të Veprimit i cili do të drejtojë punën e MZHU dhe bashkëpunimit të saj me institucionet e nivelit shtetëror, qeveritë vendore, dhe organizatat komunitare në përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Tiranë.

Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës përdor informacion nga burime të ndryshme : (1) studime dhe raporte të mëparshme, (2) një anketë rastësore e fokusuar mbi familjet Rome dhe Egjiptiane në nevojë strehimi, (3) fokus grupe me palët e interesuara përkatëse dhe (4) verifikimi në terren i lagjes dhe infrastrukturës në bashkinë Tiranë.

Hartimi i këtij raporti u bazua në rishikimin e raporteve të ndryshme të përgatitura nga MZHU, PNUD dhe/ose organizata kërkimore të pavarura (shih Bibliografinë).

### 2.2. Karakteristikat e kampionit

Për shkak të qëllimit të mirëpërcaktuar të studimit, nuk ishte e mundur të identifikohesh një kampion. Në të kundërt, të gjitha komunitetet Rome dhe Egjiptiane të Bashkisë Tiranë u përfshinë në njësinë kërkimore. Madhësia e kampionit (sipas përcaktimit të shtjelluar mësipër) është e paraqitur më poshtë (Tabela 1):

Tabela 1: Karakteristikat e kampionit

Pyetësi	Madhësia e kampionit përbëhet nga:	
	Komuniteti Rom	Komuniteti Egjiptian
Nr.1: Biseda me fokus grupe	100 përqind	100 përqind
Nr.2: Ballë për ballë	86 përqind	76 përqind

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

### 2.3. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave

U konsiderua e nevojshme mbledhja e informacionit të detajuar mbi madhësinë dhe përbërjen e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Tiranë si dhe mbi nevojat e tyre të përgjithshme rreth strehimit.

Bisedat me Fokus Grupe u zhvilluan me dy grupe interesi, përkatësisht Departamenti i Zhvillimit Urban dhe Departamenti i Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Tiranës. Veç kësaj, përdorimi i bisedave me fokus grupe ndihmoi në mbledhjen e informacionit në lidhje me përpjekjet e qeverisë vendore për të siguruar strehim për komunitetet që përbëjnë objektivin themelor të këtij Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës.

Megjithatë, me qëllim zbulimin në thellësi të shqetësimeve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në lidhje me strehimin, intervistat ballë për ballë me familjet ofruan të dhëna të nevojshme.

Pyetësi i parë (pyetësor me pyetje të hapura) mundësoi mbledhjen e informacionit në lidhje me:

- ▶ Përbërjen e të pastrehëve, numrin, vendndodhjen e tyre, ndarjen sipas specifikave të nevojave të tyre për strehim ashtu si dhe sipas statusit të tyre socio-ekonomik.
- ▶ Kapacitetet e qeverisë vendore për të zgjidhur çështjen e strehimit, të pakten për komunitetet Rome dhe Egjiptiane.
- ▶ Sfidat e Strehimit në nivel vendor.

Pyetësi i dytë lehtësoi analizën në thellësi të banesave në secilin prej vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane, përkatësisht:

- ▶ Tipi i banesave, madhësia e tyre dhe kushtet infrastrukturore.
- ▶ Kushtet infrastrukturore të vendbanimeve dhe aksesit ndaj shërbimeve.

Verifikimi në terren i lagjes dhe infrastrukturës shqyrtoi:

- ▶ Vlerësimin e përgjithshëm të kushteve të vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane, përkatësisht kushtet fizike, qasja ndaj infrastrukturës (rrjeti i furnizimit me ujë, sistemi i ujit të mbetjeve, rrjeti elektrik), kushtet e higjenës (janë apo jo të furnizuar me ujë dhe kanalizime nga rrjeti i qytetit), marrja e shërbimeve të tjera publike, probleme të tjera në lidhje me këtë (probleme furnizuesi dhe konsumatori).
- ▶ Vlerësimin e kostove që nevojiten për përmirësimin e situatës ekzistente ose lidhja e

komuniteteve me shërbimet në nivel lagjeje si dhe në nivel lagjeje dhe shtëpie.

- Analizën e situatës së lagjeve specifike të cilat janë të prirura ndaj rreziqeve natyrore ose të tjera.
- Përpunimin e gjetjeve nëpërmjet verifikimit në terren, të cilat shërbejnë për përgatitjen dhe propozimin e 2-3 skenarëve për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe infrastrukturës.

## 2.4. Parimet e analizës

Në përputhje me kontekstin e Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, grupi i studimi përcaktoi disa kritere mbi të cilat është bazuar vlerësimi i kostos për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të infrastrukturës së vendbanimeve të komunitetit Rom dhe Egjiptian:

Së pari, informacioni i marrë nga administrata vendore dhe anketat e vendndodhjes, nëpërmjet pyetësorëve, u përdor për të përcaktuar një synim të qartë të projektit, si nga ana cilësore ashtu dhe ajo sasiore.

Së dyti, bazuar në strukturën e familjes, u krijua një dosje mbi nevojat për llojet dhe numrin e apartamenteve të nevojshme. Sipërfaqet e banimit dhe të ndërtimit u përcaktuan sipas Entit Kombëtar të Banesave dhe legjislacionit në fuqi.

Këto shërbyen si informacion kyç për të gjithë procesin e analizës financiare dhe vlerësimit të kostove për përmirësimin strukturor të banesave dhe atë infrastrukturor të zonave të banimit. Objektivi kryesor ishte hartimi i një metodologjie të qartë në mënyrë që të bëhëj i mundur vlerësimi dhe llogaritja e kostove të pritshme të proceseve të implementimit të projekteve.

E gjithë kjo procedurë, në fund, rezultoi në metodologjinë e propozimit të analizës financiare e cila iu prezantua administratës vendore dhe përfituesve, duke i ndihmuar ata të marrin vendime të realizueshme me qëllim përgatitjen e strategjive të zhvillimit dhe propozimin e zgjidhjeve të qëndrueshme.

Bazuar mbi të dhënat që rezultuan nga përpunimi i pyetësorëve, u zhvilluan dhe analizuan financiarisht skenarë të ndryshëm:

**A. Skenari i parë** – procesi i përmirësimit të kushteve ekzistuese të jetesës në strukturat rezidenciale

**B. Skenari i dytë** – përdorimi i fondit të lirë ekzistues të strukturave rezidenciale (nëpërmjet blerjes ose procesit të punësimit)

**C. Skenari i tretë** – ndërtimi i strukturave të reja dhe infrastrukturës për qëllim të strehimit social

## A. Proçesi i përmirësimit të kushteve ekzistuese të jetesës në strukturat rezidenciale

Nga pikëpamja e vlerësimit të kostos, metodologjia u bazua në dy kritere kryesore:

- Vlerësimi i situatës ekzistuese të strukturave të rezidencave, duke shqyrtuar kushtet e jetesës, kushtet e higjienës, dhomat e nevojshme ekzistuese sipas standarteve, kushtet teknike të strukturës (lidhur me sigurinë) – informacioni i marrë nga pyetësorët e anketave të vendndodhjeve.
- Vlerësimi i kostos për riparimin e këtyre elementeve dhe rehabilitimin e këtyre hapësirave, nëpërmjet procesit të rikonstruktimit, me qëllim që këto struktura të përmbushin kushtet e nevojshme të pranueshme, duke i kthyer në këtë mënyrë në zona të banueshme në përmbushje të standarteve dhe normave.

Faktori kryesor i marrë seriozisht në konsideratë ishte statusi i pronësisë së rezidencës (pyetja kryesore e pyetësorit). Ky element mund të rrisë direkt pjesën e investimit, dhe nga ana tjetër është element vendimtar në sigurimin e investimit afatgjatë dhe veçanërisht në sigurimin e qëllimit të investimit.

Metodologjia e përlogaritjes u bazua në metoda të thjeshta klasike, mbështetur në listën e çmimeve të referencës dhe një indeks i përafërt i procesit të ndërhyrjes rikonstruktive i cili u përfutua nga Studimi i eksperiencave ekzistuese të tregut dhe të eksperiencave të ngjashme.

Vlerësimi deri në çfarë mase llojet e secilës ndërhyrjeje janë të mundshme dhe të arsyeshme kundrejt aseteve dhe kushteve ekzistuese dhe eksperiencës së administratës vendore për t'u marrë me çështjet e strehimit të grupeve të synuara, ishte pritshmëria e përgjithshme e Studimit mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës.

Për më tepër, si skenar u krahasua me të tjerët me qëllim gjetjen se cili prej tyre është më i saktë për t'u përdorur dhe deri në ç'masë, në mënyrë që përdorimi i një ose më shumë skenarëve në të njëjtin qytet por në lagje të ndryshme ose në grupe ose organizma sociale të ndryshëm, të rezultojë i mundshëm.

Një tjetër aspekt pozitiv i këtij skenari është që mund të përdoret gjithashtu si një proces rigjenerimi urban dhe mund të aplikohet në disa zona të braktisura të qytetit të cilat mund të kenë potencial special për t'u integruar në strukturën dhe jetën e qytetit.

## B. Përdorimi i fondit të lirë ekzistues të strukturave rezidenciale (nëpërmjet blerjes ose qiramarrjes)

Nga pikëpamja e vlerësimit të kostos, metodologjia u bazua në dy drejtime kryesore: vlerësimi i qerasë dhe shitjeve të tregut vendas të pasurive të patundshme. Informacioni, i përfutur si nga administrata vendore ashtu dhe nga të dhënat e tregut, u plotësua me vendndodhjen e strukturave rezidenciale ekzistuese dhe gjendjen e tyre (si nga pikëpamja teknike ashtu edhe nga pikëpamja e pronësisë). Për të dyja këto, u krye një vlerësim i kushteve me qëllim sigurimin e përmbushjes së standarteve të kërkuara.

Edhe në rastet e të pastrehëve, faktorët kryesorë të konsideruar ishin sipërfaqja e përshtatshme (zona e banimit) në përputhje me strukturën e familjes, dhe kosto për metër katror (LEK/m<sup>2</sup>) e shitjes ose edhe e qerasë, ashtu si dhe vendndodhja e tyre. Bazuar në këto, disa analiza më të hollësishme u realizuan për të siguruar përpilimin e disa skenareve të ndryshme të investimit si edhe të kostos financiare të tyre.

### C. Ndërtimi i strukturave të reja dhe infrastrukturës për qëllim të strehimit social

Vlerësimi i kostos totale për këtë skenar u bazua në tre kosto të ndërlidhura:

- ▶ Kosto e truallit (vendndodhja e ngastrës)
- ▶ Kosto e ndërtimit të strukturës
- ▶ Kosto e infrastrukturës

Nga pikëpamja teknike ky skenar paraqet një vlerësim kostoje të thjeshtë i cili bazohet në tre faktorë të mirënjohur, nga pikëpamja ekonomike dhe financiare. Ajo çka nevojitet është një ide reale projekti dhe një vendndodhje për ngastrën e zgjedhur në mënyrë që të përlllogaritët saktësisht kosto e këtyre lloj ndërhyrjesh duke marrë në konsideratë të tre elementët.

Lidhur me përlllogaritjen e koston, metodologjia duhet të shqyrtojë përlllogaritjen e çdo faktori në mënyrë të pavarur dhe bashkarisht, ku rastet e ndryshme për gjetjen e vendndodhjes së ngastrës duhet të përfaqësohen nga administrata vendore, ashtu si dhe format e investimeve.

Zgjedhja e truallit është vendimtare në përlllogaritjen e koston totale. Në këtë aspekt, kosto e truallit, është një variabël shumë i rëndësishëm, i cili është i lidhur direkt me statusin e pronësisë, me qëllim që pronat shtetërore të truallit të mund të çojnë në kosto investimi më të ulta, - përveç efekteve anësore të tjera pozitive me të cilat veprime të tilla shoqërohen gjithmonë, siç është interesi direkt i qeverisë vendore, i cili në shumë raste është vendimtar për suksesin e projektit. Në këtë rast kosto e truallit konsiderohet si një variabël i rëndësishëm, veçanërisht në lidhje me statusin e pronësisë, me qëllim gjetjen e truallit në pronësi publike.

Një tjetër aspekt i analizuar është kosto e pronës në lidhje me koston e lidhjes me infrastrukturën publike. Në këtë mënyrë mund të rezultojnë skenarë më të qëndrueshëm të procesit të zgjedhjes së truallit, jo vetëm në lidhje me disponueshmërinë e autoriteteve vendore për të ofruar truallin, por gjithashtu ekonomikisht, për shkak të përmirësimit të këtyre vendndodhjeve në zona urbane me kushte më të mira rezidenciale dhe sociale.

Kosto e ndërtimit u përlllogarit bazuar në indekset dhe çmimet e referencës së Entit Kombëtar të Banesave sipas ligjeve. Bazuar në numrin e nevojave dhe strukturave të familjeve, propozohet një skenar mbi zonën e nevojshme të jetesës, e cila bashkë me ambientet komunitare dhe të shërbimit, rezultojë në zonën finale të ndërtimit. Kjo shërben si informacion bazë për vlerësimin e koston së ndërtimit të shtëpive sociale.

Rezultati i pritshëm është një shumë totale e përafërt e investimit të nevojshëm. Kosto e infrastrukturës duhet të shqyrtojë urbanizimin ose shkallën e urbanizimit të truallit. Kjo lidhet drejt për drejt me pozicionimin e zonës së propozuar në qytet, veçanërisht kundrejt shërbimeve publike dhe infrastrukturës, dhe mundësitë e aksesit dhe lidhjes me rrugët dhe sistemet e furnizimit dhe shkarkimit.

Të gjitha këto përdoren si variabla për të paraqitur një formulë të thjeshtë e cila do të ndihmojë autoritetet vendore të përlllogarisin dhe krijojnë një vizion më të mirë mbi koston totale të një procesi të tillë. Për më tepër, kjo do të ndihmojë për të pasur më shumë se një zgjidhje, dhe në këtë mënyrë do të ndihmojë në gjenerimin e fondeve dhe investimeve nga drejtime të ndryshme, element i cili është vendimtar në suksesin e procesit.

Rezultatet e secilit skenar do të analizohen në lidhje me kushtet lokale të çdo bashkie, ashtu si dhe sipas mundësive reale për investime të secilës qeveri vendore, bazuar në fondet e tyre ose mundësi të tjera. Për këtë, procesi i analizës bazohet mbi rezultatet që vijnë nga pyetësorët:

ato të dhëna të cilat kanë lidhje me të ardhurat e familjeve dhe ato të cilat kanë të bëjnë me investimin e kapaciteteve të bashkive mbi banesat sociale dhe projekte të tjera përkatëse.

Bazuar në këto, Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit vlerëson koston si edhe burimet financiare të mundshme për të përballuar investimin. Qasjet e ndryshme të propozuara mund të çojnë në prodhimin e më shumë projekteve me qëllim të mirëpërcaktuar dhe duke synuar projekte më të kontrollueshme, të cilat çojnë në implementimin e suksesshëm.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se bazuar në kushtet financiare lokale dhe numrin e familjeve në nevojë, si dhe mbi stokun e banesave, kriteret e nënvizuara më lart janë të rëndësishme dhe duhet të merren seriozisht në konsideratë, sepse, siç u shpjegua, rezultatet e tyre varen shumë nga variablat lokale.

Si mekanizëm i fundit, metodologjia e përlllogaritjes së koston synon të krijojë një formë llogaritjeje për secilin rast në mënyrë që të ndihmojë autoritetet vendore në procesin e vendimarrjes.

Bazuar në koston tashmë të përlllogaritura, kjo metodologji gjithashtu adresoi:

- ▶ Efektin e kategorizimit mbi vlerësimin financiar të projekteve;
- ▶ Koston e huave për përfituesit;
- ▶ Analiza kosto-përfitim, kosto e projektit, norma e interesit, norma e brendshme e kthimit dhe koha e pagesës, metodat e vlerësimit, etj.
- ▶ Burimet e kapitalit të mbledhur si dhe forma të tjera që rezultojnë në kapital.

Si e tillë, kjo metodologji, së pari paraqet më shumë se një mundësi reale dhe financiare për zgjidhje të qëndrueshme, dhe së dyti, hap mundësinë e përlllogaritjes dhe vlerësimit midis opsioneve të ndryshme e cila do të bazohet direkt mbi kapitalin dhe kushtet financiare të kapaciteteve lokale. Në këtë mënyrë shtron bazat për aplikimin e projekteve dhe zgjidhjeve origjinale, duke fuqizuar edhe mundësitë e bashkëpunimit publik dhe privat, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme afatgjata.

## ANALIZA PËRSHKRUERE DHE E DETAJUAR E KUSHTEVE TË STREHIMIT DHE JETESËS SË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE (GJETJET E STUDIMIT)

Kapitulli 3 adreson kërkesën për strehim të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane sipas tre kriterëve të vlerësimit, respektivisht:

**Kriteri 1:** Situata e strehimit të familjeve

**Kriteri 2:** Kushtet socio-ekonomike të familjeve


**Kriteri 3:** Kushtet infrastrukturore të vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane

Të dhënat e mbledhura nga studimi janë përpunuar dhe analizuar në bazë të secilit kriter të theksuar mësipër. Në mënyrë të ngjashme, gjetjet kërkimore respektive janë identifikuar dhe formuluar sipas vlerësimit të kriterëve.

### 3.1. Situata e strehimit e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane

Familjet e pastreha në Tiranë përbëjnë 1,1 përqind të popullsisë, ndërsa Romët dhe Egjiptianët bashkarisht përbëjnë 13 përqind të të gjitha familjeve të pastreha. (figura 1 dhe tabela 2).

**Figura 1: Numri i familjeve të pastreha përballë popullsisë totale, 2016**



**Burimi:** Census, 2011 dhe Studimi, 2016

**Tabela 2: Numri i familjeve të Pastreha në Bashkinë Tiranë të ndara sipas etnicitetit kulturor, 2016**

	Familje	%
Të Pastrehë	1.550	100
Rom dhe Egjiptian të pastrehë	267	12,9

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

Siç tregojnë tabela 3 dhe figura 2, 75 përqind e familjeve të pastreha është e Komunitetit Rom ndërsa familjet e pastreha të komunitetit Egjiptian përbëjnë 25 përqind.

**Tabela 3: Situata e familjeve të pastreha Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Tiranë**

	Total	Roma	%	Egjiptian	%
<b>Familje në nevojë strehimi për shkak të:</b>	<b>267</b>	<b>200</b>	<b>100</b>	<b>67</b>	<b>100</b>
Nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	0	0	0	0	0
Kanë në pronësi hapësirë banimi nën standartet e banimit	267	200	75	67	25
Jetojnë në banesa nën standartet e banimit.	0	0	0	0	0

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës 2016


Megjithë ndryshimet e lehta në terma madhësie, komunitetet Rome dhe Egjiptiane jetojnë në kushte strehimi të dëshpëruara. (foto si më poshtë).



**Foto të vendbanimit Rom**

Duke krahasuar nevojën për strehim të dy komuniteteve të përjashtuara, vihet re se numri i familjeve të komunitetit Egjiptian është tre herë më i lartë se sa numri i atyre të komunitetit Rom (Figura 2). Megjithatë, familjet që jetojnë në banesa nën standartet e banimit përbëjnë kategorinë më të madhe të familjeve në nevojë në të dy komunitetet, respektivisht 77 përqind nga komuniteti Rom dhe 62 përqind nga komuniteti Egjiptian. (Figura 2).


**Figura 2: Numri i Familjeve Rome dhe Egjiptiane në nevojë strehimi, 2016**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

Duke krahasuar nevojën për strehim të të dy komuniteteve të përjashtuara, vihet re se numri i familjeve të komunitetit Rom është pothuajse 3 herë më i lartë se numri i familjeve të komunitetit Egjiptian (tabela 3). Megjithatë, familjet, shtëpitë e të cilëve janë nën standartet e strehimit, përbëjnë të vetmen kategori familjesh në nevojë strehimi në të dy komunitetet. (Figura 3).

**Figura 3: Komunitetet Rome dhe Egjiptiane, Situata e Strehimit në Bashkinë Tiranë, 2016**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës 2016

Komuniteti Rom është vendosur në katër zona, ndërsa komunitetet Egjiptiane janë përqëndruar në 4 vendbanime sipas informacionit të ofruar në Tabelën 4:

**Tabela 4: Vendbanimet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Tiranë, 2016**

Vendbanime	Familje Rome	Familje Egjiptiane
Nj. Ad. nr 1/Rr."Ish Fonderia MEK " ( Shkozë)	52 familje	
Njs. Ad. Nr. 5/Rr. Gjergj Ligisi pranë Kombinatit "Josif Pashko" – Zogu i Zi dhe Bregu i Lumit pranë Fabrikës së Tullave Nr3.	21 familje	44 familje
Nj. Ad. Nr. 11 / Rr. "Irfan Tomini"/Selitë e Vogël	34 familje	23 familje
Nj. Ad. Nr 4 /Rr. Njazi Meka dhe Bregu i Lumit – Allias	93 familje	
<b>Total</b>	<b>200 familje</b>	<b>67 familje</b>


**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës 2016

Harta 1 (aneksi A) tregon vendndodhjen e vendbanimeve.

Pothuajse 47 përqind e familjeve në nevojë të komunitetit Rom janë të vendosura në Allias (Bregu i lumit), 3 km në Veri të qytetit të Tiranës. Kjo zonë përbëhet nga shtëpi individuale 1-4 katëshe, komuniteti Rom është i vendosur përgjatë shtratit të lumit të Tiranës. Pjesa tjetër, 53 përqind është vendosur në tre zona të tjera. Pothuajse 66 përqind e komunitetit Egjiptian janë vendosur në afërsi të lagjes së Laprakës, 5.5 km në Perëndim të qytetit të Tiranës. Kjo zonë përbëhet nga shtëpi individuale 1-4 katëshe. Pjesa tjetër, 34 përqind, janë vendosur përgjatë rrugës "Irfan Tomini". Për sa i përket rrugëve dhe rrjetit inxhinierik, infrastruktura ekzistuese është e cilësisë së mirë .

Figura 4 tregon të gjitha familjet në nevojë strehimi sipas vendbanimeve të tyre. Figura 4 paraqit vetëm ato që banojnë në banesa jashtë çdo standarti meqë familjet e pastreha në Tiranë përballen vetëm me problemin e mungesës së strehimit të përshtatshëm sipas standarteve.

**Figura 4: Familjet Rome dhe Egjiptiane të cilat jetojnë në banesa nën standartet e banimit, sipas vendbanimeve, 2016**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016



**Foto nga vendbanimet Egjiptiane**

Vlerësimi më në thellësi i kushteve të strehimit të vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Tiranë bazohet në informacionin e marrë nga pyetësi 2 (pjesët 5A, 5B, 5C, dhe 5D) si dhe nga vizitat në terren që ju bënë secilit komunitet. Për të identifikuar kërkesën për strehim në secilin komunitet, u kryen intervista ballë për ballë me 83.5 përqind të familjeve, siç tregohet në tabelën 5.

**Tabela 5: Numri i intervistave ballë për ballë në Bashkinë Tiranë**

	Banorë	Familje
Popullsi Rome & Egjiptiane	1.068	267
Popullsi e intervistuar Rome & Egjiptiane	892	223
Në përqindje	83.5	83.5

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

**Tabela 5.1: Intervistat në secilin vendbanim Rom dhe Egjiptian të Bashkisë Tiranë, 2016**

Vendbanime	Familje Rome të intervistuar	Familje Egjiptiane të intervistuar
1. Nj. Ad. nr 1/ Rr. "Ish Fonderia MEK" ( Shkozë)	58 familje	2 familje
2. Njs. Ad. Nr. 5 / Rr. Gjergj Ligisi pranë Kombinatit "Josif Pashko" – Zogu i Zi dhe Bregu i Lumit pranë Fabrikës së Tullave Nr3.	33 familje	23 familje
3. Nj. Ad. Nr. 11 / Rr. "Irfan Tomini" / Selitë e Vogël	25 familje	Asnjë familje Egjiptiane
4. nj. Ad. Nr 4 / Rr. Njazi Meka dhe Bregu i Lumit – Allias	56 familje	26 familje
<b>Total</b>	<b>172 familje</b>	<b>51 familje</b>

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016


Vlerësimi i nevoja për strehim tregon se komunitetet Rome dhe Egjiptiane ndajnë shqetësime të përbashkëta: atyre i mungojnë kushtet e përshtatshme të strehimit sipas çdo standarti të ligjit. (Tabela 6).

**Tabela 6: Familjet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane sipas situatës së tyre të strehimit**

Lloji i kushteve të strehimit <sup>9</sup>	Nr	Në %
Jetojnë në tenda, barraka, magazina	199	89,2%
Jetojnë në garsoniera	1	0,4%
Jetojnë në apartamente 1+1	2	0,9%
Jetojnë në apartamente 2+1	1	0,4%
Jetojnë në apartamente 3+1 ose më shumë	0	0,0%
<b>Total</b>	<b>203</b>	<b>91%</b>

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

**Figura 5: Situata aktuale e strehimit e komuniteteve R/E**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

Siç mund të shihet nga tabela 6 dhe figura 5, pothuajse 90 përqind e familjeve jetojnë në tenda, barraka, magazina. Siç u vu re gjatë vizitave në terren pothuajse të gjitha "banesat" kishin probleme në lidhje me kushtet strukturore dhe Higjeno-Sanitare.

Për sa i përket aksesit ndaj rrjeteve të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe energjisë elektrike (tabela 7), pothuajse të gjitha familjet janë të lidhura me rrjetin e furnizimit të energjisë. Vetëm 4 përqind e familjeve ishin të lidhura me rrjetin e kanalizimeve, pjesa tjetër shkarkojnë në gropa septike dhe kryesisht direkt në lumë pasi "banesat" e tyre janë të vendosura përgjatë lumit. Për sa i përket furnizimit me ujë vetëm 61 përqind janë të lidhur edhe pse zonat janë të pajisura me rrjet.

**Tabela 7: Aksesi ndaj ujit, kanalizimeve dhe rrjeteve të furnizimit me energji të komunitetit R/E në Bashkinë Tiranë**


Përqindja e familjeve që kanë akses ndaj punëve inxhinierike	Vizita në terren
Rrjeti i furnizimit me Ujë	60.5%
Rrjeti i Kanalizimeve	4.0%
Rrjeti i furnizimit me Energji	99.5%

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

Për sa i përket llojit të vendbanimeve vetëm për komunitetin Rom (figura 6), studimi tregoi se 96 përqind e popullsisë Rome totale jetojnë në tenda, barraka dhe magazina, 3.2 përqind jetojnë në 1+1, 0.6 përqind jetojnë në 2+1. Kushtet e infrastrukturës në Tiranë janë optimale në të gjitha vendbanimet Rome, megjithatë pothuajse 96 përqind kanë probleme me kushtet e ndërtimit të banesave pasi jetojnë në barraka.

9 Shënim: Të dhënat për 20 familje mungojnë

**Figura 6: Llojet e banesave, komuniteti Rom**




**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

Për sa i përket infrastrukturës inxhinierike dhe kushteve Higjeno-Sanitare, të dhënat e studimit tregojnë se të gjitha familjet nuk i përmbushin standartet e kërkuara.

Për sa i përket llojit të vendbanimeve vetëm për komunitetin Egjiptian (figura 7), studimi tregoi se 92 përqind e popullsisë totale Egjiptiane jetojnë në tenda, barraka ose magazina, 2 përqind jetojnë në garsoniera, 4 përqind jetojnë në 1+1 dhe 2 përqind jetojnë në 2+1. Kushtet infrastrukturore në Tiranë janë optimale në të gjitha vendbanimet Egjiptiane, megjithatë 92 përqind kanë probleme me kushtet e ndërtimit të banesave të tyre pasi jetojnë në barraka.

**Figura 7: Llojet e strehimeve, komuniteti Egjiptian**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

Në lidhje me infrastrukturën inxhinierike dhe kushtet Higjiëno-Sanitare, asnjë nga familjet nuk i përmbush standartet e kërkuara.

Në përfundim, ekipi i vlerësimit njih se nevojat e familjeve Rome dhe Egjiptiane, banesat e të cilave, janë jashtë standarteve të banimit janë veçanërisht emergjente në të katra vendbanimet për shkak të mungesës së kushteve bazë për sa i përket standarteve infrastrukturore si dhe kushteve higjiëno-sanitare.

### 3.2. Situata Ekonomike dhe Sociale e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane

Në mënyrë që nevojat për Strehim Social të prioritizohen, situata e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane analizohet në bazë të një kombinimi treguesish të situatës socio ekonomike dhe kategorizimit të strehimit.

Për sa i përket situatës socio-ekonomike, përdoret klasifikimi i të ardhurave nga INSTAT. Sipas INSTAT, ka tre kategori bazë të ardhurash të cilat përdoren në vlerësimin e varfërisë, përkatësisht "Familje pa të ardhura", " Familje të ardhurat e të cilës janë më pak se 20,000 LEK në muaj" dhe "Familje të ardhurat e të cilës janë më pak se 30,000 LEK në muaj".

Grupi i kërkimit i shtoi secilës kategori nga tre nën kategori, në mënyrë që të pasqyronte më saktë profilin e përjashtimit socio-ekonomik në Bashkinë e Tiranës.

Për sa i përket situatës së strehimit, përkufizimi "I pa strehë" përdoret sipas përcaktimit të Ligjit Nr. 9232, datë 13.05.2004 "Mbi Programet Sociale të Strehimit në Zonën Urbane" duke përfshirë dhe rishikimet dhe ndryshimet e këtij ligji.

Siç mund të kuptohet nga informacioni i ofruar në tabelën 8, të gjitha familjet e pastreha vuajnë edhe mungesën e të ardhurave.

**Tabela 8: Treguesi i Përbërë i situatës socio-ekonomike dhe e strehimit e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane**


Kategorizimi i Strehimit	Jetojnë në banesa nën standartin e banimit	
	Rom	Egjiptian
<b>Kategorizimi socio-ekonomik</b>		
Familje pa të ardhura	18	60
Pa të ardhura + persona të sëmurë	6	3
Familje pa të ardhura, me një mbajtës grua	61	0
Familje pa të ardhura + fëmijë	115	4
<b>Total</b>	<b>200</b>	<b>67</b>

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

Figura 8 ilustron në një mënyrë shumë të qartë nevojën kritike për strehim të pothuajse 2/3 të familjeve të të dy komuniteteve, të cilat përpos jetesës në banesa jashtë çdo standarti, vuajnë dhe nga përjashtimi i shumëfishtë për shkak të mungesës së të ardhurave ashtu si dhe situata sociale kritike e familjes (shumë fëmijë, persona të sëmurë, gra të vetme etj).



**Figura 8: Familjet Rome dhe Egjiptiane të cilat jetojnë në banesa nën çdo standart sipas të ardhurave të tyre, 2016**



Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

### 3.3. Territori dhe infrastruktura e vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane

Për sa i përket territorit dhe infrastrukturës së vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane, pothuajse të gjitha familjet jetojnë në ndërtesa strukturat e të cilave janë të amortizuara, ndërsa ndërhyrjet për t'i përmirësuar ato janë të pamundura. Këto komunitete i ndryshojnë vendndodhjet e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Pjesa më e madhe jetojnë në tenda, barraka dhe magazina dhe janë të pambrojtur nga temperaturat ose reshjet. Banesat kryesisht kanë mungesë të elementeve bazë si çatitë, dyert, dritaret. Përveç kësaj, hapësira e banimit është larg normave të strehimit.

Për sa i përket "vendndodhjes së vendbanimeve", distanca nga shërbimet e mirëqënies sociale është përtej standarteve. Vendbanimet janë larg qendrave mjekësore, shkollave dhe kopshteve. Siguria është një tjetër shqetësim kritik. Vendbanimet janë afër lumenjve, gjë e cila i vë ata në rrezik të vazhdueshëm ndaj përmytjeve. Fëmijët në moshë shkollore janë në rrezik të lartë për shkak të vendndodhjes së pasigurt të vendbanimeve.

Vizitat në terren treguan se megjithëse këto vendbanime janë të pajisura me të gjithë infrastrukturën inxhinierike, pjesa më e madhe e familjeve nuk kanë akses ndaj saj.

Duke marrë në konsideratë përbërjen e familjeve ashtu si dhe kushtet ekzistuese të strehimit të popullsisë Rome në Bashkinë Tiranë, ekipi i vlerësimit prodhoi tabelën 8, e cila ofron informacion rreth kërkesës për strehim në bashkinë Tiranë. Në ndërtimin e tabelës 8, standartet ekzistuese të strehimit sipas legjislacionit aktual, gjithashtu janë marrë në konsideratë. Në ndërtimin e tabelës 8, informacioni nga intervistat ballë për ballë është përdorur për të vlerësuar kërkesën totale.

Siç treguan të dhënat e përpunuara nga pyetësi 2, banesat ekzistuese janë jashtë çdo standarti, për këtë arsye të gjitha familjet kanë nevojë për një shtëpi të përshtatshme sipas standarteve, me përjashtim të vetëm 8 familjeve nga 113, të cilat kanë në pronësi një hapësirë banimi në përputhje me legjislacionin shqiptar.


**Tabela 9: Kërkesa për strehim e komunitetit Rom në Bashkinë Tiranë**

Lloji i Banesës	Nevojat sipas studimit	Vlerësimi i nevojave
Nr. I familjeve që kanë nevojë për garsonierë	47	55
Zona totale e nevojshme për garsoniera (total m <sup>2</sup> )	1298,4	1.509,8
% e garsonierave	13%	13%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 1+1	13	15
Zona totale e nevojshme për apartamente 1+1 (total m <sup>2</sup> )	593,3	689,9
% e 1+1	6%	6%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 2+1	37	53
Zona totale e nevojshme për apartamente 2+1 (total m <sup>2</sup> )	2075,6	2.413,5
% e 2+1	20%	20%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 deri në 75,5 m <sup>2</sup>	33	38
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1 (total m <sup>2</sup> )	2453	2.852,3
% e 3+1	24%	24%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 më shumë se 75,5 m <sup>2</sup>	42	49
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1+ (total m <sup>2</sup> )	3853	4.480,2
% e 3+1+	38%	38%
<b>Numri Total i Familjeve</b>	<b>172</b>	<b>200</b>
<b>Zona totale e nevojshme për strehim m<sup>2</sup></b>	<b>10.273,3</b>	<b>11.945,7</b>

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

Siç tregon tabela 9, ka nevojë për 200 apartamente (100 përqind e numrit total të familjeve), me një hapësirë ndërtimi prej 11.945,7 m<sup>2</sup>, për të strehuar përkatësisht 55 familje me garsoniera (13% e hapësirës totale të ndërtimit) në 1.509,8 m<sup>2</sup> hapësirë ndërtimi; 15 familje me apartamente 1+1 (6% e hapësirës totale të ndërtimit) në 689,9 m<sup>2</sup> hapësirë ndërtimi; 53 familje me apartamente 2+1 (20% e hapësirës totale të ndërtimit) në 2.413,5 m<sup>2</sup> hapësirë ndërtimi; 38 familje me apartamente 3+1 (24% e hapësirës totale të ndërtimit) në 2.852,3 m<sup>2</sup> hapësirë ndërtimi dhe 49 familje me apartamente 4+ (38% e hapësirës totale të ndërtimit) në 4.480,2 m<sup>2</sup> hapësirë ndërtimi.

**Figura 9: Nevojat për strehim të komunitetit Rom**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016


Tabela 10 ofron të njëjtin informacion si tabela 9, por për komunitetin Egjiptian. Siç mund të shihet, 14 familje kanë nevojë për garsoniera (11 përqind e hapësirës totale të ndërtimit) në një hapësirë ndërtimi prej 410,3 m<sup>2</sup>; 9 familje kanë nevojë për apartamente 1+1 (11 përqind e hapësirës totale të ndërtimit) në një hapësirë ndërtimi prej 418,7 m<sup>2</sup>; 21 familje (31 përqind e hapësirës totale të ndërtimit) kanë nevojë për apartamente 2+1, të cilat mund të ofrohen në një hapësirë ndërtimi prej 1188,7 m<sup>2</sup>; 12 familje (23 përqind e hapësirës totale të ndërtimit) kanë nevojë për apartamente 3+1, të cilat mund të ofrohen në një hapësirë ndërtimi prej 892,7 m<sup>2</sup> dhe 11 familje (25 përqind e hapësirës totale të ndërtimit) kanë nevojë për apartamente 4+, të cilat mund të ofrohen në një hapësirë ndërtimi prej 925,5 m<sup>2</sup>. Në total, popullsia Egjiptiane në Tiranë ka nevojë për 67 apartamente të cilat mund të ofrohen në një hapësirë ndërtimi prej 3.862,7 m<sup>2</sup>.

**Tabela 10: Kërkesa për strehim e komuniteti Egjiptian në Bashkinë Tiranë**

Lloji i Banesës	Nevojat sipas studimit	Vlerësimi i nevojave
Nr. i familjeve që kanë nevojë për garsonierë	11	14
Zona totale e nevojshme për garsoniera (total m <sup>2</sup> )	312,3	410,3
% e garsonierave	11%	11%
Nr. i familjeve që kanë nevojë për apartamente 1+1	7	9
Zona totale e nevojshme për apartamente 1+1 (total m <sup>2</sup> )	318,7	418,7
% e 1+1	11%	11%
Nr. i familjeve që kanë nevojë për apartamente 2+1	16	21
Zona totale e nevojshme për apartamente 2+1 (total m <sup>2</sup> )	904,8	1.188,7
% e 2+1	31%	31%
Nr. i familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 deri në 75,5 m <sup>2</sup>	9	12
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1 (total m <sup>2</sup> )	679,5	892,7
% e 3+1	23%	23%
Nr. i familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 më shumë se 75,5 m <sup>2</sup>	8	11
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1+ (total m <sup>2</sup> )	725	925,5
% e 4+	25%	25%
<b>Numri total i familjeve</b>	<b>51</b>	<b>67</b>
<b>Zona totale e nevojshme për strehim</b>	<b>2.940,3</b>	<b>3.862,7</b>

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

**Figura 10: Nevojat për strehim të komunitetit Egjiptian**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

### 3.4 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 3

Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në bashkinë e Tiranës vuajnë nga përjashtimi i shumëfishtë socio-ekonomik, i cili manifestohet nëpërmjet varfërisë ekstreme në të cilën jetojnë. E drejta e tyre themelore për strehim iu është mohuar.

- ▶ Edhe pse të gjithë Romët dhe Egjiptianët zotërojnë një hapësirë banimi, ajo është jashtë çdo standarti jetese.
- ▶ Edhe pse vendbanimet e tyre janë të pajisura me infrastrukturë dhe janë afër me qytetin e Tiranës si dhe shërbimet bazë të mirëqënies sociale, mungesa e higjienës bazë dhe kushteve të jetesës, i vendos ata në rrezik të lartë përjashtimi.
- ▶ Kushtet e strehimit të komunitetit Rom në bashkinë e Tiranës janë veçanërisht të këqija: asnjë prej tyre nuk jeton në banesa të standardizuara. Vetëm 4 përqind e familjeve janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve. Vetëm 61 përqind janë të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë edhe pse të gjitha banesat janë të pajisura me rrjet të furnizimit me ujë.
- ▶ Duket e përshtatshme të arrihet në konkluzionin se ka nevojë banesash për 200 familje Rome dhe 67 familje Egjiptiane, të cilat mund të strehohen në një hapësirë ndërtimi prej 15.808,4 m<sup>2</sup>.
- ▶ Fatkeqësisht, komunitetet Rome dhe Egjiptiane nuk mund ta zgjidhin vetë situatën e tyre të strehimit për shkak të mungesës së të ardhurave. Asnjë prej tyre nuk ka të ardhura, ndërsa pothuajse ¾ e tyre, përpos mungesës së të ardhurave vuajnë nga përjashtimi i shumëfishtë për shkak të situatës sociale të familjes.
- ▶ Për këtë arsye, strehimi social mbetet politika e vetme efektive për të zgjidhur nevojat e strehimit midis komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.

## 4. ALTERNATIVA TË POLITIKAVE PUBLIKE

### 4.1. Ndërrhyrjet dhe planet e qeverisë vendore

Ligji Nr. 9232 për "Strehimin Social" u miratua për herë të parë në vitin 2004. Që prej asaj kohe, ligji është ndryshuar disa herë me qëllim rritjen e efektivitetit të tij duke lehtësuar procedurat e aplikimit si dhe rritjen e aksesit për personat e pastrehë ndaj tregut të banesave.

Bashkia Tiranë e ka adresuar çështjen e strehimit që në vitin 2004. Strehimi me Projektin e Qëllimit Social<sup>10</sup> financohet nëpërmjet një marrëveshje huaje midis Qeverisë së Shqipërisë dhe Bankës së Zhvillimit të Këshillit të Europës miratuar në Nëntor 2007. Projekti adresonte mungesën e strehimit e cila ndikonte mbi familjet me të ardhura të ulta dhe të mesme në Shqipëri. Projekti pritej të krijonte zgjidhje për strehimin nëpërmjet ndërtimit të afërsisht 1,100 apartamente në bashki të ndryshme urbane të Shqipërisë. Qeveria e Shqipërisë propozoi të financonte Projektin me një hua shtetërore prej € 15 milion nga BKE, e cila do të përfaqësonte deri në 70% të kostove të pranueshme të strehimit. Kostot e mbetura pritej të bashkë financoheshin nga Qeveria dhe bashkitë pjesëmarrëse, duke përfshirë Tiranën, si përfitues kryesor.

Si rezultat, u ndërtuan 400 apartamente për 1,400 banorë, bashkia është pronare e banesave të reja sociale si dhe ofruesi i asistencës për strehim. Për më tepër, Bashkia Tiranë ka adoptuar gjerësisht programet e strehimit social si më poshtë (Tabela 11):

- ▶ Banesat sociale me qera (BSQ)
- ▶ Subvencionet për banesa (SB)
- ▶ Banesat me kosto të ulët (BKU)

Që në 2013, 1.059 familje të pastreha kanë përfituar nga legjislacioni. 385 familje kanë përfituar nga BSQ në gusht 2015 dhe korrik 2016. Nga Maj 2016, çdo muaj, Këshilli Bashkiak ka aprovuar strehim për familjet e pastreha nëpërmjet SB, kryesisht për kategoritë sociale të përjashtuara, sipas specifikave të ligjit mbi Strehimin Social.

Bashkia e Tiranës planifikon gjithashtu të ndërtojë banesa sociale për 52 familje Rome të cilat jetojnë në Shkozë dhe 93 të tjera të cilat janë vendosur në Bregu i Lumit/Allias. Deri tani, familjet Rome dhe Egjiptiane të paraqitura në vazhdim, kanë përfituar sipas informacionit të ofruar në tabelën 11.

**Tabela 11: Numri i familjeve Rome dhe Egjiptiane të cilat kanë përfituar dhe programet përkatëse të strehimit social, 2011-2016**

Familjet	Rom	Egjiptian
BSQ	90	77
SB	18	6

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

Me gjithë përpjekjet e forta, ka ende një nevojë të dukshme për ndërhyrje, për këtë arsye një plan veprimi është i një rëndësie maksimale.

**Tabela 12: Arsyet që pengojnë familjet Rome dhe Egjiptiane të përmbushin të drejtën e tyre për "Strehim".**

	KUFIZIMET E KËRKESËS	KUFIZIMET E OFERTËS
TREGU I PËRGJITHSHËM I STREHIMIT	Situatë socio-ekonomike kritike e aplikuesve potencial	Probleme ligjore lidhur me të drejtën e pronës/truallit. Mungesa e apartamenteve të lira. Mungesa e tokës së lirë për ndërtim. Çmim i lartë i qerasë /blerjes.
SEGMENTI I TREGUT TË STREHIMIT TË ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE	Situatë socio-ekonomike kritike e aplikuesve potencial Vështirësi për të përmbushur obligimet kontraktuale. Punësimi informal. Regjistrim civil informal.	Mungesa e tokës së lirë për ndërtim. Çmim i lartë i qerasë /blerjes. Diskriminimi. Pronarët e banesave refuzojnë ti japin banesat me qera familjeve Rome dhe Egjiptiane.

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

Është e vështirë të ofrohen sugjerime bazuar në përlllogaritjet e buxhetit për shkak të mungesës së informacionit nga Bashkia e Tiranës. Tabela 13 ofron të dhëna vetëm mbi dy tregues, të cilët nuk ndihmojnë në analizën e çështjes.

**Tabela 13: Buxheti i Bashkisë Tiranë i alokuar për strehimin social, 2010-2016.**

Buxheti/vitet	2016	Në %
Total në 000/Lek	NA	
Të ardhurat vendore në 000/Lek	NA	
Të ardhurat vendore për strehimin social në 000/Lek	NA	
Buxheti total i alokuar për Strehimin Social në 000/Lek	40,000	
Transfertat e pakushtëzuara në 000/Lek	1,531,451	
Ngritje fondesh (burime të tjera, donacione, fonde të jashtme) në Euro	NA	

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016 dhe <http://open.data.al/en/lajme/lajm/id/1647/titull/Unconditional-and-specific-transfers-by-municipalities-2016>

<sup>10</sup> Excerpts from the feasibility study. The document was prepared by the Albanian authorities with technical assistance provided by Dr. Sasha Tsenkova for the CEB in March 2006. The document was then revised following CEB Appraisal mission in July 2006.

## 4.2 Sugjerime politikash publike për të zgjidhur Çështjen e Strehimit në Bashki

Duke ju referuar Ligjit Nr. 9232, programet e strehimit social janë “programe të cilat shërbejnë për të strehuar familjet dhe individët të cilët për shkak të situatës së tyre ekonomike dhe sociale nuk mund të përballojnë ofertën e tregut të lire ose kredinë”.

Qeveria ka krijuar tre programe të strehimit social: **banesa sociale me qera, banesat me kosto të ulët, dhe programin e pajisjes së truallit me infrastrukturë**. Për më tepër, qeveria ka krijuar ofrimin e subvencioneve të strehimit, subvencionimit të kredive, grantet e vogla, dhe grantet e menjëhershme të cilat synojnë grupe specifike (shih më poshtë për një përshkrim të secilit program). Përfituesit e programeve të strehimit social duhet të përmbushin një nga kriteret në vazhdim: ata nuk duhet të kenë një banesë në pronësi, duhet të kenë një banesë e cila është nën normat e banimit; ose duhet të jenë të pastrehë për shkak të katastrofave natyrore (Ligji 9232, Neni 4).

Zgjedhja e përfituesve bazohet në kushtet e tyre të jetesës si dhe rrethanave të tyre sociale dhe ekonomike. Prioriteti është vendosur mbi 15 grupe, duke përfshirë familjet me një prind kryefamiljar, familjet e gjera, të rriturit më të vjetër, personat e paaftë, çiftet e reja, familjet që kanë ndryshuar vendbanim, jetimët, emigrantët që kthehen, punonjësit e migruar nga qyteti në qytet, azilkërkuesit, oficerët e rënë në detyrë, viktimat e dhunës familjare, familjet Rome, familjet Egjiptiane, dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.

Për tu përzgjedhur në sistemin e pikëzimit, familja duhet të përmbushë dy kushte: Të ardhurat mujore nuk duhet të jenë më të larta se 100% e mesatares së zonës për strehim social dhe 120% për strehimin me kosto të ulët; Familjet nuk duhet të kenë në pronësi një banesë, ose të jetojnë në një shtëpi, përmasat e të cilës nuk janë më të mëdha se standartet minimale të vendosura nga ligji.

Për të vlerësuar programet e Strehimit Social të cilat mund të jenë efektive për Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Tiranë, u ndërtua tabela 14. Nga analiza e thellë e informacionit të dhënë në tabelën 14, gjasat e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane për të patur akses ndaj programeve të Strehimit Social duken të ulta.

**Tabela 14: Vlerësimi i programeve të Strehimit Social kundrejt kushteve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.**

Programet e Strehimit Social	Kriteret e përgjithshme	Familjet në nevojë strehimi		
		Nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	Kanë në pronësi hapësirë banimi nën standartin e banimit	Jetojnë në banesa nën standartin e banimit
	1. Nuk duhet të kenë në pronësi një shtëpi; 2. Duhet të kenë një vend banimi nën normat e strehimit; 3. Duhet të jenë të pastrehë për shkak të katastrofave natyrore			267 familje, të gjitha pa të ardhura.
BSQ Banesat Sociale me Qera	Qeveria vendore ndërton njësi strehimi, të cilat jepen me qera me çmime të lira nga kategoritë sociale.			Për familjet pa të ardhura, mund të aplikohet nëse “kushtet e qerasë” ndryshohen.
SS Subvencionimi i Strehimit	Autoritetet vendore mund të alokojnë subvencione strehimi për përfituesit e banesave sociale me qera. SS ≤ 50% e vlerës minimale të qerasë. (Vlera e qerasë – SS) ≤ 30% e të ardhurave të familjes.			Mund të aplikohet nëse “kushtet e qerasë” ndryshohen.
BKU Banesat me Kosto të Ulët	Njësit me kosto të ulët ndërtohen ose blihen me çdo fond për familjet, të ardhurat e të cilave janë ≤ 120 % e mesatares së të ardhurave të rrethit.			Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.
TPI Trualli i pajisur me infrastrukturë	Investime në infrastrukturën e truallit në prona shtetërore, nga qeveria vendore për qëllime sociale ose përfitim. Duhet të ketë truall të lirë.			Mund të aplokojnë nëse: Kosto e lejon “Qëllimi social” i përcaktuar. Territoret ekzistuese mund të përdoren. E lejojnë kushtet infrastrukturore dhe inxhinierike të territoreve ekzistuese.

Programet e Strehimit Social	Kriteret e përgjithshme	Familjet në nevojë strehimi		
		Nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	Kanë në pronësi hapësirë banimi nën standartin e banimit	Jetojnë në banesa nën standartin e banimit
SBQ Subvencionimi i Banesave me qera	Nëse qeraja e njësisë sociale të strehimit $\geq$ 25% të të ardhurave të familjes, familja përfiton subvencionim qeraje. SBQ = qeraja aktuale – qeraja e përballueshme.			Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.
SK Subvencionimi i Kredive	Përfituesit e banesave me kosto të ulët kanë të drejtë të marrin një kredi me terma të favorshëm nga një institucion financiar, i cili ka një kontratë me Ministrinë e Financave.			Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.
Grantet e vogla, dhe grantet e menjëhershme që synojnë grupe specifike (shih më poshtë për përshkrimin e secilit program)	Përfituesve të banesave me kosto të ulët i jepen grante të menjëhershme në rrethana të veçanta.			Nuk aplikohet

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

Ndërsa ndryshimi i kushteve të qerasë si dhe e “qëllimit social” kërkojnë akte ligjore, duket se shkalla e opsioneve është e ulët për zgjidhjen e nevojave të strehimit kundrejt komuniteteve Rome dhe Egjiptiane:

#### Opsion 1:

**Programi BSQ: Qeveria vendore ndërton njësi banimi.**

Hipotezat:

- ▶ Ka truall të lirë.
- ▶ Ka vullnet politik dhe mundësi financiare për të ofruar strehim pa pagesë.
- ▶ Risku i diskriminimit pozitiv neglizhohet.

Përfituesit sipas opsionit: 267 familje, vetëm ato që jetojnë në banesa jashtë çdo standarti.

#### Opsion 2:

**Programi PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në pronat shtetërore.**

Hipotezat:

- ▶ Ka truall të lirë/ prona shtetërore të lira/ objekte.
- ▶ Ka vullnet politik dhe mundësi financiare për të ofruar strehim pa pagesë.
- ▶ Risku i diskriminimit pozitiv neglizhohet.

Përfituesit sipas opsionit: E njëjta gjë si në Opsionin 1, 308 familje.

Nuk ka “truall të lirë” në të cilin ekziston vetëm nevoja e investimit në infrastrukturë. Mundësia e vetme për zgjidhje duket se është ajo e shtjelluar në Opsionin 1.

#### Opsion 3:

**Programi PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në vendbanimet ekzistuese Rome dhe Egjiptiane.**

Hipotezat:

- ▶ Mundësia e përdorimit efektiv i territoreve ekzistuese është e lartë.
- ▶ Kushtet infrastrukturore dhe inxhinierike të territoreve ekzistuese e lejojnë.

Përfituesit sipas opsionit: 10 familje. Ky është numri i familjeve që zotërojnë një hapësirë banimi (4 përqind e totalit të familjeve të intervistuar). Të gjithë të tjerët jetojnë në tenda ose barraka dhe e ndryshojnë vendndodhjen e tyre vazhdimisht.

#### Opsion 4:

**Një kombinim ndërmjet tre alternativave të mëparshme**

Përfituesit sipas opsionit: 267 familje, barazim me numrin total të familjeve në nevojë strehimi.

### 4.3. Një vlerësim i koston për ndërhyrje të ndryshme të bashkive

#### Opsioni 1:

**Programi BSQ: Qeveria vendore ndërton njësi banimi.**

Disa kriteret merren në konsideratë:

- ▶ Kosto mesatare e njësisë i referohet “**Udhëzimit nr.4 dt 30.4.2015 për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2015.**”
- ▶ Sipas **Entit Kombëtar të Banesave**, kosto mesatare e ndërtimit në Tiranë është 32.113 lek/m<sup>2</sup>.
- ▶ Kosto për rrjetin inxhinierik vlerësohet në 23 €/m<sup>2</sup>; 3197 lek/m<sup>2</sup> (10€ rrjeti elektrik, 5 € për IT, 8€ për furnizimin me ujë, kanalizime dhe rrjeti i pusetave).

Prandaj, vlerësimi i koston për ndërtimet e reja për komunitetin Rom (200 apartamente në 11.9945,7 m<sup>2</sup> hapësirë ndërtimi):

$$\text{Kosto e ndërtimit} = 11.945,7\text{m}^2 * 32.113\text{lek/m}^2 = \text{Lek } 383.612.264,1$$

$$\text{Rrjetet inxhinierike} = 11.945,7\text{m}^2 * 3.197\text{lek/m}^2 = \text{Lek } 38.190.402,9$$

$$\text{Kosto totale} = 383.612.264,1 \text{ lek} + 38.190.402,9 \text{ lek} = \text{Lek } 421.802.667$$

Vlerësimi i koston për ndërtimet e reja për komunitetin Egjiptian (67 apartamente në 3.862,7m<sup>2</sup> hapësirë ndërtimi):

$$\text{Kosto e ndërtimit} = 3.862,7\text{m}^2 * 32.113\text{lek/m}^2 = \text{Lek } 124.042.885,1$$

$$\text{Rrjetet inxhinierike} = 3.862,7\text{m}^2 * 3.197\text{lek/m}^2 = \text{Lek } 12.349.051,9$$

$$\text{Kosto totale} = 124.042.885,1 \text{ lek} + 12.349.051,9 \text{ lek} = \text{Lek } 136.391.973$$

**Opsioni 1: Kosto Totale për ndërtim të ri = Lek 558.194.640**

### Opsioni 2:

**Programi PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në pronat shtetërore.**

Ky opsion nuk është përpunuar më tej pasi nuk ka asnjë pronë shtetërore e lirë e cila mund të përdoret për këtë qëllim. Në kushtet e dhëna, ky program nuk mund të aplikohet.

### Opsioni 3:

**Program PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në vendbanimet ekzistuese Rome dhe Egjiptiane.**

Disa kriteret janë marrë në konsideratë:

- ▶ Udhëzimi i MZHU datë 03/08/2015 për sa i përket koston maksimale të rehabilitimit të infrastrukturës ekzistuese.
- ▶ Kosto e rehabilitimit nuk duhet të kalojë 650.000,00 lekë/banesë dhe ndërtimi i ri nuk duhet të tejkalojë 1.200.00,0 lekë/banesë (përfshirë TVSH).
- ▶ Vetëm familjet që zotërojnë një hapësirë banimi dhe kosto mesatare e rehabilitimit/ndërtimit të ri përlogaritet 925.000,0 lekë (650.000 + 1.200.00)/2, janë marrë në konsideratë

**Table 13: Përmbledhje e rezultateve të familjeve të intervistuar**

Nr. I familjeve që nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	11
Nr. I familjeve që zotërojnë hapësirë banimi nën kërkesat e zonës	8
Nr. I familjeve që banojnë nën standartet e miratuara	223
Nr. I familjeve që jetojnë në qendra komunitare	0

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

Siç mund të shihet nga tabela 15 më lart, 11 familje nga 223 (5%) të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane zotërojnë një hapësirë banimi, e cila është gjithsesi nën standartin e kërkuar të zonës.

Bazuar në kriteret e shtjelluara më sipër, numri i përfituesve potencial është 13 familje (5 përqind nga 267 familje).

$$\text{Kosto totale e rehabilitimit} = 13 \text{ familje} * 925.000,0 \text{ lek/familje} = \text{Lek } 12.025.000$$

**Opsioni 3: Kosto Totale për rehabilitim = Lek 12.025.000**

Ekipi nuk sugjeron këtë opsion pasi nuk e zgjidh problemin e strehimit për sa i përket standartit minimal të hapësirës së banimit sipas ligjeve Shqiptare, gjithashtu vetëm 5 përqind e familjeve do të përfitojnë nga kjo.

### Opsioni 4:

**Një kombinim ndërmjet tre alternativave të mëparshme**

Ky opsion nuk konsiderohet më tej pasi siç mund ta shohim nga opsioni i mëparshëm, i vetmi që mund ta zgjidhë në mënyrë permanente problemin e strehimit është opsioni nr. 1.

**Tabela 14: Përmbledhje e rezultateve të kostove të alternativave të politikave në krahasim me Buxhetin Bashkiak aktual**

Opsioni i Politikës	Kosto	Buxheti Bashkiak 2016	Në % në krahasim me buxhetin aktual
Opsioni 1(në 000)	Lekë 1.153.841	Lekë 2.819.356.	41 përqind
Opsioni 3(në 000)	Lekë 351.500	Lekë 2.819.356	12,5 përqind

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

#### 4.4 Plan veprimi për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane

	Objektivat/detyrat	Kohëzgjatja	Rezultate/Mjetet e verifikimit
<b>1.</b>	<b>Bashkia Durrës Strategjia e Strehimit për Romët dhe Egjiptianët</b>	<b>Qershor 2017</b>	<b>Strategjia e Strehimit për Romët dhe Egjiptianët miratohet nga Këshilli Bashkiak</b>
1.1	Diskutim dhe miratim i raportit të Vlerësimit	Dhjetor 2016	Raporti i Takimit
1.2	Analiza në thellësi i opsioneve të politikave	Janar 2017	Këshilli Bashkiak është në djeni të opsioneve të politikave.
1.3	Ri-vlerësim i nevojave për strehim	Shkurt 2017	Raporti i vlerësimit validohet nga Ekipi i Menaxhimit të Bashkisë
1.4	Ri-vlerësimi i furnizimit të strehimit.	Shkurt 2017	Raporti i vlerësimit validohet nga Ekipi i Menaxhimit të Bashkisë
1.5	Ri-vlerësimi i alternativave të politikës.	Mars 2017	Merret vendimi final mbi politikën më të mirë.
1.6	Përgatitja dhe miratimi i Strategjisë	Maj 2017	Strategjia miratohet nga Këshilli
1.7	Përgatitja e planit të implementimit	Qershor 2017	Plani i implementimit miratohet
<b>2.</b>	<b>Buxheti i Strategjisë së Strehimit për Romët dhe Egjiptianët</b>	<b>Tetor 2017</b>	<b>Bashkia ngre fonde të mjaftueshme për të përballuar implementimin e Strategjisë së Strehimit</b>
2.1	Rishikimi i buxhetit vendor	Qershor 2017	Miratohet plan buxheti i ri
2.2	Diskutim mbi strategjinë me palët e interesuara dhe donatorët	Qershor 2017	Vullneti i palëve të interesuara për të investuar konfirmohet
<b>3.</b>	<b>Rishikimi i legjislacionit</b>	<b>Qershor 2017</b>	<b>Legjislacioni rishikohet dhe miratohet</b>
3.1	Propozim për rishikim të legjislacionit mbi Strehimin Social sipas opsioneve të politikave të identifikuar	Qershor 2017	Ndryshime ndaj legjislacionit miratohen
<b>4.</b>	<b>Implementohet Strategjia e Strehimit</b>	<b>Dhjetor 2017</b>	<b>Plani i investimit për zgjidhjen e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane miratohet nga Këshilli Bashkiak</b>
4.1	Identifikimi i nevojave për ndërtim (analizë e detajuar)	Tetor 2017	Miratohet plani i investimit
4.2	Zgjidhja e problemeve ligjore midis zonave të ndërtimit të zgjedhura dhe/ose sugjeruara.	Nëntor 2017	Çdo problem ligjor është zgjidhur
4.3	Studim i realizueshmërisë së zonave të ndërtimit të zgjedhura dhe/ose sugjeruara	Nëntor 2017	Plani i investimit miratohet
4.4	Finalizimi i planit të investimit	Dhjetor 2017	Projekti i investimit miratohet nga ekipi i menaxhimit të bashkisë.

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2016

#### 4.5 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 4

Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Durrës kanë nevojë urgjente të zgjidhet çështja e strehimit të tyre. Megjithatë:

- ▶ Gjetjet sugjerojnë se Bashkia Tiranë me situatën aktuale të buxhetit, mund të përpiqet të zgjidhë pjesërisht çështjen e strehimit për Romët dhe Egjiptianët si dhe për pjesën tjetër të popullsisë. Megjithatë, nevojitet një analizë financiare e mëtejshme për shkak të mungesës së informacionit nga Sektori i Buxhetit.
- ▶ Pavarësisht se qeveria ka krijuar programe të strehimit social, shumica prej tyre nuk duken të përshtatshme për të zgjidhur nevojat e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane për shkak të kufizimeve të të ardhurave.
- ▶ Vetëm dy programe të strehimit social mund të merren në konsideratë, përkatësisht banesat me kosto të ulët, dhe programi i pajisjes së truallit me infrastrukturë, nëse merren në konsideratë disa ndryshime ligjore.
- ▶ Bazuar në përlogaritjet e kostove, Opsioni i Politikës 1 nuk mund të financohet nga Buxheti i Bashkisë, për këtë arye Bashkia Tiranë ka nevojë për mbështetje financiare ose nga buxheti qendror ose forma të tjera burimesh të jashtme. Edhe pse përlogaritja e kostove të opsionit të politikës 3 tregon se në terma absolute mund të financohet nga bashkia, kjo mund të mos jetë e mundur për shkak të shpenzimeve të tjera që bashkia duhet të kryejë.
- ▶ Nga ana tjetër, ka kosto të tjera indirekte të cilat mund të hasen për shkak të rreziqeve të lidhura me sicilin nga opsionet e politikave. Për më tepër, disa nga rreziqet mund të kenë implikime financiare, përkatësisht risku i diskriminimit pozitiv, risku i izolimit si dhe risku i tensioneve sociale midis ish-pronarëve të pronave dhe truallit.

## KONKLuzionet finale

- ▶ Në përgjithësi gjetjet sjellin një kuadër të qartë të sfidave me të cilat përballlet strehimi social në bashkinë Tiranë. Analiza tregon se kuadri ligjor aktual nuk është i mjaftueshëm për të zgjidhur problemet e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane. Gjetjet e kapitujve 3 dhe 4 sugjerojnë se adresimi i problemit të të pastrehëve Rom dhe Egjiptian në Tiranë kërkon ndërmarrjen e hapave të shumëfishtë njëkohësisht, për shembull, rishikimi i kuadrit ligjor, zhvendosja e vëmendjes së programeve të strehimit social dhe financimit në drejtim të të varfërve më të varfër, dhe fuqizimi i kapaciteteve fiskale të qeverive vendore.
- ▶ Raporti i vlerësimit ofron një kontribut të vlefshëm në plotësimin e disa hapësirave në të dhëna specifike duke rishikuar dhe vlerësuar provat ekzistuese mbi kushtet e strehimit dhe jetesës (p.sh., kushtet e banimit, aksesit ndaj ujit, elektricitetit dhe kanalizimeve) të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë e Tiranës.
- ▶ Për më tepër, raporti sjell një kontribut të vlefshëm në nivel politike. Plani i Veprimit, i zhvilluar në pikën 4.4 mund të përdoret si instrument udhëheqës për MZHU dhe bashkëpunimin e saj me institucionet e nivelit shtetëror, qeveritë vendore dhe organizatat komunitare për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Tiranë.
- ▶ Megjithatë, studimi ka një rëndësi të veçantë për Bashkinë e Tiranës. Në nivel qeverisje vendore, duke përllogaritur investimet që duhen kryer në bashkinë e Tiranës me qëllim përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, gjetjet dhe sugjerimet nuk do të kontribuojnë vetëm në implementimin e Planit të Veprimit, por gjithashtu në fuqizimin e kapaciteteve të administratës vendore kundrejt implementimit në tërësinë e saj të strategjisë së strehimit social në nivel vendor.

## Bibliografia


- A Needs Assessment Study on Roma and Egyptian Communities in Albania, CESS mbështetur nga UNDP, 2012
- Civil Society Monitoring Report, the Implementation of the National Roma Integration CORRUPTION RISK ASSESSMENT: PROVISION OF SOCIAL HOUSING IN
- ALBANIA, Dritan Shutina, May 2011
- Housing Policies and Practice for Roma in Albania, UNDP ALBANIA, SEPTEMBER 2013
- National Strategy for Development and Integration, 2014-2020.
- National Action Plan for the Integration of Roma and Egyptians in Albania, 2016-2020; Roma and Egyptian in Albania- Socio-demographic and economic profile, based on census 2011, January 2015.
- Strategy and Decade Action Plan in 2012, ALBANIA, 2013, HDPC
- Strategy for Social Housing, 2015-2025
- Social Inclusion Policy Document, 2015-2020



# SHTOJCË

## Harta e Vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Tiranë





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

PROGRAMI “MBËSHTETJA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE NË SHQIPËRI”

VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
**ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKINË DURRËS**  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË TYRE

---

RAPORTI FINAL  
Janar 2017





## PËRMBAJTJA

FALËNDERIME	5
LISTA E SHKURTIMEVE	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
HYRJE	9
KAPITULLI 1: RISHIKIMI I KONTEKSTIT LIGJOR KUNDREJT TË DREJTËS PËR STREHIM TË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE	11
1.1 Situata e përgjithshme e nevojave për strehim të Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë e Durrësit	
1.2 Politikat Publike të “Strehimit” të miratuara në Bashkinë e Durrësit	
1.3 Treguesit e përmirësimit të kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Durrës	
KAPITULLI 2: METODOLOGJIA E KËRKIMIT	15
2.1 Qëllimi, synimi dhe objektivat	
2.2 Karakteristikat e kampionit	
2.3 Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave	
2.4 Parimet e analizës	
A. Proçesi i përmirësimit të kushteve ekzistuese të jetesës në strukturat rezidenciale	
B. Përdorimi i fondit të lirë ekzistues të strukturave rezidenciale (nëpërmjet blerjes ose proçesit të punësimit)	
C. Ndërtimi i strukturave të reja dhe infrastrukturës për qëllim të strehimit social	
KAPITULLI 3: ANALIZA PËRSHKRUESE DHE E DETAJUAR E KUSHTEVE TË STREHIMIT DHE JETESËS SË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE (GJETJET E STUDIMIT)	21
3.1 Situata e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	
3.2 Situata ekonomike dhe sociale e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	
3.3 Territori dhe infrastruktura e vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane	
3.4 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 3	
KAPITULLI 4: ALTERNATIVA TË POLITIKAVE PUBLIKE	33
4.1 Ndërhyrje dhe plane të qeverisë vendore	
4.2 Sugjerime të politikave publike për të zgjidhur çështjen e strehimit në Bashki	
4.3 Vlerësimi i kostove të ndërhyrjes	
4.4 Plan veprimi për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	
4.5 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 4	
KONKLuzionet finale	42
BIBLIOGRAFIA	43
SHTOJCË: HARTA E VENDBANIMEVE	44

### Raport

*“Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Durrës, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të tyre”*

Ky dokument është përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Urban në konsultim të ngushtë me përfaqësues të Bashkive dhe shoqërisë civile, si dhe ekspertëve të organizatave lokale dhe të fushës së strehimit social.

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit është ofruar nga Qendra Kombëtare Shqiptare për Studime Sociale (NCSS) dhe WeissGerber & Partners (W&P) në kuadër të Projektit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (UNSSIA), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), apo të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Tiranë, Janar 2017

## Lista e tabelave dhe figurave

Tabela 1: Karakteristikat e kampionit	16
Tabela 2: Situata e familjeve të pastreha në Bashkinë Durrës, duke përfshirë komunitetet Rome dhe Egjiptiane	21
Tabela 3: Vendbanimet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Durrës, 2016	23
Tabela 4: Numri i intervistave ballë për ballë në Bashkinë Durrës	24
Tabela 4.1: Intervistat në secilin vendbanim Rom dhe Egjiptian të Bashkisë Durrës, 2016	24
Tabela 5: Familjet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane sipas situatës së tyre të strehimit	25
Tabela 6: Aksesi ndaj ujit, kanalizimeve dhe rrjeteve të furnizimit me energji të komunitetit R/E në Bashkinë Durrës	26
Table 7: Treguesi i Përbërë i situatës socio-ekonomike dhe e strehimit e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	28
Table 8: Kërkesa për strehim e komunitetit Rom në Bashkinë Durrës	30
Tabela 9: Kërkesa për strehim e komunitetit Egjiptian në Bashkinë Durrës	31
Tabela 10: Arsyet që pengojnë familjet Rome dhe Egjiptiane të përmbushin të drejtën e tyre për "Strehim"	33
Tabela 11: Buxheti i Bashkisë Durrës i alokuar për strehimin social, 2010-2016	34
Tabela 12: Vlerësimi i programeve të Strehimit Social kundrejt kushteve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.	35
.....	
Figura 1: Familjet në nevojë strehimi, 2016	22
Figura 2: Komunitetet Rome dhe Egjiptiane, Situata e Strehimit në Bashkinë Durrës, 2016	22
Figura 3: Vendbanimet Rome dhe Egjiptiane sipas llojeve të problemeve të strehimit, 2016	23
Figura 4: Situata aktuale e strehimit të komuniteteve R/E	25
Figura 5: Llojet e banesave, komuniteti Rom	26
Figura 6: Llojet e banesave, komuniteti Egjiptian	27
Figura 7: Strehimi Rom dhe Egjiptian sipas të ardhurave të tyre	28
Figura 8: Familjet pa të ardhura të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane sipas situatës së strehimit, në përqindje	29
Figura 9: Nevojat e strehimit për komunitetin Rom	31
Figura 10: Nevojat e strehimit për komunitetin Egjiptian	32
.....	



## FALËNDERIME

Qendra Kombëtare Shqiptare e Studimeve Sociale (NCSS), dhe Weiss Gerber & Partners, produkt i punës së të cilëve është ky studim, falënderojnë grupin e ekspertëve të drejtuar nga Prof.Asoc.Dr. Arlinda Ymeraj dhe Znj. Ardiana Fortuzi.

Falënderime të veçanta për punonjësit e Bashkive Tiranë, Durrës, Lezhë, Krujë dhe Shkodër që, në cilësinë e institucioneve zbatues të programeve të strehimit, mbledhën dhe përpunuan informacionin në përputhje të plotë me kërkesat e këtij vlerësimi. I shprehim mirënjohje stafit të Ministrisë së Zhvillimit Urban, në veçanti Znj. Aida Seseri, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Urbane dhe Strehimit, për mbështetjen e profesionale në kryerjen e studimit si dhe stafin e UNDP për administrimin e kujdesshëm të procesit.

## LISTA E SHKURTIMEVE

Bashkimi European	<b>BE</b>
Ministria e Zhvillimit Urban	<b>MZHU</b>
Enti Kombëtar i Strehimit	<b>EKS</b>
Dokumenti I Politikës së Përfshirjes Sociale	<b>DPPS</b>
Programi i Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri	<b>UNSSIA</b>

## PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i studimit të nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rom dhe Egjiptian në bashkinë Durrës me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre, bazohet në një analizë të kujdesshme të nevojave për strehim dhe të të ardhurave, sugjeron disa politika të shoqëruara me kostot respektive, të përmbledhura në një plan veprimi. Si i tillë, ai udhëheq punën e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe bashkëpunimit të saj me institucionet e nivelit shtetëror, qeveritë vendore dhe organizatat komunitare për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Durrësit.

Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit konstatoi se:

- ▶ 6,200 familje janë të pastreha në Durrës, nga të cilat 5,6 përqind janë të Komunitetit Rom ndërsa 1,9 përqind janë të Komunitetit Egjiptian, gjithsej 465 familje të pastreha nga të dy komunitetet.
- ▶ Numri i familjeve të pastreha nga komunitetit Rom është tre herë më i lartë se sa ato të komunitetit Egjiptian. Megjithatë, familjet të cilat jetojnë në banesa nën standartin e banimit përbëjnë kategorinë më të madhe të familjeve në nevojë për strehim nga të dy komunitetet, respektivisht 77 përqind nga komuniteti Rom dhe 62 përqind nga komuniteti Egjiptian.
- ▶ Komunitetet Rome dhe Egjiptiane janë të përqëndruara në 5 vendbanime, sipas Hartës së paraqitur në shtojcë.
- ▶ 97 përqind e familjeve Rome dhe 39 përqind e komunitetit Egjiptian nuk i përmbushin standartet e duhura të banimit dhe kushteve higjeno-sanitare.
- ▶ Nuk ka familje me të ardhura 30,000 Lek në muaj, ndërsa pjesa më e madhe e familjeve në nevojë strehimi nuk ka anjë të ardhur.
- ▶ Vetëm 6 përqind e Romëve dhe 16 përqind e Egjiptianëve kanë në pronësi një hapësirë banimi, megjithatë ajo është jashtë çdo standarti banimi.
- ▶ Kushtet e strehimit të komunitetit Rom në bashkinë e Durrësit janë veçanërisht të këqija: vetëm 1,9 përqind jetojnë në banesa që përmbushin standartin. Pothuajse asnjë nga familjet nuk janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve. Edhe përse të gjitha banesat janë të lidhura me rrjetin energjistik dhe të furnizimit me ujë, pothuajse asnjë prej tyre nuk ka elektricitet ashtu si dhe ujë të pijshëm dhe/ose tualet të brendshëm.
- ▶ Është e nevojshme të ndërtohen 465 banesa, përkatësisht për 350 familje Rome dhe 115 familje Egjiptiane, të cilat mund të realizohen në një hapësirë ndërtimi prej 34,379.5 m<sup>2</sup>, ndërsa bashkia ka ofruar vetëm 5,000 m<sup>2</sup> terren ndërtimi.
- ▶ Fatkeqësisht, komunitetet Rome dhe Egjiptiane nuk mund ta zgjidhin vetë situatën e tyre të strehimit për shkak të mungesës së të ardhurave. 76 përqind e atyre në nevojë kritike për strehim (jetojnë në banesa jashtë çdo standarti) nuk kanë asnjë të ardhur.

- ▶ Strehimi social mbetet politika më efektive për të zgjidhur nevojat e strehimit midis komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.
- ▶ Midis alternativave të ndryshme të politikave të sugjeruara në raport, Opsioni 1 (Programi: Qeveria vendore ndërton njësi strehimi) duket i realizueshëm. Kosto e tij në është 1,153,840,632 lekë (437 banesa), ndërsa Opsioni 2, Rikonstruksioni i banesave ekzistuese (380 banesa), kushton 351,500,000 lekë.
- ▶ Kosto e rehabilitimit të infrastrukturës në lekë është 104,487,551.

Raporti përbëhet nga katër kapituj përveç Hyrjes dhe Konkluzioneve Finale. Kapitulli i parë rishikon kontekstin ligjor në lidhje me të drejtën e strehimit të Romëve dhe Egjiptianëve. Kapitulli i dytë përshkruan metodologjinë e analizës. Kapitulli i tretë adreson gjetjet, ndërsa kapitulli i fundit shtjellon analizën e mëtejshme në lidhje me vlerësimin e kostove të alternativave të ndryshme të politikave, duke nxjerrë në pah argumentat për variantin më të përshtatshëm. Raporti mbyllet me konkluzionet finale. Një hartë dixhitale jep informacion të përditësuar rreth vendndodhjeve të Romëve dhe Egjiptianëve.



## HYRJA

Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë dhe po implementon një reformë sociale të gjerë dhe komplekse, me qëllim fuqizimin e mekanizmave institucional për të siguruar se askush nuk do të përjashtohet nga gëzimi i të drejtave të tyre. Sipas Termave të Referencës, politika e përfshirjes sociale është çelësi i promovimit të qëllimeve më të gjera të politikave të rritjes dhe zhvillimit si dhe adresimit të shkaqeve të mungesave të shumëfishta dhe varfërisë. Adoptimi i Dokumentit Politik të Përfshirjes Sociale 2015-2020 i hap rrugën:

- ▶ Identifikimit dhe adresimit të sfidave me të cilat përballet monitorimi dhe vlerësimi i përfshirjes sociale duke nxjerrë në pah indikatorët e BE-së dhe kombëtar, prej të cilëve kërkohet të mbështesin reduktimin e varfërisë dhe zhvillimin e masave efektive që përmirësojnë mirëqënien;
- ▶ Promovimit të koherencës së politikës, vendosjes së prioriteteve dhe caktimit të përgjegjësisë për kryerjen e monitorimit dhe matjes së përfshirjes sociale;
- ▶ Vlerësimin në mënyrë transparente të efektit të politikave që ndiqen dhe përpjekjeve të Qeverisë për të fuqizuar politikën që ndikojnë mbi përfshirjen sociale.

Në këtë kontekst, Programi i Mbështetjes së Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri (UNSSIA) kërkon të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve Shqiptare në nivel qendror dhe vendor për të avancuar me axhendën kombëtare të përfshirjes sociale me një pikëpamje të tillë e cila do të sigurojë konsistencë dhe koherencë nga politikën qeveritare dhe programuesit në arritjen e efektit maksimal të mundshëm për përfshirjen sociale të personave në risk; dhe rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe qytetarëve si mbajtësit e të drejtave në procesin kombëtar të përfshirjes sociale.

Brenda kontekstit të UNSSIA, vëmendje e veçantë i kushtohet veprimeve që mund të eliminojnë barrierat me të cilat Romët dhe Egjiptianët përballen për të aksesuar shërbimet, për të përmirësuar kushtet e jetesës nëpërmjet integritit dhe promovimit të dialogut interkulturor. Plani Kombëtar i Veprimit për Integritin e Romëve dhe Egjiptianëve përfaqëson një angazhim të ri i cili mbulon periudhën 2016-2020, dhe synon respektivisht këto dy komunitete. Në të reflektohet rritja e masave që po implementohen dhe gjithashtu planet për aktivitete të reja për promovimin e integritit të Romëve dhe Egjiptianëve, me një fond të angazhuar nga buxheti i Shtetit dhe hapësirat e financimit të identifikuar për periudhën 2016-2020 si dhe gjetja e mjeteve financiare nëpërmjet koordinimit me programe të tjera ndërkombëtare.

Romët dhe Egjiptianët përballen me barrierë direkte dhe indirekte në marrjen e shërbimeve publike, si rrjedhojë e pamundësisë për përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes, mungesës së informacionit ose të të kuptuarit të procedurave administrative, ashtu si dhe stigmatizimi dhe sjellja diskriminuese nga ana e shumicës së popullsisë. Përjashtimi afatgjatë ka ndikuar në kushtet e jetesës së Romëve dhe Egjiptianëve, trajtimi diskriminues nga shumica e popullsisë dhe marrëdhënia me institucionet qeveritare.

Midis të gjithë grupeve të pambrojtura, ekzistojnë të dhëna domethënëse të cilat tregojnë se Romët dhe Egjiptianët jetojnë në lagje të varfëra ku ka shumë pak ose aspak mundësi për të marrë shërbime publike. Studimet tregojnë se niveli i varfërisë midis komunitetit Rom është dy

herë më i lartë se shumica e popullsisë, ndërsa shkalla e papunësisë është tre herë më e lartë se mesatarja<sup>3</sup>. Tridhjetë e nëntë përqind e banesave ku jetojnë Romët dhe 21 përqind e atyre të banuara nga Egjiptianët nuk kanë akses ndaj ujit të pijshëm<sup>4</sup>. I njëjti burim informacioni tregon se 36 përqind e Romëve jetojnë në shtëpi të rrënuara ose lagje të varfëra (geto).

Si pjesë e strategjisë së përgjithshme për përfshirjen e grupeve më të cënueshme dhe në një linjë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU) po nis implementimin e Strategjisë për Strehimin Social (SSS) për periudhën 2015 -2025. Qëllimi i SSS është “ti ofrojë familjeve me të ardhura të ulta dhe mesatare të cilat nuk e përballojnë dot një shtëpi në tregun e lirë, dhe veçanërisht, familjeve me indikatorë vulnerabiliteti që rezultojnë në përjashtimin nga strehimi, zgjidhje për strehimin të cilat janë të disponueshme, të prekshme, të përballueshme dhe cilësore.”

Është bërë e njohur nga të gjitha palët e interesuara se ekzistojnë hendeqe kritike përsa i përket informacionit në lidhje me popullsinë Rome/Egjiptiane. Mungesa e regjistrimit në gjendjen civile, kryesisht e popullsisë Rome, ka pasur një ndikim vendimtar në “padukshmërinë” e “problemeve kritike” të popullsisë Rome. Megjithatë, shkaqet rrënjësore gjenden më thellë, në strukturën ligjore dhe institucionale të sistemit të shërbimeve publike të Shqipërisë. Veç kësaj, Reforma Territoriale dhe Administrative e implementuar së fundmi, ka ndryshuar ndarjen territoriale të bashkive.

Për të mundësuar integrimin dhe përfshirjen e popullsisë Rome/Egjiptiane, veçanërisht për të zgjidhur problemin e strehimit, është e nevojshme të kryhet një analizë e thellë e vendbanimeve jashtë standartit të strehimit të Romëve dhe Egjiptianëve në nivel bashkie dhe të vlerësohet nevoja për investime në mënyrë që të përmirësohen kushtet e strehimit dhe të jetesës së këtyre dy komuniteteve.

Raporti “ Studim mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkinë e Durrësit me qëllim vlerësimin e nevojës për investime për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së këtyre dy komuniteteve” sjell një analizë të thellë të vendbanimeve të Romëve dhe Egjiptianëve kundrejt standarteve të strehimit ashtu si dhe programeve të strehimit social. Raporti ofron të dhëna që lejojnë identifikimin e nevojave për investime në bashki, të ndara nga programet aktuale të strehimit social dhe do të udhëheqë punën e MZHU dhe bashkëpunimin e saj me institucionet e nivelit shtetëror, qeveritë vendore, dhe organizatat e komunitetit në përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Durrës.

3 Decade of Roma Inclusion Secretariat Foundation, Civil Society Monitoring Report on the Implementation of the National Roma Integration Strategy and Decade Action Plan in 2012 in Albania, përgatitur nga një grup autorësh (Bajrami, Ivia; Cabiri, Ylli; Hasantari, Adriatik; Kazanxhiu, Latif; Koci, Renart; Mustafaj, Enver; Myrteli, Laver; Nuredin, Albana; Pegini, Hafize; Rama, Lindita; Rushiti, Selvie; Xega, Gerta; Ziu, Dritan), publikuar në Maj 2013, [http://www.issuelab.org/click/download2/civil\\_society\\_monitoring\\_report\\_on\\_the\\_implementation\\_of\\_the\\_national\\_roma\\_integration\\_strategy\\_and\\_decade\\_action\\_plan\\_in\\_2012\\_in\\_albania](http://www.issuelab.org/click/download2/civil_society_monitoring_report_on_the_implementation_of_the_national_roma_integration_strategy_and_decade_action_plan_in_2012_in_albania), fq. 20.

4 Të dhëna nga UNDP/WB/EC 2011 Socio-economic Survey quoted in the UNDP's Needs Assessment Study on Roma and Egyptian Communities in Albania, Shkurt 2012, <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/roma-needs-assessment-report/>, fq. 24.-25.

## 1. RISHIKIMI I KONTEKSTIT LIGJOR KUNDREJT TË DREJTËS PËR STREHIM TË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE

Strehimi është një e drejtë njerëzore themelore e ruajtur në marrëveshje dhe traktate ndërkombëtare. Kur individët kanë strehim të sigurt dhe të përballueshëm i cili është i përshtatshëm me rrethanat e tyre jetësore, nevojat e tjera mund të plotësohen, siç janë punësimi, edukimi dhe mundësitë e jetës. Disa grupe qytetarësh në Shqipëri janë në risk mohimi të kësaj të drejte njerëzore themelore për shkak të çështjeve të përballueshmërisë së strehimit. Midis tyre, Romët dhe Egjiptianët janë veçanërisht të riskuar për shkak të përjashtimit të shumëfishtë.

Komunitetet Rome konsiderohen si grupi minoritar më vulnerabël në Shqipëri, i cili përballlet më vlefshëm gjerësisht të përhapur, marginalizimin socio-ekonomik dhe diskriminimin e shpeshtë, veçanërisht në lidhje me marrjen e shërbimit të edukimit, mbrojtjen sociale, shëndetësinë, punësimin dhe strehimin e përshtatshëm. Romët nuk njihen publikisht si minoritet i veçantë dhe ata kanë statusin e minoritetit etno-gjuhësor. Pavarsisht nga kjo, Kushtetuta e Shqipërisë adreson të gjitha parimet themelore të të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Shqipëria është gjithashtu pjesë e traktateve kryesore ndërkombëtare për sa i përket të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve.

Shqipëria ka nënshkruar Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut (2.10.1996), Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (4.10.1991), Konventën Ndërkombëtare mbi Eliminimin e Çdo Forme Diskriminimi Racial (11.5.1994) dhe Kartën Sociale Europiane (e rishikuar) (14.11.02). Si e tillë, shtetet anëtare janë të detyruara të sigurojnë qasje ndaj strehimit të barabartë për çdo qytetar.

### 1.1 Situata e përgjithshme e nevojave për strehim të Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë e Durrësit

Duke qenë të detyruar të bëjnë një jetë rruge për vite me rradhë pa qasje ndaj shërbimeve të strehimit, shkollimit, kujdesit shëndetësor dhe punësimit, familjet Rome janë kyçur brenda rrethit vicioz të informalitetit, duke bërë të pamundur përfitimin nga shërbimet sociale standarte duke përfshirë dhe programet e strehimit social. Krahasuar me Romët, komuniteti Egjiptian duket më i integruar në mjedisin social.

Midis Romëve, varfëria dhe mungesa e strehimit të përshtatshëm janë më dominante. Për shembull, në një anketë rajonale të 2011 mbi situatën e strehimit të Romëve në Shqipëri, 8 përqind e Romëve që morrën pjesë në studim konfirmuan se përjetojnë humbje të shumëfishta të strehimit, në krahasim me më pak se 1 përqind të jo-Romëve, ndërsa 30 përqind e Romëve të anketuar nuk kishin përmirësim të ujit, kanalizimeve dhe furnizimit me energji elektrike në krahasim me 7 përqind e jo-Romëve. Rreth 45 përqind e Romëve pjesëmarrës në anketë jetonin në banesa të cilave iu mungonte të paktën një nga komoditetet e mëposhtme: kuzhinë e brendshme, tualet i brendshëm, dush ose vaskë e brendshme, dhe energji elektrike. Gjithashtu u raportua se mesatarisht, më shumë se dy persona jetonin në të njëjtën dhomë, çka është shumë më tepër se mesatarja e OECD-së prej 0.8 personash për dhomë<sup>3</sup>.

3 [www.oecdbetterlifeindex.org/topics/housing/](http://www.oecdbetterlifeindex.org/topics/housing/)

Sipas "Studimit të Vlerësimit të Nevojave të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri", shumica e familjeve Rome jetojnë në shtëpi të vjetra (38.4 përqind) ose kasolle (20.8 përqind) dhe përbëhen nga një (66.3 përqind) ose më shumë familje bërthamë (27.5 përqind)<sup>4</sup>. Ata e konsiderojnë veten pronarë të vendbanimit të tyre (80.6 përqind), me vetëm rreth 10.8 përqind të cilët raportojnë se jetojnë me qera<sup>5</sup>. Shumë vendbanime Rome të kohëve të fundit janë kampe ku Romët jetojnë në tenda të improvizuara ose kasolle prane brigjeve të lumit. Madhësia e kampeve ndryshon sipas zonës.

Ndërkohë në bashkinë e Durrësit, 77 përqind e familjeve Rome jetojnë në banesa jashtë çdo standarti. Ato janë më të ngjashme me kasollet. Vetëm 6 përqind prej tyre zotërojnë një hapësirë banimi. Megjithatë vendbanimet e tyre janë të pajisura me infrastrukturë dhe janë afër me qytetin e Durrësit si dhe me shërbimet bazë të mirëqënies, mungesa e higjenes minimale dhe e kushteve të jetesës, i çon ato në risk të lartë përjashtimi.

Kushtet e strehimit të komunitetit Rom në bashkinë e Durrësit janë veçanërisht të këqija: vetëm 1.9 përqind jetojnë në shtëpi me standarte. Pothuajse asnjë nga familjet nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimeve. Megjithatë të gjitha banesat janë të lidhura me rrjetin e furnizimit të energjisë dhe të ujit, pothuajse asnjë prej tyre nuk ka energji elektrike ashtu si dhe ujë të pijshëm dhe/ ose tualet të brendshëm.

Në Shqipëri, komuniteti Egjiptian është përgjithësisht më i integruar se ai Rom. Megjithatë, ata gjithashtu, përballen me një numër të ngjashëm kufizimesh ashtu si Romët. Anëtarët e komunitetit Egjiptian jetojnë kryesisht në shtëpi të vjetra (45.8 përqind) ose banesa në gjendje të mirë riparimi, por jo të reja. Ata gjithashtu raportojnë se janë pronarë të shtëpive (83.5 përqind), dhe vetëm një përqindje e vogël (7.1 përqind) thonë se e kanë marrë me qera strehimin e tyre. Vetëm 10.9 përqind e anëtarëve të komunitetit Egjiptian raportojnë se jetojnë në kasolle, një përqindje shumë më e ulët se midis Romëve<sup>6</sup>.

Megjithatë në Bashkinë e Durrësit situata e komunitetit Egjiptian duket më e keqe në krahasim me përshkrimin e mësipërm. 22 përqind e komunitetit Egjiptian nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi, ndërsa 63 përqind jetojnë në banesa nën çdo standart banimi. Megjithatë 16 përqind kanë në pronësi një hapësirë banimi, ajo është nën standartin bazë të banimit.

Kushtet e banimit të komunitetit Egjiptian në bashkinë e Durrësit janë dukshëm më të mira se sa ato të Romëve. Një përqindje e lartë (60.1 përqind) raportojnë se jetojnë në kushte optimale duke marrë në konsideratë infrastrukturën inxhinierike dhe kushtet higjieno-sanitare.

## 1.2 Politikat Publike të "Strehimit" të miratuara në Bashkinë e Durrësit

Strategjia e re e Strehimit Social 2015-2025 bazohet në detyrat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015-2020 (SKZHI). Një nga objektivat e SKZHI (II), është "të garantojë qasje të barabartë ndaj instrumentave ekonomikë dhe socialë për të gjithë grupet dhe individët e shoqërisë sonë".

Për sa i përket strehimit social, SKZHI identifikon disa sfida kritike në lidhje me grupet sociale më të përjashtuara:

- a. Të implementojë një politikë të integruar strehimi e cila piketon grupet me të ardhura të pakta dhe ata më vulnerabël;
- b. Të sigurojë adoptimin e standarteve minimale të strehimit;
- c. Të përmirësojë kushtet e strehimit për komunitetet Rome dhe Egjiptiane;

Strategjia e re e Strehimit Social i hap rrugën një shumëllojshmërie programesh të strehimit social të cilat mund të përshtaten duke u bazuar në një ligj të ri mbi Strehimin Social.

Ligji Nr.9232 mbi "Strehimin Social" u miratua për herë të parë në vitin 2004. Që prej asaj kohe ligji është ndryshuar disa herë me qëllim rritjen e efektivitetit të tij duke lehtësuar procedurat e aplikimit si dhe mundësimin për më shumë akses ndaj tregut të strehimit për të pastrehët. Veç kësaj, Bashkia Durrës ka adresuar Planet e saj Strategjike të Zhvillimit siç është Strategjia Rajonale për Zhvillimin e qytetit të Durrësit (2005) dhe Strategjia e Zhvillimit Territorial, 2015-2030. Megjithatë, një strategji specifike për strehimin nuk është miratuar ende.

Duke ju referuar Ligjit Nr. 9232, programet e strehimit social janë "programe të cilat shërbejnë për të strehuar familjet dhe individët të cilët për shkak të situatës së tyre ekonomike dhe sociale nuk mund të përballojnë ofertën e tregut të lirë ose kredinë". Qeveria ka krijuar tre programe të strehimit social:

- ▶ Banesat sociale me qera,
- ▶ Banesat me kosto të ulët, dhe
- ▶ Programi i pajisjes së truallit me infrastrukturë.

Veç kësaj, qeveria ka mundësuar ofrimin e subvencioneve të strehimit, kredive të subvencionuara, grantet e vogla, dhe grantet e menjëherëshme të cilat synojnë grupe specifike (shih më poshtë për përshkrimin e secilit program). Përfituesit e programeve të strehimit social duhet të përmbushin një nga kriteret e mëposhtme:

- ▶ Ata nuk duhet të kenë në pronësi një shtëpi;
- ▶ Ata duhet të kenë një vend banimi i cili është nën normat e strehimit;
- ▶ Ata duhet të jenë të pastreh për shkak të katastrofave natyrore (Ligji 9232, Neni 4).

Përzgjedhja e përfituesve bazohet në kushtet e tyre të jetesës ashtu si dhe mbi rrethanat e tyre sociale dhe ekonomike. Prioriteti është vendosur mbi pesëmbëdhjetë grupe, duke përfshirë familjet me një prind, familjet e gjera, të rriturit më të vjetër, personat e paafte, çiftet e reja, familjet që kanë ndryshuar vendbanimin, jetimët, emigrantët e kthyer, punëtorët migrant, azil kërkuesit, oficerët e rënë në detyrë, viktimat e dhunës në familje, familjet Rome, familjet Egjiptiane, dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.

Sipas Shutina<sup>7</sup>, deri në 2008 Bashkia e Durrësit angazhohej në programet e strehimit social kryesisht nëpërmjet EKS-së, e cila ofronte vetëm 96 apartamente në një periudhë kohore prej dhjetë vitesh. Në fillim të viteve 2000, bashkia gjithashtu ndërtoi 24 apartamente duke përdorur të ardhurat e saj, dhe në vend që ti shiste ato nëpërmjet një skeme me kosto të ulët, vendosi t'ja jepte me qera familje me të ardhura të ulta. Edhe përse për kohën ishte një veprim novator, projekti u konsiderua nga Auditit i Lartë i Shtetit si jo në përputhje me ligjet në fuqi. Këto apartamente, ende jepen me qera me Lek 1,000 (afërsisht 7 Euro) në muaj, çmim i cili është tej mase i ulët në krahasim me qeratë në tregun e lirë. Këto familje janë përgjegjëse për

4 A Needs Assessment Study on Roma and Egyptian Communities in Albania, CESS mbështetur nga UNDP, 2012, fq.24

5 Ibid

6 Njëllonj

7 CORRUPTION RISK ASSESSMENT: PROVISION OF SOCIAL HOUSING IN ALBANIA, Dritan Shutina, Ekspert i Këshillit Europian, Maj 2011



mirëmbajtjen e ndërtesës, edhe pse pronësia është e bashkisë.

Megjithatë, bashkia nuk ka një strategji strehimi dhe informacioni mbi nevojat për strehim mbështetet mbi aplikimet.

### 1.3 Treguesit e përmirësimit të kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Durrës

Që prej 2007, në përputhje me Ligjin e Strehimit Social, bashkia ka ndërmarrë dy programe strehimi kryesore:

- ▶ Banesat me Qera Sociale,
- ▶ Banesat me kosto të ulët me Subvencion Kredie.

Që prej 2010, Bashkia Durrës ka investuar për Strehimin Social, 156,424,000 lekë gjithsej ose afërsisht 1,526,070,666 lekë në vit. Megjithatë, për tu për zgjedhur për sistemin e pikëzimit, familja duhet të përmbushë dy kushte: Të ardhurat mujore nuk duhet të jenë më të larta se 100 përqind e mesatares së zonës për banesat sociale dhe 120 përqind për banesat me kosto të ulët; Familjet nuk duhet të kenë në pronësi një shtëpi, ose të jetojnë në një shtëpi, madhësia e të cilës nuk është më e madhe se standartet minimale të vendosura me ligj. Si rrjedhojë, vetëm 10 familje nga komunitetet Rome dhe Egjiptiane (respektivisht 5 prej secilit grup) kanë përfituar prej programeve të strehimit social që prej implementimit të tyre fillestar. Ata janë të përjashtuar nga programet e strehimit social për shkak të mungesës së punësimit dhe/ ose nuk kanë të ardhura mujore të rregullta, që është kusht fillestar i Bankave për financim.

## 2.

## METODOLOGJIA E KËRKIMIT

### 2.1 Qëllimi, synimi dhe objektivat e Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit

Studimi "Mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkinë e Durrësit me qëllim vlerësimin e nevojës për investime për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së këtyre dy komuniteteve" synon të vlerësojë "nevojën për investime për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe të jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Durrës" për të drejtuar punën e MZHU dhe partnerëve të saj në përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Durrës".

Duke qëndruar në një linjë me qëllimin e përgjithshëm, Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit ka arritur objektivat si më poshtë:

- ▶ Ofrimin e të dhënave të sakta mbi kushtet e strehimit dhe të jetesës (p.sh. kushtet e banimit, aksesit ndaj ujit, elektricitetit, dhe kanalizimeve) të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë e Durrësit.
- ▶ Vlerësimin e investimeve që duhet të bëhen në bashkinë e Durrësit me qëllim përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.
- ▶ Zhvillimin e Planit të Veprimit i cili do të drejtojë punën e MZHU dhe bashkëpunimit të saj me institucionet e nivelit shtetëror, qeveritë vendore, dhe organizatat komunitare në përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Durrës.

Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit përdor informacion nga burime të ndryshme: (1) studime dhe raporte të mëparshme, (2) një anketë rastësore e fokusuar mbi familjet Rome dhe Egjiptiane në nevojë strehimi, (3) fokus grupe me palët e interesuara përkatëse dhe (4) verifikimi në terren i lagjes dhe infrastrukturës në bashkinë Durrës.

Hartimi i këtij raporti u bazua në rishikimin e raporteve të ndryshme të përgatitura nga MZHU, PNUD dhe/ose organizata kërkimore të pavarura (shih Bibliografinë).

### 2.2. Karakteristikat e kampionit

Për shkak të qëllimit të mirëpërcaktuar të Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, nuk ishte e mundur të identifikohet një kampion. Në të kundërt, të gjitha komunitetet Rome dhe Egjiptiane të Bashkisë Durrës u përfshinë në njësinë kërkimore. Madhësia e kampionit (sipas përcaktimit të shtjelluar mësipër) është e paraqitur më poshtë (Tabela 1):

**Tabela 1: Karakteristikat e kampionit**

Pyetësori	Madhësia e kampionit përbëhet nga:	
	Komuniteti Rom	Komuniteti Egjiptian
Nr.1: Biseda me fokus grupe	100 përqind	100 përqind
Nr.2: Ballë për ballë	30 përqind	35 përqind

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

### 2.3. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave

U konsiderua e nevojshme mbledhja e informacionit të detajuar mbi madhësinë dhe përbërjen e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Durrës si dhe mbi nevojat e tyre të përgjithshme rreth strehimit.

Bisedat me Fokus Grupe u zhvilluan me dy grupe interesi, përkatësisht Departamenti i Zhvillimit Urban dhe Departamenti i Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Durrësit. Veç kësaj, përdorimi i bisedave me fokus grupe ndihmoi në mbledhjen e informacionit në lidhje me përpjekjet e qeverisë vendore për të siguruar strehim për komunitetet që përbëjnë themelort të këtij Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit.

Megjithatë, me qëllim zbulimin në thellësi të shqetësimeve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në lidhje me strehimin, intervistat ballë për ballë me familjet ofruan të dhëna të nevojshme.

Pyetësori i parë (pyetësor me pyetje të hapura) mundësoi mbledhjen e informacionit në lidhje me:

- ▶ Përbërjen e të pastrehëve, numrin, vendndodhjen e tyre, ndarjen sipas specifikave të nevojave të tyre për strehim ashtu si dhe sipas statusit të tyre socio-ekonomik.
- ▶ Kapacitetet e qeverisë vendore për të zgjidhur çështjen e strehimit, të pakten për komunitetet Rome dhe Egjiptiane.
- ▶ Sfidat e Strehimit në nivel vendor.

Pyetësori i dytë lehtësoi analizën në thellësi të banesave në secilin prej vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane, përkatësisht:

- ▶ Tipi i banesave, madhësia e tyre dhe kushtet infrastrukturore.
- ▶ Kushtet infrastrukturore të vendbanimeve dhe aksesit ndaj shërbimeve.

Verifikimi në terren i lagjes dhe infrastrukturës shqyrtoi:

- ▶ Vlerësimin e përgjithshëm të kushteve të vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane, përkatësisht kushtet fizike, qasja ndaj infrastrukturës (rrjeti i furnizimit me ujë, sistemi i ujit të mbetjeve, rrjeti elektrik), kushtet e higjenës (janë apo jo të furnizuar me ujë dhe kanalizime nga rrjeti i qytetit), marrja e shërbimeve të tjera publike, probleme të tjera në lidhje me këtë (probleme furnizuesi dhe konsumatori).
- ▶ Vlerësimin e kostove që nevojiten për përmirësimin e situatës ekzistente ose lidhja e

komuniteteve me shërbimet në nivel lagjeje si dhe në nivel lagjeje dhe shtëpie.

- ▶ Analizën e situatës së lagjeve specifike të cilat janë të prirura ndaj rreziqeve natyrore ose të tjera.
- ▶ Përpunimin e gjetjeve nëpërmjet verifikimit në terren, të cilat shërbejnë për përgatitjen dhe propozimin e 2-3 skenarëve për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe infrastrukturës.

### 2.4. Parimet e analizës

Në përputhje me kontekstin e Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, grupi i studimit mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit përcaktoi disa kriteret mbi të cilat është bazuar vlerësimi i kostos për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të infrastrukturës së vendbanimeve të komunitetit Rom dhe Egjiptian:

**Së pari**, informacioni i marrë nga administrata vendore dhe anketat e vendndodhjes, nëpërmjet pyetësorëve, u përdor për të përcaktuar një synim të qartë të projektit, si nga ana cilësore ashtu dhe ajo sasiore.

**Së dyti**, bazuar në strukturën e familjes, u krijua një dosje mbi nevojat për llojet dhe numrin e apartamenteve të nevojshme. Sipërfaqet e banimit dhe të ndërtimit u përcaktuan sipas Entit Kombëtar të Banesave dhe legjislacionit në fuqi.

Këto shërbyen si informacion kyç për të gjithë procesin e analizës financiare dhe vlerësimit të kostove për përmirësimin strukturor të banesave dhe atë infrastrukturor të zonave të banimit. Objektivi kryesor ishte hartimi i një metodologjie të qartë në mënyrë që të bëhëj i mundur vlerësimi dhe llogaritja e kostove të pritshme të proceseve të implementimit të projekteve.

E gjithë kjo procedurë, në fund, rezultoi në metodologjinë e propozimit të analizës financiare e cila iu prezantua administratës vendore dhe përfituesve, duke i ndihmuar ata të marrin vendime të realizueshme me qëllim përgatitjen e strategjive të zhvillimit dhe propozimin e zgjidhjeve të qëndrueshme.

Bazuar mbi të dhënat që rezultuan nga përpunimi i pyetësorëve, u zhvilluan dhe analizuan financiarisht skenarë të ndryshëm:

**A. Skenari i parë** – procesi i përmirësimit të kushteve ekzistuese të jetesës në strukturat rezidenciale

**B. Skenari i dytë** – përdorimi i fondit të lirë ekzistues të strukturave rezidenciale (nëpërmjet blerjes ose procesit të punësimit)

**C. Skenari i tretë** – ndërtimi i strukturave të reja dhe infrastrukturës për qëllim të strehimit social

## A. Proçesi i përmirësimit të kushteve ekzistuese të jetesës në strukturat rezidenciale

Nga pikëpamja e vlerësimit të kostos, metodologjia u bazua në dy kritere kryesore:

- Vlerësimi i situatës ekzistuese të strukturave të rezidencave, duke shqyrtuar kushtet e jetesës, kushtet e higjienës, dhomat e nevojshme ekzistuese sipas standarteve, kushtet teknike të strukturës (lidhur me sigurinë) – informacion i marrë nga pyetësorët e anketave të vendndodhjeve.
- Vlerësimi i kostos për riparimin e këtyre elementeve dhe rehabilitimin e këtyre hapësirave, nëpërmjet proçesit të rikonstruktimit, me qëllim që këto struktura të përmbushin kushtet e nevojshme të pranueshme, duke i kthyer në këtë mënyrë në zona të banueshme në përmbushje të standarteve dhe normave.

Faktori kryesor i marrë seriozisht në konsideratë ishte statusi i pronësisë i rezidencës (pyetja kryesore e pyetësorit). Ky element mund të rrisë direkt pjesën e investimit, dhe nga ana tjetër është element vendimtar në sigurimin e investimit afatgjatë dhe veçanërisht në sigurimin e qëllimit të investimit.

Metodologjia e përlllogaritjes u bazua në metoda të thjeshta klasike, mbështetur në listën e çmimeve të referencës dhe një indeks i përafërt i proçesit të ndërhyrjes rikonstruktive i cili u përfutua nga Studimi i eksperiencave ekzistuese të tregut dhe të eksperiencave të ngjashme.

Vlerësimi deri në çfarë mase llojet e secilës ndërhyrje janë të mundshme dhe të arsyeshme kundrejt aseteve dhe kushteve ekzistuese dhe eksperiencës së administratës vendore për t'u marrë me çështjet e strehimit të grupeve të synuara, ishte pritshmëria e përgjithshme e Studimit mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit.

Për më tepër, si skenar u krahasua me të tjerët me qëllim gjetjen se cili prej tyre është më i saktë për t'u përdorur dhe deri në ç'masë, në mënyrë që përdorimi i një ose më shumë skenarëve në të njëjtin qytet por në lagje të ndryshme ose në grupe ose organizma sociale të ndryshëm, të rezultojë i mundshëm.

Një tjetër aspekt pozitiv i këtij skenari është që mund të përdoret gjithashtu si një proçes rigjenerimi urban dhe mund të aplikohet në disa zona të braktisura të qytetit të cilat mund të kenë potencial special për t'u integruar në strukturën dhe jetën e qytetit.

## B. Përdorimi i fondit të lirë ekzistues të strukturave rezidenciale (nëpërmjet blerjes ose qiramarrjes)

Nga pikëpamja e vlerësimit të kostos, metodologjia u bazua në dy drejtime kryesore: vlerësimi i qerasë dhe shitjeve të tregut vendas të pasurive të patundshme. Informacioni, i përfutur si nga administrata vendore ashtu dhe nga të dhënat e tregut, u plotësua me vendndodhjen e strukturave rezidenciale ekzistuese dhe gjendjen e tyre (si nga pikëpamja teknike ashtu edhe nga pikëpamja e pronësisë). Për të dyja këto, u krye një vlerësim i kushteve me qëllim sigurimin e përmbushjes së standarteve të kërkuara.

Edhe në rastet e të pastrehëve, faktorët kryesorë të konsideruar ishin sipërfaqja e përshtatshme (zona e banimit) në përputhje me strukturën e familjes, dhe kosto për metër katror (LEK/m<sup>2</sup>) e shitjes ose edhe e qerasë, ashtu si dhe vendndodhja e tyre. Bazuar në këto, disa analiza më të hollësishme u realizuan për të siguruar përpilimin e disa skenareve të ndryshme të investimit si edhe të kostos financiare të tyre.

## C. Ndërtimi i strukturave të reja dhe infrastrukturës për qëllim të strehimit social

Vlerësimi i kostos totale për këtë skenar u bazua në tre kosto të ndërlidhura:

- Kosto e truallit (vendndodhja e ngastrës)
- Kosto e ndërtimit të strukturës
- Kosto e infrastrukturës

Nga pikëpamja teknike ky skenar paraqet një vlerësim kostoje të thjeshtë i cili bazohet në tre faktorë të mirënjohur, nga pikëpamja ekonomike dhe financiare. Ajo çka nevojitet është një ide reale projekti dhe një vendndodhje për ngastrën e zgjedhur në mënyrë që të përlllogaritet saktësisht kosto e këtyre lloj ndërhyrjesh duke marrë në konsideratë të tre elementët.

Lidhur me përlllogaritjen e kostos, metodologjia duhet të shqyrtojë përlllogaritjen e çdo faktori në mënyrë të pavarur dhe bashkarisht, ku rastet e ndryshme për gjetjen e vendndodhjes së ngastrës duhet të përfaqësohen nga administrata vendore, ashtu si dhe format e investimeve.

Zgjedhja e truallit është vendimtare në përlllogaritjen e kostos totale. Në këtë aspekt, kosto e truallit, është një variabël shumë e rëndësishme, i cili është i lidhur direkt me statusin e pronësisë, me qëllim që pronat shtetërore të truallit të mund të çojnë në kosto investimi më të ulta, - përveç efekteve anësore të tjera pozitive me të cilat veprime të tilla shoqërohen gjithmonë, siç është interesi direkt i qeverisë vendore, i cili në shumë raste është vendimtar për suksesin e projektit. Në këtë rast kosto e truallit konsiderohet si një variabël e rëndësishme, veçanërisht në lidhje me statusin e pronësisë, me qëllim gjetjen e truallit në pronësi publike.

Një tjetër aspekt i analizuar është kosto e pronës në lidhje me koston e lidhjes me infrastrukturën publike. Në këtë mënyrë mund të rezultojnë skenarë më të qëndrueshëm të proçesit të zgjedhjes së truallit, jo vetëm në lidhje me disponueshmërinë e autoriteteve vendore për të ofruar truallin, por gjithashtu ekonomikisht, për shkak të përmirësimit të këtyre vendndodhjeve në zona urbane me kushte më të mira rezidenciale dhe sociale.

Kosto e ndërtimit u përlllogarit bazuar në indekset dhe çmimet e referencës së Entit Kombëtar të Banesave sipas ligjeve. Bazuar në numrin e nevojave dhe strukturave të familjeve, propozohet një skenar mbi zonën e nevojshme të jetesës, e cila bashkë me ambjentet komunitare dhe të shërbimit, rezultojë në zonën finale të ndërtimit. Kjo shërben si informacion bazë për vlerësimin e kostos së ndërtimit të shtëpive sociale.

Rezultati i pritshëm është një shumë totale e përafërt e investimit të nevojshëm. Kosto e infrastrukturës duhet të shqyrtojë urbanizimin ose shkallën e urbanizimit të truallit. Kjo lidhet drejt për drejt me pozicionimin e zonës së propozuar në qytet, veçanërisht kundrejt shërbimeve publike dhe infrastrukturës, dhe mundësitë e aksesit dhe lidhjes me rrugët dhe sistemet e furnizimit dhe shkarkimit.

Të gjitha këto përdoren si variabla për të paraqitur një formulë të thjeshtë e cila do të ndihmojë autoritetet vendore të përlllogarisin dhe krijojnë një vizion më të mirë mbi koston totale të një proçesi të tillë. Për më tepër, kjo do të ndihmojë për të pasur më shumë se një zgjidhje, dhe në këtë mënyrë do të ndihmojë në gjenerimin e fondeve dhe investimeve nga drejtime të ndryshme, element i cili është vendimtar në suksesin e proçesit.

Rezultatet e secilit skenar do të analizohen në lidhje me kushtet lokale të çdo bashkie, ashtu si dhe sipas mundësive reale për investime të secilës qeveri vendore, bazuar në fondet e tyre ose mundësi të tjera. Për këtë, proçesi i analizës bazohet mbi rezultatet që vijnë nga pyetësorët:

ato të dhëna të cilat kanë lidhje me të ardhurat e familjeve dhe ato të cilat kanë të bëjnë me investimin e kapaciteteve të bashkive mbi banesat sociale dhe projekte të tjera përkatëse.

Bazuar në këto, Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit vlerëson kostot si edhe burimet financiare të mundshme për të përballuar investimin. Qasjet e ndryshme të propozuara mund të çojnë në prodhimin e më shumë projekteve me qëllim të mirëpërcaktuar dhe duke synuar projekte më të kontrollueshme, të cilat çojnë në implementimin e suksesshëm.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se bazuar në kushtet financiare lokale dhe numrin e familjeve në nevojë, si dhe mbi stokun e banesave, kriteret e nënvizuara më lart janë të rëndësishme dhe duhet të merren seriozisht në konsideratë, sepse, siç u shpjegua, rezultatet e tyre varen shumë nga variablat lokale.

Si mekanizëm i fundit, metodologjia e përlllogaritjes së kostos synon të krijojë një formë llogaritjeje për secilin rast në mënyrë që të ndihmojë autoritetet vendore në procesin e vendimarrjes.

Bazuar në kostot tashmë të përlllogaritura, kjo metodologji gjithashtu adresoi:

- ▶ Efektin e kategorizimit mbi vlerësimin financiar të projekteve;
- ▶ Koston e huave për përfituesit;
- ▶ Analiza kosto-përfitim, kosto e projektit, norma e interesit, norma e brendshme e kthimit dhe koha e pagesës, metodat e vlerësimit, etj.
- ▶ Burimet e kapitalit të mbledhur si dhe forma të tjera që rezultojnë në kapital.

Si e tillë, kjo metodologji, së pari paraqet më shumë se një mundësi reale dhe financiare për zgjidhje të qëndrueshme, dhe së dyti, hap mundësinë e përlllogaritjes dhe vlerësimit midis opsioneve të ndryshme e cila do të bazohet direkt mbi kapitalin dhe kushtet financiare të kapaciteteve lokale. Në këtë mënyrë shtron bazat për aplikimin e projekteve dhe zgjidhjeve origjinale, duke fuqizuar edhe mundësitë e bashkëpunimit publik dhe privat, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme afatgjata.

### 3.

## ANALIZA PËRSHKRUESE DHE E DETAJUAR E KUSHTEVE TË STREHIMIT DHE JETESËS SË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE (GJETJET E STUDIMIT)

Kapitulli 3 adreson kërkesën për strehim të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane sipas tre kriterëve të vlerësimit, respektivisht:

**Kriteri 1:** Situata e strehimit të familjeve

**Kriteri 2:** Kushtet socio-ekonomike të familjeve

**Kriteri 3:** Kushtet infrastrukturore të vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane

Të dhënat e mbledhura nga Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit janë përpunuar dhe analizuar në bazë të secilit kriter të theksuar më sipër. Në mënyrë të ngjashme, gjetjet kërkimore respektive janë identifikuar dhe formuluar sipas vlerësimit të kriterëve.

### 3.1. Situata e strehimit e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane

Në përgjithësi, strehimi është një nevojë kritike në Bashkinë Durrës. Siç e tregon tabela 2, ka 6,200 familje të pastreha në Durrës, nga të cilat 5,6 përqind janë të komunitetit Rom ndërsa 1,9 përqind të komunitetit Egjiptian.

**Tabela 2: Situata e familjeve të pastreha në Bashkinë Durrës, duke përfshirë komunitetet Rome dhe Egjiptiane**

	Total	Roma	%	Egjiptian	%
<b>Familje në nevojë strehimi për shkak të:</b>	<b>6,200</b>	<b>350</b>	<b>5,6</b>	<b>115</b>	<b>1,9</b>
Nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	3,400	60	1,8	25	0,7
Kanë në pronësi hapësirë banimi nën standartet e banimit	1,800	20	1.1	18	1
Jetojnë në banesa nën standartet e banimit.	1,000	270	2,7	72	7.2

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016


Megjithë numrin e limituar të familjeve në nevojë strehimi të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane (figura 1) në krahasim me numrin total të personave të pastrehë në Durrës, situata e tyre është tejet shqetësuese për shkak të përjashtimit ekstrem me të cilin ato përballen.



Foto të vendbanimit Rom

Burimi: Studim, 2016


Figura 1: Familjet në nevojë strehimi, 2016



Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

Duke krahasuar nevojën për strehim të dy komuniteteve të përjashtuara, vihet re se numri i familjeve të komunitetit Egjiptian është tre herë më i lartë se sa numri i atyre të komunitetit Rom (Figura 2). Megjithatë, familjet që jetojnë në banesa nën standartet e banimit përbëjnë kategorinë më të madhe të familjeve në nevojë në të dy komunitetet, respektivisht 77 përqind nga komuniteti Rom dhe 62 përqind nga komuniteti Egjiptian. (Figura 2).

Figura 2: Komunitetet Rome dhe Egjiptiane, Situata e Strehimit në Bashkinë Durrës, 2016



Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

Komunitetet Rome dhe Egjiptiane janë të përqëndruara në pesë vendbanime sipas informacionit të dhënë në Tabelën 3.

Tabela 3: Vendbanimet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Durrës, 2016

Vendbanime	Familje Rome	Familje Egjiptiane
1. Lagja nr.14 Rr."Vath Truja" (Nishtulla) Shkozet Durrës	145 familje	45 familje
2. Kullë, Njësia Administrative Sukth, Durrës	50 familje	15 familje
3. Xhafzotaj, Durrës	70 familje	20 familje
4. Fllakë, Durrës	50 familje	20 familje
5. Lagja nr.7, Rr. "Hajdar Demiri", Durrës	35 familje	15 familje
<b>Total</b>	<b>350 familje</b>	<b>115 familje</b>


Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

Harta 1 (aneksi A) tregon vendndodhjen e vendbanimeve.

Pothuajse 41 përqind e familjeve në nevojë nga të dy komunitetet janë të vendosura në Shkozet, 3 km në lindje të qytetit të Durrësit. Kjo zonë përbëhet nga shtëpi individuale 1-4 katëshe. Për sa i përket rrugëve dhe rrjetit inxhinierik, infrastruktura ekzistuese është e një cilësie të mirë.

Si mund të shihet lehtësisht në Tabelën Nr.4, shumica prej tyre jetojnë në banesa nën standartet e banimit.

Figura 3: Vendbanime Rome dhe Egjiptiane sipas llojeve të problemeve të strehimit, 2016



Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

19 përqind e familjeve janë vendosur në Xhafzotaj, 5.5 km në lindje të qytetit të Durrësit. Kjo zonë përbëhet nga shtëpi individuale 1-4 katëshe dhe ndërtesa industriale. Ka infrastrukturë ekzistuese për sa i përket rrugëve dhe rrjetit inxhinierik. Përsëri shumica e familjeve përballen me çështjet e standarteve të jetesës së banesës.

26 përqind e vendbanimeve gjenden në qytetin e Durrësit, por në dy zona të ndryshme. Të gjitha këto zona janë të pajisura me infrastrukturë inxhinierike. Vetëm 14 përqind e familjeve janë të vendosura në Sukth, 14 km verilindje nga qyteti i Durrësit dhe 1 km në perëndim të fshatit Kulla.

Kjo zonë përbëhet nga shtëpi individuale 1-3 katëshe dhe është përgjithësisht zonë bujqësore. Ka infrastrukturë ekzistuese për sa i përket rrugëve dhe rrjetit inxhinierik. Situata e tyre është veçanërisht shqetësuese ashtu si dhe tregohet në fotot bashkangjitur.



**Foto nga vendbanimi Rom**

Vlerësimi më në thellësi i kushteve të strehimit të vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Durrës bazohet në informacionin e marrë nga pyetësi 2 (pjesët 5A, 5B, 5C, dhe 5D) si dhe nga vizitat në terren që ju bënë secilit komunitet. Për të identifikuar kërkesën për strehim në secilin komunitet, u kryen intervista ballë për ballë me 29 përqind të familjeve, siç tregohet në tabelën 4.

**Tabela 4: Numri i intervistave ballë për ballë në Bashkinë Durrës**

	Banorë	Familje
Popullsi Rome & Egjiptiane	2.406	465
Popullsi e intervistuar Rome & Egjiptiane	696	136
Në përqindje	29	29

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

**Tabela 4.1: Intervistat në secilin vendbanim Rom dhe Egjiptian të Bashkisë Durrës, 2016**

Vendbanime	Familje Rome të intervistuar	Familje Egjiptiane të intervistuar
1. Lagjia nr.14 Rr."Vath Truja" (Nishtulla) Shkozet Durrës	100 familje	0 familje
2. Kullë, Njësia Administrative Sukth, Durrës	10 familje	0 familje
3. Xhafzotaj, Durrës	3 familje	0 familje
4. Fllakë, Durrës	0 familje	0 familje
5. Lagja nr.7, Rr. "Hajdar Demiri", Durrës	0 familje	0 familje
6. Cezma e Ferres	0 familje	23 familje
<b>Total</b>	<b>113 familje</b>	<b>23 familje</b>

**Burim:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016


Vlerësimi i nevojave për strehim tregon se komunitetet Rome dhe Egjiptiane ndajnë shqetësime të përbashkëta: atyre i mungojnë kushtet e përshtatshme të strehimit sipas çdo standarti të ligjit. (Tabela 5).

**Tabela 5: Familjet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane sipas situatës së tyre të strehimit**

Lloji i kushteve të strehimit	Nr	Në %
Jetojnë në tenda, barraka, magazina	7	5.1
Jetojnë në garsoniera	1	0.7
Jetojnë në apartamente 1+1	81	59.6
Jetojnë në apartamente 2+1	43	31.6
Jetojnë në apartamente 3+1 ose më shumë	4	3
<b>Total</b>	<b>136</b>	<b>100</b>

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

**Figura 4: Situata aktuale e strehimit e komuniteteve R/E**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

Siç mund të shihet nga tabela 5 dhe figura 4, pothuajse 91 përqind e familjeve jetojnë në apartamente 1+1 dhe 2+1. Megjithatë, vetëm 8 nga 136 familjet e intervistuar (5.9 përqind në total) ka në pronësi një hapësirë banimi në përputhje me legjislacionin. Siç u vu re gjatë vizitave në terren, pothuajse të gjitha "banesat" kishin probleme në lidhje me kushtet strukturore dhe higjeno-sanitare.

Përsa i përket aksesit ndaj ujit, kanalizimeve dhe rrjeteve të furnizimit me energji (tabela 6), asnjë nga familjet nuk ishte e lidhur me rrjetin e kanalizimeve, ata shkarkojnë në gropa septike ose kanale kullimi. Konfirmohet se i njëjti skenar aplikohet në të gjitha zonat.


**Tabela 6: Aksesi ndaj ujit, kanalizimeve dhe rrjeteve të furnizimit me energji të komunitetit R/E në Bashkinë Durrës**

Përqindja e familjeve që kanë akses ndaj punëve inxhinierike	Vizita në terren
Rrjeti i furnizimit me Ujë	100
Rrjeti i Kanalizimeve	0
Rrjeti i furnizimit me Energji	100

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

Përsa i përket llojit të vendbanimeve vetëm për komunitetin Rom (figura 5), Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit tregoi se 6.2 përqind e totalit të familjeve Rome jetojnë në tenda ose magazina, 0.9 përqind jetojnë në garsoniera, 52.2 përqind jetojnë në 1+1, 37.2 përqind jetojnë në 2+1 dhe 3.5 përqind e popullsisë totale jetojnë në 3+1. Kushtet infrastrukturore në Durrës janë optimale në të gjitha vendbanimet Rome, megjithatë pothuajse 94 përqind kanë probleme me kushtet e ndërtimit të banesave të tyre.

**Figura 5: Llojet e banesave, komuniteti Rom**




**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

Për sa i përket infrastrukturës inxhinierike dhe kushteve Higjieno-Sanitare, të dhënat e Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit tregojnë se 97 përqind e familjeve nuk i përmbushin standartet e kërkuara.

Për sa i përket vendbanimeve të komunitetit Egjiptian, Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit tregoi se 96 përqind e tyre jetojnë në 1+1 dhe pjesa tjetër e 4 përqindëshit jetojnë në 2+1 (figura 6). Kushtet infrastrukturore në Durrës janë optimale në të gjitha vendbanimet Egjiptiane, megjithatë të gjithë përballen me kushte kritike ndërtimi të strehimeve.

**Figura 6: Llojet e strehimeve, komuniteti Egjiptian**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

Në lidhje me infrastrukturën inxhinierike dhe kushtet Higjieno-Sanitare, 39 përqind e familjeve nuk i përmbush standartet e kërkuara.

Në përfundim, grupi i vlerësimit njih se nevojat e familjeve Rome dhe Egjiptiane, banesat e të cilave, janë jashtë standarteve të banimit janë veçanërisht emergjente në të pesta vendbanimet për shkak të mungesës së kushteve bazë për sa i përket standarteve infrastrukturore si dhe kushteve higjieno-sanitare.

### 3.2. Situata Ekonomike dhe Sociale e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane

Në mënyrë që nevojat për Strehim Social të prioritarizohen, situata e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane analizohet në bazë të një kombinimi treguesish të situatës socio ekonomike dhe kategorizimit të strehimit.

Për sa i përket situatës socio-ekonomike, përdoret klasifikimi i të ardhurave nga INSTAT. Sipas INSTAT, ka tre kategori bazë të ardhurash të cilat përdoren në vlerësimin e varfërisë, përkatësisht "Familje pa të ardhura", "Familje të ardhurat e të cilës janë më pak se 20,000 LEK në muaj" dhe "Familje të ardhurat e të cilës janë më pak se 30,000 LEK në muaj". Grupi i kërkimit i shtoi secilës kategori nga tre nën kategori, në mënyrë që të pasqyronte më saktë profilin e përjashtimit socio-ekonomik në Bashkinë e Durrësit.

Për sa i përket situatës së strehimit, përkufizimi "I pa strehë" përdoret sipas përcaktimit të Ligjit Nr. 9232, datë 13.05.2004 "Mbi Programet Sociale të Strehimit në Zonën Urbane" duke përfshirë dhe rishikimet dhe ndryshimet e këtij ligji.

Siç mund të kuptohet nga informacioni i dhënë në tabelën 7, ndërsa nuk ka asnjë familje me të ardhura 30,000 Lekë në muaj, pjesa më e madhe e familjeve në nevojë strehimi nuk kanë asnjë të ardhur.


**Tabela 7: Treguesi i Përbërë i situatës socio-ekonomike dhe e strehimit e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane**

Kategorizimi i Strehimit	Nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi		Kanë në pronësi hapësirë banimi nën standartin e banimit		Jetojnë në banesa nën standartin e banimit	
	Rom	Egjiptian	Rom	Egjiptian	Rom	Egjiptian
<b>Kategorizimi socio-ekonomik</b>						
Familje pa të ardhura	45	10	13	10	200	61
Pa të ardhura + persona të sëmurë	5	0	3	0	22	0
Familje pa të ardhura, me një mbajtës grua	0	0	0	0	3	0
Familje pa të ardhura + fëmijë <sup>1</sup>	0	0	0	5	0	3
Të ardhura < Lek20.000/m	5	8	2	3	20	8
Të ardhura < Lek20.000/m + persona të sëmurë	5	7	2	0	10	0
Të ardhura < Lek20.000/m, + fëmijë	0	0	0	0	10	0
Të ardhura < Lek20.000/m, një mbajtës grua	0	0	0	0	5	0
<b>Total</b>	<b>60</b>	<b>25</b>	<b>20</b>	<b>18</b>	<b>270</b>	<b>72</b>

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

Figura 7 tregon nevojat e strehimit për të dy komunitetet (Rom dhe Egjiptian) sipas të ardhurave të tyre.


**Figura 7: Strehimi Rom dhe Egjiptian sipas të ardhurave të tyre**



Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

Figura 8 ilustron përbërjen vetëm të "familjeve pa të ardhura" sipas nevojave të tyre të strehimit.

**Figura 8: Familje pa të ardhura të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane sipas situatës së strehimit, në përqindje**



Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

Ashtu si tregohet në figurat 7 dhe 8, pjesa më e madhe e familjeve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane jetojnë në varfëri të tejskajshme për shkak të mungesës së të ardhurave, ndërsa banesat e tyre janë nën çdo standart banimi.

### 3.3. Territori dhe infrastruktura e vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane

Për sa i përket territorit dhe infrastrukturës së vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane, pothuajse të gjitha familjet jetojnë në ndërtesa struktura e të cilave janë të amortizuara, ndërsa ndërhyrjet për ti përmirësuar ato janë të pamundura. Pjesa më e madhe jetojnë në tenda dhe magazina dhe janë të pambrojtur nga temperaturat ose reshjet. Banesat kryesisht kanë mungesë të elementeve bazë si çatitë, dyert, dritaret. Përveç kësaj, hapësira e jetesës së shtëpive është tej norme sipas legjislacionin të strehimit social.

Për sa i përket "vendndodhjes së vendbanimeve", distanca nga shërbimet e mirëqënies sociale është përtej standarteve. Vendbanimet janë larg qendrave mjekësore, shkollave dhe kopshteve. Siguria është një tjetër shqetësim kritik. Vendbanimet janë afër lumenjve, gjë e cila i vë ata në rrezik të vazhdueshëm ndaj përmbytjeve. Fëmijët në moshë shkollore janë në rrezik të lartë për shkak të vendndodhjes së pasigurt të vendbanimeve.

Vizitat në terren treguan se megjithëse këto vendbanime janë të pajisura me të gjithë infrastrukturën inxhinierike, pjesa më e madhe e familjeve nuk kanë akses ndaj saj.

Duke marrë në konsideratë përbërjen e familjeve ashtu si dhe kushtet ekzistuese të strehimit të popullsisë Rome në Bashkinë Durrës, ekipi i vlerësimit prodhoi tabelën 8, e cila ofron informacion rreth kërkesës për strehim në bashkinë Durrës. Në ndërtimin e tabelës 8, standartet ekzistuese



të strehimit sipas legjislacionit aktual, gjithashtu janë marrë në konsideratë. Në ndërtimin e tabelës 8, informacioni nga intervistat ballë për ballë është përdorur për të vlerësuar kërkesën totale.

Siç treguan të dhënat e përpunuara nga pyetësi 2, banesat ekzistuese janë jashtë çdo standarti, për këtë arsye të gjitha familjet kanë nevojë për një shtëpi të përshtatshme sipas standarteve, me përjashtim të vetëm 8 familjeve nga 113, të cilat kanë në pronësi një hapësirë banimi në përputhje me legjislacionin Shqiptar.


**Tabela 8: Kërkesa për strehim e komunitetit Rom në Bashkinë Durrës**

Lloji i Banesës	Nevojat e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit	Vlerësimi i nevojave
Nr. I familjeve që kanë nevojë për garsonierë	0	0
Zona totale e nevojshme për garsoniera (total m <sup>2</sup> )	0	0
% e garsonierave	0%	0%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 1+1	5	15
Zona totale e nevojshme për apartamente 1+1 (total m <sup>2</sup> )	227,8	706.18
% e 1+1	3.0%	3.0%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 2+1	26	81
Zona totale e nevojshme për apartamente 2+1 (total m <sup>2</sup> )	1474,8	4571.88
% e 2+1	19.3%	19.3%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 deri në 75,5 m <sup>2</sup>	42	130
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1 (total m <sup>2</sup> )	3160	9794.1
% e 3+1	41.4%	41.4%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 më shumë se 75,5 m <sup>2</sup>	31	96
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1+ (total m <sup>2</sup> )	2783	8627.34
% e 3+1+	36.4%	36.4%
<b>Numri Total i Familjeve</b>	<b>104</b>	<b>322</b>
<b>Zona totale e nevojshme për strehim m<sup>2</sup></b>	<b>7.645,6</b>	<b>23.699,5</b>

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

Siç tregon tabela 8, në mënyrë që të strehohet i gjithë komuniteti Rom, ka nevojë për 322 apartamente (92 përqind e numrit total të familjeve), me një hapësirë ndërtimi prej 23,699.5 m<sup>2</sup>, për të strehuar përkatësisht 81 familje me apartamente 2+1 (19% e popullsisë Rome totale) në 4571.88 m<sup>2</sup> hapësirë ndërtimi; 130 familje me apartamente 3+1 (41% e popullsisë Rome totale) në 9794.1 m<sup>2</sup> hapësirë ndërtimi dhe 96 familje me apartamente 4+ (36% e popullsisë Rome totale) në 8627.34 m<sup>2</sup> hapësirë ndërtimi.

**Figura 9: Nevojat për strehim të komunitetit Rom**



Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016


Tabela 9 jep të njëjtin informacion si tabela 8, por për komunitetin Egjiptian. Siç mund të shihet, 20 familje (13% e popullsisë Egjiptiane totale) kanë nevojë për apartamente 2+1, të cilat mund të ofrohen në një hapësirë ndërtimi prej 1137.5 m<sup>2</sup>. 35 familje (29%) kanë nevojë për apartamente 3+1, të cilat mund të ofrohen në një hapësirë ndërtimi prej 2642.5 m<sup>2</sup>, ndërsa 60 familje (58%) kanë nevojë për apartamente 4+. Në total, popullsia Egjiptiane në Durrës ka nevojë për 115 apartamente në një hapësirë ndërtimi prej 10.680 m<sup>2</sup>.

**Tabela 9: Kërkesa për strehim e komuniteti Egjiptian në Bashkinë Durrës**

Lloji i Banesës	Nevojat e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit	Vlerësimi i nevojave
Nr. i familjeve që kanë nevojë për garsonierë	0	0
Zona totale e nevojshme për garsoniera (total m <sup>2</sup> )	0	0
% e garsonierave	0%	0%
Nr. i familjeve që kanë nevojë për apartamente 1+1	0	0
Zona totale e nevojshme për apartamente 1+1 (total m <sup>2</sup> )	0	0
% e 1+1	0%	0%
Nr. i familjeve që kanë nevojë për apartamente 2+1	4	20
Zona totale e nevojshme për apartamente 2+1 (total m <sup>2</sup> )	227,2	1137.5
% e 2+1	12.6%	12.6%
Nr. i familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 deri në 75,5 m <sup>2</sup>	7	35
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1 (total m <sup>2</sup> )	528.5	2642.5
% e 3+1	29.4%	29.4%
Nr. i familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 më shumë se 75,5 m <sup>2</sup>	12	60
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1+ (total m <sup>2</sup> )	1041	5205
% e 4+	57.9%	57.9%
<b>Numri total i familjeve</b>	<b>23</b>	<b>115</b>
<b>Zona totale e nevojshme për strehim</b>	<b>1.796,7</b>	<b>8.983,5</b>

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

**Figura 10: Nevojat për strehim të komunitetit Egjiptian**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

### 3.4 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 3

Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në bashkinë e Durrësit vuajnë nga përjashtimi i shumëfishtë socio-ekonomik, i cili manifestohet nëpërmjet varfërisë ekstreme në të cilën jetojnë. E drejta e tyre themelore për strehim i është mohuar.

- ▶ Vetëm 6 përqind e Romëve dhe 16 përqind e Egjiptianëve kanë në pronësi një hapësirë banimi, edhe pse ajo është jashtë çdo standarti jetese. Pjesa më e madhe e Romëve dhe Egjiptianëve në bashkinë Durrës, përkatësisht 77 përqind nga komuniteti Rom dhe 62 përqind nga komuniteti Egjiptian kanë nevojë për banesa për shkak të mungesës së kushteve bazë të jetesës.
- ▶ Edhe pse vendbanimet e tyre janë të pajisura me ifrastrukturë dhe janë afër me qytetin e Durrësit si dhe shërbimet bazë të mirëqënies sociale, mungesa e higjienës bazë dhe kushteve të jetesës, i vendos ata në rrezik të lartë përjashtimi.
- ▶ Kushtet e strehimit të komunitetit Rom në bashkinë e Durrësit janë veçanërisht të këqija: vetëm 1,9 përqind jetojnë në shtëpi të standardizuara. Pothuajse asnjë nga familjet nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimeve. Edhe pse të gjitha banesat janë të lidhura me rrjetin e furnizimit me energji dhe atë të ujit, pothuajse asnjë prej tyre nuk ka elektricitet si dhe ujë të pijshëm dhe/ose tualet të brendshëm.
- ▶ Duket e përshtatshme të arrihet në konkluzionin se ekziston nevoja për shtëpi për 350 familje Rome dhe 115 familje Egjiptiane, të cilat mund të strehohen në një hapësirë ndërtimi prej 34,379.5 m<sup>2</sup>.
- ▶ Fatkeqësisht, komunitetet Rome dhe Egjiptiane nuk mund ta zgjidhin vetë situatën e tyre të strehimit për shkak të mungesës së të ardhurave. 76 përqind e atyre në nevojë kritike për strehim (jetojnë në banesa jashtë çdo standarti) nuk kanë asnjë të ardhur.
- ▶ Për këtë arsye, strehimi social mbetet politika e vetme efektive për të zgjidhur nevojat e strehimit midis komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.

## 4.

## ALTERNATIVA TË POLITIKAVE PUBLIKE

### 4.1. Ndërhyrjet dhe planet e qeverisë vendore

Ligji Nr. 9232 për “Strehimin Social” u miratua për herë të parë në vitin 2004. Që prej asaj kohe, ligji është ndryshuar disa herë me qëllim rritjen e efektivitetit të tij duke lehtësuar procedurat e aplikimit si dhe rritjen e aksesit për personat e pastrehë ndaj tregut të banesave. Për më tepër, Bashkia Durrës ka adresuar Planin Urban dhe Strehimit në Planet e saj Strategjike të Zhvillimit siç janë Strategjia Rajonale e Zhvillimit për qytetin e Durrësit (2005) dhe Strategjia e Zhvillimit Territorial, 2015-2030. Megjithatë, një strategji specifike mbi strehimin ende nuk është miratuar.

Përpos kësaj, bashkia Durrës është përpjekur ta zgjidhë problemin e strehimit. Derimë tani, 695 familje kanë përfituar nga programi i strehimit me kosto të ulët i Entit Kombëtar të Banesave (EKB), 256 familje nga programet e banesave sociale me qera, ndërsa 88 apartamente janë në proces shpërndarje. Për më tepër, 283 familje të tjera kanë përfituar nga programi i “kredisë me kosto të ulët” (në total 1,322 duke përfshirë 88 apartamentet që nuk janë ndarë ende).

Edhe pse analiza e problemit të përgjithshëm të strehimit shkon përtej qëllimit të këtij studimi, grupi i studimit argumentoi se zgjidhjet e përmendura më sipër kanë arritur të strehojnë vetëm 21 përqind të kërkesës aktuale për strehim.

Situata e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane duket më dramatike. Vetëm 5 familje përkatësisht nga secili komunitet i synuar, ka përfituar nga programet e Strehimit Social, përkatësisht nga programi i “Subvencionimit të qerasë”. Tabela 10 paraqet një përmbledhje të arsyeve që i pengojnë familjet Rome dhe Egjiptiane të zgjidhin çështjet e strehimit.

**Tabela 10: Arsyet që pengojnë familjet Rome dhe Egjiptiane të përmbushin të drejtën e tyre për “Strehim”**

	KUFIZIMET E KËRKESËS	KUFIZIMET E OFERTËS
TREGU I PËRGJITHSHËM I STREHIMIT	Pa të ardhura ose familje me të ardhura të ulta. Pa akses ose me akses të limituar ndaj tregut të huave për shkak të mungesës së pronave. Pa alternativa për të siguruar garancitë bankare.	Çmime të larta të shtëpive në tregun privat. Ndërtime informale, pa çertifikatë pronësie të ligjshme. Shfuqizimi i ndërtimeve të reja.
SEGMENTI I TREGUT TË STREHIMIT TË ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE	Pa regjistrim në zyrën e gjendjes civile. Informaliteti i vendit të banimit. Traditat e jetesës.	Dëshirë e ulët/ refuzim i tregut privat për të strehuar familjet Rome dhe Egjiptiane.

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

Tabela 11 tregon pjesën e buxhetit vendor të përcaktuar për strehimin social. Siç mund të kuptohet qartësisht, edhe pse transfertat e pakushtëzuara të 2016 përbëjnë 20 përqind të buxhetit total, fondet vendore të alokuara për strehimin social përbëjnë vetëm 4 përqind, ndërsa fondet nga të ardhurat vendore janë të papërfillshme.

**Tabela 11: Buxheti i Bashkisë Durrës i alokuar për strehimin social, 2010-2016**

Buxheti/vitet	2010-2015	Në %	2016	Në%
Total në 000/Lek	6.337.068		2.819.356	
Transfertat e pakushtëzuara në 000/Lek			573,031	20
Buxheti total i alokuar për Strehimin Social në 000/Lek	180.152	3	114.193	4
Të ardhurat vendore për strehimin social në 000/Lek	8.981	0,1	1.372	0,05
Ngritje fondesh (burime të tjera, donacione, fonde të jashtme) në Euro	3.341.410			

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

Gjetjet sugjerojnë se Bashkia e Durrësit, në gjendjen aktuale buxhetore, nuk mund ta zgjidhë çështjen e strehimit as për Romët dhe Egjiptianët as për të gjithë popullsinë. Megjithatë, të gjitha alternativat e politikave publike do të diskutohen në pjesët e mëtejshme të raportit.

## 4.2 Sugjerime politikash publike për të zgjidhur Çështjen e Strehimit në Bashki

Duke ju referuar Ligjit Nr. 9232, programet e strehimit social janë "programe të cilat shërbejnë për të strehuar familjet dhe individët të cilët për shkak të situatës së tyre ekonomike dhe sociale nuk mund të përballojnë ofertën e tregut të lire ose kredinë".

Qeveria ka krijuar tre programe të strehimit social: **banesa sociale me qera, banesat me kosto të ulët, dhe programin e pajisjes së truallit me infrastrukturë**. Për më tepër, qeveria ka krijuar ofrimin e subvencioneve të strehimit, subvencionimit të kredive, grantet e vogla, dhe grantet e menjëhershme të cilat synojnë grupe specifike (shih më poshtë për një përshkrim të secilit program). Përfituesit e programeve të strehimit social duhet të përmbushin një nga kriteret në vazhdim: ata nuk duhet të kenë një banesë në pronësi, duhet të kenë një banesë e cila është nën normat e banimit; ose duhet të jenë të pastrehë për shkak të katastrofave natyrore (Ligji 9232, Neni 4).

Zgjedhja e përfituesve bazohet në kushtet e tyre të jetesës si dhe rrethanave të tyre sociale dhe ekonomike. Prioriteti është vendosur mbi 15 grupe, duke përfshirë familjet me një prind kryefamiljar, familjet e gjera, të rriturit më të vjetër, personat e paaftë, çiftet e reja, familjet që kanë ndryshuar vendbanim, jetimët, emigrantët që kthehen, punonjësit e migruar nga qyteti në qytet, azilkërkuesit, oficerët e rënë në detyrë, viktimat e dhunës familjare, familjet Rome, familjet Egjiptiane, dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.

Për tu përzgjedhur në sistemin e pikëzimit, familja duhet të përmbushë dy kushte: Të ardhurat mujore nuk duhet të jenë më të larta se 100% e mesatares së zonës për strehim social dhe 120% për strehimin me kosto të ulët; Familjet nuk duhet të kenë në pronësi një banesë, ose të jetojnë në një shtëpi, përmasat e të cilës nuk janë më të mëdha se standartet minimale të vendosura nga ligji.

Për të vlerësuar programet e Strehimit Social të cilat mund të jenë efektive për Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Durrës, u ndërtua tabela 12. Nga analiza e thellë e informacionit të dhënë në tabelën 12, gjasat e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane për të patur akses ndaj programeve të Strehimit Social duken të ulta.

**Tabela 12: Vlerësimi i programeve të Strehimit Social kundrejt kushteve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.**

Programet e Strehimit Social	Kriteret e përgjithshme	Familjet në nevojë strehimi		
		Nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	Kanë në pronësi hapësirë banimi nën standartin e banimit	Jetojnë në banesa nën standartin e banimit
	1. Nuk duhet të kenë në pronësi një shtëpi; 2. Duhet të kenë një vend banimi nën normat e strehimit; 3. Duhet të jenë të pastrehë për shkak të katastrofave natyrore	85 familje, nga të cilat 60 familje pa të ardhura dhe 25 me të ardhura të pamjaftueshme, më pak se 20,000 lekë në muaj.	38 familje, nga të cilat 31 familje pa të ardhura dhe 7 familje me të ardhura të pamjaftueshme prej 20,000 lekë në muaj.	342 familje, prej të cilave 286 familje pa të ardhura dhe pjesa tjetër me të ardhura të pamjaftueshme.
BSQ Banesat Sociale me Qera	Qeveria vendore ndërton njësi strehimi, të cilat jepen me qera me çmime të lira për kategoritë sociale.	Mund të aplikojnë nëse "kushtet e qerasë" ndryshohen.	Mund të aplikojnë nëse "kushtet e qerasë" ndryshohen.	Mund të aplikojnë nëse "kushtet e qerasë" ndryshohen.
SS Subvencionimi i Strehimit	Autoritetet vendore mund të alokojnë subvencione strehimi për përfituesit e banesave sociale me qera. $SS \leq 50\%$ e vlerës minimale të qerasë. $(Vlera\ e\ qerasë - SS) \leq 30\%$ e të ardhurave të familjes.	Mund të aplikojnë nëse "kushtet e qerasë" ndryshohen.	Mund të aplikojnë nëse "kushtet e qerasë" ndryshohen.	Mund të aplikojnë nëse "kushtet e qerasë" ndryshohen.
BKU Banesat me Kosto të Ulët	Njësit me kosto të ulët ndërtohen ose blihen me çdo fond për familjet, të ardhurat e të cilave janë $\leq 120\%$ e mesatares së të ardhurave të rrethit.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.

Programet e Strehimit Social	Kriteret e përgjithshme	Familjet në nevojë strehimi		
		Nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	Kanë në pronësi hapësirë banimi nën standartin e banimit	Jetojnë në banesa nën standartin e banimit
TPI Trualli i pajisur me infrastrukturë	Investime në infrastrukturën e truallit në prona shtetërore, nga qeveria vendore për qëllime sociale ose përfitim. Duhet të ketë truall të lirë.	Mund të aplokojnë nëse:  Ka truall të lirë; Kosto e lejon; Të përcaktuara për "qëllime sociale"	Mund të aplokojnë nëse:  Ka truall të lirë; Kosto e lejon; Të përcaktuara për "qëllime sociale"  Territoret ekzistuese mund të përdoren. E lejojnë kushtet infrastrukturore dhe inxhinierike të territoreve ekzistuese.	Mund të aplokojnë nëse:  Ka truall të lirë; Kosto e lejon; Të përcaktuara për "qëllime sociale"  Territoret ekzistuese mund të përdoren. E lejojnë kushtet infrastrukturore dhe inxhinierike të territoreve ekzistuese.
SBQ Subvencionimi i Banesave me qera	Nëse qeraja e njësisë sociale të strehimit $\geq 25\%$ të të ardhurave të familjes, familja përfiton subvencionim qeraje. SBQ = qeraja aktuale – qeraja e përballueshme.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.
SK Subvencionimi i Kredive	Përfituesit e banesave me kosto të ulët kanë të drejtë të marrin një kredi me terma të favorshëm nga një institucion financiar, i cili ka një kontratë me Ministrinë e Financave.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.
Grantet e vogla, dhe grantet e menjëhershme që synojnë grupe specifike (shih më poshtë për përshkrimin e secilit program)	Përfituesve të banesave me kosto të ulët i jepen grante të menjëhershme në rrethana të veçanta.	Nuk aplikojnë	Nuk aplikojnë	Nuk aplikojnë

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

Ndërsa ndryshimi i kushteve të qerasë si dhe e "qëllimit social" kërkojnë akte ligjore, duket se shkalla e opsioneve është e ulët për zgjidhjen e nevojave të strehimit kundrejt komuniteteve Rome dhe Egjiptiane:

#### Opsion 1:

##### Programi BSQ: Qeveria vendore ndërton njësi banimi.

Hipotezat:

- Ka truall të lirë.
- Ka vullnet politik dhe mundësi financiare për të ofruar strehim pa pagesë.
- Risku i diskriminimit pozitiv neglizhohet.

Përfituesit sipas opsionit: 437 familje, vetëm ato që jetojnë në banesa jashtë çdo standarti.

Gjatë vizitës në terren në Durrës, në zonën e Nish Tullës, grupi identifikoi një truall të mundshëm ndërtimi (në pronësi të bashkisë Durrës). Sipas informacionit të dhënë nga Bashkia kjo zonë është afërsisht 5,000m<sup>2</sup>. Gjatë vizitës, grupi u informua se shumë familje që banojnë atë vendndodhje, kishin filluar procedurat për legalizimin e shtëpive. (shih aneksin e fotove). Rekomandimi ynë do të ishte të ndërtoheshin banesa sociale të reja në atë truall dhe të strehoeshin familjet Rome të zonës.

#### Opsion 2:

##### Programi PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në pronat shtetërore.

Hipotezat:

- Ka truall të lirë/ prona shtetërore të lira/ objekte.
- Ka vullnet politik dhe mundësi financiare për të ofruar strehim pa pagesë.
- Risku i diskriminimit pozitiv neglizhohet.

Përfituesit sipas opsionit: 437 familje, vetëm ato që jetojnë në banesa jashtë çdo standarti.

Nuk ka "truall të lirë" në të cilin ekziston vetëm nevoja e investimit në infrastrukturë. Mundësia e vetme për zgjidhje duket se është ajo e shtjelluar në Opsionin 1.

#### Opsion 3:

##### Programi PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në vendbanimet ekzistuese Rome dhe Egjiptiane.

Hipotezat:

- Mundësia e përdorimit efektiv i territoreve ekzistuese është e lartë.
- Kushtet infrastrukturore dhe inxhinierike të territoreve ekzistuese e lejojnë.

Përfituesit sipas opsionit: 356 familje. Ky është numri i familjeve në nevojë për përmirësim të kushteve të jetesës, por që zotërojnë një hapësirë banimi.

#### Opsion 4:

##### Një kombinim ndërmjet tre alternativave të mëparshme

Përfituesit sipas opsionit: 437 familje (të njëjtën si në Opsionin 1).

### 4.3. Një vlerësim i koston për ndërhyrje të ndryshme të bashkive

#### Opsioni 1:

**Programi BSQ: Qeveria vendore ndërton njësi banimi.**

Disa kritere merren në konsideratë:

- Kosto mesatare e njësisë i referohet **“Udhëzimit nr.4 dt 30.4.2015 për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2015.”**
- Sipas **Entit Kombëtar të Banesave**, kosto mesatare e ndërtimit në Durrës është 32.107 lek/m<sup>2</sup>.
- Kosto për rrjetin inxhinierik vlerësohet në 23 €/m<sup>2</sup>; 3197 lek/m<sup>2</sup> (10€ rrjeti elektrik, 5 € për IT, 8€ për furnizimin me ujë, kanalizime dhe rrjeti i pusetave).

Prandaj, vlerësimi i koston për ndërtimet e reja për komunitetin Rom (322 apartamente në 23.699,5 m<sup>2</sup> hapësirë ndërtimi):

$$\text{Kosto e ndërtimit} = 23.699,5 \text{ m}^2 * 32.107 \text{ lek/m}^2 = \text{Lek } 760.919.846,5$$

$$\text{Rrjetet inxhinierike} = 23.699,5 \text{ m}^2 * 3.197 \text{ lek/m}^2 = \text{Lek } 75.767.301,5$$

$$\text{Kosto totale} = 760.919.846,5 \text{ lek} + 75.767.301,5 \text{ lek} = \text{Lek } 836.687.148$$

Vlerësimi i koston për ndërtimet e reja për komunitetin Egjiptian (115 apartamente në 8.983,5m<sup>2</sup> hapësirë ndërtimi):

$$\text{Kosto e ndërtimit} = 8.983,5 \text{ m}^2 * 32.107 \text{ lek/m}^2 = \text{Lek } 288.433.234,5$$

$$\text{Rrjetet inxhinierike} = 8.983,5 \text{ m}^2 * 3.197 \text{ lek/m}^2 = \text{Lek } 28.720.249,5$$

$$\text{Kosto totale} = 288.433.234,5 \text{ lek} + 28.720.249,5 \text{ lek} = \text{Lek } 317.153.484$$

**Opsioni 1: Kosto Totale për ndërtim të ri = Lek 1.153.840.632**

#### Opsioni 2:

**Programi PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në pronat shtetërore.**

Ky opsion nuk është përpunuar më tej pasi nuk ka asnjë pronë shtetërore e lirë e cila mund të përdoret për këtë qëllim. Në kushtet e dhëna, ky program nuk mund të aplikohet.

#### Opsioni 3:

**Program PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në vendbanimet ekzistuese Rome dhe Egjiptiane.**

Disa kritere janë marrë në konsideratë:

- Udhëzimi i MZHU datë 03/08/2015 për sa i përket koston maksimale të rehabilitimit të infrastrukturës ekzistuese.
- Kosto e rehabilitimit nuk duhet të kalojë 650.000,00 lekë/banesë dhe ndërtimi i ri nuk duhet të tejkalojë 1.200.000,0 lekë/banesë (përfshirë TVSH).

- Vetëm familjet që zotërojnë një hapësirë banimi dhe kosto mesatare e rehabilitimit/ndërtimit të ri përlogarit 925.000,0 lekë (650.000 + 1.200.00)/2, janë marrë në konsideratë

**Table 13: Përmbledhje e rezultateve të familjeve të intervistuar**

Nr. I familjeve që nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	32
Nr. I familjeve që zotërojnë hapësirë banimi nën kërkesat e zonës	104
Nr. I familjeve që banojnë nën standartet e miratuara	136
Nr. I familjeve që jetojnë në qendra komunitare	0

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

Siç mund të shihet nga tabela 13 e mësipërme, 104 familje nga 136 (76.5%) e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane zotërojnë një hapësirë banimi, e cila është nën standartet e kërkuara për zonës. Sipas tabelës 2, 380 familje nga 465 (81.7%) e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane zotërojnë një hapësirë banimi nën standartet e banimit. Bazuar në kriteret e shtjelluara mësipër, numri i përfituesve potencial janë 380 familje (81.7 përqind e 465 familjeve).

**Kosto totale e rehabilitimit = 380 familje \* 925.000,0 lekë/familje = Lekë 351.500.000,0**

**Opsioni 3: Kosto Totale për rehabilitim = Lekë 351.500.000,0**

Ekipi nuk sugjeron këtë opsion pasi nuk e zgjidh problemin e strehimit për sa i përket standartit minimal të hapësirës së banimit sipas ligjeve Shqiptare.

#### Opsioni 4:

**Një kombinim ndërmjet tre alternativave të mëparshme**

Ky opsion nuk konsiderohet më tej pasi siç mund ta shohim nga opsioni i mëparshëm, i vetmi që mund ta zgjidhe në mënyrë permanente problemin e strehimit është opsioni nr. 1.

**Tabela 14: Përmbledhje e rezultateve të kostove të alternativave të politikave në krahasim me Buxhetin Bashkiak aktual**

Opsioni i Politikës	Kosto	Buxheti Bashkiak 2016	Në % në krahasim me buxhetin aktual
Opsioni 1 (në 000)	Lekë 1.153.841	Lekë 2.819.356.	41 përqind
Opsioni 3 (në 000)	Lekë 351.500	Lekë 2.819.356	12,5 përqind

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

#### 4.4 Plan veprimi për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane

	Objektivat/detyrat	Kohëzgjatja	Rezultate/Mjetet e verifikimit
<b>1.</b>	<b>Bashkia Durrës Strategjia e Strehimit për Romët dhe Egjiptianët</b>	<b>Qershor 2017</b>	<b>Strategjia e Strehimit për Romët dhe Egjiptianët miratohet nga Këshilli Bashkiak</b>
1.1	Diskutim dhe miratim i raportit të Vlerësimit	Dhjetor 2016	Raporti i Takimit
1.2	Analiza në thellësi i opsioneve të politikave	Janar 2017	Këshilli Bashkiak është në djeni të opsioneve të politikave.
1.3	Ri-vlerësim i nevojave për strehim	Shkurt 2017	Raporti i vlerësimit validohet nga Ekipi i Menaxhimit të Bashkisë
1.4	Ri-vlerësimi i furnizimit të strehimit.	Shkurt 2017	Raporti i vlerësimit validohet nga Ekipi i Menaxhimit të Bashkisë
1.5	Ri-vlerësimi i alternativave të politikës.	Mars 2017	Merret vendimi final mbi politikën më të mirë.
1.6	Përgatitja dhe miratimi i Strategjisë	Maj 2017	Strategjia miratohet nga Këshilli
1.7	Përgatitja e planit të implementimit	Qershor 2017	Plani i implementimit miratohet
<b>2.</b>	<b>Buxheti i Strategjisë së Strehimit për Romët dhe Egjiptianët</b>	<b>Tetor 2017</b>	<b>Bashkia ngrre fonde të mjaftueshme për të përballuar implementimin e Strategjisë së Strehimit</b>
2.1	Rishikimi i buxhetit vendor	Qershor 2017	Miratohet plan buxheti i ri
2.2	Diskutim mbi strategjinë me palët e interesuara dhe donatorët	Qershor 2017	Vullneti i palëve të interesuara për të investuar konfirmohet
<b>3.</b>	<b>Rishikimi i legjislacionit</b>	<b>Qershor 2017</b>	<b>Legjislacioni rishikohet dhe miratohet</b>
3.1	Propozim për rishikim të legjislacionit mbi Strehimin Social sipas opsioneve të politikave të identifikuar	Qershor 2017	Ndryshime ndaj legjislacionit miratohen
<b>4.</b>	<b>Implementohet Strategjia e Strehimit</b>	<b>Dhjetor 2017</b>	<b>Plani i investimit për zgjidhjen e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane miratohet nga Këshilli Bashkiak</b>
4.1	Identifikimi i nevojave për ndërtim (analizë e detajuar)	Tetor 2017	Miratohet plani i investimit
4.2	Zgjidhja e problemeve ligjore midis zonave të ndërtimit të zgjedhura dhe/ose sugjeruara.	Nëntor 2017	Çdo problem ligjor është zgjidhur
4.3	Studim i realizueshmërisë së zonave të ndërtimit të zgjedhura dhe/ose sugjeruara	Nëntor 2017	Plani i investimit miratohet
4.4	Finalizimi i planit të investimit	Dhjetor 2017	Projekti i investimit miratohet nga ekipi i menaxhimit të bashkisë.

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

#### 4.5 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 4

Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Durrës kanë nevojë urgjente të zgjidhet çështja e strehimit të tyre. Megjithatë:

- ▶ Gjetjet sugjerojnë se Bashkia Durrës me situatën aktuale të buxhetit, nuk mund ta zgjidhë çështjen e strehimit as për Romët dhe Egjiptianët dhe as për pjesën tjetër të popullsisë.
- ▶ Pavarësisht se qeveria ka krijuar programe të strehimit social, shumica prej tyre nuk duken të përshtatshme për të zgjidhur nevojat e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane për shkak të kufizimeve të të ardhurave.
- ▶ Vetëm dy programe të strehimit social mund të merren në konsideratë, përkatësisht banesat me kosto të ulët, dhe programi i pajisjes së truallit me infrastrukturë, nëse merren në konsideratë disa ndryshime ligjore.
- ▶ Megjithëse përlogaritja e kostove për opsionet e politikave tregon se në terma absolute ato mund të financohen nga bashkia, kjo mund të mos jetë e mundur për shkak të shpenzimeve të tjera që bashkia duhet të kryejë.
- ▶ Nga ana tjetër, ka kosto të tjera indirekte të cilat mund të hasen për shkak të rreziqeve të lidhura me secilin nga opsionet e politikave. Për më tepër, disa nga rreziqet mund të kenë implikime financiare, përkatësisht risku i diskriminimit pozitiv, risku i izolimit si dhe risku i tensioneve sociale midis ish-pronarëve të pronave dhe truallit.
- ▶ Përfundimisht, është e nevojshme të ndërtohen 465 banesa, përkatësisht për 350 familje Rome dhe 115 familje Egjiptiane, të cilat mund të realizohen në një hapësirë ndërtimi prej 34,379.5 m<sup>2</sup>, ndërsa bashkia ka ofruar vetëm 5,000 m<sup>2</sup> terren ndërtimi.
- ▶ Fatkeqësisht, komunitetet Rome dhe Egjiptiane nuk mund ta zgjidhin vetë situatën e tyre të strehimit për shkak të mungesës së të ardhurave. 76 përqind e atyre në nevojë kritike për strehim (jetojnë në banesa jashtë çdo standarti) nuk kanë asnjë të ardhur.
- ▶ Strehimi social mbetet politika më efektive për të zgjidhur nevojat e strehimit midis komuniteteve Rome dhe Egjiptiane. Midis alternativave të ndryshme të politikave të sugjeruara në raport, Opsioni 1 (Programi: Qeveria vendore ndërton njësi strehimi) duket i realizueshëm. Kosto e tij në mijë lekë është 1,153,840,632 (437 banesa), ndërsa Opsioni 2, Rikonstruksioni i banesave ekzistuese (380 banesa), kushton 351,500,000 mijë lekë.
- ▶ Kosto e rehabilitimit të infrastrukturës në mijë lekë është 104,487,551.

## KONKLuzionet finale

Në përgjithësi gjetjet sjellin një kuadër të qartë të sfidave me të cilat përballet strehimi social në bashkinë Durrës. Analiza tregon se kuadri ligjor aktual nuk është i mjaftueshëm për të zgjidhur problemet e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane. Gjetjet e kapitujve 3 dhe 4 sugjerojnë se adresimi i problemit të të pastrehëve Rom dhe Egjiptian në Durrës kërkon ndërmarrjen e hapave të shumëfishtë njëkohësisht, për shembull, rishikimi i kuadrit ligjor, zhvendosja e vëmendjes së programeve të strehimit social dhe financimit në drejtim të të varfërve më të varfër, dhe fuqizimi i kapaciteteve fiskale të qeverive vendore.

Raporti i vlerësimit ofron një kontribut të vlefshëm në plotësimin e disa hapësirave në të dhëna specifike duke rishikuar dhe vlerësuar provat ekzistuese mbi kushtet e strehimit dhe jetesës (p.sh., kushtet e banimit, aksesit ndaj ujit, elektricitetit dhe kanalizimeve) të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë e Durrësit.

Për më tepër, raporti sjell një kontribut të vlefshëm në nivel politike. Plani i Veprimit, i zhvilluar në pikën 4.4 mund të përdoret si instrument udhëheqës për MZHU dhe bashkëpunimin e saj me institucionet e nivelit shtetëror, qeveritë vendore dhe organizatat komunitare për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Durrës.


Megjithatë, Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit ka një rëndësi të veçantë për Bashkinë e Durrësit. Në nivel qeverisje vendore, duke përlogaritur investimet që duhen kryer në bashkinë e Durrësit me qëllim përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, gjetjet dhe sugjerimet nuk do të kontribuojnë vetëm në implementimin e Planit të Veprimit, por gjithashtu në fuqizimin e kapaciteteve të administratës vendore kundrejt implementimit në tërësinë e saj të strategjisë së strehimit social në nivel vendor.

## Bibliografia


- A Needs Assessment Study on Roma and Egyptian Communities in Albania, CESS mbështetur nga UNDP, 2012
- Civil Society Monitoring Report, the Implementation of the National Roma Integration CORRUPTION RISK ASSESSMENT: PROVISION OF SOCIAL HOUSING IN
- ALBANIA, Dritan Shutina, May 2011
- Housing Policies and Practice for Roma in Albania, UNDP ALBANIA, SEPTEMBER 2013
- National Strategy for Development and Integration, 2014-2020.
- National Action Plan for the Integration of Roma and Egyptians in Albania, 2016-2020; Roma and Egyptian in Albania- Socio-demographic and economic profile, based on census 2011, January 2015.
- Strategy and Decade Action Plan in 2012, ALBANIA, 2013, HDPC
- Strategy for Social Housing, 2015-2025
- Social Inclusion Policy Document, 2015-2020

# SHTOJCË

## Harta e Vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane







REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

PROGRAMI “MBËSHTETJA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE NË SHQIPËRI”

VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
**ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKINË KRUJË**  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË TYRE

---

RAPORTI FINAL  
Janar 2017





## PËRMBAJTJA

FALËNDERIME	5
LISTA E SHKURTIMEVE	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
HYRJE	9
KAPITULLI 1: RISHIKIMI I KONTEKSTIT LIGJOR KUNDREJT TË DREJTËS PËR STREHIM TË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE	11
1.1 Situata e përgjithshme e nevojave për strehim të Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë e Krujës	
1.2 “Strehimi” Politikat Publike të adoptuara në Bashkinë Krujë	
1.3 Evidenca mbi përmirësimin e kushteve të banimit dhe të jetesës, të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Krujës	
KAPITULLI 2: METHODOLOGJIA E KËRKIMIT	15
2.1 Shtrirja, qëllimi dhe objektivat e studimit	
2.2 Karakteristikat e kampionit	
2.3 Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave	
2.4 Parimet e analizës	
A. Proçesi i përmirësimit të kushteve ekzistuese të jetesës në strukturat rezidenciale	
B. Përdorimi i fondit të lirë ekzistues të strukturave rezidenciale (nëpërmjet blerjes ose proçesit të punësimit)	
C. Ndërtimi i strukturave të reja dhe infrastrukturës për qëllim të strehimit social	
KAPITULLI 3: ANALIZA PËRSHKRUESE DHE E DETAJUAR E KUSHTEVE TË STREHIMIT DHE JETESËS SË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE (GJETJET E STUDIMIT)	21
3.1 Situata e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	
3.2 Situata ekonomike dhe sociale e Komuniteteve R&E	
3.3 Territori dhe infrastruktura e vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane	
3.4 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 3	
KAPITULLI 4: ALTERNATIVA TË POLITIKAVE PUBLIKE	35
4.1 Ndërhyrje dhe plane të qeverisë vendore	
4.2 Sugjerime politikash publike për të zgjidhur problemin e strehimit në Bashki	
4.3 Një vlerësim i kostos për ndërhyrje të ndryshme të bashkive	
4.4 Plan veprimi për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	
4.5 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 4	
KONKLuzionet finale	44
BIBLIOGRAFIA	45
SHTOJCË: HARTA E VENDBANIMEVE	46

### Raport

*“Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Krujë, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të tyre”*

Ky dokument është përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Urban në konsultim të ngushtë me përfaqësues të Bashkive dhe shoqërisë civile, si dhe ekspertëve të organizatave lokale dhe të fushës së strehimit social.

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit është ofruar nga Qendra Kombëtare Shqiptare për Studime Sociale (NCSS) dhe WeissGerber & Partners (W&P) në kuadër të Projektit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (UNSSIA), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), apo të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Tiranë, Janar 2017

## Lista e tabelave dhe figurave

Tabela 1: Karakteristikat e kampionit	16
Tabela 2: Numri i familjeve të pastreha (banorëve) në Bashkinë Krujë sipas etnisë kulturore, 2016	22
Tabela 3: Gjendja e familjeve të pastreha Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Krujës	22
Tabela 4: Vendbanimet e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Krujë, 2016	24
Tabela 5: Numri i intervistave ballë për ballë në Bashkinë Krujë	25
Tabela 5.1: Intervistat në secilin vendbanim Rome dhe Egjiptian të Bashkisë Krujë, 2016	26
Tabela 6: Familjet nga Komunitetet R&E sipas gjendjes së strehimit	26
Tabela 7: Aksesi tek rrjetet e furnizimit me ujë, kanalizimet dhe energjia të Komuniteteve R/E në Bashkinë Krujë	27
Tabela 8: Treguesi i përbërë i gjendjes social-ekonomike & situatës së strehimit të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	29
Tabela 9: Kërkesa për strehim e komunitetit Rom në Bashkinë Krujë	32
Tabela 10: Kërkesa për strehim e komuniteti Egjiptian në Bashkinë Krujë	33
Tabela 11: Arsytet që pengojnë familjet Rome dhe Egjiptiane të realizojnë të drejtën për strehim	35
Tabela 12: Buxheti i Bashkisë Krujë për strehim social, 2016	36
Tabela 13: Zbërthimi i familjeve të pastreha sipas të ardhurave	37
Tabela 14: Vlerësimi i programeve të Strehimit Social kundrejt kushteve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	37
<hr/>	
Figura 1: Të pastrehë Romë dhe Egjiptianë në krahasim me totalin e të pastrehëve dhe popullsinë, 2016	21
Figura 2: Familje të pastreha në përqindje, 2016	23
Figura 3: Situata e strehimit e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Krujës, 2016	23
Figura 4: Vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, sipas llojit të problemit të strehimit, 2016	25
Figura 5: Situata aktuale e strehimit e komuniteteve R/E	27
Figura 6: Llojet e banesave, komuniteti Rom	28
Figura 7: Llojet e strehimeve, komuniteti Egjiptian	28
Figura 8: Strehimi Rom dhe Egjiptian sipas të ardhurave të tyre	30
Figura 9: Familje pa të ardhura të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane sipas situatës së strehimit, në përqindje	30
Figura 10: Nevojat për strehim të komunitetit Rom	32
Figura 11: Nevojat për strehim të komunitetit Egjiptian	34



## FALËNDERIME

Qendra Kombëtare Shqiptare e Studimeve Sociale (NCSS), dhe Weiss Gerber & Partners, produkt i punës së të cilëve është ky studim, falënderojnë grupin e ekspertëve të drejtuar nga Prof.Asoc.Dr. Arlinda Ymeraj dhe Znj. Ardiana Fortuzi.

Falënderime të veçanta për punonjësit e Bashkive Tiranë, Durrës, Lezhë, Krujë dhe Shkodër që, në cilësinë e institucioneve zbatues të programeve të strehimit, mblodhën dhe përpunuan informacionin në përputhje të plotë me kërkesat e këtij vlerësimi. I shprehim mirënjohje stafit të Ministrisë së Zhvillimit Urban, në veçanti Znj. Aida Seseri, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Urbane dhe Strehimit, për mbështetjen e profesionale në kryerjen e studimit si dhe stafin e UNDP për administrimin e kujdesshëm të procesit.

## LISTA E SHKURTIMEVE

Bashkimi European	<b>BE</b>
Ministria e Zhvillimit Urban	<b>MZHU</b>
Enti Kombëtar i Strehimit	<b>EKS</b>
Dokumenti I Politikës së Përfshirjes Sociale	<b>DPPS</b>
Programi i Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri	<b>UNSSIA</b>

## PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i studimit të nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rom dhe Egjiptian në bashkinë Krujë me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre, bazohet në një analizë të kujdesshme të nevojave për strehim dhe të të ardhurave, sugjeron disa politika të shoqëruara me kostot respektive, të përmbledhura në një plan veprimi. Si i tillë, ai udhëzon punën e MZHU dhe bashkëpunimin e saj me institucionet shtetërore, qeverisjet lokale dhe me organizatat e komunitetit në përmirësimin e kushteve të banimit dhe të jetesës të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Krujës.

Raporti konstatoi se:

- Familjet e pastreha në Krujë përbëjnë 2,5 përqind të popullsisë, ndërsa Romët dhe Egjiptianët sëbashku përbëjnë rreth 60 përqind të të gjitha familjeve të pastreha, ose 73 përqind të banorëve të pastrehë.
- Numri i familjeve Egjiptiane të pastreha është 1,37 herë më i lartë se numri i familjeve nga komuniteti Rom. Gjithsesi, familjet që zotërojnë hapësirë nën normat e strehimit, përbëjnë kategorinë më të madhe të familjeve në nevojë për të dy komunitetet, respektivisht 50 përqind komuniteti Rom dhe 55 përqind komuniteti Egjiptian.
- Komuniteti Rom është vendosur në një zone, Lagjia Kastrioti, ndërsa komuniteti Egjiptian është shpërndarë në 19 vendbanime, sipas Hartës në shtojcë.
- 88 përqind e familjeve nuk i plotëson standartet përsa i përket infrastrukturës inxhinierike dhe kushteve higjieno sanitare. Nevojat e familjeve Rome dhe Egjiptiane, banesat e të cilëve janë jashtë standarteve të jetesës, janë veçanërisht emergjente në të gjitha banesat për shkak të mungesës së të gjitha kushteve thelbësore, të infrastrukturës dhe të standarteve higjieno sanitare.
- Vetëm 10,2 përqind e familjeve kanë të ardhura (më pak se 30 000lekënë muaj), pjesa më e madhe e familjeve në nevojë për banesë, nuk kanë fare të ardhura. Ata jetojnë në varfëri të skajshme, për shkak të mungesës së të ardhurave, ndërsa banesat e tyre janë jashtë çdo standarti banimi.
- Ka një nevojë urgjente për banesa për 140 familje Rome dhe 168 familje Egjiptiane, të cilët mund të akomodohen në një sipërfaqe ndërtimi prej 18.391,47m<sup>2</sup>; por fatkeqësishtkomunitetet Rome dhe Egjiptiane nuk janë në gjendje t'a zgjidhin vetë problemin e tyre të strehimit për shkak të mungesës së të ardhurave.
- Strehimi social mbetet politika më efektive për të zgjidhur nevojat e strehimit midis komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.
- Midis alternativave të ndryshme të politikave të sugjeruara në raport, Opsioni 1 (Programi: Qeveria vendore ndërton njësi strehimi) duket i realizueshëm. Kosto e tij në është 656,733,323 lekë (308 banesa), ndërsa Opsioni 2, Rikonstruksioni i banesave ekzistuese (174 banesa), kushton 160,950,000lekë.
- Kosto e rehabilitimit të infrastrukturës në lekë është 58,798,488.

Raporti përbëhet nga katër kapituj përveç Hyrjes dhe Konkluzioneve Finale. Kapitulli i parë rishikon kontekstin ligjor në lidhje me të drejtën e strehimit të Romëve dhe Egjiptianëve. Kapitulli i dytë përshkruan metodologjinë e analizës. Kapitulli i tretë adreson gjetjet, ndërsa kapitulli i fundit shtjellon analizën e mëtejshme në lidhje me vlerësimin e kostove të alternativave të ndryshme të politikave, duke nxjerrë në pah argumentat për variantin më të përshtatshëm. Raporti mbyllet me konkluzionet finale. Një hartë dixhitale jep informacion të përditësuar rreth vendndodhjeve të Romëve dhe Egjiptianëve.



## HYRJA

Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë dhe po implementon një reformë sociale të gjerë dhe komplekse, me qëllim fuqizimin e mekanizmave institucional për të siguruar se askush nuk do të përjashtohet nga gëzimi i të drejtave të tyre. Sipas Termave të Referencës, politika e përfshirjes sociale është çelësi i promovimit të qëllimeve më të gjera të politikave të rritjes dhe zhvillimit si dhe adresimit të shkaqeve të mungesave të shumëfishta dhe varfërisë. Adoptimi i Dokumentit Politik të Përfshirjes Sociale 2015-2020 i hap rrugën:

- ▶ Identifikimit dhe adresimit të sfidave me të cilat përballet monitorimi dhe vlerësimi i përfshirjes sociale duke nxjerrë në pah indikatorët e BE-së dhe kombëtar, prej të cilëve kërkohet të mbështesin reduktimin e varfërisë dhe zhvillimin e masave efektive që përmirësojnë mirëqënien;
- ▶ Promovimit të koherencës së politikës, vendosjes së prioriteteve dhe caktimit të përgjegjësive për kryerjen e monitorimit dhe matjes së përfshirjes sociale;
- ▶ Vlerësimin në mënyrë transparente të efektit të politikave që ndiqen dhe përpjekjeve të Qeverisë për të fuqizuar politikën që ndikojnë mbi përfshirjen sociale.

Në këtë kontekst, Programi i Mbështetjes së Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri (UNSSIA) kërkon të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve Shqiptare në nivel qendror dhe vendor për të avancuar me axhendën kombëtare të përfshirjes sociale me një pikëpamje të tillë e cila do të sigurojë konsistencë dhe koherencë nga politikën qeveritare dhe programuesit në arritjen e efektit maksimal të mundshëm për përfshirjen sociale të personave në risk; dhe rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe qytetarëve si mbajtësit e të drejtave në procesin kombëtar të përfshirjes sociale.

Brenda kontekstit të UNSSIA, vëmendje e veçantë i kushtohet veprimeve që mund të eliminojnë barrierat me të cilat Romët dhe Egjiptianët përballen për të aksesuar shërbimet, për të përmirësuar kushtet e jetesës nëpërmjet integritit dhe promovimit të dialogut interkulturor. Plani Kombëtar i Veprimit për Integritin e Romëve dhe Egjiptianëve përfaqëson një angazhim të ri i cili mbulon periudhën 2016-2020, dhe synon respektivisht këto dy komunitete. Në të reflektohet rritja e masave që po implementohen dhe gjithashtu planet për aktivitete të reja për promovimin e integritit të Romëve dhe Egjiptianëve, me një fond të angazhuar nga buxheti i Shtetit dhe hapësirat e financimit të identifikuar për periudhën 2016-2020 si dhe gjetja e mjeteve financiare nëpërmjet koordinimit me programe të tjera ndërkombëtare.

Romët dhe Egjiptianët përballen me barrierë direkte dhe indirekte në marrjen e shërbimeve publike, si rrjedhojë e pamundësisë për përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes, mungesës së informacionit ose të të kuptuarit të procedurave administrative, ashtu si dhe stigmatizimi dhe sjellja diskriminuese nga ana e shumicës së popullsisë. Përjashtimi afatgjatë ka ndikuar në kushtet e jetesës së Romëve dhe Egjiptianëve, trajtimi diskriminues nga shumica e popullsisë dhe marrëdhënia me institucionet qeveritare.

Midis të gjithë grupeve të pambrojtura, ekzistojnë të dhëna domethënëse të cilat tregojnë se Romët dhe Egjiptianët jetojnë në lagje të varfëra ku ka shumë pak ose aspak mundësi për të marrë shërbime publike. Studimet tregojnë se niveli i varfërisë midis komunitetit Rom është dy

herë më i lartë se shumica e popullsisë, ndërsa shkalla e papunësisë është tre herë më e lartë se mesatarja<sup>3</sup>. Tridhjetë e nëntë përqind e banesave ku jetojnë Romët dhe 21 përqind e atyre të banuara nga Egjiptianët nuk kanë akses ndaj ujit të pijshëm<sup>4</sup>. I njëjti burim informacioni tregon se 36 përqind e Romëve jetojnë në shtëpi të rrënuara ose lagje të varfëra (geto).

Si pjesë e strategjisë së përgjithshme për përfshirjen e grupeve më të cënueshme dhe në një linjë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU) po nis implementimin e Strategjisë për Strehimin Social (SSS) për periudhën 2015 -2025. Qëllimi i SSS është “ti ofrojë familjeve me të ardhura të ulta dhe mesatare të cilat nuk e përballojnë dot një shtëpi në tregun e lirë, dhe veçanërisht, familjeve me indikatorë vulnerabiliteti që rezultojnë në përjashtimin nga strehimi, zgjidhje për strehimin të cilat janë të disponueshme, të prekshme, të përballueshme dhe cilësore.”

Është bërë e njohur nga të gjitha palët e interesuara se ekzistojnë hendeqe kritike përsa i përket informacionit në lidhje me popullsinë Rome/Egjiptiane. Mungesa e regjistrimit në gjendjen civile, kryesisht e popullsisë Rome, ka pasur një ndikim vendimtar në “padukshmërinë” e “problemeve kritike” të popullsisë Rome. Megjithatë, shkaqet rrënjësore gjenden më thellë, në strukturën ligjore dhe institucionale të sistemit të shërbimeve publike të Shqipërisë. Veç kësaj, Reforma Territoriale dhe Administrative e implementuar së fundmi, ka ndryshuar ndarjen territoriale të bashkive.

Për të mundësuar integrimin dhe përfshirjen e popullsisë Rome/Egjiptiane, veçanërisht për të zgjidhur problemin e strehimit, është e nevojshme të kryhet një analizë e thellë e vendbanimeve jashtë standartit të strehimit të Romëve dhe Egjiptianëve në nivel bashkie dhe të vlerësohet nevoja për investime në mënyrë që të përmirësohen kushtet e strehimit dhe të jetesës së këtyre dy komuniteteve.

Raporti “ Studim mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkinë e Krujës me qëllim vlerësimin e nevojës për investime për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së këtyre dy komuniteteve” sjell një analizë të thellë të vendbanimeve të Romëve dhe Egjiptianëve kundrejt standarteve të strehimit ashtu si dhe programeve të strehimit social. Raporti ofron të dhëna që lejojnë identifikimin e nevojave për investime në bashki, të ndara nga programet aktuale të strehimit social dhe do të udhëheqë punën e MZHU dhe bashkëpunimin e saj me institucionet e nivelit shtetëror, qeveritë vendore, dhe organizatat e komunitetit në përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Durrës.

3 Decade of Roma Inclusion Secretariat Foundation, Civil Society Monitoring Report on the Implementation of the National Roma Integration Strategy and Decade Action Plan in 2012 in Albania, përgatitur nga një grup autorësh (Bajrami, Ivia; Cabiri, Ylli; Hasantari, Adriatik; Kazanxhiu, Latif; Koci, Renart; Mustafaj, Enver; Myrteli, Laver; Nuredin, Albana; Pegini, Hafize; Rama, Lindita; Rushiti, Selvie; Xega, Gerta; Ziu, Dritan), publikuar në Maj 2013, [http://www.issuelab.org/click/download2/civil\\_society\\_monitoring\\_report\\_on\\_the\\_implementation\\_of\\_the\\_national\\_roma\\_integration\\_strategy\\_and\\_decade\\_action\\_plan\\_in\\_2012\\_in\\_albania](http://www.issuelab.org/click/download2/civil_society_monitoring_report_on_the_implementation_of_the_national_roma_integration_strategy_and_decade_action_plan_in_2012_in_albania), fq. 20.

4 Të dhëna nga UNDP/WB/EC 2011 Socio-economic Survey quoted in the UNDP's Needs Assessment Study on Roma and Egyptian Communities in Albania, Shkurt 2012, <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/roma-needs-assessment-report/>, fq. 24.-25.

## 1. RISHIKIMI I KONTEKSTIT LIGJOR KUNDREJT TË DREJTËS PËR STREHIM TË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE

Strehimi është një e drejtë njerëzore themelore e ruajtur në marrëveshje dhe traktate ndërkombëtare. Kur individët kanë strehim të sigurt dhe të përballueshëm i cili është i përshtatshëm me rrethanat e tyre jetësore, nevojat e tjera mund të plotësohen, siç janë punësimi, edukimi dhe mundësitë e jetës. Disa grupe qytetarësh në Shqipëri janë në risk mohimi të kësaj të drejte njerëzore themelore për shkak të çështjeve të përballueshmërisë së strehimit. Midis tyre, Romët dhe Egjiptianët janë veçanërisht të riskuar për shkak të përjashtimit të shumëfishtë.

Komunitetet Rome konsiderohen si grupi minoritar më vulnerabël në Shqipëri, i cili përballlet më vlefshëm gjerësisht të përhapur, marginalizimin socio-ekonomik dhe diskriminimin e shpeshtë, veçanërisht në lidhje me marrjen e shërbimit të edukimit, mbrojtjen sociale, shëndetësinë, punësimin dhe strehimin e përshtatshëm. Romët nuk njihen publikisht si minoritet i veçantë dhe ata kanë statusin e minoritetit etno-gjuhësor. Pavarsisht nga kjo, Kushtetuta e Shqipërisë adreson të gjitha parimet themelore të të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Shqipëria është gjithashtu pjesë e traktateve kryesore ndërkombëtare për sa i përket të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve.

Shqipëria ka nënshkruar Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut (2.10.1996), Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (4.10.1991), Konventën Ndërkombëtare mbi Eliminimin e Çdo Forme Diskriminimi Racial (11.5.1994) dhe Kartën Sociale Europiane (e rishikuar) (14.11.02). Si e tillë, shtetet anëtare janë të detyruara të sigurojnë qasje ndaj strehimit të barabartë për çdo qytetar.

### 1.1 Situata e përgjithshme e nevojave për strehim të Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë e Krujës

Duke qenë të detyruar të bëjnë një jetë rruge për vite me rradhë pa qasje ndaj shërbimeve të strehimit, shkollimit, kujdesit shëndetësor dhe punësimin, familjet Rome janë kyçur brenda rrethit vicioz të informalitetit, duke bërë të pamundur përfitimin nga shërbimet sociale standarte duke përfshirë dhe programet e strehimit social. Krahasuar me Romët, komuniteti Egjiptian duket më i integruar në mjedisin social.

Tek Romët, varfëria dhe mungesa e strehimit të përshtatshëm janë më të përhapura. Për shembull, në një anketim rajonal të 2011 mbi situatën e strehimit të romëve në Shqipëri, 8 përqind e Romëve që morën pjesë në studim jetonin një privim të shumëfishtë strehimi, krahasuar me më pak se 1 përqind nga jo-romët, ndërsa 30 përqind e Romëve të anketuar nuk kishin përmirësim në furnizim me ujë, kanalizime dhe energji krahasuar me 7 përqind të jo-romëve. Rreth 45 përqind e Romëve që morën pjesë në anketim strehoheshin në banesa që i mungonte të paktën një nga facilitetet e mëposhtëme: kuzhinë brenda, banje brenda, banjë ose dush brenda, dhe energjia. Raportohet gjithashtu se, mesatarisht, më shumë se dy njerëz banonin në një dhomë, që është përtej mesatares se OECD prej 0.8 njerëz në një dhomë<sup>3</sup>.

3 [www.oecdbetterlifeindex.org/topics/housing/](http://www.oecdbetterlifeindex.org/topics/housing/)

Sipas “Një Studimi të Vlerësimit të Nevojave për Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri”, pjesa më e madhe e familjeve Rome banojnë në shtëpi të (38.4 përqind) ose or kasolle (20.8 përqind) dhe konsistojnë në një (66.3përqind) ose më shumë se një (27.5 përqind) kurora<sup>4</sup>. Ata e konsiderojnë veten pronarë të shtëpive të tyre (80.6 percent), me vetëm 10.8 përqind raportime për banesë me qera<sup>5</sup>. Shumë vendbanime të vona të Romëve janë kampe ku Romët jetojnë në tenda të improvizuara ose kasolle në brigjet e lumit. Madhësia e kampeve ndryshon sipas zonave.

Ndrërsa në Bashkinë Krujë, familjet e pastreha në përgjithësi përbëjnë 2,5 përqind, nga të cilat më shumë se 60 përqind janë Romë dhe Egjiptianë (25% Romë dhe 35% Egjiptianë). Megjithëse vetëm 4 përqind e Romëve janë raportuar që nuk kanë nje banesë, pjesa tjetër 96 përqind ose kanë sipërfaqe nën standartin e strehimit (50,5 përqind) ose jetonë në kushte nën standartin e strehimit 45,5 përqind). Ato janë më të ngjashme me kasollet. Megjithatë pothuajse të gjitha vendbanimet janë pajisur me infrastrukturë dhe janë afër qytetit te Krujës, dhe shërbimeve sociale bazë, mungesa e kushteve bazë të higjienës dhe të banimit i ve ata në risk të lartë për përjashtim.

Kushtet e banimit të komunitetit Rom në bashkinë e Krujës janë shumë të këqia: vetëm 6,8 përqind jetojnë në banesa sipas standarteve, 80 përqind e familjeve nuk janë të lidhura me rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimet dhe 24 përqind nuk janë të lidhur me rrjetin e energjisë. Megjithëse të gjitha vendbanimet Rome dhe 70 përqind e vendbanimeve Egjiptiane janë të pajisuara me të gjitha rrjetet inxhinierike.

Në Shqipëri, komuniteti Egjiptian në përgjithësi është më i integruar se Romët. Megjithatë edhe ata hasen me një numër kufizimesh të ngjashme si Romët. Anëtarët e komunitetit Egjiptian , kryesisht, banojnë në banesa të vjetra (45,8 përqind) ose shtëpi të riparuar, por jot ë reja. Ata gjithashtu raportojnë të jenë pronarë të banesave (83.5 përqind) dhe vetëm një përqindje e vogël (7.1 përqind) thonë që jane me qera. Vetëm 10.9 përqind e anëtarëve të komunitetit Egjiptian raportojnë se banojnë në Baraka, një përqindje shumë më ë ulët se e Romëve<sup>6</sup>.

Gjithsesi, në Bashkinë Krujë, situatë e komunitetit Egjiptian duket më keq krahasuar me përshkrimin e mësipërm. Rreth 40 përqind (39,6) e komunitetit Egjiptian nuk zotëron një hapësirë banimi. Megjithëse 55përqind zotëron sipërfaqe banimi, ajo është përsëri nën standarteve bazë të jetesës. Vetëm 5 përqind banojnë në shtëpi pa asnje kusht bazë jetese.

## 1.2 “Strehimi” Politikat Publike të adoptuara në Bashkinë Krujë

Strategjia e re e Strehimit Social 2015-2025 bazohet në detyrat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015-2020 (SKTHI). Një nga objektivat e SKZHI (II), është “të garantojë qasje të barabartë ndaj instrumentave ekonomikë dhe socialë për të gjithë grupet dhe individët e shoqërisë sonë”.

Për sa i përket strehimit social, SKZHI identifikon disa sfida kritike në lidhje me grupet sociale më të përjashtuara:

- a. Të implementojë një politikë të integruar strehimi e cila piketon grupet me të ardhura të pakta dhe ata më vulnerabël;

<sup>4</sup> Vlerësim i nevojave të komunitetit Rom dhe Egjiptian në Shqipëri, CESS e mbështetur nga PNUD, 2012, fq.24

<sup>5</sup> Njëlloj

<sup>6</sup> Njëlloj

- b. Të sigurojë adoptimin e standarteve minimale të strehimit;

- c. Të përmirësojë kushtet e strehimit për komunitetet Rome dhe Egjiptiane;

Strategjia e re e Strehimit Social i hap rrugën një shumëllojshmërie programesh të strehimit social të cilat mund të përshtaten duke u bazuar në një ligj të ri mbi Strehimin Social.

Ligji Nr.9232 mbi “Strehimin Social” u miratua për herë të parë në vitin 2004. Që prej asaj kohe ligji është ndryshuar disa herë me qëllim rritjen e efektivitetit të tij duke lehtësuar procedurat e aplikimit si dhe mundësimin për më shumë akses ndaj tregut të strehimit për të pastrehët. Veç kësaj, Bashkia Durrës ka adresuar Planet e saj Strategjike të Zhvillimit siç është Strategjia Rajonale për Zhvillimin e qytetit të Durrësit (2005) dhe Strategjia e Zhvillimit Territorial, 2015-2030. Megjithatë, një strategji specifike për strehimin nuk është miratuar ende.

Duke ju referuar Ligjit Nr. 9232, programet e strehimit social janë “programe të cilat shërbejnë për të strehuar familjet dhe individët të cilët për shkak të situatës së tyre ekonomike dhe sociale nuk mund të përballojnë ofertën e tregut të lirë ose kredinë”. Qeveria ka krijuar tre programe të strehimit social:

- ▶ Banesat sociale me qera,
- ▶ Banesat me kosto të ulët, dhe
- ▶ Programi i pajisjes së truallit me infrastrukturë.

Veç kësaj, qeveria ka mundësuar ofrimin e subvencioneve të strehimit, kredive të subvencionuara, grantet e vogla, dhe grantet e menjëherëshme të cilat synojnë grupe specifike (shih më poshtë për përshkrimin e secilit program). Përfituesit e programeve të strehimit social duhet të përmbushin një nga kriteret e mëposhtme:

- ▶ Ata nuk duhet të kenë në pronësi një shtëpi;
- ▶ Ata duhet të kenë një vend banimi i cili është nën normat e strehimit;
- ▶ Ata duhet të jenë të pastreh për shkak të katastrofave natyrore (Ligji 9232, Neni 4).

Përzgjedhja e përfituesve bazohet në kushtet e tyre të jetesës ashtu si dhe mbi rrethanat e tyre sociale dhe ekonomike. Prioriteti është vendosur mbi pesëmbëdhjetë grupe, duke përfshirë familjet me një prind, familjet e gjera, të rriturit më të vjetër, personat e paafte, çiftet e reja, familjet që kanë ndryshuar vendbanimin, jetimët, emigrantët e kthyer, punëtorët migrant, azil kërkuesit, oficerët e rënë në detyrë, viktimat e dhunës në familje, familjet Rome, familjet Egjiptiane, dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.

Sidoqoftë, Bashkia e Krujës nuk ka një strategji strehimi dhe informacioni. Nevoja për strehim bazohet tek aplikimet.

### 1.3 Evidenca mbi përmirësimin e kushteve të banimit dhe të jetesës, të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Krujës

Pavarësisht ligjit të Strehimit Social, bashkia nuk ka implementuar ndonjë program, kryesisht për shkak të mungesës së Strategjisë për Strehimin Social, dhe të fondeve respektive. Me përjashtim të 37 familjeve Rome që kanë përfituar disa vjet më parë nga Programi i Strehimit Social, nuk ka të dhëna të tjera që të dëshmojnë s ecurinë e politikave të Strehimit Social në Krujë.

## 2. METODOLOGJIA E KËRKIMIT

### 2.1 Shtrirja, qëllimi dhe objektivat e studimit

Studimi “Mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkinë e Krujës me qëllim vlerësimin e nevojës për investime për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së këtyre dy komuniteteve” synon të vlerësojë “nevojën për investime për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe të jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Krujë” për të drejtuar punën e MZHU dhe partnerëve të saj në përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Krujë”.

Duke qëndruar në një linjë me qëllimin e përgjithshëm, Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës ka arritur objektivat si më poshtë:

- ▶ Ofrimin e të dhënave të sakta mbi kushtet e strehimit dhe të jetesës (p.sh. kushtet e banimit, aksesit ndaj ujit, elektricitetit, dhe kanalizimeve) të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë e Krujës.
- ▶ Vlerësimin e investimeve që duhet të bëhen në bashkinë e Krujës me qëllim përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.
- ▶ Zhvillimin e Planit të Veprimit i cili do të drejtojë punën e MZHU dhe bashkëpunimit të saj me institucionet e nivelit shtetëror, qeveritë vendore, dhe organizatat komunitare në përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Krujë.

Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës përdor informacion nga burime të ndryshme : (1) studime dhe raporte të mëparshme, (2) një anketë rastësore e fokusuar mbi familjet Rome dhe Egjiptiane në nevojë strehimi, (3) fokus grupe me palët e interesuara përkatëse dhe (4) verifikimi në terren i lagjes dhe infrastrukturës në bashkinë Krujë.

Hartimi i këtij raporti u bazua në rishikimin e raporteve të ndryshme të përgatitura nga MZHU, PNUD dhe/ose organizata kërkimore të pavarura (shih Bibliografinë).

### 2.2. Karakteristikat e kampionit

Për shkak të qëllimit të mirëpërcaktuar të Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, nuk ishte e mundur të identifikohesh një kampion. Në të kundërt, të gjitha komunitetet Rome dhe Egjiptiane të Bashkisë Krujë u përfshinë në njësinë kërkimore. Madhësia e kampionit (sipas përcaktimit të shtjelluar më sipër) është e paraqitur më poshtë (Tabela 1):



**Tabela 1: Karakteristikat e kampionit**

Pyetësi	Madhësia e kampionit përbëhet nga:	
	Komuniteti Rom	Komuniteti Egjiptian
Nr.1: Biseda me fokus grupe	100 përqind	100 përqind
Nr.2: Ballë për ballë	92 përqind	90 përqind

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, 2016

### 2.3. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave

U konsiderua e nevojshme mbledhja e informacionit të detajuar mbi madhësinë dhe përbërjen e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Krujë si dhe mbi nevojat e tyre të përgjithshme rreth strehimit.

Bisedat me Fokus Grupe u zhvilluan me dy grupe interesi, përkatësisht Departamenti i Zhvillimit Urban dhe Departamenti i Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Krujës. Veç kësaj, përdorimi i bisedave me fokus grupe ndihmoi në mbledhjen e informacionit në lidhje me përpjekjet e qeverisë vendore për të siguruar strehim për komunitetet që përbëjnë themelort të këtij Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës.

Megjithatë, me qëllim zbulimin në thellësi të shqetësimeve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në lidhje me strehimin, intervistat ballë për ballë me familjet ofruan të dhëna të nevojshme.

Pyetësi i parë (pyetësor me pyetje të hapura) mundësoi mbledhjen e informacionit në lidhje me:

- ▶ Përbërjen e të pastrehëve, numrin, vendndodhjen e tyre, ndarjen sipas specifikave të nevojave të tyre për strehim ashtu si dhe sipas statusit të tyre socio-ekonomik.
- ▶ Kapacitetet e qeverisë vendore për të zgjidhur çështjen e strehimit, të pakten për komunitetet Rome dhe Egjiptiane.
- ▶ Sfidat e Strehimit në nivel vendor.

Pyetësi i dytë lehtësoi analizën në thellësi të banesave në secilin prej vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane, përkatësisht:

- ▶ Tipi i banesave, madhësia e tyre dhe kushtet infrastrukturore.
- ▶ Kushtet infrastrukturore të vendbanimeve dhe aksesit ndaj shërbimeve.

Verifikimi në terren i lagjes dhe infrastrukturës shqyrtoi:

- ▶ Vlerësimin e përgjithshëm të kushteve të vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane, përkatësisht kushtet fizike, qasja ndaj infrastrukturës (rrjeti i furnizimit me ujë, sistemi i ujit të mbetjeve, rrjeti elektrik), kushtet e higjenës (janë apo jo të furnizuar me ujë dhe kanalizime nga rrjeti i qytetit), marrja e shërbimeve të tjera publike, probleme të tjera në lidhje me këtë (probleme furnizuesi dhe konsumatori).
- ▶ Vlerësimin e kostove që nevojiten për përmirësimin e situatës ekzistente ose lidhja e

komuniteteve me shërbimet në nivel lagjeje si dhe në nivel lagjeje dhe shtëpie.

- ▶ Analizën e situatës së lagjeve specifike të cilat janë të prirura ndaj rreziqeve natyrore ose të tjera.
- ▶ Përpunimin e gjetjeve nëpërmjet verifikimit në terren, të cilat shërbejnë për përgatitjen dhe propozimin e 2-3 skenarëve për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe infrastrukturës.

### 2.4. Parimet e analizës

Në përputhje me kontekstin e Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, grupi i studimit mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës përcaktoi disa kritere mbi të cilat është bazuar vlerësimi i kostos për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të infrastrukturës së vendbanimeve të komunitetit Rom dhe Egjiptian:

**Së pari**, informacioni i marrë nga administrata vendore dhe anketat e vendndodhjes, nëpërmjet pyetësorëve, u përdor për të përcaktuar një synim të qartë të projektit, si nga ana cilësore ashtu dhe ajo sasiore.

**Së dyti**, bazuar në strukturën e familjes, u krijua një dosje mbi nevojat për llojet dhe numrin e apartamenteve të nevojshme. Sipërfaqet e banimit dhe të ndërtimit u përcaktuan sipas Entit Kombëtar të Banesave dhe legjislacionit në fuqi.

Këto shërbyen si informacion kyç për të gjithë procesin e analizës financiare dhe vlerësimit të kostove për përmirësimin strukturor të banesave dhe atë infrastrukturor të zonave të banimit. Objektivi kryesor ishte hartimi i një metodologjie të qartë në mënyrë që të bëhëj i mundur vlerësimi dhe llogaritja e kostove të pritshme të proceseve të implementimit të projekteve.

E gjithë kjo procedurë, në fund, rezultoi në metodologjinë e propozimit të analizës financiare e cila iu prezantua administratës vendore dhe përfituesve, duke i ndihmuar ata të marrin vendime të realizueshme me qëllim përgatitjen e strategjive të zhvillimit dhe propozimin e zgjidhjeve të qëndrueshme.

Bazuar mbi të dhënat që rezultuan nga përpunimi i pyetësorëve, u zhvilluan dhe analizuan financiarisht skenarë të ndryshëm:

**A. Skenari i parë** – procesi i përmirësimit të kushteve ekzistuese të jetesës në strukturat rezidenciale

**B. Skenari i dytë** – përdorimi i fondit të lirë ekzistues të strukturave rezidenciale (nëpërmjet blerjes ose procesit të punësimit)

**C. Skenari i tretë** – ndërtimi i strukturave të reja dhe infrastrukturës për qëllim të strehimit social

## A. Proçesi i përmirësimit të kushteve ekzistuese të jetesës në strukturat rezidenciale

Nga pikëpamja e vlerësimit të kostos, metodologjia u bazua në dy kritere kryesore:

- ▶ Vlerësimi i situatës ekzistuese të strukturave të rezidencave, duke shqyrtuar kushtet e jetesës, kushtet e higjienës, dhomat e nevojshme ekzistuese sipas standarteve, kushtet teknike të strukturës (lidhur me sigurinë) – informacion i marrë nga pyetësorët e anketave të vendndodhjeve.
- ▶ Vlerësimi i kostos për riparimin e këtyre elementeve dhe rehabilitimin e këtyre hapësirave, nëpërmjet proçesit të rikonstruktimit, me qëllim që këto struktura të përmbushin kushtet e nevojshme të pranueshme, duke i kthyer në këtë mënyrë në zona të banueshme në përmbushje të standarteve dhe normave.

Faktori kryesor i marrë seriozisht në konsideratë ishte statusi i pronësisë i rezidencës (pyetja kryesore e pyetësorit). Ky element mund të rrisë direkt pjesën e investimit, dhe nga ana tjetër është element vendimtar në sigurimin e investimit afatgjatë dhe veçanërisht në sigurimin e qëllimit të investimit.

Metodologjia e përlllogaritjes u bazua në metoda të thjeshta klasike, mbështetur në listën e çmimeve të referencës dhe një indeks i përafërt i proçesit të ndërhyrjes rikonstruktive i cili u përfutua nga Studimi i eksperiencave ekzistuese të tregut dhe të eksperiencave të ngjashme.

Vlerësimi deri në çfarë mase llojet e secilës ndërhyrje janë të mundshme dhe të arsyeshme kundrejt aseteve dhe kushteve ekzistuese dhe eksperiencës së administratës vendore për t'u marrë me çështjet e strehimit të grupeve të synuara, ishte pritshmëria e përgjithshme e Studimit mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës.

Për më tepër, si skenar u krahasua me të tjerët me qëllim gjetjen se cili prej tyre është më i saktë për t'u përdorur dhe deri në ç'masë, në mënyrë që përdorimi i një ose më shumë skenarëve në të njëjtin qytet por në lagje të ndryshme ose në grupe ose organizma sociale të ndryshëm, të rezultojë i mundshëm.

Një tjetër aspekt pozitiv i këtij skenari është që mund të përdoret gjithashtu si një proçes rigjenerimi urban dhe mund të aplikohet në disa zona të braktisura të qytetit të cilat mund të kenë potencial special për t'u integruar në strukturën dhe jetën e qytetit.

## B. Përdorimi i fondit të lirë ekzistues të strukturave rezidenciale (nëpërmjet blerjes ose qiramarrjes)

Nga pikëpamja e vlerësimit të kostos, metodologjia u bazua në dy drejtime kryesore: vlerësimi i qerasë dhe shitjeve të tregut vendas të pasurive të patundshme. Informacioni, i përfutur si nga administrata vendore ashtu dhe nga të dhënat e tregut, u plotësua me vendndodhjen e strukturave rezidenciale ekzistuese dhe gjendjen e tyre (si nga pikëpamja teknike ashtu edhe nga pikëpamja e pronësisë). Për të dyja këto, u krye një vlerësim i kushteve me qëllim sigurimin e përmbushjes së standarteve të kërkuara.

Edhe në rastet e të pastrehëve, faktorët kryesorë të konsideruar ishin sipërfaqja e përshtatshme (zona e banimit) në përputhje me strukturën e familjes, dhe kosto për metër katror (LEK/m<sup>2</sup>) e shitjes ose edhe e qerasë, ashtu si dhe vendndodhja e tyre. Bazuar në këto, disa analiza më të hollësishme u realizuan për të siguruar përpilimin e disa skenareve të ndryshme të investimit si edhe të kostos financiare të tyre.

## C. Ndërtimi i strukturave të reja dhe infrastrukturës për qëllim të strehimit social

Vlerësimi i kostos totale për këtë skenar u bazua në tre kosto të ndërlidhura:

- ▶ Kosto e truallit (vendndodhja e ngastrës)
- ▶ Kosto e ndërtimit të strukturës
- ▶ Kosto e infrastrukturës

Nga pikëpamja teknike ky skenar paraqet një vlerësim kostoje të thjeshtë i cili bazohet në tre faktorë të mirënjohur, nga pikëpamja ekonomike dhe financiare. Ajo çka nevojitet është një ide reale projekti dhe një vendndodhje për ngastrën e zgjedhur në mënyrë që të përlllogaritet saktësisht kosto e këtyre lloj ndërhyrjesh duke marrë në konsideratë të tre elementët.

Lidhur me përlllogaritjen e kostos, metodologjia duhet të shqyrtojë përlllogaritjen e çdo faktori në mënyrë të pavarur dhe bashkarisht, ku rastet e ndryshme për gjetjen e vendndodhjes së ngastrës duhet të përfaqësohen nga administrata vendore, ashtu si dhe format e investimeve.

Zgjedhja e truallit është vendimtare në përlllogaritjen e kostos totale. Në këtë aspekt, kosto e truallit, është një variabël shumë e rëndësishme, i cili është i lidhur direkt me statusin e pronësisë, me qëllim që pronat shtetërore të truallit të mund të çojnë në kosto investimi më të ulta, - përveç efekteve anësore të tjera pozitive me të cilat veprime të tilla shoqërohen gjithmonë, siç është interesi direkt i qeverisë vendore, i cili në shumë raste është vendimtar për suksesin e projektit. Në këtë rast kosto e truallit konsiderohet si një variabël e rëndësishme, veçanërisht në lidhje me statusin e pronësisë, me qëllim gjetjen e truallit në pronësi publike.

Një tjetër aspekt i analizuar është kosto e pronës në lidhje me koston e lidhjes me infrastrukturën publike. Në këtë mënyrë mund të rezultojnë skenarë më të qëndrueshëm të proçesit të zgjedhjes së truallit, jo vetëm në lidhje me disponueshmërinë e autoriteteve vendore për të ofruar truallin, por gjithashtu ekonomikisht, për shkak të përmirësimit të këtyre vendndodhjeve në zona urbane me kushte më të mira rezidenciale dhe sociale.

Kosto e ndërtimit u përlllogarit bazuar në indekset dhe çmimet e referencës së Entit Kombëtar të Banesave sipas ligjeve. Bazuar në numrin e nevojave dhe strukturave të familjeve, propozohet një skenar mbi zonën e nevojshme të jetesës, e cila bashkë me ambjentet komunitare dhe të shërbimit, rezultojë në zonën finale të ndërtimit. Kjo shërben si informacion bazë për vlerësimin e kostos së ndërtimit të shtëpive sociale.

Rezultati i pritshëm është një shumë totale e përafërt e investimit të nevojshëm. Kosto e infrastrukturës duhet të shqyrtojë urbanizimin ose shkallën e urbanizimit të truallit. Kjo lidhet drejt për drejt me pozicionimin e zonës së propozuar në qytet, veçanërisht kundrejt shërbimeve publike dhe infrastrukturës, dhe mundësitë e aksesit dhe lidhjes me rrugët dhe sistemet e furnizimit dhe shkarkimit.

Të gjitha këto përdoren si variabla për të paraqitur një formulë të thjeshtë e cila do të ndihmojë autoritetet vendore të përlllogarisin dhe krijojnë një vizion më të mirë mbi koston totale të një proçesi të tillë. Për më tepër, kjo do të ndihmojë për të pasur më shumë se një zgjidhje, dhe në këtë mënyrë do të ndihmojë në gjenerimin e fondeve dhe investimeve nga drejtime të ndryshme, element i cili është vendimtar në suksesin e proçesit.

Rezultatet e secilit skenar do të analizohen në lidhje me kushtet lokale të çdo bashkie, ashtu si dhe sipas mundësive reale për investime të secilës qeveri vendore, bazuar në fondet e tyre ose mundësi të tjera. Për këtë, proçesi i analizës bazohet mbi rezultatet që vijnë nga pyetësorët:

ato të dhëna të cilat kanë lidhje me të ardhurat e familjeve dhe ato të cilat kanë të bëjnë me investimin e kapaciteteve të bashkive mbi banesat sociale dhe projekte të tjera përkatëse.

Bazuar në këto, Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit vlerëson kostot si edhe burimet financiare të mundshme për të përballuar investimin. Qasjet e ndryshme të propozuara mund të çojnë në prodhimin e më shumë projekteve me qëllim të mirëpërcaktuar dhe duke synuar projekte më të kontrollueshme, të cilat çojnë në implementimin e suksesshëm.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se bazuar në kushtet financiare lokale dhe numrin e familjeve në nevojë, si dhe mbi stokun e banesave, kriteret e nënvizuara më lart janë të rëndësishme dhe duhet të merren seriozisht në konsideratë, sepse, siç u shpjegua, rezultatet e tyre varen shumë nga variablat lokale.

Si mekanizëm i fundit, metodologjia e përlllogaritjes së kostos synon të krijojë një formë llogaritjeje për secilin rast në mënyrë që të ndihmojë autoritetet vendore në procesin e vendimarrjes.

Bazuar në kostot tashmë të përlllogaritura, kjo metodologji gjithashtu adresoi:

- ▶ Efektin e kategorizimit mbi vlerësimin financiar të projekteve;
- ▶ Koston e huave për përfituesit;
- ▶ Analiza kosto-përfitim, kosto e projektit, norma e interesit, norma e brendshme e kthimit dhe koha e pagesës, metodat e vlerësimit, etj.
- ▶ Burimet e kapitalit të mbledhur si dhe forma të tjera që rezultojnë në kapital.

Si e tillë, kjo metodologji, së pari paraqet më shumë se një mundësi reale dhe financiare për zgjidhje të qëndrueshme, dhe së dyti, hap mundësinë e përlllogaritjes dhe vlerësimit midis opsioneve të ndryshme e cila do të bazohet direkt mbi kapitalin dhe kushtet financiare të kapaciteteve lokale. Në këtë mënyrë shtron bazat për aplikimin e projekteve dhe zgjidhjeve origjinale, duke fuqizuar edhe mundësitë e bashkëpunimit publik dhe privat, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme afatgjata.

### 3.

## ANALIZA PËRSHKRUESE DHE E DETAJUAR E KUSHTEVE TË STREHIMIT DHE JETESËS SË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE (GJETJET E STUDIMIT)

Kapitulli 3 adreson kërkesën për strehim të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane sipas tre kriterëve të vlerësimit, respektivisht:

**Kriteri 1:** Situata e strehimit të familjeve

**Kriteri 2:** Kushtet socio-ekonomike të familjeve


**Kriteri 3:** Kushtet infrastrukturore të vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane

Të dhënat e mbledhura nga studimi janë përpunuar dhe janë analizuar bazuar në secilin kriter të përmëndur më sipër. Në mënyrë të ngjashme gjetjet respektive janë identifikuar dhe formuluar sipas kriterëve të vlerësimit.

### 3.1. Situata e strehimit e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane

Familjet e pastreha në Krujë përbëjnë 2 përqind të popullsisë, ndërsa romët dhe egjiptianët së bashku përbëjnë gati 60 përqind të të gjithë familjeve të pastreha ose 73 përqind të banorëve. (figura 1 dhe tabela 2).

**Figura 1: Të pastrehë Romë dhe Egjiptianë në krahasim me totalin e të pastrehëve dhe popullsinë, 2016**



**Burimi:** Census, 2011 dhe Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

**Tabela 2: Numri i familjeve të pastreha (banorëve) në Bashkinë Krujë sipas etnisë kulturore, 2016**

	Banorë	%	Familje	%
Të Pastrehë	1,500	100	375	100
Rom dhe Egjiptian të pastrehë	1,101	73	226	60

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

Siç tregohet në tabelën 3 dhe figurën 2, 25 përqind të të gjithë familjeve të pastreha në Krujë, janë nga Komuniteti Rom dhe 35 përqind nga Komuniteti Egjiptian.

**Tabela 3: Gjendja e familjeve të pastreha Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Krujës, përfshi:**

	Total	Roma	%	Egjiptian	%
<b>Familje në nevojë strehimi për shkak të:</b>	<b>226</b>	<b>95</b>	<b>100</b>	<b>131</b>	<b>100</b>
Nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	56	4	4,3	52	40
Kanë në pronësi hapësirë banimi nën standartet e banimit	120	48	50,5	72	55
Jetojnë në banesa nën standartet e banimit.	50	43	45,2	7	5


**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

Pavarësisht diferencave të vogla përsa i përket madhësisë, Komunitetet Rome dhe Egjiptiane jetojnë në kushte të dëshpëruara banimi. (foto në vijim)



**Foto të vendbanimit Rom**


**Figura 2: Familje të pastreha në përqindje, 2016**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

Duke krahasuar nevojat për strehim të të dy komuniteteve të përjashtuara, vërehet se numri i familjeve nga Komuniteti Egjiptian është 1,37 herë më lartë se numri i familjeve të Komunitetit Rom (Tabela 3). Gjithësesi familjet që zotërojnë sipërfaqe banimi nën standartet e strehimit përbëjnë kategorinë më të madhe të familjeve në nevojë për të dy komunitetet, respektivisht 50 përqind nga Komuniteti Rom dhe 55 përqind nga Komuniteti Egjiptian. ( Figura 3).

**Figura 3: Situata e strehimit e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Krujës, 2016**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

Komuniteti Rom është vendosur në një zonë (Lagja Kastrioti) ndërsa Komuniteti Egjiptian është shpërndarë në 19 vendbanime sipas informacionit të dhënë në Tabelën 4:

**Tabela 4: Vendbanimet e Romëve dhe Egjiptianëve ne Bashkinë Krujë, 2016**

Vendbanime	Familje Rome	Familje Egjiptiane
Lagjia Kastrioti-zona nr. 1	94 familje	3 familje
Lagjia Grumbullim-zona nr. 2		39 familje
Lagjia SMT-zona nr. 5		8 f familje
VILA 99 deri VARREZAT-zona nr. 6		12 familje
Lagjia Magaze zona nr. 11		3 familje
Lagjia Bakushe Visha-zona nr. 3	1 familje	6 familje
Lagjia Punetori- zona nr. 9		6 familje
Lagjia Kryqezim rruge Kruje-zona nr. 8		6 familje
Lagjia Kameron zona nr. 7		12 familje
Shkolla 9 vjec nr 1- zona nr. 15		1 familje
Lagjia A.Gjeli-zona nr. 4		6 familje s
Fabrika e çimentos-zona nr. 21		6 familje
Fshati Larushk-zona nr. 10		4 familje
Koop.Partizani-zona nr. 16		1 familje
Kruje Qender-zona nr. 14		1 familje
Qender Thumane-zona nr. 12		12 familje
Qender Burizane-zona nr. 13		2 f familje s
Fshat Qerek-zona. 18		1 familje
Dukagjin i ri -zona nr. 19		2 familje
<b>Totali</b>	<b>95 familje</b>	<b>131 familje</b>

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

Harta (shtojcë) tregon vendndodhjen e banesave .


100 përqind e Komunitetit Rom në nevojë është vendosur tekLagjia Kastrioti, pjesë e qytetit të Fushë Krujës. Kjo zonë përbëhet nga shtëpi individuale një deri në tre kate.

Përsa i përket rrugës dhe rrjeteve inxhinierike, infrastruktura ekzistuese është në gjëndje të mirë.

Rreth 66 përqind e Komunitetit Egjiptian është vendosur në Zonat e Lagjia Grumbullimi, Lagjia SMT, Lagjia e re, Lagjia Kameron. Këto zona përbëhen nga shtëpi individuale 1-4 kate, magazina të vjetra ku janë strehuar disa nga familjet egjiptiane. Përsa i përket rrugës dhe rrjetit inxhinierik infrastruktura ekzistuese është në gjëndje të mirë, përvec Zonës 7, ku nuk ka infrastrukturë inxhinierike.

Siç mund të vërehetqartë në Figurën 4, pjesa më e madhe e tyre jetojnë në banesa nën standartet e strehimit.

**Figura 4: Vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, sipas llojit të problemit të strehimit, 2016**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

Pjesa tjetër e familjeve Egjiptiane (34 përqind) janë vendosur në 14 vendbanime. Të gjitha këto zona janë të paisurame infrastrukturë inxhinierike përvec zonave Nr. 10, 13,18 dhe 19 ku nuk ka infrastrukturë inxhinierike.



**Foto nga vendbanimet Egjiptiane**

Vlerësimi në thellësi i kushteve të banimit të Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë e Krujës është bazuar në informacionin e nxjerrë nga Pyetsori 2 (pjesa 5A, 5B, 5C dhe 5D) si dhe nga vizitat në vend që janë bërë në çdo vendbanim . Për të indentifikuar nevojën për strehim të secilit Komunitet, janë kryer intervista ballë për ballë me 91 përqind të familjeve siç tregohen në Tabelën 5.

**Tabela 5: Numri i intervistave ballë për ballë në Bashkinë Krujë**

	Banorë	Familje
Popullsia Rome & Egjiptiane	1.555	308
Popullsia e intervistuar Rome & Egjiptiane	1.111	280
Në përqindje	71	91

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

**Tabela 5.1: Intervistat në secilin vendbanim Rome dhe Egjiptian te Bashkisë Krujë, 2016**

Vendbanimet	Familjet e intervistuar Rome	Familjet e intervistuar Egjiptiane
1. "Kastrioti" F-Krujë	129 familje	No Egyptian families
2. Lagja "Grumbullimi" F-Krujë	Nr i familjeve Rome	33 familje
3. Lagja "B.Visha" F-Krujë	Nr i familjeve Rome	8 familje
4. Lagja "A.Gjeli" F-Krujë	Nr i familjeve Rome	7 familje
5. Lagja "S.M.T" F-Krujë	Nr i familjeve Rome	17 familje
6. Lagja e Re, Rruga e Krujës, Vila 99, F-Krujë	Nr i familjeve Rome	30 familje
7. Lagja "Kameras", Arrameras, F-Krujë	Nr i familjeve Rome	20 familje
8. Kryqëzimi I Unazës së Vogël, F-Krujë	Nr i familjeve Rome	9 familje
9. Lagja "Punëtori", F-Krujë	Nr i familjeve Rome	7 familje
10. Arrameras i Sipërm, (Rruga Stafuka), F-Krujë	Nr i familjeve Rome	6 familje
12. Qendër Thumanë, Nj.A.Thumanë	Nr i familjeve Rome	7 familje
13. Qendër Borizanë, Nj.A.Thumanë	Nr i familjeve Rome	7 familje
Total	129 familje	151 familje
<b>Total</b>	<b>113 familje</b>	<b>23 familje</b>

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016


Vlerësimi i nevojave për strehim tregon që Komunitetet Rome dhe Egjiptiane kanë probleme të ngjashme, banesat e tyre janë jashtë çdo norme e standarti banimi. (Tabela 6).

**Tabela 6: Familjet nga Komunitetet R&E sipas gjendjes së strehimit**

Lloji i kushteve të strehimit	Nr	Në %
Jetojnë në tenda, barraka, magazina	82	29.3%
Jetojnë në garsoniera	155	55.4%
Jetojnë në apartamente 1+1	38	13.6%
Jetojnë në apartamente 2+1	4	1.4%
Jetojnë në apartamente 3+1 ose më shumë	1	0.4%
<b>Total</b>	<b>280</b>	<b>100</b>

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

**Figura 5: Situata aktuale e strehimit e komuniteteve R/E**



Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

Siç mund të shihet nga Tabela 6 dhe Figura 5, rreth 29 përqind e familjeve jetojnë në tenda, baraka, magazine, 56 përqind jetojnë në garsoniere dhe pjesa tjetër prej 15 përqind jetojnë në apartamente 1+1 dhe 2+1. Siç është vënë re gjatë vizitave në vend, pothuajse të gjitha "shtëpitë" kanë probleme me strukturat dhe kushtet higjieno-sanitare.

Përsa i përket aksesit tek uji, kanalizimet dhe energjia (tabela 6), vetem 21 përqind e familjeve janë të lidhura me sistemin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.


**Tabela 7: Aksesit tek rrjetet e furnizimit me ujë, kanalizimet dhe energjia te Komuniteteve R/E ne Bashkine Kruje**

Përqindja e familjeve që mund të përdorin rrjetin inxhinierik	Vizitat në vend
Rrjeti i Ujësjetës	21.4%
Rrjeti i Kanalizimeve	20.7%
Rrjeti i Energjisë Elektrike	75.4%

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

Përsa i përket llojit të vendbanimeve vetëm për Komunitetin Rom (figura 6), studimi tregoi që 42 përqind e popullsisë totale të Romëve jetojnë në tenda, baraka, ose magazine, 54 përqind jetojnë në garsoniera, 4 përqind jetojnë në 1+1. Kushtet e infrastrukturës në Krujë janë optimal në të gjitha vendbanimet Rome, megjithatë rreth 75 përqind kanë probleme me kushtet e ndërtimit të banesave.

**Figura 6: Llojet e banesave, komuniteti Rom**




**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

Përsa i përket infrastrukturës inxhinierike dhe kushteve higjieno sanitare, të dhënat nga studimi tregojnë se 99 përqind e familjeve nuk i arrijnë standartet e nevojshme.

Përsa i përket vendbanimeve të Komunitetit Egjiptian studimi ka treguar që rreth 19 përqind jetojnë në tenda, baraka, magazine, 56 përqind në garsoniere, 22 përqind në apartamente 1+1 dhe pjesa tjetër prej 3 përqind banojnë në apartamente 2+1 ose 3+1. (Figura 7)

Kushtet e infrastrukturës në Krujë janë optimale pothuajse në të gjitha vendbanimet egjiptiane, vetëm në 5 vendbanime ( 21 përqind e familjeve totale ) mungon infrastruktura inxhinierike dhe pothuajse që të gjithë kanë probleme kritike me kushtet e ndërtimit të banesave.

**Figura 7: Llojet e strehimeve, komuniteti Egjiptian**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

Në lidhje me infrastrukturën inxhinierike dhe kushtet higjieno sanitare 88 përqind e familjeve nuk i arrijnë standartet e nevojshme.

Si konkluzion, grupi i vlerësimit gjykon se nevojat e familjeve Rome dhe Egjiptiane, banesat e të cilëve janë jashtë standarteve të jetesës, është një emergjence e vecantë në të gjitha vendbanimet për shkak të mungesës së çdo kushti bazë infrastrukturës, dhe standarteve higjieno-sanitare.

### 3.2. Situata ekonomike dhe sociale e Komuniteteve R&E

Në mënyrë që nevojat për Strehim Social të prioritarizohen, situata e komuniteteve Rome dhe Egjiptiana analizohet në bazë të një kombinimi treguesish të situatës socio ekonomike dhe kategorizimit të strehimit.

Për sa i përket situatës socio-ekonomike, përdoret klasifikimi i të ardhurave nga INSTAT. Sipas INSTAT, ka tre kategori bazë të ardhurash të cilat përdoren në vlerësimin e varfërisë, përkatësisht "Familje pa të ardhura", " Familje të ardhurat e të cilës janë më pak se 20,000 LEK në muaj" dhe "Familje të ardhurat e të cilës janë më pak se 30,000 LEK në muaj". Grupi i kërkimit i shtoi secilës kategori nga tre nën kategori, në mënyrë që të pasqyronte më saktë profilin e përjashtimit socio-ekonomik në Bashkinë Krujë.

Për sa i përket situatës së strehimit, përkufizimi "I pa strehë" përdoret sipas përcaktimit të Ligjit Nr. 9232, datë 13.05.2004 "Mbi Programet Sociale të Strehimit në Zonën Urbane" duke përfshirë dhe rishikimet dhe ndryshimet e këtij ligji.

Sic mund të kuptohet nga informacioni i dhënë në Tabelën 8, ndërsa ka vetëm shumë pak familje (10,2 përqind) të ardhurat e të cilëve janë me pak se 30.000 All në muaj, pjesa më e madhe e familjeve në nevojë nuk kanë fare të ardhura. ( shih Tabeln 8).

**Tabela 8: Treguesi i përbërë i gjëndjes social-ekonomike & situatës së strehimit të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane**


Kategorizimi i Strehimit	Nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi		Kanë në pronësi hapësirë banimi nën standartin e banimit		Jetojnë në banesa nën standartin e banimit	
	Rom	Egjiptian	Rom	Egjiptian	Rom	Egjiptian
<b>Kategorizimi socio-ekonomik</b>						
Familje pa të ardhura	0	7	11	6	1	0
Pa të ardhura + persona të sëmurë	1	5	1	14	0	2
Familje pa të ardhura, me një mbajtës grua	1	3	2	6	1	0
Familje pa të ardhura + fëmijë <sup>7</sup>	2	29	33	37	38	3
Të ardhura <Lek20.000/m	0	8	1	0	0	1
Të ardhura <Lek20.000/m + persona të sëmurë	0	0	0	2	0	0
Të ardhura <Lek20.000/m, +fëmijë	0	0	0	1	0	0
Të ardhura<Lek20.000/m, një mbajtës grua	0	0	0	1	0	1
Të ardhura<Lek30.000/m, një mbajtës grua	0	0	0	4	2	0
Të ardhura <Lek30.000/m, +fëmijë	0	0	0	1	1	0
<b>Total</b>	<b>4</b>	<b>52</b>	<b>48</b>	<b>72</b>	<b>43</b>	<b>7</b>

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

<sup>7</sup> Fëmijë 0 deri 1 vjeç.

Figura 8 tregon nevojat për strehim për të dy komunitetet (Rome dhe Egjiptiane) sipas të ardhurave.


**Figura 8: Strehimi Rom dhe Egjiptian sipas të ardhurave të tyre**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

Figura 9 tregon përbërjen vetëm të "familjeve pa të ardhura" sipas nevojës së tyre për strehim.

**Figura 9: Familje pa të ardhura të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane sipas situatës së strehimit, në përqindje**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

Sic tregohet në figurat 8 dhe 9, pjesa më e madhe e familjeve nga Komunitetet Rome dhe Egjiptiane jetojnë në varfëri të skajshme për shkak të mungesës së të ardhurave, ndërsa banesat e tyre janë jashtë çdo standarti banimi.

### 3.3. Territori dhe infrastruktura e vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane

Sic është thënë më parë në Kapitullin 3.1, në lidhje me kushtet e strehimit të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, ata jetojnë në varfëri ekstreme. Strukturat e banesave të tyre janë të amortizuara dhe e bëjnë të pamundur ndërhyrjen për ti përmirësuar.

Kryesisht ata jetojnë në tenda, baraka dhe magazina dhe janë të pambrojtur nga temperaturat dhe rreshjet. Banesat shpesh kanë mungesë të elementëve bazë si çati, dyer, dritare. Edhe kushtet e zonave të banimit janë nën nivelin e standarteve të miratuara të strehimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Një faktor tjetër i rëndësishëm është vendndodhja e tyre, larg nga Qendrat Mjekësore, shkollat dhe kopshtet. Disa prej tyre janë shumë afër lumenjve që i rrezikon ata sistematikisht nga përmbytjet. Pas vizitës të vendbanimeve Rome e Egjiptiane në Krujë u arrit në përfundimin se ata jetojnë nën standartet e strehimit, si në drejtim të konstruksioneve të banesave, ashtu edhe sipas hapësirave të banimit, të cilat janë të pamjaftueshme.

Vizitat në vendbanimet e tyre treguan gjithashtu se ndërsa këto vendbanime janë të pajisura me infrastrukturën inxhinierike, pjesa më e madhe e familjeve nuk kanë akses në to.

Komuniteti Egjiptian jeton në kushte më të këqija se Komuniteti Rom. Duke marrë parasysh përbërjen e familjeve si dhe kushtet ekzistuese të strehimit të popullsisë Rome në Bashkinë e Krujës, Grupi i Vleresimit hartoi Tabelën 9, e cila jep informacion në lidhje me nevojën për strehim në Bashkinë Krujë.

Në përgatitjen e Tabelës 8, janë marrë në konsideratë standartet ekzistuese të strehimit sipas legjislacionit aktual dhe është përdorur informacioni nga intervistat ballë për ballë për të llogaritur nevojën totale.

Siç tregojnë të dhënat e përpunuara nga Pyetsori 2, banesat ekzistuese janë jashtë çdo standarti, prandaj të gjitha familjet kanë nevojë për shtëpi të përshtatshme sipas standarteve, me përjashti të vetëm 8 familjeve, nga 113, të cilat zotërojnë sipërfaqë banimi në përputhje me legjislacionin shqiptar.




**Tabela 9: Kërkesa për strehim e komunitetit Rom në Bashkinë Krujë**

Lloji i Banesës	Nevojat siaps studimit	Llogaritja e nevojave
Nr. I familjeve që kanë nevojë për garsonierë	18	20
Zona totale e nevojshme për garsoniera (total m <sup>2</sup> )	500,8	543,50
% e garsonierave	6%	6%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 1+1	14	15
Zona totale e nevojshme për apartamente 1+1 (total m <sup>2</sup> )	634,2	688,28
% e 1+1	8%	8%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 2+1	44	48
Zona totale e nevojshme për apartamente 2+1 (total m <sup>2</sup> )	2484,2	2696,03
% e 2+1	32%	32%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 deri në 75,5 m <sup>2</sup>	38	41
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1 (total m <sup>2</sup> )	2841,5	3083,80
% e 3+1	37%	37%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 më shumë se 75,5 m <sup>2</sup>	15	16
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1+ (total m <sup>2</sup> )	1282,5	1391,86
% e 3+1+	17%	17%
<b>Numri Total i Familjeve</b>	<b>129</b>	<b>140</b>
<b>Zona totale e nevojshme për strehim m<sup>2</sup></b>	<b>7.743,2</b>	<b>8.403,47</b>

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

Siç tregon Tabela 9, për të akomoduar të gjithë Komunitetin Rom nevojiten 140 apartamente (100 përqind e numrit total të familjeve), me një sipërfaqe ndërtimi prej 8.403,47 m<sup>2</sup>, për të akomoduar respektivisht: 20 familje me garsoniere, (6% e sipërfaqes totale të ndërtimit) në 543,5 m<sup>2</sup>, 15 familje me apartamente 1+1 (8% e sipërfaqes totale të ndërtimit) në 688,28 m<sup>2</sup>, 48 familje me apartamente 2+1 (32% e sipërfaqes totale të ndërtimit) në 2696,03 m<sup>2</sup>, 41 familje me apartamente 3+1 (37% e sipërfaqes totale të ndërtimit) në 3083,8 m<sup>2</sup>, 16 familje me apartamente 4+ s (17% e sipërfaqes totale të ndërtimit) në 1391,86 m<sup>2</sup>.

**Figura 10: Nevojat për strehim të komunitetit Rom**



Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016


Tabela 10 jep të njëjtin informacion si Tabela 9, por për Komunitetin Egjiptian. Siç mund të vihet re, 30 familje kanë nevojë për garsoniere (7 përqind të sipërfaqes totale të ndërtimit) në 707,6 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi, 16 familje kanë nevojë për apartament 1+1 (7 përqind të sipërfaqes totale të ndërtimit) në 744,1 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi, 51 familje kanë nevojë për apartament 2+1 (28 përqind të sipërfaqes totale të ndërtimit) në 2813,7 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi, 47 familje kanë nevojë për apartament 3+1 (36 përqind të sipërfaqes totale të ndërtimit) në 3640,9 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi, ndërsa 23 familje kanë nevojë për apartament 4+ (21 përqind të sipërfaqes totale të ndërtimit) në 2081,1 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi. Në total, popullsia Egjiptiane në Krujë ka nevojë për 168 apartamente në 9.988 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi.

**Tabela 10: Kërkesa për strehim e komuniteti Egjiptian në Bashkinë Krujë**

Lloji i Banesës	Nevojat siaps studimit	Llogaritja e nevojave
Nr. i familjeve që kanë nevojë për garsonierë	27	30
Zona totale e nevojshme për garsoniera (total m <sup>2</sup> )	636,8	708,5
% e garsonierave	7%	7%
Nr. i familjeve që kanë nevojë për apartamente 1+1	15	17
Zona totale e nevojshme për apartamente 1+1 (total m <sup>2</sup> )	668,8	744,1
% e 1+1	7%	7%
Nr. i familjeve që kanë nevojë për apartamente 2+1	46	51
Zona totale e nevojshme për apartamente 2+1 (total m <sup>2</sup> )	2529	2813,7
% e 2+1	28%	28%
Nr. i familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 deri në 75,5 m <sup>2</sup>	42	47
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1 (total m <sup>2</sup> )	3272,5	3640,9
% e 3+1	36%	36%
Nr. i familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 më shumë se 75,5 m <sup>2</sup>	21	23
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1+ (total m <sup>2</sup> )	1870,5	2081,1
% e 4+	21%	21%
<b>Numri total i familjeve</b>	<b>151</b>	<b>168</b>
<b>Zona totale e nevojshme për strehim</b>	<b>8.977,6</b>	<b>9.988</b>

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

**Figura 11: Nevojat për strehim të komunitetit Egjiptian**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

### 3.4 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 3

Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Krujë vuajnë nga përjashtimi i shumfishtë socio-ekonomik që manifestohet nëpërmjet varfërisë ekstreme në të cilën jetojnë. E drejta e tyre bazë e strehimit është e mohuar.

- ▶ Megjithëse 50,5 përqind e Romëve dhe 55 përqind e Egjiptianëve zotërojnë një hapësirë banimi, ato janë jashtë çdo standarti jetese. Pjesa tjetër e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë e Krujës , respektivisht 49,5 përqind Romë dhe 45 përqind Egjiptian kanë nevojë për strehim për shkak të mungesës të çdo kushti bazë jetese.
- ▶ Megjithëse vendbanimet e tyre, 100% e Romeve dhe 79% e Egjiptianeve janë të pajisur me infrastrukturë dhe janë afër qytetit të Fushë Krujës dhe shërbimeve bazë sociale, mungesa e kushteve bazë të higjienës dhe jetesës , i ve ata në rrezik të lartë për përjashtim.
- ▶ Kushtet e banimit të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Krujës janë shumë të këqija: vetem 6,8 përqind jetojnë në shtëpi në kushte të pranueshme; 80 përqind e familjeve nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellesit dhe kanalizimeve dhe 24 përqind nuk janë të lidhur me rrjetin e furnizimit me energji, megjithëse të gjitha vendbanimet rome dhe 79 përqind e vendbanimeve egjiptiane janë të pajisura ne të gjitha rrjetet inxhinierike. .
- ▶ Është e nevojshme të sigurohen 140 banesa për familje rome dhe 168 për familje egjiptiane, të cilët mund të akomodohen në një sipërfaqe ndëtimi prej 18,391.47 m<sup>2</sup> .
- ▶ Pë fat të keq, Komunitetet Rome dhe Egjiptiane nuk mund t’a zgjidhin vetë situatën e strehimit për arsye të mungesës së të ardhurave. Pothuajse që të gjithë ata (89,8 përqind) janë pa të ardhura
- ▶ Prandaj, strehimi social mbetet e vetmja politikë efektive për të zgjidhur nevojat e strehimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian.

## 4.

## ALTERNATIVA TË POLITIKAVE PUBLIKE

### 4.1. Ndërhyrjet dhe planet e qeverisjes lokale

Ligji Nr. 9232 për “Strehimin Social” u miratua për herë të parë në vitin 2004. Që prej asaj kohe, ligji është ndryshuar disa herë me qëllim rritjen e efektivitetit të tij duke lehtësuar procedurat e aplikimit si dhe rritjen e aksesit për personat e pastrehë ndaj tregut të banesave. Për më tepër, Bashkia Krujë nuk e ka adresuar problemin e strehimit në Planin e Zhvillimit të Territorit, të miratuar së fundmi.

Strehimi nëpërgjithësi dhe strehimi social në veçanti nuk janë komponentë të këtij plani. Përveç kësaj Bashkia Krujë nuk ka patur asnjë herë buxhet për strehimin social me përjashtim të vitit 2016. Të dhënat tregojnë se 37 familje rome kanë përfituar mbështetje për strehim në periudhën 2010-2015.<sup>8</sup>

Pavarësisht përqindjes së ulët të të pastrehëve në Bashkinë Krujë ( rreth 2,5 përqind ,Figura 10) situata kërkon një plan për zgjidhje.

**Tabela 11: Arsyet që pengojnë familjet Rome dhe Egjiptiane të realizojnë të drejtën për strehim**

	KUFIZIMET E KËRKESËS	KUFIZIMET E OFERTËS
TREGU I PËRGJITHSHËM I BANESAVE	Situata kritike socio-ekonomike e aplikantëve potencialë	Problemet ligjore në lidhje me të drejtën e pronës/tokës Mungesë e planit për strehim Mungesë e fondeve. Mungesë e projekteve.
SEGMENTI I TREGUT TË STREHIMIT TË ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE	Situata kritike socio-ekonomike e aplikantëve potencialë	Mungesa e tokës së lirë për ndërtim Mungesa e planit për ndërtim social.

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

Tabela 12 tregon pjesën e buxhetit lokal të caktuar për ndërtime banesash sociale. Siç mund të kuptohet , megjithë transfertat pakushtëzuar në 2016 përbën 48 përqind dhe të ardhurat lokale 27 përqind të buxhetit të përgjithshëm, buxheti lokal, i destinuar tek strehimi social është zero, nuk ka fonde lokale të dhëna për strehimin social, ndërsa të “ardhurat e veta” të destinuara për strehim social përbëjnë një fond thuajse të papërfillshëm (4 përqind).

<sup>8</sup> Studimi, 2016

**Tabela 12: Buxheti i Bashkisë Krujë për strehim social, 2016**

Buxheti/vitet	2016	Në%
Total në 000/Lek	519,554	100
Të ardhurat lokale në 000/All	193,450	27
Të ardhurat e vetapër strehim social në 000/All	21,306	4
Buxheti Total i alokuar për Strehim Social në 000/All	0	0
Tansfera të pakushtëzuara në 000/All	249,566	48
Ngritje fondesh (burime të tjera, donacione, fonde të jashtme) në EURO	0	

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016 dhe <http://open.data.al/en/lajme/lajm/id/1647/titull/Unconditional-and-specific-transfers-by-municipalities-2016>

Analiza tregon se Bashkia Kurjë mund të përpiqet të identifikojë burime financiare lokale për të zgjidhur pjesërisht problemin e strehimit. Gjithsesi, analiza e buxhetit duhte të shkojë dorë për dorë me përgatitjen e e një Strategjie Strehimi/Strehimi Social dhe të Planit të Veprimit, të cilët mungojnë.

## 4.2 Sugjerime politikash publike për të zgjidhur problemin e strehimit në Bashki

Duke ju referuar Ligjit Nr. 9232, programet e strehimit social janë “programe të cilat shërbejnë për të strehuar familjet dhe individët të cilët për shkak të situatës së tyre ekonomike dhe sociale nuk mund të përballojnë ofertën e tregut të lire ose kredinë”.

Qeveria ka krijuar tre programe të strehimit social: **banesa sociale me qera, banesat me kosto të ulët, dhe programin e pajisjes së truallit me infrastrukturë**. Për më tepër, qeveria ka krijuar ofrimin e subvencioneve të strehimit, subvencionimit të kredive, grantet e vogla, dhe grantet e menjëhershme të cilat synojnë grupe specifike (shih më poshtë për një përshkrim të secilit program). Përfituesit e programeve të strehimit social duhet të përmbushin një nga kriteret në vazhdim: ata nuk duhet të kenë një banesë në pronësi, duhet të kenë një banesë e cila është nën normat e banimit; ose duhet të jenë të pastrehë për shkak të katastrofave natyrore (Ligji 9232, Neni 4).

Zgjedhja e përfituesve bazohet në kushtet e tyre të jetesës si dhe rrethanave të tyre sociale dhe ekonomike. Prioriteti është vendosur mbi 15 grupe, duke përfshirë familjet me një prind kryefamiljar, familjet e gjera, të rriturit më të vjetër, personat e paaftë, çiftet e reja, familjet që kanë ndryshuar vendbanim, jetimët, emigrantët që kthehen, punonjësit e migruar nga qyteti në qytet, azilkërkuesit, oficerët e rënë në detyrë, viktimat e dhunës familjare, familjet Rome, familjet Egjiptiane, dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.

Për tu përzgjedhur në sistemin e pikëzimit, familja duhet të përmbushë dy kushte: Të ardhurat mujore nuk duhet të jenë më të larta se 100% e mesatares së zonës për strehim social dhe 120% për strehimin me kosto të ulët; Familjet nuk duhet të kenë në pronësi një banesë, ose të jetojnë në një shtëpi, përmasat e të cilës nuk janë më të mëdha se standartet minimale të vendosura nga ligji.

Për të identifikuar programet më të përshtatshme të strehimit social për për komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Krujës, u hartuan Tabelat 13 dhe 14. Nga analiza e thellë e informacionit të dhënë në tabelën 13, gjasat e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane për të patur akses ndaj programeve të Strehimit Social duken të ulta.

**Tabela 13: Zbërthimi I familjeve të pastreha sipas të ardhurave**

Familjet e pastreha	Pa të ardhura	Të ardhura të pamjaftueshme	Totali
Nuk zotërojnë sipërfaqe banimi	48	8	56
Zotërojnë sipërfaqe banimi nën standartet e strehimit	110	10	120
Jetojnë në shtëpi nën standartet e strehimit	45	5	50
Totali	203	23	226
Në përqindje	89,8	10,2	100

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

**Tabela 14: Vlerësimi i programeve të Strehimit Social kundrejt kushteve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane**

Programet e Strehimit Social	Kriteret e përgjithshme	Familjet në nevojë strehimi		
		Nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	Kanë në pronësi hapësirë banimi nën standartin e banimit	Jetojnë në banesa nën standartin e banimit
	1.Nuk duhet të zotërojnë një banesë; 2. Duhet të kenë një vend banimi nën normat e strehimit; 3. Duhet të jenë të pastrehë për shkak të fatkeqesive natyrore.	56 familje nga të cilat 48 pa të ardhura dhe 8 me të ardhura të pamjaftueshme, më pak se All 30,000 në muaj	120 familje nga të cilat 110 pa të ardhura dhe 10 me të ardhura të pamjaftueshme më pak se All 30,000 në muaj	50 familje nga të cilat 45 pa të ardhura dhe pjesa tjetër me të ardhura të pamjaftueshme
BSQ Banesat Sociale me Qera	Qeveria vendore ndërton njësi banimi, të cilat jepen me qera me çmim të ulët për kategoritë sociale.	Për familjet pa të ardhura, mund të aplikohet, nëse “modifikohen kushtet e qerasë” Për familjet me të ardhura të pamjaftueshme mund të jetë një zgjidhje Nr. Optimal i Përfutuesve:8	Për familjet pa të ardhura, mund të aplikohet, nëse “modifikohen kushtet e qerasë” Për familjet me të ardhura të pamjaftueshme mund të jetë një zgjidhje Nr. Optimal i Përfutuesve 10	Për familjet pa të ardhura, mund të aplikohet, nëse “modifikohen kushtet e qerasë”

Programet e Strehimit Social	Kriteret e përgjithshme	Familjet në nevojë strehimi		
		Nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	Kanë në pronësi hapësirë banimi nën standartin e banimit	Jetojnë në banesa nën standartin e banimit
SS Subvencionimi i Strehimit	Autoritetet vendore mund të alokojnë subvencione strehimi për përfituesit e banesave sociale me qera. SS ≤ 50% e velrës minimale të qerasë. (Vlera e qerasë – SS) ≤ 30% e të ardhurave të familjes.	Mund të aplikojnë nëse “kushtet e qerasë” ndryshohen.	Mund të aplikojnë nëse “kushtet e qerasë” ndryshohen.	Mund të aplikojnë nëse “kushtet e qerasë” ndryshohen.
BKU Banesat me Kosto të Ulët	Njësit me kosto të ulët ndërtohen ose blihen me çdo fond për familjet, të ardhurat e të cilave janë ≤ 120 % e mesatares së të ardhurave të rrethit.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.
TPI Truallit i pajisur me infrastrukturë	Investime në infrastrukturën e truallit në prona shtetërore, nga qeveria vendore për qëllime sociale ose përfitim. Duhet të ketë truall të lirë.	Mund të aplikojnë nëse: • Ka truall të lirë; • Kosto e lejon; • Të përcaktuara për “qëllime sociale”	Mund të aplikojnë nëse: • Ka truall të lirë; • Kosto e lejon; • Të përcaktuara për “qëllime sociale” • Territoret ekzistuese mund të përdoren. • E lejojnë kushtet infrastrukturore dhe inxhinierike të territoreve ekzistuese.	Mund të aplikojnë nëse: • Ka truall të lirë; • Kosto e lejon; • Të përcaktuara për “qëllime sociale” • Territoret ekzistuese mund të përdoren. • E lejojnë kushtet infrastrukturore dhe inxhinierike të territoreve ekzistuese.
SBQ Subvencionimi i Banesave me qera	Nëse qeraja e njësisë sociale të strehimit ≥ 25% të të ardhurave të familjes, familja përfiton subvencionim qeraje. SBQ = qeraja aktuale – qeraja e përballeshme.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.
SK Subvencionimi i Kredive	Përfituesit e banesave me kosto të ulët kanë të drejtë të marrin një kredi me terma të favorshëm nga një institucion financiar, i cili ka një kontratë me Ministrinë e Financave.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.	Të përjashtuar për shkak të kriterit të të ardhurave.

Grantet e vogla, dhe grantet e menjëhershme që synojnë grupe specifike (shih më poshtë për përshkrimin e secilit program)	Përfituesve të banesave me kosto të ulët i jepen grante të menjëhershme në rrethana të veçanta.	Nuk aplikojnë	Nuk aplikojnë	Nuk aplikojnë
---	---	---------------	---------------	---------------

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

Ndërsa modifikimi i kushteve të qerasë si dhe “qëllimi social” kërkojnë veprime ligjore, duket të ketë një hapsirë shumë të ngushtë për zgjidhje kundrejt nevojave për strehim të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, nëse plotësohen/zgjidhen disa kushtëzime:

### Opsion 1:

#### Programi BSQ: Qeveria vendore ndërton njësi banimi.

Hipotezat:

- ▶ Ka truall të lirë.
- ▶ Ka vullnet politik dhe mundësi financiare për të ofruar strehim pa pagesë.
- ▶ Risku i diskriminimit pozitiv neglizhohet.

Përfituesit e mundshëm : 308 familje, vetëm ato që jetojnë në banesa jashtë çdo standarti.

### Opsion 2:

#### Programi PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në pronat shtetërore.

Hipotezat:

- ▶ Ka truall të lirë/ prona shtetërore të lira/ objekte.
- ▶ Ka vullnet politik dhe mundësi financiare për të ofruar strehim pa pagesë.
- ▶ Risku i diskriminimit pozitiv neglizhohet.

Përfituesit e mundshëm: Njësoj si në Variantin 1, 308 familje .

Nuk ka “truall të lirë” në të cilin ekziston vetëm nevoja e investimit në infrastrukturë. Mundësia e vetme për zgjidhje duket se është ajo e shtjelluar në Opsionin 1.

### Opsion 3:

#### Programi PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në vendbanimet ekzistuese Rome dhe Egjiptiane.

Hipotezat:

- ▶ Mundësia e përdorimit efektiv i territoreve ekzistuese është e lartë.
- ▶ Kushtet infrastrukturore dhe inxhinierike të territoreve ekzistuese e lejojnë.

Përfituesit opsionale: 215 familje. Ky është numri i familjeve në nevojë për të përmirësuar kushtet e jetesës, por që kanë një hapësirë banimi.

#### Opsion 4:

##### Një kombinim ndërmjet tre alternativave të mëparshme

Përfituesit opsionale: 308 familje, i njëjtë me numrin total të familjeve në nevojë për strehim.

### 4.3. Një vlerësim i kostos për ndërhyrje të ndryshme të bashkive

#### Opsioni 1:

##### Programi BSQ: Qeveria vendore ndërton njësi banimi.

Disa kritere merren në konsideratë:

- Kosto mesatare e njësisë i referohet **“Udhëzimit nr.4 dt 30.4.2015 për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2015.”**
- Sipas **Entit Kombëtar të Banesave**, kosto mesatare e ndërtimit në Krujë është: 32.511 lek/m<sup>2</sup>.
- Kosto për rrjetet inxhinierike është 23 €/m<sup>2</sup>; 3,197 lek/m<sup>2</sup> (10€ për elektrike, 5 € për IT, 8€ për rrejtin e furnizimit me ujë, kanalizimet dhe ujrën e shiut).

Kështu kosto për ndërtim të reja për komunitetin Rom (140 apartamente në sipërfaqe ndërtimi 8.403,47 m<sup>2</sup>):

$$\text{Kosto e ndërtimit} = 32.511 \text{ lek/m}^2 * 8.403,47 \text{ m}^2 = \text{ALL } 273.205.213,2$$

$$\text{Rrjetet inxhinierike} = 8.403,47 \text{ m}^2 * 3.197 \text{ lek/m}^2 = \text{ALL } 26.865.893,6$$

$$\text{Kosto totale} = 273.205.213,2 \text{ lek} + 26.865.893,6 \text{ lek} = \text{All } 300.071.106,8$$

Vlerësimi i kostos për ndërtimet e reja për komunitetin Egjiptian (168 apartamente në sipërfaqe ndërtimi 9.988m<sup>2</sup>):

$$\text{Kosto e ndërtimit} = 32.511 \text{ lek/m}^2 * 9.988,3 \text{ m}^2 = \text{All } 324.729.621,3$$

$$\text{Rrjetet inxhinierike} = 9.988,3 \text{ m}^2 * 3.197 \text{ lek/m}^2 = \text{All } 31.932.595,1$$

$$\text{Kosto totale} = 324.729.621,3 \text{ lek} + 31.932.595,1 \text{ lek} = \text{All } 356.662.216,4$$

**Opsioni 1: Kosto Totale për ndërtim të ri = All 656.733.323**

#### Opsioni 2:

##### Programi PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në pronat shtetërore.

Ky opsion nuk është përpunuar më tej pasi nuk ka asnjë pronë shtetërore e lirë e cila mund të përdoret për këtë qëllim. Në kushtet e dhëna, ky program nuk mund të aplikohet.

#### Opsioni 3:

##### Program PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në vendbanimet ekzistuese Rome dhe Egjiptiane.

Disa kritere janë marrë në konsideratë:

- Udhëzimi i MZHU datë 03/08/2015 për sa i përket kostos maksimale të rehabilitimit të infrastrukturës ekzistuese.
- Kosto e rehabilitimit nuk duhet të kalojë 650.000,00 lekë/banesë dhe ndërtimi i ri nuk duhet të tejkalojë 1.200.00,0 lekë/banesë (përfshirë TVSH).
- Vetëm familjet që zotërojnë një hapësirë banimi dhe kosto mesatare e rehabilitimit/ndërtimit të ri përlogarit 925.000,0 lekë (650.000 + 1.200.00)/2, janë marrë në konsideratë

**Table 15: Përmbledhje e rezultateve të familjeve të intervistuar**

Nr. I familjeve që nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	122
Nr. I familjeve që zotërojnë hapësirë banimi nën kërkesat e zonës	158
Nr. I familjeve që banojnë nën standartet e miratuara	280
Nr. I familjeve që jetojnë në qendra komunitare	0

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

Sic mund të shihet nga tabela 15 më sipër, 158 familje nga 280 (56.4%) të komunitetit Rom dhe Egjiptian zotëron sipërfaqe banimi, që, megjithatë, është nën standartin e strehimit.

Bazuar në kriteret e shpjeguara më sipër, numri i përfituesve potencialë është 174 familje. (56.4 përqind e 308 familjeve).

**Kosto totale e rehabilitimit = 174 familje \* 925.000,0 lek/familje = All 160.950.000,0**

**Opsioni 3: Kosto Totale për rehabilitim = All 160.950.000,0**

Grupi i studimit, nuk sugjeron të synohet ky variant sepse nuk e zgjidh problemin e strehimit, përdërisa çënohet minimumi i standartit të hapësirës së banimit, sipas ligjit Shqiptar.

#### Opsioni 4:

##### Një kombinim ndërmjet tre alternativave të mëparshme

Ky opsion nuk konsiderohet më tej pasi siç mund ta shohim nga opsioni i mëparshëm, i vetmi që mund ta zgjidhë në mënyrë permanente problemin e strehimit është opsioni nr. 1.

**Tabela 14: Përmbledhje e rezultateve të kostove të alternativave të politikave në krahasim me Buxhetin Bashkiak aktual**

Opsioni i Politikës	Kosto	Buxheti Bashkiak 2016	Në % në krahasim me buxhetin aktual
Opsioni 1 (në 000)	Lekë 1.153.841	Lekë 2.819.356.	41 përqind
Opsioni 3 (në 000)	Lekë 351.500	Lekë 2.819.356	12,5 përqind

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

#### 4.4 Plan veprimi për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane

	Objektivat/detyrat	Kohëzgjatja	Rezultate/Mjetet e verifikimit
<b>1.</b>	<b>Bashkia Durrës Strategjia e Strehimit për Romët dhe Egjiptianët</b>	<b>Qershor 2017</b>	<b>Strategjia e Strehimit për Romët dhe Egjiptianët miratohet nga Këshilli Bashkiak</b>
1.1	Diskutim dhe miratim i raportit të Vlerësimit	Dhjetor 2016	Raporti i Takimit
1.2	Analiza në thellësi i opsioneve të politikave	Janar 2017	Këshilli Bashkiak është në djeni të opsioneve të politikave.
1.3	Ri-vlerësim i nevojave për strehim	Shkurt 2017	Raporti i vlerësimit validohet nga Ekipi i Menaxhimit të Bashkisë
1.4	Ri-vlerësimi i furnizimit të strehimit.	Shkurt 2017	Raporti i vlerësimit validohet nga Ekipi i Menaxhimit të Bashkisë
1.5	Ri-vlerësimi i alternativave të politikës.	Mars 2017	Merret vendimi final mbi politikën më të mirë.
1.6	Përgatitja dhe miratimi i Strategjisë	Maj 2017	Strategjia miratohet nga Këshilli
1.7	Përgatitja e planit të implementimit	Qershor 2017	Plani i implementimit miratohet
<b>2.</b>	<b>Buxheti i Strategjisë së Strehimit për Romët dhe Egjiptianët</b>	<b>Tetor 2017</b>	<b>Bashkia ngre fonde të mjaftueshme për të përballuar implementimin e Strategjisë së Strehimit</b>
2.1	Rishikimi i buxhetit vendor	Qershor 2017	Miratohet plan buxheti i ri
2.2	Diskutim mbi strategjinë me palët e interesuara dhe donatorët	Qershor 2017	Vullneti i palëve të interesuara për të investuar konfirmohet
<b>3.</b>	<b>Rishikimi i legjislacionit</b>	<b>Qershor 2017</b>	<b>Legjislacioni rishikohet dhe miratohet</b>
3.1	Propozim për rishikim të legjislacionit mbi Strehimin Social sipas opsioneve të politikave të identifikuar	Qershor 2017	Ndryshime ndaj legjislacionit miratohen
<b>4.</b>	<b>Implementohet Strategjia e Strehimit</b>	<b>Dhjetor 2017</b>	<b>Plani i investimit për zgjidhjen e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane miratohet nga Këshilli Bashkiak</b>
4.1	Identifikimi i nevojave për ndërtim (analizë e detajuar)	Tetor 2017	Miratohet plani i investimit
4.2	Zgjidhja e problemeve ligjore midis zonave të ndërtimit të zgjedhura dhe/ose sugjeruara.	Nëntor 2017	Çdo problem ligjor është zgjidhur
4.3	Studim i realizueshmërisë së zonave të ndërtimit të zgjedhura dhe/ose sugjeruara	Nëntor 2017	Plani i investimit miratohet
4.4	Finalizimi i planit të investimit	Dhjetor 2017	Projekti i investimit miratohet nga ekipi i menaxhimit të bashkisë.

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës, 2016

#### 4.5 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 4

Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Durrës kanë nevojë urgjente të zgjidhet çështja e strehimit të tyre. Megjithatë:

- ▶ Gjetjet tregojnë se Bashkia Krujë, brënda kushteve aktuale të buxhetit, mund të përpiqet të zgjidhë pjesërisht problemin e strehimit ose për Romët dhe Egjiptianët ose për të gjithë popullsinë. Gjithsesi, është e nevojshme një mbështetje nga palë të tjera.
- ▶ Pavarësisht faktit që qeveria ka krijuar programe të strehimit social, pjesa më e madhe e tyre, nuk duket të jenë të përshtatshme për të zgjidhur nevojat për strehim të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, për shkak të kushtëzimit nga të ardhurat.
- ▶ Mund të merren në konsideratë vetëm dy programe të strehimit social, konkretisht strehimi me kosto të ulët dhe program i pajisjes së tokës me infrastrukturë, nëse merren në konsideratë disa rishikime ligjore.
- ▶ Bazuar në llogaritjen e kostos, Varianti 1 nuk mund të financohet nga Buxheti i Bashkisë, prandaj Bashkia Krujë ka nevojë për mbështetje financiare ose nga buxheti qendror ose nga burime të tjera të jashtme. Megjithëse llogaritjet e koston për variantin 2 tregojnë se, në kushte absolute ai mund të financohet nga Bashkia, por kjo nuk mund të bëhet për shkak të mungesës së tokës së lire. Varianti 3 mund ta zgjidhë pjesërisht problemin, megjithëse e ka koston sa rreth 1/3 e buxhetit total.
- ▶ Në anën tjetër, ka edhe kosto të tjera indirekte që duhen konsideruar për shkak të rrezikut që mbart secili variant i politikave. Përveç kësaj, disa rreziqe mund të kenë implikime financiare, respektivisht rreziku i diskriminimit, rreziku i izolimit si dhe rreziku i tensionit social me ish pronarët e pronave dhe tokave.
- ▶ Bashkia Krujë është në nevojë urgjente për Zhvillimin e një Strategjie Strehimi dhe Plani Veprimi.

## KONKLuzionet finale

- ▶ Në përgjithësi gjetjet sjellin një kuadër të qartë të sfidave me të cilat përballet strehimi social në bashkinë Krujë. Analiza tregon se kuadri ligjor aktual nuk është i mjaftueshëm për të zgjidhur problemet e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane. Gjetjet e kapitujve 3 dhe 4 sugjerojnë se adresimi i problemit të të pastrehëve Rom dhe Egjiptian në Krujë kërkon ndërmarrjen e hapave të shumëfishtë njëkohësisht, për shembull, rishikimi i kuadrit ligjor, zhvendosja e vëmendjes së programeve të strehimit social dhe financimit në drejtim të të varfërve më të varfër, dhe fuqizimi i kapaciteteve fiskale të qeverive vendore.
- ▶ Raporti i vlerësimit ofron një kontribut të vlefshëm në plotësimin e disa hapësirave në të dhëna specifike duke rishikuar dhe vlerësuar provat ekzistuese mbi kushtet e strehimit dhe jetesës (p.sh., kushtet e banimit, aksesit ndaj ujit, elektricitetit dhe kanalizimeve) të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë e Krujës.
- ▶ Për më tepër, raporti sjell një kontribut të vlefshëm në nivel politike. Plani i Veprimit, i zhvilluar në pikën 4.4 mund të përdoret si instrument udhëheqës për MZHU dhe bashkëpunimin e saj me institucionet e nivelit shtetëror, qeveritë vendore dhe organizatat komunitare për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Krujë.
- ▶ Megjithatë, Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Krujës ka një rëndësi të veçantë për Bashkinë e Krujës. Në nivel qeverisje vendore, duke përllogaritur investimet që duhen kryer në bashkinë e Krujës me qëllim përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, gjetjet dhe sugjerimet nuk do të kontribuojnë vetëm në implementimin e Planit të Veprimit, por gjithashtu në fuqizimin e kapaciteteve të administratës vendore kundrejt implementimit në tërësinë e saj të strategjisë së strehimit social në nivel vendor.

## Bibliografia


- A Needs Assessment Study on Roma and Egyptian Communities in Albania, CESS mbështetur nga UNDP, 2012
- Civil Society Monitoring Report, the Implementation of the National Roma Integration CORRUPTION RISK ASSESSMENT: PROVISION OF SOCIAL HOUSING IN ALBANIA, Dritan Shutina, May 2011
- Housing Policies and Practice for Roma in Albania, UNDP ALBANIA, SEPTEMBER 2013
- National Strategy for Development and Integration, 2014-2020.
- National Action Plan for the Integration of Roma and Egyptians in Albania, 2016-2020; Roma and Egyptian in Albania- Socio-demographic and economic profile, based on census 2011, January 2015.
- Strategy and Decade Action Plan in 2012, ALBANIA, 2013, HDPC
- Strategy for Social Housing, 2015-2025
- Social Inclusion Policy Document, 2015-2020

# SHTOJCË

## *Harta e Vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane*







REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

PROGRAMI “MBËSHTETJA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE NË SHQIPËRI”

VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
**ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKINË LEZHË**  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË TYRE

---

RAPORTI FINAL  
Janar 2017





## PËRMBAJTJA

FALËNDERIME	5
LISTA E SHKURTIMEVE	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
HYRJE	9
KAPITULLI 1: RISHIKIMI I KONTEKSTIT LIGJOR KUNDREJT TË DREJTËS PËR STREHIM TË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE	11
1.1 Situata e përgjithshme e nevojave për strehim të Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë e Lezhës	
1.2 “Strehimi” Politikat Publike të adoptuara në Bashkinë Lezhë	
KAPITULLI 2: METODOLOGJIA E KËRKIMIT	13
2.1 Shtrirja, qëllimi dhe objektivat e studimit	
2.2 Karakteristikat e kampionit	
2.3 Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave	
2.4 Parimet e analizës	
A. Proçesi i përmirësimit të kushteve ekzistuese të jetesës në strukturat rezidenciale	
B. Përdorimi i fondit të lirë ekzistues të strukturave rezidenciale (nëpërmjet blerjes ose proçesit të punësimit)	
C. Ndërtimi i strukturave të reja dhe infrastrukturës për qëllim të strehimit social	
KAPITULLI 3: ANALIZA PËRSHKRUESE DHE E DETAJUAR E KUSHTEVE TË STREHIMIT DHE JETESËS SË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE (GJETJET E STUDIMIT)	19
3.1 Situata e strehimit e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	
3.2 Situata Ekonomike dhe Sociale e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	
3.3 Territori dhe infrastruktura e vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane	
3.4 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 3	
KAPITULLI 4: ALTERNATIVA TË POLITIKAVE PUBLIKE	29
4.1 Ndërhyrje dhe plane të qeverisë vendore	
4.2 Sugjerimet e Politikave Publike për të zgjidhur problemin e strehimit në Bashki	
4.3 Një vlerësim i kostos për ndërhyrje të ndryshme të bashkisë	
4.4 Plan veprimi për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	
4.5 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 4	
KONKLuzionet FINALE	38
BIBLIOGRAFIA	39
SHTOJCË: HARTA E VENDBANIMEVE	40

### Raport

*“Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Lezhë, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të tyre”*

Ky dokument është përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Urban në konsultim të ngushtë me përfaqësues të Bashkive dhe shoqërisë civile, si dhe ekspertëve të organizatave lokale dhe të fushës së strehimit social.

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit është ofruar nga Qendra Kombëtare Shqiptare për Studime Sociale (NCSS) dhe WeissGerber & Partners (W&P) në kuadër të Projektit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (UNSSIA), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), apo të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Tiranë, Janar 2017

## Lista e tabelave dhe figurave

Tabela 1: Karakteristikat e kampionit	13
Tabela 2: Numri i familjeve të pastreha (banorëve) në Bashkinë Lezhë sipas etnisë kulturore, 2016	20
Tabela 3: Gjendja e familjeve të pastreha Rome dhe Egjiptianë në Bashkinë e Lezhës.	20
Tabela 4: Vendbanimet e Romëve dhe Egjiptianëve ne Bashkinë Lezhë, 2016	21
Tabela 5: Numri i intervistave të drejtpërdrejta në Bashkinë Lezhë	23
Tabela 5.1: Intervistat në çdo vendbanim Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Lezhë, 2016	23
Tabela 6: Familjet Rome dhe Egjiptiane sipas llojeve të banesave të tyre	23
Table 7: Aksesi tek rrjetet e furnizimit me ujë , kanalizimet dhe energjia të Komuniteteve R/E ne Bashkinë Lezhë	24
Table 8: Treguesi i përbërë i gjëndjes social-ekonomike & situatës së strehimit të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	25
Tabela 9: Nevojat per strehim të Komunitetit Rom në Bashkinë Lezhë	27
Tabela 10: Buxheti i Bashkisë Lezhë për strehim social, 2016	29
Tabela 11: Vlerësimi i programeve të Strehimit Social kundrejt kushteve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	31
Tabela 12: Përmbledhje e rezultateve të familjeve të intervistuar	35
Tabela 13: Përmbledhje e Rezultateve të kostove të varianteve të politikave në krahasim me Buxhetin aktual të Bashkisë	35
.....	
Figura 1: Familjet e pastreha Rome dhe Egjiptiane kundrejtë popullsisë totale	19
Figura 2: Situata e Strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Lezhë, 2016	21
Figura 3: Vendbanimet Rome dhe Egjiptiane sipas problemeve të strehimit, 2016	22
Figura 4: Situata aktuale e strehimit e komuniteteve R/E	24
Figura 5: Strehimi i Romëve dhe Egjiptianëve, sipas të ardhurave të tyre, 2016	26
Figura 6: Nevojat për strehim të komunitetit Rom	28
.....	



## FALËNDERIME

Qendra Kombëtare Shqiptare e Studimeve Sociale (NCSS), dhe Weiss Gerber & Partners, produkt i punës së të cilëve është ky studim, falënderojnë grupin e ekspertëve të drejtuar nga Prof.Asoc.Dr. Arlinda Ymeraj dhe Znj. Ardiana Fortuzi.

Falënderime të veçanta për punonjësit e Bashkive Tiranë, Durrës, Lezhë, Krujë dhe Shkodër që, në cilësinë e institucioneve zbatues të programeve të strehimit, mbledhën dhe përpunuan informacionin në përputhje të plotë me kërkesat e këtij vlerësimi. I shprehim mirënjohje stafit të Ministrisë së Zhvillimit Urban, në veçanti Znj. Aida Seseri, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Urbane dhe Strehimit, për mbështetjen e profesionale në kryerjen e studimit si dhe stafin e UNDP për administrimin e kujdesshëm të procesit.

## LISTA E SHKURTIMEVE

Bashkimi European	<b>BE</b>
Ministria e Zhvillimit Urban	<b>MZHU</b>
Enti Kombëtar i Strehimit	<b>EKS</b>
Dokumenti I Politikës së Përfshirjes Sociale	<b>DPPS</b>
Programi i Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri	<b>UNSSIA</b>

## PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i studimit të nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rom dhe Egjiptian në bashkinë Lezhë me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre, bazohet në një analizë të kujdesshme të nevojave për strehim dhe të të ardhurave, sugjeron disa politika të shoqëruara me kostot respektive, të përmbledhura në një plan veprimi. Si i tillë, udhëheq punën e MZHU dhe bashkëpunimin e saj me institucionet shtetërore, qeveritë lokale dhe organizatat komunitare në përmirësimin e kushteve të strehimit dhe të jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Lezhë.

Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës konstatoi se:

- ▶ Familjet e pastreha Rome dhe Egjiptiane së bashku perbejnë pothuajse 2,1 përqind të popullësisë, përkatësisht 76 përqind komuniteti Egjiptian dhe 24 përqind komuniteti Romë.
- ▶ Gjysma e Romëve dhe Egjiptianëve nuk zotërojnë nje hapësirë banimi, ndërsa më shume se gjysma e tyre nuk kanë asnjë të ardhur.
- ▶ Më shume se 1/3 e atyre në nevojë për strehim, janë pa të ardhura.
- ▶ Kushtet e banesave te komuniteteve Romë dhe Egjiptian janë shumë të këqija: vetëm 7.6 përqind jetojnë në banesa sipas standartit. Rreth 70 përqind e familjeve nuk janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve. Pothuajse të gjitha familjet janë të lidhura me rrjetin elektrik dhe 66 përqind janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, pra situata e tyre mbetet kritike.
- ▶ Eshhtë e nevojshme të ndërtohen 300 banesa për familje Rome dhe Egjiptiane, të cilat mund të realizohen në një hapësirë ndërtimi prej 17.502 m<sup>2</sup>, ndërsa bashkia nuk ka ofruar terren ndërtimi.
- ▶ Fatkeqësisht, komunitetet Rome dhe Egjiptiane nuk mund ta zgjidhin vetë situatën e tyre të strehimit për shkak të mungesës së të ardhurave. Thuhet se 100 përqind e familjeve, përveç se në nevojë për strehim, janë edhe pa të ardhura.
- ▶ Strehimi social mbetet politika më efektive për të zgjidhur nevojat e strehimit midis komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.
- ▶ Midis alternativave të ndryshme të politikave të sugjeruara në raport, Opsioni 1 (Programi: Qeveria vendore ndërton njësi strehimi) duket i realizueshëm. Kosto e tij në lekë është 623,718, 774 (300 banesa) ndërsa Opsioni 2, Rikonstruksioni i banesave ekzistuese (194 banesa), kushton 179,450,000 lekë.
- ▶ Kosto e rehabilitimit të infrastrukturës është 55,953,854 lekë.
- ▶ Bazuar në llogaritjet e kostove, asnjë nga opsionet nuk mund të financohen nga buxheti i Bashkise, prandaj Bashkia Lezhë ka nevojë për mbështetje financiare ose nga buxheti qendror ose nga burime të tjera.
- ▶ Nga ana tjetër ka kosto indirekte që do të hasen për shkak të rrezikut që shoqëron secilin variant të politikave. Veç kësaj, disa nga rreziqet mund të kenë implikime financiare,

përkatësisht rreziku i diskriminimit pozitiv, rreziku i veçimit (izolimit) si edhe rreziku i konfliktit social midis ish pronarëve të pronave dhe tokës.

Raporti përbëhet nga katër kapituj përveç Hyrjes dhe Konkluzioneve Finale. Kapitulli i parë rishikon kontekstin ligjor në lidhje me të drejtën e strehimit të Romëve dhe Egjiptianëve. Kapitulli i dytë përshkruan metodologjinë e analizës. Kapitulli i tretë adreson gjetjet, ndërsa kapitulli i fundit shtjellon analizën e mëtejshme në lidhje me vlerësimin e kostove të alternativave të ndryshme të politikave, duke nxjerrë në pah argumentat për variantin më të përshtatshëm. Raporti mbyllet me konkluzionet finale. Një hartë dixhitale jep informacion të përditësuar rreth vendndodhjeve të Romëve dhe Egjiptianëve.



## HYRJA

Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë dhe po implementon një reformë sociale të gjerë dhe komplekse, me qëllim fuqizimin e mekanizmave institucional për të siguruar se askush nuk do të përjashtohet nga gëzimi i të drejtave të tyre. Sipas Termave të Referencës, politika e përfshirjes sociale është çelësi i promovimit të qëllimeve më të gjera të politikave të rritjes dhe zhvillimit si dhe adresimit të shkaqeve të mungesave të shumëfishta dhe varfërisë. Adoptimi i Dokumentit Politik të Përfshirjes Sociale 2015-2020 i hap rrugën:

- ▶ Identifikimit dhe adresimit të sfidave me të cilat përballet monitorimi dhe vlerësimi i përfshirjes sociale duke nxjerrë në pah indikatorët e BE-së dhe kombëtar, prej të cilëve kërkohet të mbështesin reduktimin e varfërisë dhe zhvillimin e masave efektive që përmirësojnë mirëqënien;
- ▶ Promovimit të koherencës së politikës, vendosjes së prioriteteve dhe caktimit të përgjegjësive për kryerjen e monitorimit dhe matjes së përfshirjes sociale;
- ▶ Vlerësimin në mënyrë transparente të efektit të politikave që ndiqen dhe përpjekjeve të Qeverisë për të fuqizuar politikën që ndikojnë mbi përfshirjen sociale.

Në këtë kontekst, Programi i Mbështetjes së Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri (UNSSIA) kërkon të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve Shqiptare në nivel qendror dhe vendor për të avancuar me axhendën kombëtare të përfshirjes sociale me një pikëpamje të tillë e cila do të sigurojë konsistencë dhe koherencë nga politikën qeveritare dhe programuesit në arritjen e efektit maksimal të mundshëm për përfshirjen sociale të personave në risk; dhe rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe qytetarëve si mbajtësit e të drejtave në procesin kombëtar të përfshirjes sociale.

Brenda kontekstit të UNSSIA, vëmendje e veçantë i kushtohet veprimeve që mund të eliminojnë barrierat me të cilat Romët dhe Egjiptianët përballen për të aksesuar shërbimet, për të përmirësuar kushtet e jetesës nëpërmjet integritit dhe promovimit të dialogut interkulturor. Plani Kombëtar i Veprimit për Integritin e Romëve dhe Egjiptianëve përfaqëson një angazhim të ri i cili mbulon periudhën 2016-2020, dhe synon respektivisht këto dy komunitete. Në të reflektohet rritja e masave që po implementohen dhe gjithashtu planet për aktivitete të reja për promovimin e integritit të Romëve dhe Egjiptianëve, me një fond të angazhuar nga buxheti i Shtetit dhe hapësirat e financimit të identifikuar për periudhën 2016-2020 si dhe gjetja e mjeteve financiare nëpërmjet koordinimit me programe të tjera ndërkombëtare.

Romët dhe Egjiptianët përballen me barrierë direkte dhe indirekte në marrjen e shërbimeve publike, si rrjedhojë e pamundësisë për përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes, mungesës së informacionit ose të të kuptuarit të procedurave administrative, ashtu si dhe stigmatizimi dhe sjellja diskriminuese nga ana e shumicës së popullsisë. Përjashtimi afatgjatë ka ndikuar në kushtet e jetesës së Romëve dhe Egjiptianëve, trajtimi diskriminues nga shumica e popullsisë dhe marrëdhënia me institucionet qeveritare.

Midis të gjithë grupeve të pambrojtura, ekzistojnë të dhëna domethënëse të cilat tregojnë se Romët dhe Egjiptianët jetojnë në lagje të varfëra ku ka shumë pak ose aspak mundësi për të marrë shërbime publike. Studimet tregojnë se niveli i varfërisë midis komunitetit Rom është dy

herë më i lartë se shumica e popullsisë, ndërsa shkalla e papunësisë është tre herë më e lartë se mesatarja<sup>3</sup>. Tridhjetë e nëntë përqind e banesave ku jetojnë Romët dhe 21 përqind e atyre të banuara nga Egjiptianët nuk kanë akses ndaj ujit të pijshëm<sup>4</sup>. I njëjti burim informacioni tregon se 36 përqind e Romëve jetojnë në shtëpi të rrënuara ose lagje të varfëra (geto).

Si pjesë e strategjisë së përgjithshme për përfshirjen e grupeve më të cënueshme dhe në një linjë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU) po nis implementimin e Strategjisë për Strehimin Social (SSS) për periudhën 2015 -2025. Qëllimi i SSS është “ti ofrojë familjeve me të ardhura të ulta dhe mesatare të cilat nuk e përballojnë dot një shtëpi në tregun e lirë, dhe veçanërisht, familjeve me indikatorë vulnerabiliteti që rezultojnë në përjashtimin nga strehimi, zgjidhje për strehimin të cilat janë të disponueshme, të prekshme, të përballueshme dhe cilësore.”

Është bërë e njohur nga të gjitha palët e interesuara se ekzistojnë hendeqe kritike përsa i përket informacionit në lidhje me popullsinë Rome/Egjiptiane. Mungesa e regjistrimit në gjendjen civile, kryesisht e popullsisë Rome, ka pasur një ndikim vendimtar në “padukshmërinë” e “problemeve kritike” të popullsisë Rome. Megjithatë, shkaqet rrënjësore gjenden më thellë, në strukturën ligjore dhe institucionale të sistemit të shërbimeve publike të Shqipërisë. Veç kësaj, Reforma Territoriale dhe Administrative e implementuar së fundmi, ka ndryshuar ndarjen territoriale të bashkive.

Për të mundësuar integrimin dhe përfshirjen e popullsisë Rome/Egjiptiane, veçanërisht për të zgjidhur problemin e strehimit, është e nevojshme të kryhet një analizë e thellë e vendbanimeve jashtë standartit të strehimit të Romëve dhe Egjiptianëve në nivel bashkie dhe të vlerësohet nevoja për investime në mënyrë që të përmirësohen kushtet e strehimit dhe të jetesës së këtyre dy komuniteteve.

Raporti “ Studim mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkinë e Lezhës me qëllim vlerësimin e nevojës për investime për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së këtyre dy komuniteteve” sjell një analizë të thellë të vendbanimeve të Romëve dhe Egjiptianëve kundrejt standarteve të strehimit ashtu si dhe programeve të strehimit social. Raporti ofron të dhëna që lejojnë identifikimin e nevojave për investime në bashki, të ndara nga programet aktuale të strehimit social dhe do të udhëheqë punën e MZHU dhe bashkëpunimin e saj me institucionet e nivelit shtetëror, qeveritë vendore, dhe organizatat e komunitetit në përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Durrës.

3 Decade of Roma Inclusion Secretariat Foundation, Civil Society Monitoring Report on the Implementation of the National Roma Integration Strategy and Decade Action Plan in 2012 in Albania, përgatitur nga një grup autorësh (Bajrami, Ivia; Cabiri, Ylli; Hasantari, Adriatik; Kazanxhiu, Latif; Koci, Renart; Mustafaj, Enver; Myrteli, Laver; Nuredin, Albana; Pegini, Hafize; Rama, Lindita; Rushiti, Selvie; Xega, Gerta; Ziu, Dritan), publikuar në Maj 2013, [http://www.issuelab.org/click/download2/civil\\_society\\_monitoring\\_report\\_on\\_the\\_implementation\\_of\\_the\\_national\\_roma\\_integration\\_strategy\\_and\\_decade\\_action\\_plan\\_in\\_2012\\_in\\_albania](http://www.issuelab.org/click/download2/civil_society_monitoring_report_on_the_implementation_of_the_national_roma_integration_strategy_and_decade_action_plan_in_2012_in_albania), fq. 20.

4 Të dhëna nga UNDP/WB/EC 2011 Socio-economic Survey quoted in the UNDP's Needs Assessment Study on Roma and Egyptian Communities in Albania, Shkurt 2012, <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/roma-needs-assessment-report/>, fq. 24.-25.

## 1. RISHIKIMI I KONTEKSTIT LIGJOR KUNDREJT TË DREJTËS PËR STREHIM TË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE

Strehimi është një drejtë njerëzore bazë që është sanksionuar në traktatet dhe konventat ndërkombëtare. Kur njerëzit kanë strehim të sigurt dhe të përballueshëm që është i përshtatshëm me kushtet e tyre të jetesës, mund të plotësohen edhe nevojat e tjera si opunësimi, arsimimi dhe mundësitë e jetesës. Disa grupe qytetarësh në Shqipëri janë në rrezik për tju mohuar kjo e drejtë bazë për shkak problemit të përballueshmërisë së strehimit. Mes tyre Romët dhe Egjiptianët jnaë vecanërisht te rrezikuar për shkak te përjashtimit të shumfishtë.

Komunitetet Rome konsiderohen si grupi minoritar më i cënueshëm në Shqipëri, që përballlet me varfërinë e thellë, me marginalizimin dhe diskriminimin e shpeshtë, vecanërisht në lidhje me aksesin në shkollim, mbrojtjen sociale, shëndetësinë, punësimin dhe strehimin e përshtatshëm. Romët nuk njihen publikisht si një minoritet i vecantë. Ata kanë statusin e një minoriteti etno-gjuhësor. Pavarësisht që Kushtetuta e Shqipërisë adreson të gjitha principet bazë të njeriut dhe të drejtat e minoriteteve.

Shqipëria ka firmosur Konventën Europiane të të Drejtave Të Njeriut (2.10.1996), Konventën Ndërkombëtare të të drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (4.10.1991), Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial (11.5.1994) dhe Kartën Sociale Europiane (të rishikuar) (14.11.02). Si e tillë palet janë të detyruara të sigurojnë akses të barabartë për strehim për cdo qytetar.

### 1.1 Situata e përgjithshme e nevojave për strehim të Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë e Lezhës

Duke qenë të detyruar të bëjnë një jetë në rrugë për vite, pa akses në strehim, shkolla, shëndetësi dhe punësim, i ka mbyllur familjet Rome në një rreth vicioz te informalitetit, duke bërë të pamundur aksesin në shërbimet sociale standarte përfshi programin e strehimit social. Krahasuar me Romët, komuniteti Egjiptian duket të jetë më i integruar në mjedisin social.

Tek Romët, varfëria dhe mungesa e strehimit të përshtatshëm janë më të përhapura. Për shembull, në një anketim rajonal të 2011 mbi situatën e strehimit të romëve në Shqipëri, 8 përqind e Romëve që morën pjesë në studim jetonin nje privim të shumfishtë strehimi, krahasuar me më pak se 1 përqind nga jo-romët, ndërsa 30 përqind e Romeve të anketuar muk kishin përmirësim në furnizim me ujë, kanalizime dhe energji krahasuar me 7 përqind te jo-romëve. Rreth 45 përqind e Romëve që morën pjesë në anketim strehoheshin në banesa që I mungonte të paktën një nga facilitetet e mëposhtëme: kuzhinë brënda, banje brënda, banjë ose dush brënda, dhe energjia. Raportohet gjithashtu se , mesatarisht, më shumë se dy njerëz banonin në një dhomë, që është përtej mesatares se OECD prej 0.8 njerëz në një dhomë<sup>3</sup>.

Sipas “Një Studimi të Vlerësimit të Nevojave për Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri”, pjesa më e madhe e familjeve Rome banojnë në shtëpi të (38.4 përqind) ose or kasolle (20.8 përqind) dhe konsistojnë në një (66.3përqind) ose më shumë se një (27.5 përqind) kurora <sup>4</sup>.

3 [www.oecdbetterlifeindex.org/topics/housing/](http://www.oecdbetterlifeindex.org/topics/housing/)

4 Një studim i Vlerësimit të Nevojave të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri, CESS I mbështetur nga UNDP, 2012, fq 24

Ata e konsiderojnë veten pronarë të shtëpive të tyre (80.6 percent), me vetëm 10.8 përqind raportime për banesë me qera<sup>5</sup>. Shumë vendbanime të vona të Romëve janë kampe ku Romët jetojnë në tenda të improvizuara ose kasolle në brigjet e lumit. Madhësia e kampeve ndryshon sipas zonave.

Ndrërsa në Bashkinë Lezhë, familjet e pastreha në përgjithësi përbëjnë 1,1 përqind<sup>6</sup> të popullsisë totale, nga të cilat komunitetet Rome dhe Egjiptiane përbëjnë rreth 17 përqind të gjithë familjeve të pastreha.

Kushtet e banimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkinë e Lezhë janë shumë të këqija: pothuajse asnjë prej tyre nuk jeton në banesa sipas standarteve në fuqi. Vetëm 70 përqind e familjeve janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve dhe vetëm 66 përqind janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit, megjithëse pothuajse të gjithë vendbanimet janë të pajisura me rrjetin inxhinierik.

Në Shqipëri, komuniteti Egjiptian në përgjithësi është më i integruar se Romët. Megjithatë edhe ata hasen me një numër kufizimesh të ngjashme si Romët. Anëtarët e komunitetit Egjiptian, kryesisht, banojnë në banesa të vjetra (45,8 përqind) ose shtëpi të riparuar, por jot ë reja. Ata gjithashtu raportojnë të jenë pronarë të banesave (83.5 përqind) dhe vetëm një përqindje e vogël (7.1 përqind) thonë që janë me qera. Vetëm 10.9 përqind e anëtarëve të komunitetit Egjiptian raportojnë se banojnë në Baraka, një përqindje shumë më e ulët se e Romëve.

## 1.2 "Strehimi" Politikat Publike të adoptuara në Bashkinë Lezhë

Ligji Nr.9232 mbi "Strehimin Social" është adoptuar për herë të parë në 2004. Që atëherë, ligji është ndryshuar shumë herë, duke synuar të rrisë efektivitetin e tij, duke lehtësuar procedurat e aplikimit se dhe duke rritur aksesin e njerëzve të pastrehë në tregun e banesave.

Duke ju referuar këtij ligji, Bashkia Lezhë është përpjekur të zgjidhë problemin e strehimit. Bashkia Lezhë ka adaptuar këto programe strehimi:

- ▶ Banesa Sociale me Qira (SRH)
- ▶ Banesa me kosto të ulët (LCH)

Si rezultat i kësaj, 34 familje R&E kanë përfituar nga SHR dhe 8 familje R&E nga LCH.

Në Janar 2016 Bashkia ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin e Territorit, në të cilën strehimi është trajtuar shumë sipërfaqësisht, ndërsa mungesa e fondeve konsiderohet si kufizimi më kritik.<sup>7</sup>

## 2. METODOLOGJIA E KËRKIMIT

### 2.1 Shtrirja, qëllimi dhe objektivat e studimit

Studimi "Mbi vendbanimet jashtë standartit të Romevë dhe Egjiptianëve në Bashkinë e Lezhës, me qëllim vlerësimin e nevojave për investime për përmirësimin e kushteve të banimit dhe jetesës të këtyre komuniteteve" synon të vlerësojë "nevojën për investime për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të banimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Lezhë", "të udhëzojë punën e MZHU dhe partnerëve të saj, në përmirësimin e kushteve të banimit dhe të jetesës, për komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Lezhë".

Brënda kuadrit të synimit të përgjithshëm, studimi ka arritur objektivat e mëposhtme:

- ▶ Sigurimin e evidencave të sakta mbi kushtet e strehimit dhe jetesës (psh kushtet e banesave, aksesin tek uji i pijshëm, kanalizimet dhe energjia) të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë e Lezhës.
- ▶ Vlerësimin e investimeve që duhte të bëhen në bashkinë e Lezhës me qëllim përmirësimin e kushteve të strehimit dhe të jetesës për komunitet Rome dhe Egjiptiane.
- ▶ Zhvillimin e Planit të Veprimit, që do të udhëzojë punën e MZHU dhe bashkëpunëtorëve të saj me institucionet shtetërore, qeverisjet lokale dhe organizatat e komunitetit për përmirësimin e kushteve të banimit dhe të jetesës për komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Lezhës.

Studimi shfrytëzon informacione nga burime të ndryshme: (1) studime dhe raporte të mëparshme, (2) një anketim random i fokusuar në familjet Rome dhe Egjiptiane në nevojë për strehim, (3) fokus grupet me palët e interesuara dhe (4) verifikime në vend të lagjeve dhe infrastrukturës në bashkinë e Lezhës.

Përgatitja e këtij raporti është bazuar në një rishikim të një numri raportesh të përgatitur nga MZHU, PNUD dhe/ose organizata kërkimore të pavarura (shih Bibliografinë).

### 2.2 Karakteristikat e kampionit

Për shkak të qëllimit të përcaktuar të studimit, nuk ishte e mundur të identifikohesh një model. Përkundrazi, i gjithë komuniteti Rom dhe Egjiptian i Bashkisë së Lezhës përbën një njësi studimi. Madhësia e modelit (sipas përcaktimit të spjeguar më sipër) paraqitet më poshtë (Tabela 1):

**Tabela 1: Karakteristikat e kampionit**

Pyetsori	Komuniteti Rom dhe Egjiptian
Nr.1: FGDs	100 përqind
Nr.2:Ballë për ballë	26 përqind

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

<sup>5</sup> Njëlloj

<sup>6</sup> Kapitulli 3 i raportit jep një informacion dhe analizë më të thellë.

<sup>7</sup> Njëlloj

## 2.3. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave

U konsiderua e nevojshme mbledhja e informacionit të detajuar mbi madhësinë dhe përbërjen e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Lezhë si dhe mbi nevojat e tyre të përgjithshme rreth strehimit.

Bisedat me Fokus Grupe u zhvilluan me dy grupe interesi, përkatësisht Departamenti i Zhvillimit Urban dhe Departamenti i Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Lezhë. Veç kësaj, përdorimi i bisedave me fokus grupe ndihmoi në mbledhjen e informacionit në lidhje me përpjekjet e qeverisë vendore për të siguruar strehim për komunitetet që përbëjnë objektivin themelor të këtij Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës.

Megjithatë, me qëllim zbulimin në thellësi të shqetësimeve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në lidhje me strehimin, intervistat ballë për ballë me familjet ofruan të dhëna të nevojshme.

Pyetësi i parë (pyetësor me pyetje të hapura) mundësoi mbledhjen e informacionit në lidhje me:

- ▶ Përbërjen e të pastrehëve, numrin, vendndodhjen e tyre, ndarjen sipas specifikave të nevojave të tyre për strehim ashtu si dhe sipas statusit të tyre socio-ekonomik.
- ▶ Kapacitetet e qeverisë vendore për të zgjidhur çështjen e strehimit, të pakten për komunitetet Rome dhe Egjiptiane.
- ▶ Sfidat e Strehimit në nivel vendor.

Pyetësi i dytë lehtësoi analizën në thellësi të banesave në secilin prej vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane, përkatësisht:

- ▶ Tipi i banesave, madhësia e tyre dhe kushtet infrastrukturore.
- ▶ Kushtet infrastrukturore të vendbanimeve dhe aksesit ndaj shërbimeve.

Verifikimi në terren i lagjes dhe infrastrukturës shqyrtoi:

- ▶ Vlerësimin e përgjithshëm të kushteve të vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane, përkatësisht kushtet fizike, qasja ndaj infrastrukturës (rrjeti i furnizimit me ujë, sistemi i ujit të mbetjeve, rrjeti elektrik), kushtet e higjienës (janë apo jo të furnizuar me ujë dhe kanalizime nga rrjeti i qytetit), marrja e shërbimeve të tjera publike, probleme të tjera në lidhje me këtë (probleme furnizuesi dhe konsumatori).
- ▶ Vlerësimin e kostove që nevojiten për përmirësimin e situatës ekzistente ose lidhja e komuniteteve me shërbimet në nivel lagjeje si dhe në nivel lagjeje dhe shtëpie.
- ▶ Analizën e situatës së lagjeve specifike të cilat janë të prirura ndaj rreziqeve natyrore ose të tjera.
- ▶ Përpunimin e gjetjeve nëpërmjet verifikimit në terren, të cilat shërbejnë për përgatitjen dhe propozimin e 2-3 skenarëve për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe infrastrukturës.

## 2.4. Parimet e analizës

Në përputhje me kontekstin e Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit, grupi i studimit mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit përcaktoi disa kritere mbi të cilat është bazuar vlerësimi i kostos për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të infrastrukturës së vendbanimeve të komunitetit Rom dhe Egjiptian:

**Së pari**, informacioni i marrë nga administrata vendore dhe anketat e vendndodhjes, nëpërmjet pyetësorëve, u përdor për të përcaktuar një synim të qartë të projektit, si nga ana cilësore ashtu dhe ajo sasiore.

**Së dyti**, bazuar në strukturën e familjes, u krijua një dosje mbi nevojat për llojet dhe numrin e apartamenteve të nevojshme. Sipërfaqet e banimit dhe të ndërtimit u përcaktuan sipas Entit Kombëtar të Banesave dhe legjislacionit në fuqi.

Këto shërbyen si informacion kyç për të githë procesin e analizës financiare dhe vlerësimin të kostove për përmirësimin strukturor të banesave dhe atë infrastrukturor të zonave të banimit. Objektivi kryesor ishte hartimi i një metodologjie të qartë në mënyrë që të bëhëj i mundur vlerësimi dhe llogaritja e kostove të pritshme të proceseve të implementimit të projekteve.

E gjithë kjo procedurë, në fund, rezultoi në metodologjinë e propozimit të analizës financiare e cila iu prezantua administratës vendore dhe përfituesve, duke i ndihmuar ata të marrin vendime të realizueshme me qëllim përgatitjen e strategjive të zhvillimit dhe propozimin e zgjidhjeve të qëndrueshme.

Bazuar mbi të dhënat që rezultuan nga përpunimi i pyetësorëve, u zhvilluan dhe analizuan financiarisht skenarë të ndryshëm:

- A. Skenari i parë** – procesi i përmirësimin të kushteve ekzistuese të jetesës në strukturat rezidenciale
- B. Skenari i dytë** – përdorimi i fondit të lirë ekzistues të strukturave rezidenciale (nëpërmjet blerjes ose procesit të punësimit)
- C. Skenari i tretë** – ndërtimi i strukturave të reja dhe infrastrukturës për qëllim të strehimit social

### A. Proçesi i përmirësimin të kushteve ekzistuese të jetesës në strukturat rezidenciale

Nga pikëpamja e vlerësimin të kostos, metodologjia u bazua në dy kritere kryesore:

- ▶ Vlerësimin i situatës ekzistuese të strukturave të rezidencave, duke shqyrtuar kushtet e jetesës, kushtet e higjienës, dhomat e nevojshme ekzistuese sipas standarteve, kushtet teknike të strukturës (lidhur me sigurinë) – informacioni i marrë nga pyetësorët e anketave të vendndodhjeve.
- ▶ Vlerësimin i kostos për riparimin e këtyre elementeve dhe rehabilitimin e këtyre hapësirave, nëpërmjet procesit të rikonstruktimit, me qëllim që këto struktura të përmbushin kushtet e nevojshme të pranueshme, duke i kthyer në këtë mënyrë në zona të banueshme në



përmbushje të standarteve dhe normave.

Faktori kryesor i marrë seriozisht në konsideratë ishte statusi i pronësisë i rezidencës (pyetja kryesore e pyetësorit). Ky element mund të rrisë direkt pjesën e investimit, dhe nga ana tjetër është element vendimtar në sigurimin e investimit afatgjatë dhe veçanërisht në sigurimin e qëllimit të investimit.

Metodologjia e përlllogaritjes u bazua në metoda të thjeshta klasike, mbështetur në listën e çmimeve të referencës dhe një indeks i përafërt i procesit të ndërhyrjes rikonstruktive i cili u përfutua nga Studimi i eksperiencave ekzistuese të tregut dhe të eksperiencave të ngjashme.

Vlerësimi deri në çfarë mase llojet e secilës ndërhyrje janë të mundshme dhe të arsyeshme kundrejt aseteve dhe kushteve ekzistuese dhe eksperiencës së administratës vendore për t'u marrë me çështjet e strehimit të grupeve të synuara, ishte pritshmëria e përgjithshme e Studimit mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit.

Për më tepër, si skenar u krahasua me të tjerët me qëllim gjetjen se cili prej tyre është më i saktë për t'u përdorur dhe deri në ç'masë, në mënyrë që përdorimi i një ose më shumë skenarëve në të njëjtin qytet por në lagje të ndryshme ose në grupe ose organizma sociale të ndryshëm, të rezultojë i mundshëm.

Një tjetër aspekt pozitiv i këtij skenari është që mund të përdoret gjithashtu si një proces rigjenerimi urban dhe mund të aplikohet në disa zona të braktisura të qytetit të cilat mund të kenë potencial special për t'u integruar në strukturën dhe jetën e qytetit.

## B. Përdorimi i fondit të lirë ekzistues të strukturave rezidenciale (nëpërmjet blerjes ose qiramarrjes)

Nga pikëpamja e vlerësimit të koston, metodologjia u bazua në dy drejtime kryesore: vlerësimi i qerasë dhe shitjeve të tregut vendas të pasurive të patundshme. Informacioni, i përfutur si nga administrata vendore ashtu dhe nga të dhënat e tregut, u plotësua me vendndodhjen e strukturave rezidenciale ekzistuese dhe gjendjen e tyre (si nga pikëpamja teknike ashtu edhe nga pikëpamja e pronësisë). Për të dyja këto, u krye një vlerësim i kushteve me qëllim sigurimin e përmbushjes së standarteve të kërkuara.

Edhe në rastet e të pastrehëve, faktorët kryesorë të konsideruar ishin sipërfaqja e përshtatshme (zona e banimit) në përputhje me strukturën e familjes, dhe kosto për metër katror (LEK/m<sup>2</sup>) e shitjes ose edhe e qerasë, ashtu si dhe vendndodhja e tyre. Bazuar në këto, disa analiza më të hollësishme u realizuan për të siguruar përpilimin e disa skenareve të ndryshme të investimit si edhe të koston financiare të tyre.

## C. Ndërtimi i strukturave të reja dhe infrastrukturës për qëllim të strehimit social

Vlerësimi i koston totale për këtë skenar u bazua në tre kosto të ndërlidhura:

- ▶ Kosto e truallit (vendndodhja e ngastrës)
- ▶ Kosto e ndërtimit të strukturës
- ▶ Kosto e infrastrukturës

Nga pikëpamja teknike ky skenar paraqet një vlerësim kostoje të thjeshtë i cili bazohet në tre faktorë të mirënjohur, nga pikëpamja ekonomike dhe financiare. Ajo çka nevojitet është një

ide reale projekti dhe një vendndodhje për ngastrën e zgjedhur në mënyrë që të përlllogaritet saktësisht kosto e këtyre lloj ndërhyrjesh duke marrë në konsideratë të tre elementët.

Lidhur me përlllogaritjen e koston, metodologjia duhet të shqyrtojë përlllogaritjen e çdo faktori në mënyrë të pavarur dhe bashkarisht, ku rastet e ndryshme për gjetjen e vendndodhjes së ngastrës duhet të përfaqësohen nga administrata vendore, ashtu si dhe format e investimeve.

Zgjedhja e truallit është vendimtare në përlllogaritjen e koston totale. Në këtë aspekt, kosto e truallit, është një variabël shumë e rëndësishme, i cili është i lidhur direkt me statusin e pronësisë, me qëllim që pronat shtetërore të truallit të mund të çojnë në kosto investimi më të ulta, - përveç efekteve anësore të tjera pozitive me të cilat veprime të tilla shoqërohen gjithmonë, siç është interesi direkt i qeverisë vendore, i cili në shumë raste është vendimtar për suksesin e projektit. Në këtë rast kosto e truallit konsiderohet si një variabël e rëndësishme, veçanërisht në lidhje me statusin e pronësisë, me qëllim gjetjen e truallit në pronësi publike.

Një tjetër aspekt i analizuar është kosto e pronës në lidhje me koston e lidhjes me infrastrukturën publike. Në këtë mënyrë mund të rezultojnë skenarë më të qëndrueshëm të procesit të zgjedhjes së truallit, jo vetëm në lidhje me disponueshmërinë e autoriteteve vendore për të ofruar truallin, por gjithashtu ekonomikisht, për shkak të përmirësimit të këtyre vendndodhjeve në zona urbane me kushte më të mira rezidenciale dhe sociale.

Kosto e ndërtimit u përlllogarit bazuar në indeksat dhe çmimet e referencës së Entit Kombëtar të Banesave sipas ligjeve. Bazuar në numrin e nevojave dhe strukturave të familjeve, propozohet një skenar mbi zonën e nevojshme të jetesës, e cila bashkë me ambjentet komunitare dhe të shërbimit, rezultojë në zonën finale të ndërtimit. Kjo shërben si informacion bazë për vlerësimin e koston së ndërtimit të shtëpive sociale.

Rezultati i pritshëm është një shumë totale e përafërt e investimit të nevojshëm. Kosto e infrastrukturës duhet të shqyrtojë urbanizimin ose shkallën e urbanizimit të truallit. Kjo lidhet drejt për drejt me pozicionimin e zonës së propozuar në qytet, veçanërisht kundrejt shërbimeve publike dhe infrastrukturës, dhe mundësitë e aksesit dhe lidhjes me rrugët dhe sistemet e furnizimit dhe shkarkimit.

Të gjitha këto përdoren si variabla për të paraqitur një formulë të thjeshtë e cila do të ndihmojë autoritetet vendore të përlllogarisin dhe krijojnë një vizion më të mirë mbi koston totale të një procesi të tillë. Për më tepër, kjo do të ndihmojë për të pasur më shumë se një zgjidhje, dhe në këtë mënyrë do të ndihmojë në gjenerimin e fondeve dhe investimeve nga drejtime të ndryshme, element i cili është vendimtar në suksesin e procesit.

Rezultatet e secilit skenar do të analizohen në lidhje me kushtet lokale të çdo bashkie, ashtu si dhe sipas mundësive reale për investime të secilës qeveri vendore, bazuar në fondet e tyre ose mundësi të tjera. Për këtë, procesi i analizës bazohet mbi rezultatet që vijnë nga pyetësorët: ato të dhëna të cilat kanë lidhje me të ardhurat e familjeve dhe ato të cilat kanë të bëjnë me investimin e kapaciteteve të bashkive mbi banesat sociale dhe projekte të tjera përkatëse.

Bazuar në këto, Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit vlerëson koston si edhe burimet financiare të mundshme për të përballuar investimin. Qasjet e ndryshme të propozuara mund të çojnë në prodhimin e më shumë projekteve me qëllim të mirëpërcaktuar dhe duke synuar projekte më të kontrollueshme, të cilat çojnë në implementimin e suksesshëm.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se bazuar në kushtet financiare lokale dhe numrin e familjeve në nevojë, si dhe mbi stokun e banesave, kriteret e nënvizuara më lart janë të

rëndësishme dhe duhet të merren seriozisht në konsideratë, sepse, siç u shpjegua, rezultatet e tyre varen shumë nga variablat lokale.

Si mekanizëm i fundit, metodologjia e përlllogaritjes së kostos synon të krijojë një formë llogaritjeje për secilin rast në mënyrë që të ndihmojë autoritetet vendore në procesin e vendimarrjes.

Bazuar në kostot tashmë të përlllogaritura, kjo metodologji gjithashtu adresoi:

- ▶ Efektin e kategorizimit mbi vlerësimin financiar të projekteve;
- ▶ Koston e huave për përfituesit;
- ▶ Analiza kosto-përfitim, kosto e projektit, norma e interesit, norma e brendshme e kthimit dhe koha e pagesës, metodat e vlerësimit, etj.
- ▶ Burimet e kapitalit të mbledhur si dhe forma të tjera që rezultojnë në kapital.

Si e tillë, kjo metodologji, së pari paraqet më shumë se një mundësi reale dhe financiare për zgjidhje të qëndrueshme, dhe së dyti, hap mundësinë e përlllogaritjes dhe vlerësimit midis opsioneve të ndryshme e cila do të bazohet direkt mbi kapitalin dhe kushtet financiare të kapaciteteve lokale. Në këtë mënyrë shtron bazat për aplikimin e projekteve dhe zgjidhjeve origjinale, duke fuqizuar edhe mundësitë e bashkëpunimit publik dhe privat, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme afatgjata.

### 3.

## ANALIZA PËRSHKRUESE DHE E DETAJUAR E KUSHTEVE TË STREHIMIT DHE JETESËS SË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE (GJETJET E STUDIMIT)

Kapitulli 3 adreson kërkesën për strehim të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane sipas tre kriterëve të vlerësimit, respektivisht:

**Kriteri 1:** Situata e strehimit të familjeve

**Kriteri 2:** Kushtet socio-ekonomike të familjeve


**Kriteri 3:** Kushtet infrastrukturore të vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane

Të dhënat e mbledhura nga Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit janë përpunuar dhe analizuar në bazë të secilit kriter të theksuar më sipër. Në mënyrë të ngjashme, gjetjet kërkimore respektive janë identifikuar dhe formuluar sipas vlerësimit të kriterëve.

### 3.1. Situata e strehimit e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane

Familjet e pastreha në Lezhë përbëjnë 2,1 përqind të popullsisë (Figura 1).

**Figura 1: Familjet e pastreha Rome dhe Egjiptiane kundrejt popullsisë totale**



**Burimi:** Census, 2011 dhe Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

**Tabela 2: Numri i familjeve të pastreha (banorëve) në Bashkinë Lezhë sipas etnisë kulturore, 2016**

	Romë	%	Egjyptian	%
Të Pastrehë	71	24	229	76

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

Siç tregohet në tabelën 2, 24 përqind të të gjithë familjeve të pastreha në Lezhë, janë nga Komuniteti Rom dhe 76 përqind nga Komuniteti Egjiptian.

**Tabela 3: Gjendja e familjeve të pastreha Rome dhe Egjiptianë në Bashkinë e Lezhës.**

Familje në nevojë strehimi për shkak të:	R&E	%
Nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	165	55
Kanë në pronësi hapësirë banimi nën standartet e banimit	85	28
Jetojnë në banesa nën standartet e banimit.	48	16,4
Jetojnë në qendra komunitare.	2	0,6
<b>Totali</b>	<b>300</b>	<b>100</b>

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016


Pavarësisht diferencave të vogla përsa i përket madhësisë, Komunitetet Rome dhe Egjiptiane jetojnë në kushte të dëshpëruara banimi. (foto më poshtë).



**Foto nga vendbanimet Rome dhe Egjiptiane**

Është e pamundur të bësh krahasim midis kushteve të strehimit të komunitetit Rom dhe atij Egjiptian për shkak se nuk ka të dhëna të ndara për këto komunitete. Megjithatë, të dhënat ekzistuese janë të mjaftueshme për të analizuar situatën për qëllimet e këtij studimi. Siç tregohet në figurën 2 gjysma e familjeve në nevojë për strehim përbëhet nga ato që nuk zotërojnë një banesë.

**Figura 2: Situata e Strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Lezhë, 2016**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

Komunitetet Rome dhe Egjiptiane janë përqëndruar në 3 zona, informacioni sipas Tabelës 4:

**Tabela 4: Vendbanimet e Romëve dhe Egjiptianëve ne Bashkinë Lezhë, 2016**


Vendbanimet	Familjet R&E
Qyteti Lezhë	180 familje
Shëngjin	99 familje
Rrilë	21 familje
<b>Totali</b>	<b>300 familje</b>

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

Harta (shtojcë) tregon vendndodhjen e banesave.

Pothuajse 50 përqind e familjeve në nevojë nga të dy komunitetet janë të vendosura në qytetin e Lezhës (Figura 3). Kjo zonë përbehet nga banesa shumëkatëshe (deri në 10 kate) si edhe shtëpi private (1-4 kate). Përsa i takon infrastrukturës inxhinierike, ajo ekzistuesja është në gjendje të mirë.

**Figura 3: Vendbanimet Rome dhe Egjyptiane sipas problemeve të strehimit, 2016**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjyptian në Bashkinë e Lezhës 2016

Figura 3 tregon familjet në nevojë në çdo vendbanim.

35 përqind të familjeve janë të vendosura në Shëngjin. Kjo zonë përbehet nga banesa shumëkatëshe (deri në 10 kate) si edhe shtëpi private (1-4 kate). Përsa i takon infrastrukturës inxhinierike, ajo ekzistuesja është në gjendje të mirë. Përsëri, pjesa më e madhe e familjeve përballen me çështjen e standarteve të jetesës. Situata e tyre është kritike, siç tregohet edhe në fotot e mëposhtme.



**Foto nga vendbanimet Rome dhe Egjyptiane**

15 përqind të familjeve janë të vendosura në fshatin Rrilë. Kjo zonë përbehet nga banesa private (1-4 kate). Përsa i takon infrastrukturës inxhinierike, ajo ekzistuesja është në gjendje të mirë.

Vlerësimi i hollësishëm i kushteve të banimit të vendbanimeve Rome dhe Egjyptiane në Bashkinë Lezhë është bazuar në informacionet e marra nga pyetësi 2 (pjesa 5A, 5B, 5C dhe 5D) ashtu si edhe nga vizitat në terren në secilin komunitet. Në mënyrë që të identifikoheshin nevojat e strehimit për çdo komunitet, intervistat e bera në mënyrë të drejtpërdrejtë, janë bërë

me 26 përqind të familjeve, siç është treguar dhe në tabelën 5, sipas informacionit të marrë në terren.

**Tabela 5: Numri i intervistave të drejtpërdrejta në Bashkinë Lezhë**

	Banorë	Familje
Popullsia Rome dhe Egjyptiane	1421	300
Popullsia e intervistuar Rome dhe Egjyptiane	301	79
Në Përqindje	21	26

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjyptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

**Tabela 5.1: Intervistat në çdo vendbanim Rom dhe Egjyptian në Bashkinë Lezhë, 2016**

Vendbanimet	Familjet e intervistuar Rome dhe Egjyptiane
1. Lezhë	39 familje
2. Shëngjin	28 familje
3. Rrilë	12 familje
<b>Totali</b>	<b>79 familje</b>

**Burim:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjyptian në Bashkinë e Lezhës, 2016


Vlerësimi i nevojave për strehim tregon që komunitetet Rome dhe Egjyptiane ndajnë të njëjtat probleme, mungesën e kushteve të përshtatshme të banimit, në përputhje me standartet dhe ligjet në fuqi. (Tabela 6).

**Tabela 6: Familjet Rome dhe Egjyptiane sipas llojeve të banesave të tyre**

Lojet e banesave	Nr	Në %
Banojnë në tenda, barraka	51	64.6
Banojnë në garsoniera	2	2.5
Banojnë në apartamente 1+1	15	19.0
Banojnë në apartamente 2+1	8	10.1
Banojnë në apartamente 3+1 ose më shume	3	3.8
<b>Totali</b>	<b>79</b>	<b>100</b>

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjyptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

**Figura 4: Situata aktuale e strehimit e komuniteteve R/E**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

Siç shikohet nga tabela 6 dhe Figura 4, rreth 65 përqind e familjeve jetojnë në tenda, baraka ose magazina, 2.5 përqind në garsoniere, pjesa tjetër jetojnë në apartamente nga 1+1 deri në 3+1. Siç është vënë re gjatë vizitave në vend, pothuajse të gjitha "shtëpitë" kanë probleme me strukturat dhe kushtet higjieno-sanitare.

Përsa i përket aksesit tek rrjetet e ujësjellësit, kanalizimeve dhe elektrik (Tabela 7), 70 përqind e familjeve janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve, 66 përqind e familjeve janë të lidhura me rrjetin e ujësjellësit dhe 94 përqind janë të lidhura me rrjetin elektrik.

**Tabela 7: Aksesit tek rrjetet e furnizimit me ujë, kanalizimet dhe energjia të Komuniteteve R/E ne Bashkinë Lezhë**

Përqindja e familjeve që kanë akses ndaj punëve inxhinierike	Vizita në terren
Rrjeti i furnizimit me Ujë	66%
Rrjeti i Kanalizimeve	70%
Rrjeti i furnizimit me Energji	94%

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

Në lidhje me infrastrukturën inxhinierike dhe kushtet higjienike 92 përqind e familjeve nuk i përmbushin standartet në fuqi.

Si konkluzion, skuadra e vlerësimit konstaton se nevojat e familjeve Rome dhe Egjiptiane, banesat e të cilëve janë jashtë standarteve në fuqi, është emergjente në të tre vendbanimet, për shkak të mungesës së çdo nevojë bazë, qoftë të infrastrukturës, higjienës.

### 3.2. Situata Ekonomike dhe Sociale e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane

Për ti dhënë prioritet nevojave për strehim social, është analizuar gjëndja e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane bazuar në tregues të kombinuar të gjëndjes social ekonomike & kategorizimit të banesave.

Përsa i përket situates socio-ekonomike, është përdorur klasifikimi i të ardhurave të INSTAT-it. Sipas INSTAT, ka tre kategori bazë të ardhurash që përdoren për të vlerësuar varfërinë, që quhen "familje pa të ardhura", "familje me të ardhura nën 20.000 All në muaj", dhe "familje me të ardhura nën 30.000 All në muaj".

Grupi i Studimit për secilën kategori shtoi tre nënkategori, për të saktësuar më shumë profilin e përjashtimit socio-ekonomik në Bashkinë Lezhë.

Përsa i përket përcaktimit "I pastrehë" është marrë në konsideratë formulimi I Ligjit Nr. 9232, date 13.05.2004 "Mbi programet sociale për strehimin ne zonat urbane", përfshi rishikimet dhe amendamentet.

Siç mund të kuptohet nga informacioni i dhënë në Tabelën 8, nuk ka familje me të ardhura.


**Tabela 8: Treguesi i përbërë i gjëndjes social-ekonomike & situatës së strehimit të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane**

Kategorizimi i Strehimit	Nuk zotërojnë sipërfaqe banimi	Zotërojnë sipërfaqe banimi nën standart	Jetojnë në banesa nën standartet e strehimit	Jetojnë në qendra kolektive
<b>Kategorizimi socio-ekonomik</b>	<b>R&amp;E</b>	<b>R&amp;E</b>	<b>R&amp;E</b>	<b>R&amp;E</b>
Familje pa të ardhura	78	9	8	2
Familje pa të ardhura + persona të semurë	1	3	1	0
Familje pa të ardhura, gra vetem	4	3	1	0
Familje pa të ardhura + fëmijë	8	3	4	0
Të ardhura <All20.000/m	33	15	8	0
Të ardhura <All20.000/m + persona të semurë	2	5	3	0
Të ardhura <All20.000/m, + fëmijë	3	11	2	0
Të ardhura e <All20.000/m, gra vetem	2	6	3	0
Të ardhura <All30.000/m	27	6	10	0
Të ardhura e <All20.000/m, persona të semurë	2	5	3	0
Të ardhura e <All30.000/m, gra vetem	3	12	2	0
Të ardhura <All30.000/m, + fëmijë	2	7	3	0
<b>Totali</b>	<b>165</b>	<b>85</b>	<b>48</b>	<b>2</b>

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

Figura 5 ilustron qartë nevojën për strehim të më shumë se 1/3 e familjeve, të cilat përvec nevojës për strehim, vuajnë përjashtimin e shumfishtë për shkak të mungesës së të ardhurave si dhe të situatave kritike sociale në familje ( shumë fëmijë, përsosna të sëmurë, gra kryefamiljare etj).

**Figura 5: Strehimi i Romëve dhe Egjiptianëve, sipas të ardhurave të tyre, 2016**



Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

### 3.3. Territori dhe infrastruktura e vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane

Përsa i përket territorit dhe infrastrukturës të vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane, pothuajse të gjitha familjet jetojnë në banesa ku strukturat janë të amortizuara dhe e bëjnë të pamundur ndërhyrjen për ti përmirësuar. Kryesisht ata jetojnë në tenda, baraka dhe magazina dhe janë të pambrojtur nga temperaturat dhe rreshjet. Banesat shpesh kanë mungesë të elementëve bazë si cati, dyer, dritare. Përvec kësaj, sipërfaqja e banimit është shumë më e vogël se legjislacioni i strehimit social.

Përsa i takon "vendndodhjes së banesave" distanca nga shërbimet sociale, është shumë më e madhe se standartet. Vendbanimet janë larg nga qendrat mjeksore, shkollat dhe kopështet. Siguria është një shqetësim tjetër.

Shpesh vendbanimet janë afër lumenjve, që i rrezikojn vazhdimisht nga përmytjet. Fëmijet e moshës shkollare janë në rrezik për shkak të vendodhjeve të pasigurta të vendbanimeve.

Vizitat në vend treguan gjithashtu se ndërsa këto vendbanime janë pajisura me infrastrukturën inxhinierike pjesa më e madhe e familjeve nuk kanë akses në to.

Duke marrë parasysh përbërjen e familjeve si dhe kushtet ekzistuese të strehimit të popullsisë Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Lezhës, Grupi i Vleresimit hartoi Tabelën 8, e cila jep informacion në lidhje me nevojën për strehim në Bashkinë.

Në përgatitjen e Tabelës 8, janë marrë në konsideratë standartet ekzistuese të strehimit sipas legjislacionit aktual dhe është përdorur informacioni nga intervistat ballë për ballë për të llogaritur nevojën totale

Sic tregojnë të dhënat e përpunuara nga Pyetsori 2, banesat ekzistuese janë jashtë cdo standarti, prandaj të gjitha familjet kanë nevojë për shtëpi të përshtatshme sipas standarteve.


**Tabela 9: Nevojat për strehim të Komunitetit Rom në Bashkinë Lezhë**

Lloji i Banesës	Nevojat sipas studimit	Llogaritja e nevojave
Nr. I familjeve që kanë nevojë për garsonierë	7	27
Zona totale e nevojshme për garsoniera (total m <sup>2</sup> )	191,2	745,68
% e garsonierave	4%	4%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 1+1	22	86
Zona totale e nevojshme për apartamente 1+1 (total m <sup>2</sup> )	1001,9	3.907,4
% e 1+1	22%	22%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 2+1	22	86
Zona totale e nevojshme për apartamente 2+1 (total m <sup>2</sup> )	1244,6	4.853,9
% e 2+1	28%	28%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 deri në 75,5 m <sup>2</sup>	19	74
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1 (total m <sup>2</sup> )	1401,5	5.465,9
% e 3+1	31%	31%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 më shumë se 75,5 m <sup>2</sup>	7	27
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1+ (total m <sup>2</sup> )	648,5	2.529,2
% e 3+1+	14%	14%
<b>Numri Total i Familjeve</b>	<b>79</b>	<b>300</b>
<b>Zona totale e nevojshme për strehim m<sup>2</sup></b>	<b>4.487,7</b>	<b>17.502,0</b>

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

Siç tregon Tabela 9, për të akomoduar të gjithë komunitetin Rom dhe Egjiptian, nevojiten 300 apartamente (100 përqind e numrit total të familjeve), me një sipërfaqe ndërtimi 17.502,0 m<sup>2</sup>, ku mund të akomodohen respektivisht 27 familje me garsonierë, (4% e sipërfaqes totale të ndërtimit) në sipërfaqe ndërtimi 745,68 m<sup>2</sup>; 86 familje me apartamente 1+1 (22% e sipërfaqes totale të ndërtimit) në sipërfaqe ndërtimi 3.907,4 m<sup>2</sup>; 86 familje me apartamente 2+1 (28% e sipërfaqes totale të ndërtimit) në sipërfaqe ndërtimi 4.853,9 m<sup>2</sup>; 74 me apartamente 3+1 (31% e sipërfaqes totale të ndërtimit) në sipërfaqe ndërtimi 5.465,9 m; dhe 27 familje me apartamente 3+1 mbi 75.5m<sup>2</sup> (14% e sipërfaqes totale të ndërtimit) në sipërfaqe ndërtimi 2.529,2 m<sup>2</sup>.

**Figura 6: Nevojat për strehim të komunitetit Rom**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

### 3.4 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 3

Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Lezhë vuajnë nga përjashtimi i shumëfishtë socio-ekonomik që manifestohet nëpërmjet varfërisë ekstreme në të cilën jetojnë. E drejta e tyre bazë e strehimit është e mohuar.

- ▶ Gjysma e Romëve dhe Egjiptianeve nuk zotërojnë sipërfaqe banimi, nërsa më shumë se gjysma e tyre nuk kanë asnjë të ardhur.
- ▶ Më shumë se 1/3 e atyre që kanë nevojë për strehim janë pa të ardhura.
- ▶ Kushtet e banimit të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Lezhës janë shumë të këqija: vetëm 7.6 përqind jetojnë në shtëpi me standarte. Rreth 70 përqind e familjeve janë të lidhur me rrjetin e Ujësjellesit dhe Kanalizimeve, pothuajse të gjithë janë të lidhur me energjinë, por megjithatë situatë e tyre mbetet kritike.
- ▶ Ka nevojë për 300 banesa për komunitetin Rom dhe Egjiptian të cilët mund të strehohen në një hapësirë ndërtimi prej 17.502.0m<sup>2</sup>.
- ▶ Strehimi social mund të jetë një zgjidhje për 60 përqind të familjeve, ndërsa pjesa e mbetur prej 40 përqind duhet ta zgjidhë problemin e strehimit nëpërmjet alternativave të tjera.

## 4.

## ALTERNATIVA TË POLITIKAVE PUBLIKE

### 4.1. Ndërhyrjet dhe planet e qeverisë vendore

Ligji Nr.9232 mbi “Strehimin Social” është adoptuar për herë të parë në 2004. Që atëherë Ligji është ndryshuar shumë herë duke synuar rritjen e efektivitetit me anë të lehtësimit të procedurave të aplikimit si dhe rritjes së aksesit të të pastrehëve në Tregun e Strehimit.

Në përputhje me ligjin, Bashkia Lezhë, është përpjekur të zgjidhë problemin e strehimit. Bashkia Lezhë ka adoptuar programet e mëposhtëme të strehimit social:

- ▶ Strehim me qera sociale (SRH)
- ▶ Strehim me kosto të ulët (LCH)

Si rezultat, 34 familje R & E të pastreha kanë përfituar nga SRH dhe 8 nga LCH.

Në Janar 2016, Bashkia Lezhë ka aprovuar Strategjinë e Zhvillimit të Territorit, në të cilën strehimi është adresuar në mënyrë sipërfaqësore, ndërsa mungesa e fondeve është konsideruar kushtëzimi më kritik<sup>8</sup>.

**Tabela 10: Buxheti i Bashkisë Lezhë për strehim social, 2016**

Buxheti/vitet	2016	Në%
Totali në 000/All	1,195,559	100
Të ardhurat lokale në 000/All	660,450	55
Të ardhurat lokale për strehim social në 000/All	NA	
Buxheti Total i alokuar për Strehim Social në 000/All	2,280	0,2
Tansfera të pakushtëzuara në 000/All	230,553	19

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016 dhe <http://open.data.al/en/lajme/lajm/id/1647/titull/Unconditional-and-specific-transfers-by-municipalities-2016>

## 4.2 Sugjerimet e Politikave Publike për të zgjidhur problemin e strehimit në Bashki

Duke ju referuar Ligjit Nr. 9232, programet e strehimit social janë “programe të cilat shërbejnë për të strehuar familjet dhe individët të cilët për shkak të situatës së tyre ekonomike dhe sociale nuk mund të përballojnë ofertën e tregut të lire ose kredinë”.

Qeveria ka krijuar tre programe të strehimit social: **banesa sociale me qera, banesat me kosto të ulët, dhe programin e pajisjes së truallit me infrastrukturë**. Për më tepër, qeveria ka krijuar ofrimin e subvencioneve të strehimit, subvencionimit të kredive, grantet e vogla, dhe grantet e menjëhershme të cilat synojnë grupe specifike (shih më poshtë për një përshkrim të secilit program). Përfituesit e programeve të strehimit social duhet të përmbushin një nga kriteret në vazhdim: ata nuk duhet të kenë një banesë në pronësi, duhet të kenë një banesë e cila është nën normat e banimit; ose duhet të jenë të pastrehë për shkak të katastrofave natyrore (Ligji 9232, Neni 4).

Zgjedhja e përfituesve bazohet në kushtet e tyre të jetesës si dhe rrethanave të tyre sociale dhe ekonomike. Prioriteti është vendosur mbi 15 grupe, duke përfshirë familjet me një prind kryefamiljar, familjet e gjera, të rriturit më të vjetër, personat e paaftë, çiftet e reja, familjet që kanë ndryshuar vendbanim, jetimët, emigrantët që kthehen, punonjësit e migruar nga qyteti në qytet, azilkërkuesit, oficerët e rënë në detyrë, viktimat e dhunës familjare, familjet Rome, familjet Egjiptiane, dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.

Për tu përzgjedhur pëe sistemin e pikëzimit familjet duhet të plotësojnë dy kushte: Të ardhurat mujore nuk duhet të jenë më të larta se 100 % se mesatarja e Zonës për strehim social dhe 120 % për strehimin me kosto të ulët, si edhe familjet nuk duhet të zotërojnë një banesë ose të jetojnë në një banesë sipërfaqja e të cilës nuk është më e madhe se standarti minimal i vendosur me Ligj.

Për të vlerësuar programet e strehimit social që mund të vlejnjë për komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Lezhës, është hartuar Tabela 14. Duke analizuar në thellësi informacionin në Tabelën 14, duket se aksesit i Komuniteteve Rome dhe Egjiptian në programet e strehimit Social është i ulët.

**Tabela 11: Vlerësimi i programeve të Strehimit Social kundrejt kushteve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.**

Programet e Strehimit Social	Kriteret e përgjithshme	Familjet në nevojë strehimi		
		Nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	Kanë në pronësi hapësirë banimi nën standartin e banimit	Jetojnë në banesa nën standartin e banimit
	1. Nuk duhet të kenë në pronësi një shtëpi; 2. Duhet të kenë një vend banimi nën normat e strehimit; 3. Duhet të jenë të pastrehë për shkak të katastrofave natyrore	165 familje  91 pa të ardhura	85 familje  18 pa të ardhura	50 familje  16 pa të ardhura
SRH Strehim social me qera	Qeveria vendore ndërton njësi strehimi, të cilat jepen me qera me çmime të lira për kategoritë sociale.	Për familjet pa të ardhura, mund të aplikohet, nëse “modifikohen kushtet e qerasë”  Për familjet e tjera, mund të aplikohet lehtësisht nëse: • Ka banesa, • Ka fonde, • Përmbushen kriteret e të ardhurave.	Për familjet pa të ardhura, mund të aplikohet, nëse “modifikohen kushtet e qerasë”  Për familjet e tjera, mund të aplikohet lehtësisht nëse: • Ka banesa, • Ka fonde, • Përmbushen kriteret e të ardhurave.	Për familjet pa të ardhura, mund të aplikohet, nëse “modifikohen kushtet e qerasë”  Për familjet e tjera, mund të aplikohet lehtësisht nëse: • Ka banesa, • Ka fonde, • Përmbushen kriteret e të ardhurave.
HS Subvencionimi i Strehimit	Autoritetet vendore mund të alokojnë subvencione strehimi për përfituesit e banesave sociale me qera. $SS \leq 50\%$ e velrës minimale të qerasë. $(Vlera\ e\ qerasë - SS) \leq 30\%$ e të ardhurave të familjes.	Njëlloj si SRH	Njëlloj si SRH	Njëlloj si SRH
LCH Strehimi me kosto të ulët	Njësit me kosto të ulët ndërtohen ose blihen me çdo fond për familjet, të ardhurat e të cilave janë $\leq 120\%$ e mesatares së të ardhurave të rrethit.	Përfshirë pjesor për shkak të kriterit të të ardhurave.	Përfshirë pjesor për shkak të kriterit të të ardhurave.	Përfshirë pjesor për shkak të kriterit të të ardhurave.



Programet e Strehimit Social	Kriteret e përgjithshme	Familjet në nevojë strehimi		
		Nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	Kanë në pronësi hapësirë banimi nën standartin e banimit	Jetojnë në banesa nën standartin e banimit
LF Toka e pajisur me infrastrukturë	Investime në infrastrukturën e truallit në prona shtetërore, nga qeveria vendore për qëllime sociale ose përfitim. Duhet të ketë truall të lirë.	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Mund të aplokojnë nëse <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kosto e lejon;</li> <li>• “Qëllimi social” është i përcaktuar</li> <li>• Mund të përdoret territory ekzistues.</li> <li>• Infrastruktura dhe kushtet inxhinierike të territorit ekzistues e lejojnë.</li> </ul>
RHS Subvencionim i qerave të strehimit	Nëse qeraja e njësisë së strehimit social $\geq$ 25% e të ardhurave të familjes, familja përfiton subvencionim të qerasë. $RHS = \text{Aktuale} - \text{Qera e përbalueshme}$ .			Përfshihen për shkak të kriterit të të ardhurave.
SL Subvencionimi i huave	Përfituesit e banesave me kosto të ulët kanë të drejtë të marrin një kredi me terma të favorshëm nga një institucion financiar, i cili ka një kontratë me Ministrinë e Financave.			Përfshihen për shkak të kriterit të të ardhurave.
Grantet e vogla, dhe grantet e menjëhershme që synojnë grupe specifike (shih më poshtë për përshkrimin e secilit program)	Përfituesve të banesave me kosto të ulët i jepen grante të menjëhershme në rrethana të veçanta.			Nuk aplikohet

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

Ndërsa ndryshimi i kushteve të qerasë si dhe e “qëllimit social” kërkojnë akte ligjore, duket se shkalla e opsioneve është e ulët për zgjidhjen e nevojave të strehimit kundrejt komuniteteve Rome dhe Egjiptiane:

#### Opsion 1:

**Programi BSQ: Qeveria vendore ndërton njësi banimi.**

Hipotezat:

- Ka truall të lirë.
- Ka vullnet politik dhe mundësi financiare për të ofruar strehim pa pagesë.
- Risku i diskriminimit pozitiv neglizhohet.

Përfituesit e mundshëm: 250 familje (ata që nuk zoterojnë banesë ose sipërfaqja e tyre është nën standart).

#### Opsion 2:

**Programi PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në pronat shtetërore.**

Hipotezat:

- Ka truall të lirë/ prona shtetërore të lira/ objekte.
- Ka vullnet politik dhe mundësi financiare për të ofruar strehim pa pagesë.
- Risku i diskriminimit pozitiv neglizhohet.

Përfituesit e mundshëm: 300 familje.

#### Opsion 3:

**Programi PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në vendbanimet ekzistuese Rome dhe Egjiptiane.**

Hipotezat:

- Mundësia e përdorimit efektiv i territoreve ekzistuese është e lartë.
- Kushtet infrastrukturore dhe inxhinierike të territoreve ekzistuese e lejojnë.

Përfituesit e mundshëm: 50 familje. Ky është numri i familjeve që zotërojnë sipërfaqe banimi (17 përqind e totalit të familjeve).

#### Opsion 4:

**Një kombinim ndërmjet tre alternativave të mëparshme**

Përfituesit opsionale: 300 familje, i njëjtë me numrin total të familjeve në nevojë për strehim.

### 4.3. Një vlerësim i kostos për ndërhyrje të ndryshme të bashkisë

#### Opsioni 1:

##### Programi BSQ: Qeveria vendore ndërton njësi banimi.

Disa kritere merren në konsideratë:

- Kosto mesatare e njësisë i referohet **“Udhëzimit nr.4 dt 30.4.2015 për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2015.”**
- Sipas **Entit Kombëtar të Banesave**, kosto mesatare e ndërtimit në Lezhë është 32.440 lek/m<sup>2</sup>.
- Kosto për rrjetet inxhinierike është llogaritur 23 €/m<sup>2</sup>; 3197 lek/m<sup>2</sup> (10€ për elektrikun, 5 € për IT, 8€ për ujesjellësin, për ujrat e zeza dhe të shiut).

Prandaj, kosto për ndërtime të reja për komunitetin Rom dhe Egjiptian (300 apartamente në sipërfaqe ndërtimi 17.502,0 m<sup>2</sup>):

$$\text{Kosto e ndërtimit} = 17.502,0\text{m}^2 * 32.440\text{lek/m}^2 = \text{All } 567.764.880$$

$$\text{Rrjetet inxhinierike} = 17.502,0\text{m}^2 * 3.197\text{lek/m}^2 = \text{All } 55.953.894$$

$$\text{Kosto totale} = 567.764.880 \text{ lek} + 55.953.774 \text{ lek} = \text{All } 623.718.774$$

**Opsioni 1: Kosto Totale për ndërtim të ri = All 623.718.774**

#### Opsioni 2:

##### Programi PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në pronat shtetërore.

Ky opsion nuk është përpunuar më tej pasi nuk ka asnjë pronë shtetërore e lirë e cila mund të përdoret për këtë qëllim. Në kushtet e dhëna, ky program nuk mund të aplikohet.

#### Opsioni 3:

##### Program PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në vendbanimet ekzistuese Rome dhe Egjiptiane.

Disa kritere janë marrë në konsideratë:

- Udhëzimi i MZHU datë 03/08/2015 për sa i përket kostos maksimale të rehabilitimit të infrastrukturës ekzistuese.
- Kosto e rehabilitimit nuk duhet të kalojë 650.000,00 lekë/banesë dhe ndërtimi i ri nuk duhet të tejkalojë 1.200.000,0 lekë/banesë (përfshirë TVSH).
- Vetëm familjet që zotërojnë një hapësirë banimi dhe kosto mesatare e rehabilitimit/ndërtimit të ri përlogaritet 925.000,0 lekë (650.000 + 1.200.000)/2), janë marrë në konsideratë

**Table 12: Përmbledhje e rezultateve të familjeve të intervistuar**

Nr. I familjeve që nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	26
Nr. I familjeve që zotërojnë hapësirë banimi nën kërkesat e zonës	51
Nr. I familjeve që banojnë nën standartet e miratuara	77
Nr. I familjeve që jetojnë në qendra komunitare	2

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

Siç mund të shihet nga tabela 12 më sipër, 51 familje nga 79 (64.6%) të komunitetit Rom dhe Egjiptian zotëronë sipërfaqe banimi, që, megjithatë, është nën standartin e strehimit.

Bazuar në kriteret e shpjeguara më sipër, numri i përfituesve potencialë është 194 familje (64.6 përqind e 300 familjeve).

$$\text{Kosto totale e rehabilitimit} = 194 \text{ familje} * 925.000,0 \text{ lek/ familje} = \text{All } 179.450.000,0$$

**Opsioni 3: Kosto Totale për rehabilitim = All 179.450.000,0**

Grupi i studimit, nuk sugjeron të synohet ky variant sepse, nuk e zgjidh problemin e strehimit, përderisa çënohet minimum i standartit të hapsirës së banimit, sipas ligjit Shqiptar.

#### Opsioni 4:

##### Një kombinim ndërmjet tre alternativave të mëparshme

Ky opsion nuk konsiderohet më tej pasi siç mund ta shohim nga opsioni i mëparshëm, i vetmi që mund ta zgjidhe në mënyrë permanente problemin e strehimit është opsioni nr. 1.

**Tabela 13: Përmbledhje e Rezultateve të kostove të varianteve të politikave në krahasim me Buxhetin aktual të Bashkisë.**

Varianti i Politikave	Kosto	Buxheti per strehim sociale, 2016	Në % krahasuar me buxhetin aktual
Varianti 1	All 623.718.774	All 2.280.000	Nuk krahasohet
Varianti 3	All 179.450.000	All 2.280.000	Nuk krahasohet

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

#### 4.4 Plan veprimi për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane

	Objektivat/detyrat	Kohëzgjatja	Rezultate/Mjetet e verifikimit
<b>1.</b>	<b>Bashkia Durrës Strategjia e Strehimit për Romët dhe Egjiptianët</b>	<b>Qershor 2017</b>	<b>Strategjia e Strehimit për Romët dhe Egjiptianët miratohet nga Këshilli Bashkiak</b>
1.1	Diskutim dhe miratim i raportit të Vlerësimit	Dhjetor 2016	Raporti i Takimit
1.2	Analiza në thellësi i opsioneve të politikave	Janar 2017	Këshilli Bashkiak është në djeni të opsioneve të politikave.
1.3	Ri-vlerësimi i nevojave për strehim	Shkurt 2017	Raporti i vlerësimit validohet nga Ekipi i Menaxhimit të Bashkisë
1.4	Ri-vlerësimi i furnizimit të strehimit.	Shkurt 2017	Raporti i vlerësimit validohet nga Ekipi i Menaxhimit të Bashkisë
1.5	Ri-vlerësimi i alternativave të politikës.	Mars 2017	Merret vendimi final mbi politikën më të mirë.
1.6	Përgatitja dhe miratimi i Strategjisë	Maj 2017	Strategjia miratohet nga Këshilli
1.7	Përgatitja e planit të implementimit	Qershor 2017	Plani i implementimit miratohet
<b>2.</b>	<b>Buxheti i Strategjisë së Strehimit për Romët dhe Egjiptianët</b>	<b>Tetor 2017</b>	<b>Bashkia ngre fonde të mjaftueshme për të përballuar implementimin e Strategjisë së Strehimit</b>
2.1	Rishikimi i buxhetit vendor	Qershor 2017	Miratohet plan buxheti i ri
2.2	Diskutim mbi strategjinë me palët e interesuara dhe donatorët	Qershor 2017	Vullneti i palëve të interesuara për të investuar konfirmohet
<b>3.</b>	<b>Rishikimi i legjislacionit</b>	<b>Qershor 2017</b>	<b>Legjislacioni rishikohet dhe miratohet</b>
3.1	Propozim për rishikim të legjislacionit mbi Strehimin Social sipas opsioneve të politikave të identifikuar	Qershor 2017	Ndryshime ndaj legjislacionit miratohen
<b>4.</b>	<b>Implementohet Strategjia e Strehimit</b>	<b>Dhjetor 2017</b>	<b>Plani i investimit për zgjidhjen e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane miratohet nga Këshilli Bashkiak</b>
4.1	Identifikimi i nevojave për ndërtim (analizë e detajuar)	Tetor 2017	Miratohet plani i investimit
4.2	Zgjidhja e problemeve ligjore midis zonave të ndërtimit të zgjedhura dhe/ose sugjeruara.	Nëntor 2017	Çdo problem ligjor është zgjidhur
4.3	Studim i realizueshmërisë së zonave të ndërtimit të zgjedhura dhe/ose sugjeruara	Nëntor 2017	Plani i investimit miratohet
4.4	Finalizimi i planit të investimit	Dhjetor 2017	Projekti i investimit miratohet nga ekipi i menaxhimit të bashkisë.

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Lezhës, 2016

#### 4.5 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 4

Bashkia Lezhë ka një numër të madh familjesh R & E të pastreha, të cilëve i është mohuar e drejta e strehimit.

- ▶ Gjetjet tregojnë se Bashkia Lezhë, brënda kushteve aktuale të buxhetit, mund të përpiqet të zgjidhë pjesërisht problemin e strehimit ose për Romët dhe Egjiptianët ose për të gjithë popullsinë.
- ▶ Pavarësisht faktit që qeveria ka krijuar programe të strehimit social, pjesa më e madhe e tyre nuk duket të jenë të përshtatshme për të zgjidhur nevojat për strehim të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, për shkak të kushtëzimit nga të ardhurat.
- ▶ Mund të merren në konsideratë më shumë se 3 programe të strehimit social, konkretisht strehimi me qera sociale, strehimi me kosto të ulët, dhe program i pajisjes së tokës me infrastrukturë, nëse merren në konsideratë disa rishikime ligjore dhe nëse sigurohen fondet.
- ▶ Bazuar në llogaritjen e koston, as Varianti 1 as Varianti 3 nuk mund të financohen nga Buxheti i Bashkisë, prandaj Bashkia Lezhë ka nevojë për mbështetje financiare ose nga buxheti qendror ose nga burime të tjera të jashtme.
- ▶ Në anën tjetër, ka edhe kosto të tjera indirekte që duhen konsideruar për shkak të rrezikut që mbart secili variant i politikave. Përveç kësaj, disa rreziqe mund të kenë implikime financiare, respektivisht rreziku i diskriminimit, rreziku i izolimit si dhe rreziku i tensionit social me ish pronarët e pronave dhe tokave.

## KONKLUZIONET FINALE

- ▶ Në përgjithësi, gjetjet sigurojnë qartësim të sfidave që has strehimi social në Bashkinë Lezhë. Analiza tregon se kuadri aktual ligjor nuk është i mjaftueshëm për të zgjidhur problemet e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane. Gjetjet nga Kapitujt 3 dhe 4 tregojnë se adresimi i problemit të Romeve dhe Egjiptianëve të pastrehë në Lezhë kërkon ndërmarrjen e hapave të shumfishtë njëkohësisht; për shembull rishikimin e kuadrit ligjor, tërheqjen e vëmendjes së programeve të strehimit social dhe gjetjen e më të varfërve, forcimin e kapaciteteve të qeverisjes lokale.
- ▶ Raporti i vlerësimit jep një kontribut të cmueshëm për të plotësuar disa boshllëqe në të dhënat specifike , duke rishikuar dhe vlerësuar evidencat ekzistuese mbi kushtet e jetesës dhe të strehimit të (psh kushtet e strehimit, aksesin tek uji i pijshëm, kanalizimet dhe energjia) të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë e Lezhës.
- ▶ Përveç kësaj, raporti jep një kontribut të çmuar në nivelin e politikave. Plani i Veprimit , i zhvilluar në 4.4 mund të shërbejë si instrument udhëzues për MZHU dhe bashkëpunëtorët e saj të institucioneve shtetërore, të qeverisjeve lokale dh organizatave të komunitetit në përmirësimin e kushteve të banimit dhe të jetesës të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Lezhës.
- ▶ Gjithsesi, studimi ka rëndësi të veçantë për Bashkinë Lezhë. Në nivelin e qeverisjes lokale, duke vlerësuar investimet qe duhet të bëhen në Bashkinë Lezhë me qëllim përmirësimin e kushteve të strehimit dhe të jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, gjetjet dhe sugjerimet jo vetëm do të kontribuojnë në implementimin e Planit te Veprimit, por gjithashtu edhe në forcimin e kapaciteteve të qeverisjes lokale përballë implementimit të të gjithë strategjisë së strehimit social në nivel lokal.


## BIBLIOGRAFIA

- Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale 2015-2020
- Një Studim mbi Vlerësimin e Nevojave të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri , CESS, mbështetur nga PNUD. 2012
- Politikat dhe Praktika e Strehimit për Romët në Shqipëri, PNUD Shqipëri, 2013
- Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri. 2016-2020;
- Raporti i Monitorimit të Shoqërisë Civile, Implementimi i Integritit të Romëve,
- Romët dhe Egjiptianët në profiling Socio-demografik dhe ekonomi të Shqipërisë, bazuar në Census 2011, Janar 2015;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit të Dekadës në 2012, Shqipëri. 2013 HDPC
- Strategjia për Strehimin Social, 2015-2025
- Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin. 2014-2020.
- Strategjia Territoriale Bashkia Lezhe, January 2016

# SHTOJCË

## Harta e Vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

PROGRAMI “MBËSHTETJA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE NË SHQIPËRI”

VLERËSIM I NEVOJAVE PËR INVESTIME  
NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE  
**ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKINË SHKODËR**  
ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS SË TYRE

---

RAPORTI FINAL  
Janar 2017



BASHKIA SHKODËR



## PËRMBAJTJA

FALËNDERIME	5
LISTA E SHKURTIMEVE	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
HYRJE	9
KAPITULLI 1: RISHIKIMI I KONTEKSTIT LIGJOR KUNDREJT TË DREJTËS PËR STREHIM TË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE	11
1.1 Situata e përgjithshme e nevojave për strehim të Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë e Shkodrës	
1.2 Politikat Publike të “Strehimit” të miratuara në Bashkinë e Shkodrës	
1.3 Evidenca mbi përmirësimin e kushteve të banimit dhe të jetesës, të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Shkodrës	
KAPITULLI 2: METODOLOGJIA E KËRKIMIT	14
2.1 Qëllimi, synimi dhe objektivat	
2.2 Karakteristikat e kampionit	
2.3 Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave	
2.4 Parimet e analizës	
A. Proçesi i përmirësimit të kushteve ekzistuese të jetesës në strukturat rezidenciale	
B. Përdorimi i fondit të lirë ekzistues të strukturave rezidenciale (nëpërmjet blerjes ose proçesit të punësimit)	
C. Ndërtimi i strukturave të reja dhe infrastrukturës për qëllim të strehimit social	
KAPITULLI 3: ANALIZA PËRSHKRUESE DHE E DETAJUAR E KUSHTEVE TË STREHIMIT DHE JETESËS SË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE (GJETJET E STUDIMIT)	20
3.1 Situata e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	
3.2 Situata ekonomike dhe sociale e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	
3.3 Territori dhe infrastruktura e vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane	
3.4 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 3	
KAPITULLI 4: ALTERNATIVA TË POLITIKAVE PUBLIKE	31
4.1 Planet dhe ndërhyrjet e qeverisë lokale	
4.2 Sugjerime të politikave publike për të zgjidhur çështjen e strehimit në Bashki	
4.3 Kosto e vlerësuar për ndërhyrje të ndryshme nga Bashkia	
4.4 Plan veprimi për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	
4.5 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 4	
KONKLuzionet finale	40
BIBLIOGRAFIA	41
SHTOJCË: HARTA E VENDBANIMEVE	42

### Raport

*“Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Shkodër, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të tyre”*

Ky dokument është përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Urban në konsultim të ngushtë me përfaqësues të Bashkive dhe shoqërisë civile, si dhe ekspertëve të organizatave lokale dhe të fushës së strehimit social.

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit është ofruar nga Qendra Kombëtare Shqiptare për Studime Sociale (NCSS) dhe WeissGerber & Partners (W&P) në kuadër të Projektit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (UNSSIA), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), apo të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Tiranë, Janar 2017

## Lista e tabelave dhe figurave

Tabela 1. Karakteristikat e kampionit	15
Tabela 2. Gjendja e familjeve të pastreha në Bashkinë Shkodër, 2016	21
Tabela 3. Numri i intervistave të drejtpërdrejta në Bashkinë Shkodër	23
Tabela 4. Intervistat në çdo vendbanim Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Shkodër, 2016	23
Tabela 5. Familjet Rome dhe Egjiptiane sipas llojeve të banesave të tyre	24
Tabela 6. Lidhja me rrjetin e ujës jellësit, kanalizimit të ujërave të ndotur dhe rrjetin e energjisë elektrike të komuniteteve Rome dhe Egjiptian në Bashkinë Shkodër	25
Tabela 7. Treguesit përberes social-ekonomik dhe situata e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	26
Tabela 8. Kërkesat për banesa për komunitetin Rom në Bashkinë Shkodër	28
Tabela 9. Kërkesat për banesa nga komuniteti Egjiptian në Bashkinë Shkodër	29
Tabela 10. Buxheti i Bashkisë Shkodër i caktuar për strehimet sociale, 2016	31
Tabela 11. Ndarja e të pastrehëve sipas të ardhurave	32
Tabela 12. Vlerësimi i programeve të Strehimit Social kundrejt kushteve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane	33
<hr/>	
Figura 1: Familjet e pastreha Rome dhe Egjiptiane kundrejtë popullsisë totale	20
Figura 2: Familjet në nevoje për strehim, 2016	21
Figura 3: Situata e Strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Shkodër, 2016	22
Figura 4: Vendbanimet Rome dhe Egjiptiane sipas llojit të problemeve të strehimit, 2016	22
Figura 5: Situata ekzistuese e strehimit e komuniteteve R/E	24
Figura 7: Situata ekzistuese e strehimit të komunitetit Egjiptian	25
Figura 8: Romët dhe Egjiptianët, sipas të ardhurave të tyre, 2016	27
Figura 9: Nevojat e strehimit për komunitetin Rom	28
Figura 10: Nevojat e strehimit për komunitetin Egjiptian	30
<hr/>	



## FALËNDERIME

Qendra Kombëtare Shqiptare e Studimeve Sociale (NCSS), dhe Weiss Gerber & Partners, produkt i punës së të cilëve është ky studim, falënderojnë grupin e ekspertëve të drejtuar nga Prof.Asoc.Dr. Arlinda Ymeraj dhe Znj. Ardiana Fortuzi.

Falënderime të veçanta për punonjësit e Bashkive Tiranë, Durrës, Lezhë, Krujë dhe Shkodër që, në cilësinë e institucioneve zbatues të programeve të strehimit, mbledhën dhe përpunuan informacionin në përputhje të plotë me kërkesat e këtij vlerësimi. I shprehim mirënjohje stafit të Ministrisë së Zhvillimit Urban, në veçanti Znj. Aida Seseri, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Urbane dhe Strehimit, për mbështetjen e profesionale në kryerjen e studimit si dhe stafin e UNDP për administrimin e kujdesshëm të procesit.



## LISTA E SHKURTIMEVE

Bashkimi European	<b>BE</b>
Ministria e Zhvillimit Urban	<b>MZHU</b>
Enti Kombëtar i Strehimit	<b>EKS</b>
Dokumenti I Politikës së Përfshirjes Sociale	<b>DPPS</b>
Programi i Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri	<b>UNSSIA</b>

## PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i studimit të nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rom dhe Egjiptian në bashkinë Shkodër me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre, bazohet në një analizë të kujdesshme të nevojave për strehim dhe të të ardhurave, sugjeron disa politika të shoqëruara me kostot respektive, të përmbledhura në një plan veprimi. Si i tillë, ai udhëzon punën e MZHU dhe bashkëpunimin e saj me institucionet shtetërore, qeverisjet lokale dhe me organizatat e komunitetit në përmirësimin e kushteve të banimit dhe të jetesës të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Shkodrës.

Raporti konstatoi se:

- ▶ Familjet e pastreha në Shkodër perbejnë pothuajse 6% të popullsisë, ndërsa Romët dhe Egjiptianët së bashku perbejnë 0.8% të të gjitha familjeve të pastreha.
- ▶ Numri i familjeve të pastreha Egjiptiane është pothuajse tre herë më i lartë se numri i familjeve të pastreha Rome, megjithëse të dyja komunitetet jetojnë në kushte strehimi shumë të këqija.
- ▶ Komuniteti Rom është i vendosur në katër vendbanime, ndërsa Komuniteti Egjiptian është i përqëndruar në dy vendbanime, si në Harten në aneks.
- ▶ Kushtet e infrastrukturës në Shkodër janë problematike në të gjitha vendbanimet Rome. Në të gjitha familjet Rome, me përjashtim të atyre të vendosura në Urën e Bunës, jetojnë në tenda dhe barrake pa akses të rrjetit të ujësjellësit dhe furnizimit me energji elektrike, ndërsa 95% e strehimeve Egjiptiane nuk i përmbushin standartet e kërkuara të Higjienës dhe lidhjes me rrjetin e shkarkimit të ujërave të ndotura.
- ▶ Pjesa më e madhe e familjeve nga komunitetet Rome dhe Egjiptiane (95%) jetojnë në varfëri të tejskajshme si pasojë e mungesës së të ardhurave, ndërkohë që banesat e tyre janë jashtë çdo standarti strehimi.
- ▶ Ekziston një nevojë urgjente për banesa për 105 familje Rome dhe 315 familje Egjiptiane të cilat mund të akomodohen në 22.955,1m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi. Fatkeqsisht, komunitetet Rome dhe Egjiptiane nuk mund të zgjidhin vetë problemin e strehimit për shkak të mungesës së të ardhurave.
- ▶ Strehimi social mbetet e vetmja politike efektive për zgjidhjen e nevojave të strehimit për komunitetet Rome dhe Egjiptiane. Midis opsioneve për politika të ndryshme të sugjeruara në raport, Programi BQS, "Qeveria lokale ndërton njësi banimi" duket më i përshtatshmi. Bashkia e Shkodrës mund të sigurojë 70.000m<sup>2</sup> truall për të zgjidhur problemin. Kosto e vlerësuar për ndërtimet e reja për komunitetin Rom dhe Egjiptian (105 apartamente për komunitetin Rom dhe 252 apartamente për komunitetin Egjiptian 22,955.1m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi gjithsej) është 702.465.219 Lekë, shumë më e lartë se mundësitë financiare të Bashkisë Shkodër.
- ▶ Opsioni 2, Rehabilitimi i banesave ekzistuese (98 banesa) kushton 90,650,000 lekë.
- ▶ Kosto e rehabilitimit të infrastrukturës në lekë është 62,562,658.

- ▶ Bashkia e Shkodrës ka nevojë për mbështetjen financiare qoftë nga buxheti qendror ose nga burime të tjera të jashtme për të zhvilluar një Strategji strehimi dhe Planin e Veprimit.

Raporti përbëhet nga katër kapituj përveç Hyrjes dhe Konkluzioneve Finale. Kapitulli i parë rishikon kontekstin ligjor në lidhje me të drejtën e strehimit të Romëve dhe Egjiptianëve. Kapitulli i dytë përshkruan metodologjinë e analizës. Kapitulli i tretë adreson gjetjet, ndërsa kapitulli i fundit shtjellon analizën e mëtejshme në lidhje me vlerësimin e kostove të alternativave të ndryshme të politikave, duke nxjerrë në pah argumentat për variantin më të përshtatshëm. Raporti mbyllet me konkluzionet finale. Një hartë dixhitale jep informacion të përditësuar rreth vendndodhjeve të Romëve dhe Egjiptianëve.



## HYRJA

Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë dhe po implementon një reformë sociale të gjerë dhe komplekse, me qëllim fuqizimin e mekanizmave institucional për të siguruar se askush nuk do të përjashtohet nga gëzimi i të drejtave të tyre. Sipas Termave të Referencës, politika e përfshirjes sociale është çelësi i promovimit të qëllimeve më të gjera të politikave të rritjes dhe zhvillimit si dhe adresimit të shkaqeve të mungesave të shumëfishta dhe varfërisë. Adoptimi i Dokumentit Politik të Përfshirjes Sociale 2015-2020 i hap rrugën:

- ▶ Identifikimit dhe adresimit të sfidave me të cilat përballet monitorimi dhe vlerësimi i përfshirjes sociale duke nxjerrë në pah indikatorët e BE-së dhe kombëtar, prej të cilëve kërkohet të mbështesin reduktimin e varfërisë dhe zhvillimin e masave efektive që përmirësojnë mirëqënien;
- ▶ Promovimit të koherencës së politikës, vendosjes së prioriteteve dhe caktimit të përgjegjësive për kryerjen e monitorimit dhe matjes së përfshirjes sociale;
- ▶ Vlerësimin në mënyrë transparente të efektit të politikave që ndiqen dhe përpjekjeve të Qeverisë për të fuqizuar politikën që ndikojnë mbi përfshirjen sociale.

Në këtë kontekst, Programi i Mbështetjes së Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri (UNSSIA) kërkon të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve Shqiptare në nivel qendror dhe vendor për të avancuar me axhendën kombëtare të përfshirjes sociale me një pikëpamje të tillë e cila do të sigurojë konsistencë dhe koherencë nga politikën qeveritare dhe programuesit në arritjen e efektit maksimal të mundshëm për përfshirjen sociale të personave në risk; dhe rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe qytetarëve si mbajtësit e të drejtave në procesin kombëtar të përfshirjes sociale.

Brenda kontekstit të UNSSIA, vëmendje e veçantë i kushtohet veprimeve që mund të eliminojnë barrierat me të cilat Romët dhe Egjiptianët përballen për të aksesuar shërbimet, për të përmirësuar kushtet e jetesës nëpërmjet integritit dhe promovimit të dialogut interkulturor. Plani Kombëtar i Veprimit për Integritin e Romëve dhe Egjiptianëve përfaqëson një angazhim të ri i cili mbulon periudhën 2016-2020, dhe synon respektivisht këto dy komunitete. Në të reflektohet rritja e masave që po implementohen dhe gjithashtu planet për aktivitete të reja për promovimin e integritit të Romëve dhe Egjiptianëve, me një fond të angazhuar nga buxheti i Shtetit dhe hapësirat e financimit të identifikuar për periudhën 2016-2020 si dhe gjetja e mjeteve financiare nëpërmjet koordinimit me programe të tjera ndërkombëtare.

Romët dhe Egjiptianët përballen me barrierë direkte dhe indirekte në marrjen e shërbimeve publike, si rrjedhojë e pamundësisë për përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes, mungesës së informacionit ose të të kuptuarit të procedurave administrative, ashtu si dhe stigmatizimi dhe sjellja diskriminuese nga ana e shumicës së popullsisë. Përjashtimi afatgjatë ka ndikuar në kushtet e jetesës së Romëve dhe Egjiptianëve, trajtimi diskriminues nga shumica e popullsisë dhe marrëdhënia me institucionet qeveritare.

Midis të gjithë grupeve të pambrojtura, ekzistojnë të dhëna domethënëse të cilat tregojnë se Romët dhe Egjiptianët jetojnë në lagje të varfëra ku ka shumë pak ose aspak mundësi për të marrë shërbime publike. Studimet tregojnë se niveli i varfërisë midis komunitetit Rom është dy

herë më i lartë se shumica e popullsisë, ndërsa shkalla e papunësisë është tre herë më e lartë se mesatarja<sup>3</sup>. Tridhjetë e nëntë përqind e banesave ku jetojnë Romët dhe 21 përqind e atyre të banuara nga Egjiptianët nuk kanë akses ndaj ujit të pijshëm<sup>4</sup>. I njëjti burim informacioni tregon se 36 përqind e Romëve jetojnë në shtëpi të rrënuara ose lagje të varfëra (geto).

Si pjesë e strategjisë së përgjithshme për përfshirjen e grupeve më të cënueshme dhe në një linjë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU) po nis implementimin e Strategjisë për Strehimin Social (SSS) për periudhën 2015 -2025. Qëllimi i SSS është “ti ofrojë familjeve me të ardhura të ulta dhe mesatare të cilat nuk e përballojnë dot një shtëpi në tregun e lirë, dhe veçanërisht, familjeve me indikatorë vulnerabiliteti që rezultojnë në përjashtimin nga strehimi, zgjidhje për strehimin të cilat janë të disponueshme, të prekshme, të përballueshme dhe cilësore.”

Është bërë e njohur nga të gjitha palët e interesuara se ekzistojnë hendeqe kritike përsa i përket informacionit në lidhje me popullsinë Rome/Egjiptiane. Mungesa e regjistrimit në gjendjen civile, kryesisht e popullsisë Rome, ka pasur një ndikim vendimtar në “padukshmërinë” e “problemeve kritike” të popullsisë Rome. Megjithatë, shkaqet rrënjësore gjenden më thellë, në strukturën ligjore dhe institucionale të sistemit të shërbimeve publike të Shqipërisë. Veç kësaj, Reforma Territoriale dhe Administrative e implementuar së fundmi, ka ndryshuar ndarjen territoriale të bashkive.

Për të mundësuar integrimin dhe përfshirjen e popullsisë Rome/Egjiptiane, veçanërisht për të zgjidhur problemin e strehimit, është e nevojshme të kryhet një analizë e thellë e vendbanimeve jashtë standartit të strehimit të Romëve dhe Egjiptianëve në nivel bashkie dhe të vlerësohet nevoja për investime në mënyrë që të përmirësohen kushtet e strehimit dhe të jetesës së këtyre dy komuniteteve.

Raporti “ Studim mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkinë e Durrësit me qëllim vlerësimin e nevojës për investime për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së këtyre dy komuniteteve” sjell një analizë të thellë të vendbanimeve të Romëve dhe Egjiptianëve kundrejt standarteve të strehimit ashtu si dhe programeve të strehimit social. Raporti ofron të dhëna që lejojnë identifikimin e nevojave për investime në bashki, të ndara nga programet aktuale të strehimit social dhe do të udhëheqë punën e MZHU dhe bashkëpunimin e saj me institucionet e nivelit shtetëror, qeveritë vendore, dhe organizatat e komunitetit në përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Durrës.

3 Decade of Roma Inclusion Secretariat Foundation, Civil Society Monitoring Report on the Implementation of the National Roma Integration Strategy and Decade Action Plan in 2012 in Albania, përgatitur nga një grup autorësh (Bajrami, Ivia; Cabiri, Ylli; Hasantari, Adriatik; Kazanxhiu, Latif; Koci, Renart; Mustafaj, Enver; Myrteli, Laver; Nuredin, Albana; Pegini, Hafize; Rama, Lindita; Rushiti, Selvie; Xega, Gerta; Ziu, Dritan), publikuar në Maj 2013, [http://www.issuelab.org/click/download2/civil\\_society\\_monitoring\\_report\\_on\\_the\\_implementation\\_of\\_the\\_national\\_roma\\_integration\\_strategy\\_and\\_decade\\_action\\_plan\\_in\\_2012\\_in\\_albania](http://www.issuelab.org/click/download2/civil_society_monitoring_report_on_the_implementation_of_the_national_roma_integration_strategy_and_decade_action_plan_in_2012_in_albania), fq. 20.

4 Të dhëna nga UNDP/WB/EC 2011 Socio-economic Survey quoted in the UNDP's Needs Assessment Study on Roma and Egyptian Communities in Albania, Shkurt 2012, <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/roma-needs-assessment-report/>, fq. 24.-25.

## 1. RISHIKIMI I KONTEKSTIT LIGJOR KUNDREJT TË DREJTËS PËR STREHIM TË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE

Strehimi është një drejtë njerëzore bazë që është sanksionuar në traktatet dhe konventat ndërkombëtare. Kur njerëzit kanë strehim të sigurt dhe të përballueshëm që është i përshtatshëm me kushtet e tyre të jetesës, mund të plotësohen edhe nevojat e tjera si opunësimi, arsimimi dhe mundësitë e jetesës. Disa grupe qytetarësh në Shqipëri janë në rrezik për tju mohuar kjo e drejtë bazë për shkak problemit të përballueshmërisë së strehimit. Mes tyre Romët dhe Egjiptianët janë veçanërisht te rrezikuar për shkak të përjashtimit të shumfishtë.

Komunitetet Rome konsiderohen si grupi minoritar më i cënueshëm në Shqipëri, që përballat me varfërinë e thellë, me marginalizimin dhe diskriminimin e shpeshtë, veçanërisht në lidhje me aksesin në shkollim, mbrojtjen sociale, shëndetësinë, punësimin dhe strehimin e përshtatshëm. Romët nuk njihen publikisht si një minoritet i vecantë. Ata kanë statusin e një minoriteti etno-gjuhësor. Pavarësisht që Kushtetuta e Shqipërisë adreson të gjitha principet bazë të njeriut dhe të drejtat e minoriteteve.

Shqipëria ka firmosur Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut (2.10.1996), Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (4.10.1991), Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial (11.5.1994) dhe Kartën Sociale Europiane (të rishikuar) (14.11.02). Si e tillë palet janë të detyruara të sigurojnë akses të barabartë për strehim për çdo qytetar.

### 1.1 Situata e përgjithshme e nevojave për strehim të Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë e Shkodrës

Duke qenë të detyruar të bëjnë një jetë në rrugë për vite, pa akses në strehim, shkolla, shëndetësi dhe punësim, i ka mbyllur familjet Rome në një rreth vicioz të informalitetit, duke bërë të pamundur aksesin në shërbimet sociale standarte përfshi programin e strehimit social. Krahasuar me Romët, komuniteti Egjiptian duket të jetë më i integruar në mjedisin social.

Tek Romët, varfëria dhe mungesa e strehimit të përshtatshëm janë më të përhapura. Për shembull, në një anketim rajonal të 2011 mbi situatën e strehimit të romëve në Shqipëri, 8 përqind e Romëve që morën pjesë në studim jetonin një privim të shumfishtë strehimi, krahasuar me më pak se 1 përqind nga jo-romët, ndërsa 30 përqind e Romëve të anketuar nuk kishin përmirësim në furnizim me ujë, kanalizime dhe energji krahasuar me 7 përqind të jo-romëve. Rreth 45 përqind e Romëve që morën pjesë në anketim strehoheshin në banesa që i mungonte të paktën një nga facilitetet e mëposhtëme: kuzhinë brënda, banje brënda, banjë ose dush brënda, dhe energjia. Raportohet gjithashtu se, mesatarisht, më shumë se dy njerëz banonin në një dhomë, që është përtej mesatares se OECD prej 0.8 njerëz në një dhomë<sup>3</sup>.

Sipas “Një Studimi të Vlerësimit të Nevojave për Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri”, pjesa më e madhe e familjeve Rome banojnë në shtëpi të (38.4 përqind) ose or kasolle (20.8 përqind) dhe konsistojnë në një (66.3përqind) ose më shumë se një (27.5 përqind) kurora<sup>4</sup>.

3 [www.oecdbetterlifeindex.org/topics/housing/](http://www.oecdbetterlifeindex.org/topics/housing/)

4 Vlerësim i nevojave të komunitetit Rom dhe Egjiptian në Shqipëri, CESS e mbështetur nga PNUD, 2012, fq.24

Ata e konsiderojnë veten pronarë të shtëpive të tyre (80.6 percent), me vetëm 10.8 përqind raportime për banesë me qera<sup>5</sup>. Shumë vendbanime të vona të Romëve janë kampe ku Romët jetojnë në tenda të improvizuara ose kasolle në brigjet e lumit. Madhësia e kampeve ndryshon sipas zonave.

Në Bashkinë Shkodër, në total familjet e pastreha përbejnë 5.6% te popullsisë, ndër të cilat 80% e përbëjnë Romët dhe Egjiptianët (25% Romë dhe 75% Egjiptianë). Romët raportohet se nuk kanë një vendbanim të qëndrueshëm. Ato banojnë në banesa jashtë standarteve (100%). Banesat ngjasojnë më shumë me barraka. Megjithëse pothuajse të gjitha banesat e tyre janë të pajisura me infrastrukturë dhe ndodhen afër qytetit të Shkodrës ashtu si dhe shërbimet bazë të mirqënies sociale, mungesa e higjienës dhe kushtet e jetesës i vënë ato në rrezik përjashtimi.

Ne Shqipëri, komuniteti Egjiptian është në përgjithësi më i integruar se ai Rom. Megjithatë, ato gjithashtu përballen me një sere kufizimesh ashtu si edhe Romët. Anëtarët e komunitetit Egjiptian banojnë në përgjithësi në banesa të vjetra (45.8%) ose banesa në gjëndje të mire, të riparuar, por jo të reja. Ato gjithashtu raportojnë se kanë në pronësi banesa (83.5%), dhe vetëm një përqindje e vogël (7.1%) thonë se banojnë me qera. Vetëm 10.9% e komunitetit Egjiptian raportojnë se banojnë në barraka, një përqindje kjo shumë më e vogël se e Romëve në të njëjtën situatë. 6

Megjithatë në Bashkinë Shkodër situata e komunitetit Egjiptian duket më keq se sa përshkrimi i mesipërm. Pothuajse 80% (252 familje) nga komuniteti Egjiptian zotërojnë një hapësirë banimi jashtë standarteve të jetesës. Ato të gjithë banojnë në banesa jashtë çdo standarti bazë të jetesës.

## 1.2 Politikat Publike të strehimit të miratuara në Bashkinë e Shkodrës

Straegjia e re e Strehimit Social 2015-2025 bazohet në detyrat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015-2020 (SKZHI). Një nga objektivat e SKZHI (II), është "të garantojë qasje të barabartë ndaj instrumentave ekonomikë dhe socialë për të gjithë grupet dhe individët e shoqërisë sonë".

Për sa i përket strehimit social, SKZHI identifikon disa sfida kritike në lidhje me grupet sociale më të përjashtuara:

- a. Të implementojë një politikë të integruar strehimi e cila piketon grupet me të ardhura të pakta dhe ata më vulnerabël;
- b. Të sigurojë adoptimin e standarteve minimale të strehimit;
- c. Të përmirësojë kushtet e strehimit për komunitetet Rome dhe Egjiptiane;

Strategjia e re e Strehimit Social i hap rrugën një shumëllojshmërie programesh të strehimit social të cilat mund të përshtaten duke u bazuar në një ligj të ri mbi Strehimin Social.

Ligji Nr.9232 mbi "Strehimin Social" është miratuar për herë të parë në 2004. Që atëherë, ligji është ndryshuar shumë herë, duke synuar të rrisë efektivitetin e tij, duke lehtësuar procedurat e aplikimit si dhe duke rritur aksesin e njerëzve të pastrehë në tregun e banesave. Duke ju referuar Ligjit Nr. 9232, programet e strehimit social janë "programe që shërbejnë për të strehuar familjet

dhe individët të cilët për arsye të situatës së tyre ekonomike dhe sociale nuk mund t'ia përballojnë ofertën e tregut të hapur ose kredinë" Qeveria ka krijuar tre programe të strehimit social:

- ▶ Banesat sociale me qera,
- ▶ Banesat me kosto të ulët, dhe
- ▶ Programi i pajisjes së truallit me infrastrukturë.

Veç kësaj, qeveria ka mundësuar ofrimin e subvencioneve të strehimit, kredive të subvencionuara, grantet e vogla, dhe grantet e menjëherëshme të cilat synojnë grupe specifike (shih më poshtë për përshkrimin e secilit program). Përfituesit e programeve të strehimit social duhet të përmbushin një nga kriteret e mëposhtme:

- ▶ Ata nuk duhet të kenë në pronësi një shtëpi;
- ▶ Ata duhet të kenë një vend banimi i cili është nën normat e strehimit;
- ▶ Ata duhet të jenë të pastreh për shkak të katastrofave natyrore (Ligji 9232, Neni 4).

Përzgjedhja e përfituesve bazohet në kushtet e tyre të jetesës ashtu si dhe mbi rrethanat e tyre sociale dhe ekonomike. Prioriteti është vendosur mbi pesëmbëdhjetë grupe, duke përfshirë familjet me një prind, familjet e gjera, të rriturit më të vjetër, personat e paaftë, çiftet e reja, familjet që kanë ndryshuar vendbanimin, jetimët, emigrantët e kthyer, punëtorët migrant, azil kërkuesit, oficerët e rënë në detyrë, viktimat e dhunës në familje, familjet Rome, familjet Egjiptiane, dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.

Gjithsesi, Bashkia e Shkodrës nuk ka një strategji për strehimin dhe informacioni për nevojat për strehim bazohet në aplikimet e bëra.

## 1.3 Evidenca mbi përmirësimin e kushteve të banimit dhe të jetesës, të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë e Shkodrës

Deri në vitin 2015, Bashkia Shkodër nuk kishte të planifikuar asnjë ndërhyrje për të zgjidhur problemin e strehimit si pasojë e mungesës së fondeve. Megjithëse strategjia e strehimeve sociale ende mungon, gjatë vitit 2016 Bashkia :

- ▶ Rikonstruktoi 9 banesa për komunitetin Rom dhe Egjiptian,
- ▶ Ofroi 66.000m<sup>2</sup> për strehime sociale
- ▶ Siguroi 26 apartamente për jetimët dhe femrat e pamartuara

<sup>5</sup> Njëlloj

## 2. METODOLOGJIA E KËRKIMIT

### 2.1 Shtrirja, qëllimi dhe objektivat e studimit

Studimi “Mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkinë e Shkodrës me qëllim vlerësimin e nevojës për investime për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së këtyre dy komuniteteve” synon të vlerësojë “nevojën për investime për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe të jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Shkodër” për të drejtuar punën e MZHU dhe partnerëve të saj në përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Shkodër”.

Duke qëndruar në një linjë me qëllimin e përgjithshëm, Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës ka arritur objektivat si më poshtë:

- ▶ Ofrimin e të dhënave të sakta mbi kushtet e strehimit dhe të jetesës (p.sh. kushtet e banimit, aksesit ndaj ujit, elektricitetit, dhe kanalizimeve) të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë e Shkodrës.
- ▶ Vlerësimin e investimeve që duhet të bëhen në bashkinë e Shkodrës me qëllim përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.
- ▶ Zhvillimin e Planit të Veprimit i cili do të drejtojë punën e MZHU dhe bashkëpunimit të saj me institucionet e nivelit shtetëror, qeveritë vendore, dhe organizatat komunitare në përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Shkodër.

Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës përdor informacion nga burime të ndryshme : (1) studime dhe raporte të mëparshme, (2) një anketë rastësore e fokusuar mbi familjet Rome dhe Egjiptiane në nevojë strehimi, (3) fokus grupe me palët e interesuara përkatëse dhe (4) verifikimi në terren i lagjes dhe infrastrukturës në bashkinë Shkodër.

Hartimi i këtij raporti u bazua në rishikimin e raporteve të ndryshme të përgatitura nga MZHU, PNUD dhe/ose organizata kërkimore të pavarura (shih Bibliografinë).

### 2.2. Karakteristikat e kampionit

Për shkak të qëllimit të mirëpërcaktuar të “Studimit mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës”, nuk ishte e mundur të identifikohesh një kampion. Në të kundërt, të gjitha komunitetet Rome dhe Egjiptiane të Bashkisë Shkodër u përfshinë në njësinë kërkimore. Madhësia e kampionit (sipas përcaktimit të shtjelluar mësipër) është e paraqitur më poshtë (Tabela 1):

Tabela 1: Karakteristikat e kampionit

Pyetsori	Madhësia e kampionit përbëhet nga:	
	Komuniteti Rom	Komuniteti Egjiptian
Nr.1: FGD	100 përqind	100 përqind
Nr.2:Ballë për ballë	21 përqind	21 përqind

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

### 2.3. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave

U konsiderua e nevojshme mbledhja e informacionit të detajuar mbi madhësinë dhe përbërjen e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Shkodër si dhe mbi nevojat e tyre të përgjithshme rreth strehimit.

Bisedat me Fokus Grupe u zhvilluan me dy grupe interesi, përkatësisht Departamenti i Zhvillimit Urban dhe Departamenti i Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Shkodrës. Veç kësaj, përdorimi i bisedave me fokus grupe ndihmoi në mbledhjen e informacionit në lidhje me përpjekjet e qeverisë vendore për të siguruar strehim për komunitetet që përbëjnë objektivin themelor të këtij Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës.

Megjithatë, me qëllim zbulimin në thellësi të shqetësimeve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në lidhje me strehimin, intervistat ballë për ballë me familjet ofruan të dhëna të nevojshme.

Pyetësi i parë (pyetësor me pyetje të hapura) mundësoi mbledhjen e informacionit në lidhje me:

- ▶ Përbërjen e të pastrehëve, numrin, vendndodhjen e tyre, ndarjen sipas specifikave të nevojave të tyre për strehim ashtu si dhe sipas statusit të tyre socio-ekonomik.
- ▶ Kapacitetet e qeverisë vendore për të zgjidhur çështjen e strehimit, të paktën për komunitetet Rome dhe Egjiptiane.
- ▶ Sfidat e Strehimit në nivel vendor.

Pyetësi i dytë lehtësoi analizën në thellësi të banesave në secilin prej vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane, përkatësisht:

- ▶ Tipi i banesave, madhësia e tyre dhe kushtet infrastrukturore.
- ▶ Kushtet infrastrukturore të vendbanimeve dhe aksesit ndaj shërbimeve.

Verifikimi në terren i lagjes dhe infrastrukturës shqyrtoi:

- ▶ Vlerësimin e përgjithshëm të kushteve të vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane, përkatësisht kushtet fizike, qasja ndaj infrastrukturës (rrjeti i furnizimit me ujë, sistemi i ujit të mbetjeve, rrjeti elektrik), kushtet e higjienës (janë apo jo të furnizuar me ujë dhe kanalizime nga rrjeti i qytetit), marrja e shërbimeve të tjera publike, probleme të tjera në lidhje me këtë (probleme furnizuesi dhe konsumatori).

- Vlerësimin e kostove që nevojiten për përmirësimin e situatës ekzistente ose lidhja e komuniteteve me shërbimet në nivel lagjeje si dhe në nivel lagjeje dhe shtëpie.
- Analizën e situatës së lagjeve specifike të cilat janë të prirura ndaj rreziqeve natyrore ose të tjera.
- Përpunimin e gjetjeve nëpërmjet verifikimit në terren, të cilat shërbejnë për përgatitjen dhe propozimin e 2-3 skenarëve për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe infrastrukturës.

## 2.4. Parimet e analizës

Në përputhje me kontekstin e Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, grupi i studimit mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës përcaktoi disa kriteret mbi të cilat është bazuar vlerësimi i kostos për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të infrastrukturës së vendbanimeve të komunitetit Rom dhe Egjiptian:

**Së pari**, informacioni i marrë nga administrata vendore dhe anketat e vendndodhjes, nëpërmjet pyetësorëve, u përdor për të përcaktuar një synim të qartë të projektit, si nga ana cilësore ashtu dhe ajo sasiore.

**Së dyti**, bazuar në strukturën e familjes, u krijua një dosje mbi nevojat për llojet dhe numrin e apartamenteve të nevojshme. Sipërfaqet e banimit dhe të ndërtimit u përcaktuan sipas Entit Kombëtar të Banesave dhe legjislacionit në fuqi.

Këto shërbyen si informacion kyç për të gjithë procesin e analizës financiare dhe vlerësimin të kostove për përmirësimin strukturor të banesave dhe atë infrastrukturor të zonave të banimit. Objektivi kryesor ishte hartimi i një metodologjie të qartë në mënyrë që të bëhëj i mundur vlerësimi dhe llogaritja e kostove të pritshme të proceseve të implementimit të projekteve.

E gjithë kjo procedurë, në fund, rezultoi në metodologjinë e propozimit të analizës financiare e cila iu prezantua administratës vendore dhe përfituesve, duke i ndihmuar ata të marrin vendime të realizueshme me qëllim përgatitjen e strategjive të zhvillimit dhe propozimin e zgjidhjeve të qëndrueshme.

Bazuar mbi të dhënat që rezultuan nga përpunimi i pyetësorëve, u zhvilluan dhe analizuan financiarisht skenarë të ndryshëm:

**A. Skenari i parë** – procesi i përmirësimin të kushteve ekzistuese të jetesës në strukturat rezidenciale

**B. Skenari i dytë** – përdorimi i fondit të lirë ekzistues të strukturave rezidenciale (nëpërmjet blerjes ose procesit të punësimit)

**C. Skenari i tretë** – ndërtimi i strukturave të reja dhe infrastrukturës për qëllim të strehimit social

## A. Procesi i përmirësimin të kushteve ekzistuese të jetesës në strukturat rezidenciale

Nga pikëpamja e vlerësimin të kostos, metodologjia u bazua në dy kriteret kryesore:

- Vlerësimi i situatës ekzistuese të strukturave të rezidencave, duke shqyrtuar kushtet e jetesës, kushtet e higjienës, dhomat e nevojshme ekzistuese sipas standarteve, kushtet teknike të strukturës (lidhur me sigurinë) – informacioni i marrë nga pyetësorët e anketave të vendndodhjeve.
- Vlerësimi i kostos për riparimin e këtyre elementeve dhe rehabilitimin e këtyre hapësirave, nëpërmjet procesit të rikonstruktimit, me qëllim që këto struktura të përmbushin kushtet e nevojshme të pranueshme, duke i kthyer në këtë mënyrë në zona të banueshme në përmbushje të standarteve dhe normave.

Faktori kryesor i marrë seriozisht në konsideratë ishte statusi i pronësisë i rezidencës (pyetja kryesore e pyetësorit). Ky element mund të rrisë direkt pjesën e investimit, dhe nga ana tjetër është element vendimtar në sigurimin e investimit afatgjatë dhe veçanërisht në sigurimin e qëllimit të investimit.

Metodologjia e përlogaritjes u bazua në metoda të thjeshta klasike, mbështetur në listën e çmimeve të referencës dhe një indeks i përafërt i procesit të ndërhyrjes rikonstruktive i cili u përfutua nga Studimi i eksperiencave ekzistuese të tregut dhe të eksperiencave të ngjashme.

Vlerësimi deri në çfarë mase llojet e secilës ndërhyrjeje janë të mundshme dhe të arsyeshme kundrejt aseteve dhe kushteve ekzistuese dhe eksperiencës së administratës vendore për t'u marrë me çështjet e strehimit të grupeve të synuara, ishte pritshmëria e përgjithshme e Studimit mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës.

Për më tepër, si skenar u krahasua me të tjerët me qëllim gjetjen se cili prej tyre është më i saktë për t'u përdorur dhe deri në ç'masë, në mënyrë që përdorimi i një ose më shumë skenarëve në të njëjtin qytet por në lagje të ndryshme ose në grupe ose organizma sociale të ndryshëm, të rezultojë i mundshëm.

Një tjetër aspekt pozitiv i këtij skenari është që mund të përdoret gjithashtu si një proces rigjenerimi urban dhe mund të aplikohet në disa zona të braktisura të qytetit të cilat mund të kenë potencial special për t'u integruar në strukturën dhe jetën e qytetit.

## B. Përdorimi i fondit të lirë ekzistues të strukturave rezidenciale (nëpërmjet blerjes ose qiramarrjes)

Nga pikëpamja e vlerësimin të kostos, metodologjia u bazua në dy drejtime kryesore: vlerësimi i qerasë dhe shitjeve të tregut vendas të pasurive të patundshme. Informacioni, i përfutur si nga administrata vendore ashtu dhe nga të dhënat e tregut, u plotësua me vendndodhjen e strukturave rezidenciale ekzistuese dhe gjendjen e tyre (si nga pikëpamja teknike ashtu edhe nga pikëpamja e pronësisë). Për të dyja këto, u krye një vlerësim i kushteve me qëllim sigurimin e përmbushjes së standarteve të kërkuara.

Edhe në rastet e të pastrehëve, faktorët kryesorë të konsideruar ishin sipërfaqja e përshtatshme (zona e banimit) në përputhje me strukturën e familjes, dhe kosto për metër katror (LEK/m<sup>2</sup>) e shitjes ose edhe e qerasë, ashtu si dhe vendndodhja e tyre. Bazuar në këto, disa analiza më të hollësishme u realizuan për të siguruar përpilimin e disa skenareve të ndryshme të investimit si edhe të kostos financiare të tyre.

### C. Ndërtimi i strukturave të reja dhe infrastrukturës për qëllim të strehimit social

Vlerësimi i kostos totale për këtë skenar u bazua në tre kosto të ndërlidhura:

- ▶ Kosto e truallit (vendndodhja e ngastrës)
- ▶ Kosto e ndërtimit të strukturës
- ▶ Kosto e infrastrukturës

Nga pikëpamja teknike ky skenar paraqet një vlerësim kostoje të thjeshtë i cili bazohet në tre faktorë të mirënjohur, nga pikëpamja ekonomike dhe financiare. Ajo çka nevojitet është një ide reale projekti dhe një vendndodhje për ngastrën e zgjedhur në mënyrë që të përlllogaritët saktësisht kosto e këtyre lloj ndërhyrjesh duke marrë në konsideratë të tre elementët.

Lidhur me përlllogaritjen e kostos, metodologjia duhet të shqyrtojë përlllogaritjen e çdo faktori në mënyrë të pavarur dhe bashkarisht, ku rastet e ndryshme për gjetjen e vendndodhjes së ngastrës duhet të përfaqësohen nga administrata vendore, ashtu si dhe format e investimeve.

Zgjedhja e truallit është vendimtare në përlllogaritjen e kostos totale. Në këtë aspekt, kosto e truallit, është një variabël shumë i rëndësishëm, i cili është i lidhur direkt me statusin e pronësisë, me qëllim që pronat shtetërore të truallit të mund të çojnë në kosto investimi më të ulta, - përveç efekteve anësore të tjera pozitive me të cilat veprime të tilla shoqërohen gjithmonë, siç është interesi direkt i qeverisë vendore, i cili në shumë raste është vendimtar për suksesin e projektit. Në këtë rast kosto e truallit konsiderohet si një variabël i rëndësishëm, veçanërisht në lidhje me statusin e pronësisë, me qëllim gjetjen e truallit në pronësi publike.

Një tjetër aspekt i analizuar është kosto e pronës në lidhje me koston e lidhjes me infrastrukturën publike. Në këtë mënyrë mund të rezultojnë skenarë më të qëndrueshëm të procesit të zgjedhjes së truallit, jo vetëm në lidhje me disponueshmërinë e autoriteteve vendore për të ofruar truallin, por gjithashtu ekonomikisht, për shkak të përmirësimit të këtyre vendndodhjeve në zona urbane me kushte më të mira rezidenciale dhe sociale.

Kosto e ndërtimit u përlllogarit bazuar në indekset dhe çmimet e referencës së Entit Kombëtar të Banesave sipas ligjeve. Bazuar në numrin e nevojave dhe strukturave të familjeve, propozohet një skenar mbi zonën e nevojshme të jetesës, e cila bashkë me ambjentet komunitare dhe të shërbimit, rezultojë në zonën finale të ndërtimit. Kjo shërben si informacion bazë për vlerësimin e kostos së ndërtimit të shtëpive sociale.

Rezultati i pritshëm është një shumë totale e përafërt e investimit të nevojshëm. Kosto e infrastrukturës duhet të shqyrtojë urbanizimin ose shkallën e urbanizimit të truallit. Kjo lidhet drejt për drejt me pozicionimin e zonës së propozuar në qytet, veçanërisht kundrejt shërbimeve publike dhe infrastrukturës, dhe mundësitë e aksesit dhe lidhjes me rrugët dhe sistemet e furnizimit dhe shkarkimit.

Të gjitha këto përdoren si variabla për të paraqitur një formulë të thjeshtë e cila do të ndihmojë autoritetet vendore të përlllogarisin dhe krijojnë një vizion më të mirë mbi koston totale të një procesi të tillë. Për më tepër, kjo do të ndihmojë për të pasur më shumë se një zgjidhje, dhe në këtë mënyrë do të ndihmojë në gjenerimin e fondeve dhe investimeve nga drejtime të ndryshme, element i cili është vendimtar në suksesin e procesit.

Rezultatet e secilit skenar do të analizohen në lidhje me kushtet lokale të çdo bashkie, ashtu si dhe sipas mundësive reale për investime të secilës qeveri vendore, bazuar në fondet e tyre ose mundësi të tjera. Për këtë, procesi i analizës bazohet mbi rezultatet që vijnë nga pyetësorët:

ato të dhëna të cilat kanë lidhje me të ardhurat e familjeve dhe ato të cilat kanë të bëjnë me investimin e kapaciteteve të bashkive mbi banesat sociale dhe projekte të tjera përkatëse.

Bazuar në këto, Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës vlerëson kostot si edhe burimet financiare të mundshme për të përballuar investimin. Qasjet e ndryshme të propozuara mund të çojnë në prodhimin e më shumë projekteve me qëllim të mirëpërcaktuar dhe duke synuar projekte më të kontrollueshme, të cilat çojnë në implementimin e suksesshëm.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se bazuar në kushtet financiare lokale dhe numrin e familjeve në nevojë, si dhe mbi stokun e banesave, kriteret e nënvizuara më lart janë të rëndësishme dhe duhet të merren seriozisht në konsideratë, sepse, siç u shpjegua, rezultatet e tyre varen shumë nga variablat lokale.

Si mekanizëm i fundit, metodologjia e përlllogaritjes së kostos synon të krijojë një formë llogaritjeje për secilin rast në mënyrë që të ndihmojë autoritetet vendore në procesin e vendimarrjes.

Bazuar në kostot tashmë të përlllogaritura, kjo metodologji gjithashtu adresoi:

- ▶ Efektin e kategorizimit mbi vlerësimin financiar të projekteve;
- ▶ Koston e huave për përfituesit;
- ▶ Analiza kosto-përfitim, kosto e projektit, norma e interesit, norma e brendshme e kthimit dhe koha e pagesës, metodat e vlerësimit, etj.
- ▶ Burimet e kapitalit të mbledhur si dhe forma të tjera që rezultojnë në kapital.

Si e tillë, kjo metodologji, së pari paraqet më shumë se një mundësi reale dhe financiare për zgjidhje të qëndrueshme, dhe së dyti, hap mundësinë e përlllogaritjes dhe vlerësimit midis opsioneve të ndryshme e cila do të bazohet direkt mbi kapitalin dhe kushtet financiare të kapaciteteve lokale. Në këtë mënyrë shtron bazat për aplikimin e projekteve dhe zgjidhjeve origjinale, duke fuqizuar edhe mundësitë e bashkëpunimit publik dhe privat, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme afatgjata.

## ANALIZA PËRSHKRUESE DHE E DETAJUAR E KUSHTEVE TË STREHIMIT DHE JETESËS SË KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIANE (GJETJET E STUDIMIT)

Kapitulli 3 adreson kërkesën për strehim të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane sipas tre kriterëve të vlerësimit, respektivisht:

**Kriteri 1:** Situata e strehimit të familjeve

**Kriteri 2:** Kushtet socio-ekonomike të familjeve


**Kriteri 3:** Kushtet infrastrukturore të vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane

Të dhënat e mbledhura nga Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Durrësit janë përpunuar dhe analizuar në bazë të secilit kriter të theksuar më sipër. Në mënyrë të ngjashme, gjetjet kërkimore respektive janë identifikuar dhe formuluar sipas vlerësimit të kriterëve.

### 3.1. Situata e strehimit e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane

Familjet e pastreha në Shkodër përbëjnë pothuajse 6 për qind të popullsisë, ndërsa Romët dhe Egjiptianët së bashku përbëjnë 0.8 për qind të të gjithë familjeve të pastreha. (Figura 1)

**Figura 1: Familjet e pastreha Rome dhe Egjiptiane kundrejtë popullsisë totale**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

Siç shihet në tabelën 2 dhe në figurën 2, numri i familjeve të pastreha Egjiptiane është pothuajse tre herë më i lartë se numri i familjeve Rome.

**Tabela 2: Gjendja e familjeve të pastreha në Bashkinë Shkodër, 2016**

	Total	Roma	%	Egjiptian	%
<b>Familje në nevojë, për shkak të:</b>	<b>1,598</b>	<b>400</b>	<b>100</b>	<b>1,198</b>	<b>100</b>
Nuk zotërojnë një hapësirë strehimi	400	400	29	0	0
Zotërojnë një hapësirë strehimi jashtë standarteve në fuqi	1,198	0	0	1,198	71


**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

Pavarësisht ndryshimeve të vogla për sa i përket numrit, Romët dhe Egjiptianët jetojnë në situata strehimi të mjerushme. (Shiko fotot mëposhtme)



**Fotot nga vendbanimet Rome**

**Figura 2: Familjet në nevojë strehimi, 2016**




**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

Duke krahasuar nevojat për strehim të të dy komuniteteve të përjashtuar, është konstatuar se të gjitha familjet nga komuniteti Egjiptian zotërojnë banesa jashtë standarteve në fuqi, ndërkohë që të gjithë familjet Rome nuk zotërojnë një banesë të vetën. (Figura 3)




**Figura 3: Situata e Strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Shkodër, 2016**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

Komuniteti Rom është i vendosur në katër zona, ndërsa komuniteti Egjiptian është përqëndruar në dy vendbanime sipas informacionit të paraqitur në Figurën 4:

**Figura 4: Vendbanimet Rome dhe Egjiptiane sipas llojit të problemeve të strehimit, 2016**



**Burim:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

Harta (Shtojcë) paraqet vendndodhjen e vendbanimeve.

Tabela 3 dhe 4 sigurojnë informacion në lidhje me familjet e intervistuar nga të dyja komunitetet dhe vendbanimet e tyre.

Pothuajse 22 për qind e familjeve në nevojë nga komuniteti Rom, janë vendosur në një lagje të quajtur Prokuroria. Ashtu siç edhe mund të shikohet lehtësisht në Figurën 4, asnjë prej tyre nuk ka në pronësi një banesë. 17 për qind e familjeve në nevojë nga komuniteti Rom, janë të vendosur në një lagje të quajtur Dubai. Përsëri, pjesa më e madhe e familjeve përballen me çështjen e standarteve të jetesës. 17 për qind e familjeve në nevojë nga komuniteti Rom janë të vendosur në një lagje të quajtur Tophanë. 44 për qind e familjeve në nevojë nga komuniteti Rom janë të vendosur në një lagje të quajtur Matanë Ure.

75 për qind e familjeve në nevojë nga komuniteti Egjiptian janë të vendosur në një lagje të quajtur 'Te Kalaja', ndërkohë që pjesa e mbetur, 25 për qind janë të vendosur në lagjen e quajtur 'Matanë Urës' bashkë me disa familje Rome.



**Fotot nga vendbanimet Rome**

Vlerësimi i hollësishëm i kushteve të banimit të vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Shkodër është bazuar në informacionet e marra nga pyetësori 2 (pjesa 5A, 5B, 5C dhe 5D) ashtu si edhe nga vizitat në terren në secilin komunitet. Në mënyrë që të identifikoheshin nevojat e strehimit për çdo komunitet, intervistat e bera në mënyrë të drejtpërdrejtë, janë bërë me 21 për qind të familjeve, siç është treguar dhe në tabelën 4, sipas informacionit të marrë në terren.

**Tabela 3: Numri i intervistave të drejtpërdrejta në Bashkinë Shkodër**

	Banorë	Familje
Popullsia Rome dhe Egjiptiane	1.598	421
Popullsia e intervistuar Rome dhe Egjiptiane	329	87
Në Përqindje	21	21

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

**Tabela 4: Intervistat në çdo vendbanim Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Shkodër, 2016**

Vendbanime	Familje Rome të intervistuar	Familje Egjiptiane të intervistuar
1. Te Prokuroria	10 familje	Asnjë familje Egjiptiane
2. Te Dubai	8 familje	Asnjë familje Egjiptiane
3. Tophanë	8 familje	Asnjë familje Egjiptiane
4. Matanë Ure	19 familje	Asnjë familje Egjiptiane
5. Te kalaja	Asnjë familje Rome	42 familje
<b>Total</b>	<b>45 familje</b>	<b>42 familje</b>

**Burim:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

Vlerësimi i nevojave për strehim tregon se komunitetet Rome dhe Egjiptiane ndajnë shqetësime të përbashkëta: atyre i mungojnë kushtet e përshtatshme të strehimit sipas çdo standarti të ligjit. (Tabela 5).


**Tabela 5: Familjet Rome dhe Egjiptiane sipas llojeve të banesave të tyre**

Lloji i kushteve të strehimit	Nr	Në %
Jetojnë në tenda, barraka, magazina	27	36,5
Jetojnë në garsoniera	36	48,6
Jetojnë në apartamente 1+1	4	5,4
Jetojnë në apartamente 2+1	6	8,1
Jetojnë në apartamente 3+1 ose më shumë	1	1,4
<b>Total</b>	<b>74</b>	<b>100</b>

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

Siç shikohet nga Tabela 5 dhe nga Figura 5, pothuajse 37 për qind e familjeve banojnë në tenda apo barraka, 49 për qind banojnë në garsoniera dhe pjesa e mbetur, 14 për qind banojnë në apartamente 1+1 deri 3+1. Megjithatë, vetëm 2 nga 77 familjet e intervistuar (2.6 për qind në total) zotërojnë një hapësirë banimi në përputhje me ligjet Shqiptare. Siç u vu re edhe gjatë vizitave në terren, pothuajse të gjitha 'banesat' kishin probleme në lidhje me anën strukturore dhe higjienike.

**Figura 5: Situata ekzistuese e strehimit e komuniteteve R/E**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

Për sa i përket furnizimit me ujë, elektricitet dhe kanalizimet e ujërave të ndotura (tabela 6), asnjë nga familjet nuk ishin të lidhura me rrjetin e kanalizimit të shkarkimit të ujërave të ndotura, ato shkarkonin mbetjet në gropa septike ose kanale drenazhimi, ose edhe direkt në lum. Vetëm 43 për qind të tyre janë të lidhur me rrjetin e ujësjellesit dhe vetëm 66 për qind me rrjetin e energjisë elektrike.


**Tabela 6: Lidhja me rrjetin e ujësjellesit, kanalizimit të ujërave të ndotur dhe rrjetin e energjisë elektrike të komuniteteve Rome dhe Egjiptian në Bashkinë Shkodër**

Përqindja e familjeve të cilat janë të lidhura me rrjetet inxhinierike	Vizita në terren
Rrjeti i kanalizimit të ujësjellesit	43%
Rrjeti i kanalizimit të ujërave të ndotur	0%
Rrjeti i energjisë elektrike	66%

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

Për sa i përket vendbanimeve të komunitetit Egjiptian studimi tregon se 36 për qind e tyre banojnë në tenda apo barrake, 36 për qind banojnë në garsoniera dhe pjesa e mbetur, 28 për qind banojnë në apartamente 1+1 dhe apartamente 2+1 (figura 7). Kushtet e infrastrukturës në Shkodër janë optimale në vendbanimet Egjiptiane, megjithëse të gjithë përballen me kushte kritike të konstruksioneve të banesave të tyre.

**Figura 7: Situata ekzistuese e strehimit të komunitetit Egjiptian**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

Në lidhje me infrastrukturën inxhinierike dhe kushtet higjienike 95 për qind e familjeve nuk i përmbushin standartet në fuqi.

Si konkluzion, skuadra e vlerësimit konstaton se nevojat e familjeve Rome dhe Egjiptiane, banesat e të cilëve janë jashtë standarteve në fuqi, në veçanti emergjente në pesë vendbanimet, për shkak të mungesës së çdo nevojë bazë, qoftë të infrastrukturës, higjienës.

### 3.2. Situata Ekonomike dhe Sociale e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane

Në mënyrë që nevojat për Strehim Social të prioritarizohen, situata e komuniteteve Rome dhe Egjiptiana analizohet në bazë të një kombinimi treguesish të situatës socio ekonomike dhe kategorizimit të strehimit.

Për sa i përket situatës socio-ekonomike, përdoret klasifikimi i të ardhurave nga INSTAT. Sipas INSTAT, ka tre kategori bazë të ardhurash të cilat përdoren në vlerësimin e varfërisë, përkatësisht "Familje pa të ardhura", "Familje të ardhurat e të cilës janë më pak se 20,000 LEK në muaj" dhe "Familje të ardhurat e të cilës janë më pak se 30,000 LEK në muaj". Grupi i kërkimit i shtoi secilës kategori nga tre nën kategori, në mënyrë që të pasqyroste më saktë profilin e përjashtimit socio-ekonomik në Bashkinë Shkodër.

Për sa i përket situatës së strehimit, përkufizimi "I pa strehë" përdoret sipas përcaktimit të Ligjit Nr. 9232, datë 13.05.2004 "Mbi Programet Sociale të Strehimit në Zonën Urbane" duke përfshirë dhe rishikimet dhe ndryshimet e këtij ligji.

Siç mund të kuptohet nga informacioni i dhënë në Tabelën 7, ndërsa ka vetëm shumë pak familje (10,2 përqind) të ardhurat e të cilëve janë me pak se 30.000 All në muaj, pjesa më e madhe janë krejtësisht pat ë ardhura (shiko gjithashtu edhe tabelën 13).


**Tabela 7: Treguesit përberes social-ekonomik dhe situata e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.**

Kategorizimi i Banesave	Nuk kanë në pronësi një banesë	Kanë në pronësi një banesë jashtë standarteve
<b>Kategorizimi socio-ekonomik</b>	<b>Rom</b>	<b>Egjiptian</b>
Familje pa të ardhura	111	127
Familje pa të ardhura me person të semurë	27	37
Familje pa të ardhura me mbajtës grua	33	56
Familje pa të ardhura+femijë	180	567
Të ardhura <20.000Lek/muaj	12	118
Të ardhura <20.000Lek/muaj+persona të semurë	0	12
Të ardhura <20.000Lekt/muaj+ femijë	37	209
Të ardhura <30.000 Lek/muaj, me mbajtës grua	0	72
<b>Total</b>	<b>400</b>	<b>1.198</b>

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

Figura 8 paraqet nevojat për strehim për të dy komunitetet (Rome dhe Egjiptiane) sipas nivelit të të ardhurave.

**Figura 8: Romët dhe Egjiptianët sipas të ardhurave, 2016**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

Siç tregohet dhe në figurën 8, pjesa më e madhe e familjeve nga komuniteti Rom dhe Egjiptian (95 per qind) banojnë në varfëri të thellë për shkak të mungesës së të ardhurave, ndërkohë që banesat e tyre janë jashtë standarteve në fuqi.

### 3.3. Territori dhe infrastruktura e vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane

Për sa i përket territorit dhe infrastrukturës së vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane, pothuajse të gjitha familjet banojnë në banesa, struktura e të cilave është e shkatërruar, ndërkohë që ndërhyrjet përmirësuese në to janë të pamundura. Më tepër ato banojnë në barrake apo tenda dhe janë të pambrojtura nga temperaturat apo agjentët e tjerë atmosferike. Banesat më shume kanë mungesë të elementeve bazë të tyre si çati, dyer, dritare. Përveç kësaj, sipërfaqja e banesave është më e vogël se ajo që parashikohet nga ligjet përkatëse.

Për sa i përket 'vendndodhjes së vendbanimeve', distanca nga qendrat e ndihmave sociale është shumë larg standarteve. Vendbanimet janë larg qendrave mjekësore, shkollave dhe kopshteve. Siguria është një tjetër çështje kritike. Vendbanimet janë të vendosura pranë lumit, i cili është në rrezik të vazhdueshëm përmytje. Fëmijet në moshë për të ndjekur një shkollim janë në rrezik për shkak të vendndodhjes jo të sigurtë të vendbanimeve.

Vizitat në terren treguan se pavarisht se zonat janë të pajisura me të gjitha infrastrukturën inxhinierike, pjesa më e madhe e familjeve nuk kanë akses në to.

Duke marrë parasysh përbërjen familjare si dhe kushtet ekzistuese të banesave të popullsisë Rome në Bashkinë Shkodër, grupi i vlerësimit prodhoi tabelën 8, e cila siguron informacion në lidhje me kërkesat për banesa në Bashkinë Shkodër. Në ndërtimin e tabelës 8, standartet e banesave ekzistuese sipas legjislacionit në fuqi janë gjithashtu të marra në konsideratë. Në ndërtimin e tabelës 8, informacioni nga intervistat ballë për ballë është përdorur për të vlerësuar kërkesat në total.

Siç tregojnë dhe të dhënat nga pyetësi 2, banesat ekzistuese janë jashtë standarteve në fuqi dhe për këtë arsye të gjitha familjet kanë nevojë për një banesë sipas standarteve.


**Tabela 8: Kërkesat për banesa për komunitetin Rom në Bashkinë Shkodër**

Tipi i banesës	Nevojat sipas studimit (anekset)	Vlerësimi i nevojave
Nr. I familjeve që kanë nevojë për garsonierë	11	26
Zona totale e nevojshme për garsoniera (total m <sup>2</sup> )	305,6	712,0
% e garsonierave	12%	12%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 1+1	7	16
Zona totale e nevojshme për apartamente 1+1 (total m <sup>2</sup> )	318,7	742,6
% e 1+1	12%	12%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 2+1	9	21
Zona totale e nevojshme për apartamente 2+1 (total m <sup>2</sup> )	506,2	1179,4
% e 2+1	19%	19%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 deri në 75,5 m <sup>2</sup>	7	16
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1 (total m <sup>2</sup> )	528,5	1231,4
% e 3+1	20%	20%
Nr. I familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 më shumë se 75,5 m <sup>2</sup>	11	26
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1+ (total m <sup>2</sup> )	987,5	2300,9
% e 3+1+	37%	37%
<b>Numri Total i Familjeve</b>	<b>45</b>	<b>105</b>
<b>Zona totale e nevojshme për strehim m<sup>2</sup></b>	<b>2.646,5</b>	<b>6.166,3</b>

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

Siç tregon edhe tabela 8, në mënyrë që të strehohet i gjithë komuniteti Rom, nevojiten 105 apartamente (100 për qind e numrit total të familjeve), me 6.116,3 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi të nevojshme për të strehuar përkatesisht 26 familje me garsoniera (12% e sipërfaqes totale të ndërtimit) në 712.0m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi; 16 familje me apartamente 1+1 (12% e sipërfaqes totale të ndërtimit) në 742.6m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi ; 21 familje me apartamente 2+1 (19% e sipërfaqes totale të ndërtimit) me 1179.4m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi ; 16 familje me apartamente 3+1 ( 20% e sipërfaqes totale të ndërtimit) me 1231.4m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi dhe 26 familje me apartamente 3+1 më shumë se 75.5m<sup>2</sup> (37% e sipërfaqës totale të ndërtimit) me 2300.9m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi.

**Figura 9: Nevojat për strehim për komunitetin Rom**



Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016


Tabela 9 paraqet të njëjtin informacion si tabela 8, por për komunitetin Egjiptian. Siç mund të shikojmë, 68 familje ( 11% e sipërfaqes totale të ndërtimit) kërkojnë garsoniera të cilat mund të sigurohen në 1818 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi. 53 familje (13% e sipërfaqes së ndërtuar) kanë nevojë për apartamente 1+1, të cilat mund të sigurohen në 2366.3 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi. 128 familje (42% e sipërfaqes totale të ndërtimit) kanë nevojë për apartamente 2+1, të cilat mund të sigurohen në 7271m<sup>2</sup> sipërfaqe të ndërtuar. 45 familje (21% e sipërfaqes totale të ndërtimit) kanë nevojë për apartamente 3+1, te cilat mund të sigurohen në 3356.2 m<sup>2</sup> sipërfaqe të ndërtuar. 23 familje (13% e sipërfaqes totale të ndërtuar) kanë nevojë për apartamente 3+1 me më shumë se 75 m<sup>2</sup> për apartament, të cilat mund të sigurohen në 2306.3m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi. Në total, komuniteti Egjiptian në Shkodër ka nevojë për 315 apartamente të cilat sigurohen në 16.788,8 m<sup>2</sup> sipërfaqe totale ndërtimi.

**Tabela 9: Kërkesat për banesa nga komuniteti Egjiptian në Bashkinë Shkodër**

Llojet e Banesave	Nevojat sipas studimit (anekset)	Vlerësimi i nevojave
Nr. i familjeve që kanë nevojë për garsonierë	9	54
Zona totale e nevojshme për garsoniera (total m <sup>2</sup> )	242,4	1454,4
% e garsonierave	11%	11%
Nr. i familjeve që kanë nevojë për apartamente 1+1	7	42
Zona totale e nevojshme për apartamente 1+1 (total m <sup>2</sup> )	269,8	1893,0
% e 1+1	14%	14%
Nr. i familjeve që kanë nevojë për apartamente 2+1	19	102
Zona totale e nevojshme për apartamente 2+1 (total m <sup>2</sup> )	904,8	5769,6
% e 2+1	43%	43%
Nr. i familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 deri në 75,5 m <sup>2</sup>	6	36
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1 (total m <sup>2</sup> )	447,5	2685,0
% e 3+1	20%	20%
Nr. i familjeve që kanë nevojë për apartamente 3+1 më shumë se 75,5 m <sup>2</sup>	3	18
Zona totale e nevojshme për apartamente 3+1+ (total m <sup>2</sup> )	271,5	1629,0
% e 4+	12%	12%
<b>Numri total i familjeve</b>	<b>42</b>	<b>252</b>
<b>Zona totale e nevojshme për strehim</b>	<b>2.238,5</b>	<b>13.431,0</b>

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

**Figura 10: Nevojat për strehim të komunitetit Egjiptian**



**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

### 3.4 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 3

Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Shkodër vuajnë nga shumë probleme sociale dhe ekonomike përjashtuese, të manifestuara me ane të një varferie ekstreme në të cilën ato jetojnë. Atyre i është mohuar e drejta themelore e strehimit.

- Familjet Rome nuk kanë në pronësi një banesë. Megjithëse Egjiptianët kanë në pronësi një banesë, ato janë jashtë standarteve në fuqi. Më tej, të gjitha familjet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Shkodër, përkatesisht 100 për qind kanë nevojë për banesa për shkak të mungesës së kushteve të jetesës.
- Megjithatë pothuajse të gjithë vendbanimet e tyre janë të pajisur me infrastrukturë dhe janë afër qytetit të Shkodrës ashtu si edhe shërbimet kryesore sociale, mungesa e higjienës dhe e kushteve të jetesës, i vendosin ato në një rrezik të lartë.
- Kushtet e strehimit të komunitetit Rom në Shkodër janë shumë të këqija : vetëm 4 për qind banojnë në shtëpi brënda standarteve. Pothuajse asnjë familje nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimit të shkarkimit të ujerave të ndotura. Megjithëse, të gjitha banesat janë të lidhura me rrjetin elektrik dhe rrjetin e kanalizimit të ujësjesit, pothuajse asnjë familje nuk ka as elektricitet dhe as ujë të pijshëm dhe tualete të brendshme apo të jashtme.
- Eshte parë e nevojshme të përmendet që ka një nevojë urgjente për 105 familje Rome dhe 315 familje Egjiptiane, të cilat mund të akomodohen në 22.955,2m<sup>2</sup> sipërfaqe të ndertuar.
- Fatkeqesisht, komunitetet Rome dhe Egjiptiane nuk mundën dot ta zgjidhin problemin e tyre të strehimit për shkak të mungesës së të ardhurave. Pothuajse të gjithë (89.9 për qind) janë pë të ardhura.
- Më tej, strehimi social mbetet politika e vetme efektive për të zgjidhur problemin e nevojës për strehim për komunitetet Rome dhe Egjiptiane.

## 4.

## ALTERNATIVA TË POLITIKAVE PUBLIKE

### 4.1. Planet dhe ndërhyrjet e qeverisë lokale

Ligji Nr.9232 për 'Strehimet Sociale', është përshtatur për herë të parë në vitin 2004. Që atëherë, ligji është ndryshuar disa herë duke patur si synim rritjen e efikasitetit të tij duke thjeshtësuar procedurat e aplikimit ashtu si edhe rritjen e aksesit të pastreheve në tregun e banesave.

Bashkia Shkodër nuk e ka zhvilluar çështjen e strehimit. Përveç kësaj, Bashkia Shkodër nuk ka patur kurrë buxhet për strehimet sociale.

As donatorët, as sektori privat nuk kanë qenë të interesuar të bashkëpunojnë me Bashkinë Shkodër lidhur me çështjen e strehimit.

**Tabela 10: Buxheti i Bashkisë Shkodër i caktuar për strehimet sociale, 2016**

Buxheti/Vitet	2016	2010/2015	2016/2020
Total në 000/All	1.655.453	2015: 801.718 2014: 784.427 2013: 731.700 2012: 746.599 2011: 875.514 2010: 797.873	0
Të ardhurat lokale ne 000/TOT	0	0	0
Të ardhurat lokale të përcaktuara për strehimet sociale në 000/TOT	0	0	0
Të ardhurat vendore për strehimin social në 000/Lek	3.836 (9 shtëpi) 28.236 (apartamente Sociale dhe ish konvikte)	0	Aplikimi në MZHU për të mbështetur financiarisht ndërtimin e banesave sociale në 66.000 m <sup>2</sup> në pronësi të Bashkisë
Transfertat e pakufizuara në 000/TOT			
Kontributi i bashkisë	Projekti i dizajnit dhe paisja e konvikteve		
Rritja e fondeve (burime te tjera, donacione, fonde te jashtme) në Euro	0	0	0

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016 dhe <http://open.data.al/en/lajme/lajm/id/1647/titull/Unconditional-and-specific-transfers-by-municipalities-2016>

## 4.2 Sugjerimet e Politikave Publike për të zgjidhur problemin e strehimit në Bashki

Duke ju referuar Ligjit Nr. 9232, programet e strehimit social janë “programe të cilat shërbejnë për të strehuar familjet dhe individët të cilët për shkak të situatës së tyre ekonomike dhe sociale nuk mund të përballojnë ofertën e tregut të lire ose kredinë”.

Qeveria ka krijuar tre programe të strehimit social: **banesa sociale me qera, banesat me kosto të ulët, dhe programin e pajisjes së truallit me infrastrukturë**. Për më tepër, qeveria ka krijuar ofrimin e subvencioneve të strehimit, subvencionimit të kredive, grantet e vogla, dhe grantet e menjëhershme të cilat synojnë grupe specifike (shih më poshtë për një përshkrim të secilit program). Përfituesit e programeve të strehimit social duhet të përmbushin një nga kriteret në vazhdim: ata nuk duhet të kenë një banesë në pronësi, duhet të kenë një banesë e cila është nën normat e banimit; ose duhet të jenë të pastrehë për shkak të katastrofave natyrore (Ligji 9232, Neni 4).

Zgjedhja e përfituesve bazohet në kushtet e tyre të jetesës si dhe rrethanave të tyre sociale dhe ekonomike. Prioriteti është vendosur mbi 15 grupe, duke përfshirë familjet me një prind kryefamiljar, familjet e gjera, të rriturit më të vjetër, personat e paaftë, çiftet e reja, familjet që kanë ndryshuar vendbanim, jetimët, emigrantët që kthehen, punonjësit e migruar nga qyteti në qytet, azilkërkuesit, oficerët e rënë në detyrë, viktimat e dhunës familjare, familjet Rome, familjet Egjiptiane, dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.

Për t'u përzgjedhur në sistemin e pikëzimit, familja duhet të përmbushë dy kushte: Të ardhurat mujore nuk duhet të jenë më të larta se 100% e mesatares së zonës për strehim social dhe 120% për strehimin me kosto të ulët; Familjet nuk duhet të kenë në pronësi një banesë, ose të jetojnë në një shtëpi, përmasat e të cilës nuk janë më të mëdha se standartet minimale të vendosura nga ligji.

Për të identifikuar programet më të përshtatshme të strehimit social për për komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Shkodër është formuar tabela 11 dhe 12. Nga analiza e thellë e informacionit të dhënë në tabelën 10, gjasat e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane për të patur akses ndaj programeve të Strehimit Social duken të ulta.

**Tabela 11: Ndarja e të pastrehëve sipas të ardhurave**

Familjet e pastreha	Pa të ardhura	Të ardhura të pamjaftueshme	Totali
Nuk kanë në pronësi një banesë	351	49	400
Kanë në pronësi një banesë jashtë standarteve në fuqi	787	411	1.198
<b>Totali</b>	<b>1.138</b>	<b>460</b>	<b>1.598</b>
<b>Në përqindje</b>	<b>71</b>	<b>29</b>	<b>100</b>

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

Tabela 12 përmban një përmbledhje të kombinuar të informacionit për sa i përket programeve publike dhe situates së nevojës së banesave në Shkodër, në mënyrë që të identifikohen dhe të zgjidhet politika me të përshtatshme.

**Tabela 12: Vlerësimi i programeve të Strehimit Social kundrejt kushteve të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane**

Programet e Strehimit Social	Kriteret e përgjithshme	Familjet në nevojë strehimi		
		Nuk kanë në pronësi një hapësirë banimi	Kanë në pronësi hapësirë banimi nën standartin e banimit	Jetojnë në banesa nën standartin e banimit
	1. Nuk duhet të kenë në pronësi një banesë. 2. Duhet të banojnë në banesa që janë jashtë standarteve në fuqi ; 3. Duhet të jene të pastrehë si pasojë e katastrofave natyrore	400 familje ndër të cilat 351 familje janë pa të ardhura dhe 49 familje pa të ardhura të mjaftueshme, më pak se 30.000 Lek Tot. për muaj.	1.198 familje ndër të cilat 787 familje pa të ardhura dhe 411 familje me të ardhura të pamjaftueshme me 30.000 Lek Tot. në muaj.	
BSQ Banesat Sociale me Qera	Njesitë e banimit të ndërtuara nga qeverite lokale, të cilat janë dhënë me qera te ulët sipas kategorive sociale.	Për familje pa te ardhura, mund te aplikohet, nëse kushtet e qerasë modifikohen. Për familje me të ardhura të pamjaftueshme, mund të jetë një zgjidhje. Nr. i Përfutesve optimal: 49 deri në 400	Për familje pa të ardhura mund të aplikohet nëse kushtet e qerasë modifikohen Për familje me të ardhura të pamjaftueshme, mund të jete një zgjidhje. Nr. i Përfutesve optimal: 411 deri në 1.198	
BS Banesa me subvencione	Qeveritë lokale mund të caktojnë subvencionet për përfutesit e banesave me qera sociale BS<=50% të vlerës së qerasë. (Vlera e qerasë-BS <=30% të të ardhurave të familjes.	Mund të aplikojnë nëse kushtet e qerasë modifikohen.	Mund të aplikojnë nëse kushtet e qerasë modifikohen.	
BKT Banesa me kosto të ulët	Banesat me kosto të ulët janë ndërtuar ose blerë me çdo fond, për familje të ardhurat e të cilëve janë <=120% të mesatares së të ardhurave të rrethit.	Perjashtohen për shkak të kriterit të të ardhurave.		
PI Paisja e truallit me infrastrukturë	Investimi ne infrastrukturën e truallit me pronësi shtetërore nga qeveritë lokale në mënyrë që të përdoren për qëllime sociale ose për qëllime përfitimi. Duhet të jenë truaj bosh	Mund të aplikojne nëse: Ka nje truall bosh; Kosto e lejon; Percaktohet 'Qellimi Social'	Mund të aplikojne nëse: Kosto e lejon Përcaktohet 'Qellimi Social' Territori ekzistues është i zënë Infrastruktura dhe kushtet inxhinerike e territorit e lejojnë	

Programet e Strehimit Social		Familjet në nevojë strehimi		
		1.198 familje ndër të cilat 787 familje pa të ardhura dhe 411 familje me të ardhura të pamjaftueshme me 30.000Lek Tot në muaj.	Kanë në pronësi hapësirë banimi nën standartin e banimit	Jetojnë në banesa nën standartin e banimit
SQ Subvencionimi i qerasë	Nese qeraja e banesave sociale është <=25% e të ardhurave të familjes, familja përfiton subvencionimin e qerasë. SQ=Qeraja aktuale e përballueshme	Përfshihet për shkak të kriterit të të ardhurave.	Përfshihet për shkak të kriterit të të ardhurave.	
SH Subvencionimi i huave	Përfituesit e banesave me kosto të ulët kanë të drejtën të hipotekojnë me afate të favorshme nga një institucion financiar i cili ka një kontratë me MoF.	Përfshihet për shkak të kriterit të të ardhurave.	Përfshihet për shkak të kriterit të të ardhurave.	
Grantet e vogla, dhe grantet e menjëherëshme të cilat kanë si synim grupet specifike (shiko poshtë për një përshkrim të programit)	Përfituesit e banesave me kosto të ulët iu japin grantet e menjëherëshme në rrethana të veçanta.	Nuk aplikojnë	Nuk aplikojnë	

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

Ndërkohë që modifikimi i kushteve të qerasë ashtu si edhe 'qëllimit social' kërkon veprime ligjore të cilat janë shumë të kufizuara në mundësi zgjedhje duke u ballafaquar me nevojat për banesa të komuniteteve Rom dhe Egjiptiane.

### Opsion 1:

**Programi BSQ: Qeveria lokale ndërton njësi banimi.**

Hipotezat:

- ▶ Ka truall të lirë.
- ▶ Ka vullnet politik dhe mundësi financiare për të ofruar strehim pa pagesë.
- ▶ Risku i diskriminimit pozitiv neglizhohet.

Përfituesit sipas opsionit: 420 familje, vetëm ato që jetojnë në banesa jashtë çdo standarti.

Sipas informacionit nga Bashkia e Shkodrës, ka një zonë e cila ndodhet në verilindje të qytetit, afërsisht 70.000 m<sup>2</sup>, e cila mund të përdoret për ndërtimin e banesave sociale.

### Opsion 2:

**Programi PTI: Qeveria vendore investon në infrastrukturën e truallit në pronat shtetërore.**

Hipotezat:

- ▶ Ka truall/ objekte shtetërore bosh.
- ▶ Ka dëshirë politike dhe mundësi financiare për të siguruar banesa pa pagesë.
- ▶ Rreziku i diskriminimit pozitiv është neglizhuar.

Nuk ka "truall të lirë" në të cilin ekziston vetëm nevoja e investimit në infrastrukturë. Mundësia e vetme për zgjidhje duket se është ajo e shtjelluar në Opsionin 1.

### Opsion 3:

**Programi PTI: Qeveria lokale investon në paisjen me infrastrukturë të vendbanimeve ekzistuese të Romëve dhe Egjiptianëve.**

Hipotezat:

- ▶ Gjasat e përdorimit efektiv të territoreve ekzistuese janë të mëdha.
- ▶ Kushtet inxhinierike dhe të infrastrukturës së territorit ekzistues, e lejojnë.

Përfitues opsional : 98 familje. Ky është numri i familjeve të cilët kanë në pronësi një banesë (23.4 për qind e totalit të familjeve të intervistuar). Pjesa tjetër nuk ka në pronësi një banesë.

Përfituesit opsionale : 420 familje ( njësoj si në opsionin 1)

## 4.3. Kosto e vlerësuar për nderhyrje të ndryshme nga Bashkia

### Opsioni 1:

**Programi BSQ: Qeveria lokale ndërton njësi banimi.**

Disa kriteret merren në konsideratë:

- ▶ Kosto mesatare e njësisë i referohet "**Udhëzimit nr.4 dt 30.4.2015 për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2015.**"
- ▶ Sipas **Entit Kombëtar të Banesave**, kosto mesatare e ndërtimit Shkodër është 32.107 lek/m<sup>2</sup>.
- ▶ Kështu, kosto e vlerësuar për ndërtimet për komunitetin Rom ( 105 apartamente në 6166.3 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi):

$$\text{Kosto e ndërtimit} = 6166.3\text{m}^2 * 32.648\text{lek/m}^2 = 201.317.362,4 \text{ Lek}$$

$$\text{Rrjetet inxhinierike} = 6166.3\text{m}^2 * 3.197\text{lek/m}^2 = 19.713.661,1 \text{ Lek}$$

$$\text{Kosto totale} = 201.317.362,4 \text{ lek} + 19.713.661,1 \text{ lek} = 221.031.023,5 \text{ Lek}$$

Kosto e vlerësuar për ndërtimet për komunitetin Egjiptian (252 apartamente në 13.431 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi):

Kosto e ndërtimit = 13.431m<sup>2</sup> \* 32.648lek/m<sup>2</sup> = 438.495.288,0 Lek

Rrjetet inxhinierike = 13.431m<sup>2</sup> \* 3.197lek/m<sup>2</sup> = 42.938.907,0 Lek

**Kosto totale = 438.495.288 lek + 42.938.907 lek = 481.434.195 Lek**

**Opsioni 1: Kosto Totale për ndërtim të ri = 702.465.219 Lek**

### Opsioni 2:

**Programi PTI: Qeveria lokale investon në paisjen e truallit në pronësi shtetërore, me infrastrukturë.**

Ky opsion nuk është zhvilluar më tej për arsye se nuk ka truall të disponueshem në pronësi shtetërore i cili mund të përdoret për këtë qëllim. Ky program me këto të dhëna, nuk mund të aplikohet.

### Opsioni 3:

**Program PTI: Qeveria lokale investon në paisjen me infrastrukturë të vendbanimeve ekzistuese Rome dhe Egjiptiane.**

Disa kritere duhet të kihen parasysh :

- ▶ Udhëzime nga MZHU të datës 03/08/2015 në lidhje me koston maksimale për rehabilitimin e infrastrukturës ekzistuese.
- ▶ Kosto e rehabilitimit nuk duhet ta tejkalojë shumën 650.000,00 lek/banesë dhe konstruksioni i ri nuk duhet të kalojë shumën 1.200.00,0 lek/banesë (Përfshirë VAT)
- ▶ Vetëm familjet të cilat kanë në pronësi një banesë dhe mesatarja e koston së rehabilitimit/ndërtimit është vlerësuar 925.000,0 lek ((650.000+1.200.00)/2) janë konsideruar.

**Table 13: Permbledhje e rezultateve nga familjet e intervistuar**

Nr. i familjeve që nuk kanë në pronësi një banesë	59
Nr. i familjeve që kanë në pronësi një banesë poshtë sipërfaqës së nevojshme	18
Nr. i familjeve që banojnë jashtë standarteve në fuqi	77
Nr. i familjeve që banojnë në qendra komunitare	0

**Burimi:** Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

Sic mund ta shikojmë edhe nga tabela e mësipërme 13, 18 familje nga 77 (23.4%) nga komunitetet Rome dhe Egjiptiane kanë në pronësi një banesë, e cila është në sipërfaqe më të vogël se ajo e kërkuar nga standartet. Duke u bazuar në kriteret e shpjeguara më sipër, numri i përfituesve të mundshëm është 98 familje (23.4 për qind e 420 familjeve).

**Kosto totale për rehabilitim = 98 familje \* 925.000,0 lek/familje = TOT 90.650.000,0 Lek**

**Opsioni 3: Kosto Totale për rehabilitim = 90.650.000,0 Lek**

Grupi i punës nuk e rekomandon këtë opsion duke qënë se ai nuk e zgjidh këtë problem strehimi, as në minimumin e kërkuar nga standartet e strehimit sipas ligjeve shqiptare.

### Opsioni 4:

**Një përzierje të tre alternativave të mësipërme**

Ky opsion nuk është zhvilluar më tej, pasi sic mund ta shikojmë nga opsionet e mëparshme, i vetmi i cili mund ta zgjidhe në mënyre të përherëshme problemin e strehimit është opsioni nr. 1.



#### 4.4 Plan veprimi për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane

	Objektivat/detyrimet	Afati kohor	Rezultatet/Mjetet e verifikimit
<b>1.</b>	<b>Strategjia e strehimit e Bashkisë Shkodër për Romët dhe Egjiptianët</b>	<b>Qershor 2017</b>	<b>Strategjia e strehimit për Romët dhe Egjiptianët është adaptuar nga Bashkia Shkodër</b>
1.1	Diskutimi dhe aprovimi për raportin e vlerësimit	Dhjetor 2016	Raporti i takimit
1.2	Analizë e thelluar e opsioneve të politikave	Janar 2017	Këshilli Bashkiak është në dijeni të mundësive të politikave
1.3	Ri-vlerësim i nevojave për strehim	Shkurt 2017	Vlerësimi i raportit është bërë nga Ekipi Menaxhues i Bashkisë
1.4	Ri-vlerësim i sigurimit të banesave	Shkurt 2017	Vlerësimi i raportit është bërë nga Ekipi Menaxhues i Bashkisë
1.5	Ri-vlerësim i alternativave politike	Mars 2017	Marrja e vendimit përfundimtar për politiken më të mirë
1.6	Përgatitja dhe përshtatja e Strategjisë	Maj 2017	Strategjia është adaptuar nga Këshilli
1.7	Përgatitja e planit të zbatimit	Qershor 2017	Adaptimi i Planit të Zbatimit
<b>2.</b>	<b>Buxheti për Strategjinë e Strehimit për Romët dhe Egjiptianët</b>	<b>Tetor 2017</b>	<b>Bashkia rrit buxhetin e nevojshëm për të përbashkuar zbatimin e Strategjisë së Strehimit</b>
2.1	Rishikimi i buxhetit lokal	Qershor 2017	Adaptimi i Planit të Zbatimit
2.2	Diskutimi i strategjisë me palët e interesuara dhe donatorët	Qershor 2017	Dëshira e palëve të interesuara për investime, konfirmohet
<b>3.</b>	<b>Rishikimi i legjislacionit</b>	<b>Qershor 2017</b>	<b>Rishikimi dhe adaptimi i legjislacionit</b>
3.1	Propozimi për rishikimin e legjislacionit për Strehimet sociale sipas varianteve të politikave të identifikuar	Qershor 2017	Adaptimi i amendamenteve të legjislacionit
<b>4.</b>	<b>Implementimi i Strategjisë së Strehimit</b>	<b>Dhjetor 2017</b>	<b>Plani i investimit për të zgjidhur strehimin e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane adaptohet nga Këshilli i Ministrave</b>
4.1	Identifikimi i nevojave të ndertimit (analizë e detajuar)	Tetor 2017	Adaptimi i Planit të Investimit
4.2	Zgjidhje e problemeve ligjore brënda zonave të zgjedhura/sygjeruara të ndertimit	Nentor 2017	Të gjitha problemet ligjore janë të zgjidhura
4.3	Studim i zbatueshmërisë për zonat e zgjedhura/sygjeruara të ndertimit	Nentor 2017	Adaptimi i Planit të Investimit
4.4	Finalizimi i planit të investimit	Dhjetor 2017	Projekti i Investimit aprovohet nga ekipi i Menaxhimit të Bashkisë

Burimi: Studimi mbi vendbanimet e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës, 2016

#### 4.5 Përmbledhje e gjetjeve të KAPITULLIT 4

Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në bashkinë Durrës kanë nevojë urgjente të zgjidhet çështja e strehimit të tyre. Megjithatë:

- ▶ Kerkesës së lartë dhe kritike të Komunitetit Rom dhe Egjiptian
- ▶ Mungesa e një plani dhe buxheti nga Bashkia
- ▶ Mungesa e cdo mbështetje të jashtme për sa kohë çështja e strehimit është shqetësuese
- ▶ Pavarësisht faktit se qeveria ka hartuar programe për strehimet sociale, pjesa më e madhe e tyre nuk duken të përshtatshme për të përmbushur nevojat e Romëve dhe Egjiptianëve për shkak të kufizimeve të tyre për sa i përket të ardhurave.
- ▶ Vetëm dy programe të strehimeve sociale mund të konsiderohen, ai i ndertimit të banesave me kosto të ulët dhe programi për paisjen me infrastrukturë, nëse do të konsiderohen disa rishikime ligjore.
- ▶ Duke u bazuar në llogaritjen e kostos, Politikën e Opsionit 1 mund të financohen nga buxheti i Bashkisë, vetëm nëse Bashkia nuk do të përfshihet në asnjë aktivitet tjetër, pasi kosto e politikës së Opsionit 1 është sa 43 për qind e buxhetit total të bashkisë. Bashkia Shkodër ka nevojë për mbështetje financiare, qoftë nga buxheti qëndror apo nga burime të jashtme.
- ▶ Bashkia Shkodër e ka të nevojshme në mënyrë urgjente të zhvillojë një Strategji Strehimi dhe një Plan Veprimi.

## KONKLuzionet finale

- ▶ Në gjetjet e përgjithshme sigurohet qartësi në sfidat të cilat përballen me strehimin social në Bashkinë Shkodër. Analizat tregojnë se struktura ligjore aktuale nuk është e mjaftueshme për të zgjidhur problemin e strehimit për komunitetet Rome dhe Egjiptiane. Gjetjet nga kapitulli 3 dhe 4 sygjerojnë që adresimi i problemit të të pastrehëve Rom dhe Egjiptian në Shkodër duke ndërmarre disa hapa njëkohësisht, për shembull, duke rishikuar strukturën ligjore, zhvendosja e vemendjes së programeve sociale dhe fondeve për më të varfërit e të varfërve, dhe kufizimi i kapaciteteve fiskale të qeverive lokale.
- ▶ Raporti i vlerimit raporton një kontribut të vlefshëm për të përmbushur disa boshllëqe në të dhëna duke rishikuar dhe vlerësuar të dhënat e kushteve ekzistuese (p.sh kushtet e strehimit, furnizimi me ujë, elektricitet dhe shkarkimin e ujërave të ndotura) të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Shkodër.
- ▶ Veç kësaj, raporti siguron një kontribut të vlefshëm në nivel të politikave. Plani i Veprimit i zhvilluar në 4.4 mund të shërbejë si një instrument udhëheqës për MZHU dhe bashkëpunimet e saj me insitucione në nivel shtetëror, qeveritë lokale dhe organizata komunitare në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Shkodër.
- ▶ Megjithatë, studimi është me rëndësi të veçantë për Bashkinë Shkodër. Në nivel të qeverisë lokale, duke vlerësuar investimet të cilat duhet të behen në Bashkinë Shkodër me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, gjetjet dhe sygjerimet nuk do të kontribuojnë në implementimin e Planit të Zbatimit dhe gjithashtu edhe në kapacitetin e forcimit të administratës lokale përballë implementimit të të gjithë strategjisë së strehimeve sociale në nivel lokal.

## BIBLIOGRAFIA

- Dokumenti i Politikës së Përfshirjes Sociale, 2015-2020
- Monitorimi i Raportit nga Shoqëria Civile, Implementimi i Integritit Kombëtar të romëve, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2014-2020
- Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri, 2016-2020; profili socio-demografik dhe ekonomik i Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri duke u bazuar në Censusin 2011, Janar 2015.
- Strategjia dhe Plani i Veprimit Dhjetëvjeçar, 2015-2025
- Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri, CESS, mbështetur nga UNDP, 2012

# SHTOJCË

## Harta e Vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane



